RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

MBI

"AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË"

TIRANË, SHTATOR 2023

PËRMBAJTJA:

NR.	TITULLI	FAQE
I	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**3-11**
1	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3-3
2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3-7
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	8-11
II	**HYRJA**	**11-14**
1	Objektivat e auditimit	11-11
2	Qëllimi i auditimit	11-11
3	Identifikimi i çështjes	12-12
4	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	12-12
5	Përgjegjësitë e audituesve	12-12
6	Kriteret e vlerësimit	13-13
7	Standardet e auditimit	13-14
8	Metodat e auditimit	14-14
9	Dokumentimi i auditimit	14-14
III	**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	**15-185**
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.	15-15
2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.	15-185
2.1	Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të ushtruar në FSDKSH realizimin e plan veprimit, raportimit për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor dhe vlerësimi për statusin e secilit rekomandimi sipas fushave përkatëse.	15-20
2.2	Përputhshmëria me aktet ligjore dhe rregullatore në fuqi e organizimit dhe funksionimit të organeve drejtuese të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe vendimmarrja për çështje kryesore objekt auditimi. (Këshilli Administrativ dhe Drejtori i Përgjithshëm).	20-24
2.3	Auditimi mbi programimin, zbatimin dhe raportimin e buxhetit të sigurimeve shëndetësore për vitin 2022 duke përfshirë, detajimin fillestar, rishpërndarjen buxhetore, nivelet e realizimit të planit, konfirmimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara si dhe financimin e aktiviteteve të rimbursimit të barnave, kontratave koncesionare / PPP dhe paketave.	24-81
2.4	Vlerësimi i përputhshmërisë së aktivitetit të Drejtorisë e Kontrollit, Drejtorisë e Rimbursimit, Drejtorisë e Kujdesit Parësor dhe Spitalor si dhe të Drejtorisë e Shërbimit Spitalor Universitar lidhur me ushtrimin e kontrolleve në subjektet me kontratë me FSDKSH, testimin e rimbursimit të barnave dhe disponibilitetin e tyre në treg, realizimin e shërbimit për kontrata koncesionare dhe paketat e shërbimit shëndetësore, etj.	81-132
2.5	Auditimi i përputhshmërisë së prokurimeve publike për mallra, shërbime dhe punë publike me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi duke përfshirë procesin nga hartimi i nevojave, përcaktimin e fondit limit, studimin e tregut, zgjedhjen e procedurës, zhvillimin e procedurës, deri në marrjen në dorëzimin të kërkesa të prokuruara nëpërmjet zbatimit të kontratës.	132-161
2.6	Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave duke përfshirë efektet e largimeve, rekrutimet dhe transferimet, llogaritjen e përfitimeve dhe çështjeve gjyqësore.	162-174
2.7	Mbi auditimin e brendshëm dhe vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar.	174-185
IV	**GJETJET DHE REKOMANDIMET**	**185-203**
V	**ANEKSE**	**204-219**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit:

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr. 282/1, datë 03.04.2023, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Drejtorinë Qendrore (DQ) të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH). Në përfundim të auditimit, hartoi Projekt Raportin e Auditimit, bazuar në Letrat e punës, Akt Konstatimet, vërejtjet e bëra nga subjekti "Drejtoria Qendrore e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor", sipas drejtimeve të auditimit të përcaktuara në Programin e Auditimit. Projekt Raporti i Auditimit u dërgua në subjekt me shkresën nr. 282/3, datë 01.08.2023, njohja e të cilit është konfirmuar nga subjekti i audituar, me shkresën përcjellëse nr. 1108/19, datë 30.08.2023, protokolluar në KLSH me nr.282/4, datë 04.09.2023 dhe 282/5, datë 07.09.2023. Mbi këtë bazë është hartuar Raporti Përfundimtar i Auditimit.

2. Përmbledhje e gjetjeve kryesore:

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në RPA	Rëndësia	Rekomandimi
1	Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga FSDKSH, në lidhje me financimin e Kontratës së Koncesionit të Kontrollit Mjekësor Bazë (KMB/Check-up) me nr. 3082/20 prot., datë 07.01.2015, të lidhur midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtje Sociale dhe Shoqërisë Koncesionare "3P." SHPK, ka rezultuar se, janë kryer pagesa në shumën 876,082 mijë lekë për 454,828 kontrolle të kryera, nga 876,090 mijë lekë për 475,000 seanca, të planifikuara referuar projeksionit. Vlera e shërbimit për 454,828 rastet e KMB të kryera gjatë vitit 2022, rezulton në shumën 838,885 mijë lekë me TVSH. Edhe në vitin 2022, si në vitet e mëparshme, që prej fillimit të zbatimit të kësaj kontrate, janë likuiduar fatura referuar numrit të projektuar të KMB sipas kontratës dhe jo sipas numrit faktik të kryer, për rrjedhojë është faturuar shërbim i pakryer për 20,172 raste, me një kosto në shumën **37,198 mijë lekë me TVSH.** Gjithashtu, nga analizimi i disa treguesve ka rezultuar se, pavarësisht shtimit të numrit të KMB në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021, sëmundjet kronike janë shtuar me 8,603 raste, vlera e rimbursimit të barnave për shkak të rritjes së sëmundshmërisë dhe kompleksitetit të tyre me 1,184,831 mijë lekë më shumë; rritja e numrit të	Pika 2.3 Faqe 24-81	E lartë	Drejtori i Përgjithshëm i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, si përfaqësues në lidhjen e Kontratës Financiare Koncesionarit, të përgatisë një relacion të detajuar për MSHMS, si autoritet kontraktor që në bashkëpunim me Shoqërinë Koncesionare "3P." SHPK, të rishikojnë kushtet e kontratës, pika 3 "Pagesa dhe mënyra e shlyerjes" me qëllim eliminimin e pagesave për shërbim të pakryer, si rezultat i likuidimit të rasteve të cilat janë nën projeksion vjetor, si dhe të kryhen analiza mbi efektshmërinë e dhënies së këtij shërbimi.

	shtrimeve në spitale me 18,979 raste më shumë, rritja e vizitave ambulatore në Spitalet Universitare dhe Bashkiake me 123,354 raste më shumë etj., **tregojnë se efektet e masës profilaktike "Kontrolli Mjekësor Bazë", nuk janë reflektuar në rezultat konkrete, në uljen e sëmundshmërisë së popullatës, duke cenuar efektshmërinë e përdorimit të këtyre fondeve.**			
2	Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga FSDKSH, në lidhje me financimin e Kontratës Koncesionare nr. 1503/44, datë 10.02.2016 "Për ofrimin e hemodializës" të lidhur midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shoqërisë "DV" SHPK, ka rezultuar se, edhe për vitin 2022, pagesa e koncesionarit nuk kryhet për shërbim të kryer, por për shërbim të faturuar, i cili përfshin likuidimin e rasteve të pakryera ose shprehur ndryshe nën projeksion vjetor, si dhe të rasteve të realizuara mbi projeksion mujor, të secilës Qendër dialize, **në total 8,854 raste, nga të cilat 6,918 raste nën projeksion dhe 1,936 raste mbi projeksion, në shumën 99,191 mijë lekë, që përfaqëson pagesë për shërbim të pa kryer.** Planifikimi i projeksioneve nuk është në përputhje me nevojat reale për kryerjen e shërbimit, mjafton të evidentojmë faktin që rajonet Shkodër dhe Vlorë, që prej fillimit të këtij shërbimi në vitin 2016, paraqiten me realizim nën projeksion dhe rajonet Lezhë, Elbasan dhe Korçë paraqiten me mbi projeksion, gjë që ka sjellë pagesa jo vetëm për nën projeksionin e këtyre qendrave, por dhe pagesa për mbi projeksionin, evitimi i të cilave bëhet nëpërmjet një planifikimi real të numrit sipas qendrave. Për shmangien e pagesave për shërbim të pakryer, KLSH edhe në auditimin e mëparshëm i ka kërkuar FSDKSH dhe MSHMS, të negociojë me koncesionarin. FSDKSH me shkresën nr. 34/53 prot., datë 07.09.2022 "Mbi zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit" i është drejtuar MSHMS, ku kërkohet bashkëpunimi për zbatimin e rekomandimit të lënë nga KLSH, ndërsa MSHMS me nr. 307/9 prot., datë 17.10.2022, ka nxjerrë Urdhrin	Pika 2.3 Faqe 24-81	E lartë	Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të ndjekë zbatimin e Urdhrit nr.584, datë 17.10.2022 "Për ngritjen e grupit të punës për negocimin e kontratës koncesionare nr.1503/44, datë 10.02.2016 "Për shërbimin e hemodializës në pesë qendra pranë Spitaleve Rajonale të Vlorës, Shkodrës, Elbasanit, Korçës dhe Lezhës", mbi kryerjen e negociatave me shoqërinë koncesionare "DV" SHPK, për: Rishikimin e projeksionit sipas rajoneve në bazë të historikut që disponon MSHMS dhe FSDKSH; Rishikimin e kushteve të kontratës në lidhje me pagesat që në vijim të kryhen sipas parimit (Pay x Use), me qëllim **eliminimin e pagesave për shërbim të pakryer, të cilat në vitin 2022 rezultojnë në shumën 99,191 mijë lekë**.

	nr.584, datë 17.10.2022 "Për ngritjen e grupit të punës për negocimin e kontratës koncesionare "Për shërbimin e hemodializës". Pavarësisht këtyre masave formale, nga MSHMS nuk janë ndërmarrë hapa konkretë e për rrjedhojë dhe në vitin 2022 vazhdon e njëjta situatë.			
3	Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga FSDKSH, në lidhje me financimin e Kontratës Koncesionit nr.1440/33, datë 10.12.2015 "PPP-Sterilizimi i pajisjeve mjekësore", të lidhur midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shoqërisë Koncesionare "S." SHPK, ka rezultuar se, për ndërhyrjet kirurgjikale të kryera gjatë vitit 2022, në tre llojet e spitaleve, universitare, rajonale dhe bashkiake, ka përdorim të seteve të ndryshme për të njëjtën tipologji kirurgjikale, në 15,339 raste në Spitalet Universitare; në 8,708 raste në Spitalet Rajonale dhe në 55 raste në Spitalet Bashkiake. Niveli i lartë i deviacioneve, ku për të njëjtën tipologji kirurgjikale përdoren nivele të ndryshme të kompleksitetit të seteve, ku në spitalet universitare arrin deri në 52 % të rasteve, në spitalet rajonale deri në 48.5 % të rasteve, kundrejt totalit të ndërhyrjeve, reflekton mangësitë në përfshirjen e kirurgjive sipas tipologjisë, referuar nivelit të seteve, por dhe të përmbajtjes me instrumente mjekësorë të seteve referuar nivelit të kompleksitetit, gjë e cila është e shoqëruar edhe me rritjen e kostove të këtij shërbimi dhe për rrjedhojë të mbështetjes buxhetore për vazhdimësinë. Ri konfigurimi i tyre edhe pas ndryshimeve në vitin 2020, referuar aneksit nr. 4 të kontratës nr. 1440/40, datë 10.12.2015, dhe shkresës nr. 28/20, datë 04.12.2020 të koncesionarit, protokolluar në MSHMS me nr. 150/21, datë 07.12.2020 me objekt "Konfigurim i seteve 30.11.2020", ka paraqitur mangësi dhe nuk ka minimizuar problematikën e evidentuar edhe në auditimin e mëparshëm të kryer nga KLSH.	Pika 2.3 Faqe 24-81	E lartë	Drejtori i Përgjithshëm i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor të përgatisë një relacion të detajuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si autoritet kontraktor, me qëllim marrjen e masave, që në bashkëpunim me Shoqërinë Koncesionare "S" SHPK, të bëjnë të mundur rishikimin e Kontratës "Mbi Konfigurimin e seteve, datë 30.11.2020, si dhe Aneksit nr. 4, në lidhje me ri konfigurimin e seteve kirurgjikale në dy drejtime: - përfshirjen e kirurgjive sipas tipologjisë, referuar nivelit të seteve; - numrin dhe llojin e instrumenteve dhe pajisjeve mjekësore që duhet të përmbajë një set, duke rritur gamën e tyre me qëllim minimizimin e kostove të këtij shërbimi, duke marrë në konsideratë nivelin e lartë të deviacioneve, për të gjitha rastet e përdorimit të një seti kirurgjikal të nivelit të mesëm, kur mund të përdorim kompleksitetin e ulët dhe të përdorimit të një seti të kompleksitetit të lartë kur mund të përdorim kompleksitet të mesëm ose të ulët, për shkak të mungesës së një ose disa instrumenteve në këto kompleksitete.
4	Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga FSDKSH, në lidhje me financimin e kontratës koncesionit/PPP nr. 1924/2 prot., datë 10.04.2019 "Shërbimi laboratorik" të lidhur midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (kontraktues) dhe aksionerëve të koncesionarit "L",	Pika 2.3 Faqe 24-81	E lartë	Fondi i Sigurimit të Detyruar të Kujdesit Shëndetësor dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si kontraktor, duhet të kryejnë analiza të thelluara në lidhje me ecurinë dhe cilësinë e dhënies së këtij shërbimi, si dhe shpenzimeve në

	"E" dhe "A", është evidentuar se dhënia e këtij shërbimi është i kufizuar, nga kushtet e kontratës nr. 1924/2, datë 10.04.2019, pika 22.4 "Tavanet e buxhetit", sipas të cilit koncesionari nuk mund të tejkalojë fondin e miratuar për spitalet në zërin "Laboratorët", për rrjedhojë rastet shtesë duhet të transferohen në një listë pritje me përparësi, duke filluar nga periudha tjetër buxhetore e spitalit referues. **Përcaktimi i tavaneve vjetore buxhetore, kufizon kryerjen e analizave laboratorike për secilin spital, të sanksionuar në kontratën koncesionare të laboratorëve, duke rrezikuar ofrimin e analizave laboratorike, në masën e duhur, sipas nevojave spitalore dhe duke sjellë për pasojë drejtimin e pacientëve në marrjen e këtij shërbimi tek subjektet private, me kosto për qytetarët, si dhe përkeqësim të shëndetit nga moskryerja në kohë e analizave përkatëse.**			rritje të tij, me qëllim rritjen e efektivitetin e përdorimit të fondeve buxhetore.
5	Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga FSDKSH, në lidhje me financimin e kontratave PPP, ka rezultuar se për tre kontrata vlera e financimit vjetor, si dhe parashikimet e financimit të tyre në PBA 2022-2024, janë përtej mbështetjes buxhetore të parashikuar për zbatimin e tyre.	Pika 2.3 Faqe 24-81	E lartë	Drejtori i Përgjithshëm i FSDKSH në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrin masa të menjëhershme për monitorimin e këtyre kontratave, me qëllim ndjekjen dhe disiplinimin e shpenzimeve, përdorimin me efektivitet të fondeve, të cilat rezultojnë me tendencë në rritje nga viti në vit, jo vetëm si rezultat i rritjes së rasteve, por dhe si rezultat i rritjes së kostove të shërbimit për pacient, duke tejkaluar mbështetjen buxhetore të parashikuar në kontratat koncesionare. Gjithashtu nga FSDKSSH dhe MSHMS, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të merren masa për sigurimin e mbështetjes buxhetore për financimin e këtyre shërbimeve jetike për popullatën, në masën e duhur dhe në vijimësi.
6	Nga auditimi mbi procesin e rekrutimeve për vitin 2022, rezulton se në Rregulloren nr. 2, datë 06.07.2020 "Për Organizimin, Funksionimin dhe Përshkrimin e Punës së Fondit, për 34 poste pune, nuk është përcaktuar specialiteti i kërkuar dhe niveli i diplomës, referuar pozicionit të punës,	Pika 2.6 Faqe 166-178	E mesme	Drejtori i Përgjithshëm i FSDKSH-së, të marrë masa për rishikim dhe plotësimin e mangësive të evidentuara në rregulloret e cilësuara më lart, me qëllim parashikimin e kohëzgjatjes së komandimit të përkohshëm për punonjësit brenda

	por është vendosur si kriter "Arsim i Lartë", ose "Arsim i Lartë/Shkenca Shoqërore/Natyrore" pa përcaktuar se çfarë profesioni duhet të kenë punonjësit, duke lënë hapësirë për rekrutimin e punonjësve me specialitete jo të përshtatshme, për aktivitetin që kryen Fondi, si dhe për pjesën e komandimeve konstatohet se në Rregulloren nr. 1, datë 06.07.2020 "Për funksionimin e FSDKSH", Kreun 5 "Rregullorja e burimeve njerëzore", pika I/2.2 "Komandimi i përkohshëm në detyrë", nuk parashikohet kohëzgjatja e komandimit të përkohshëm për punonjësit brenda institucionit, por vetëm për punonjësit jashtë institucionit.			institucionit dhe përcaktimin e nivelit të arsimit të kërkuar dhe specialitetit për çdo pozicion pune.

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit

Konkluzion i përgjithshëm:
Në përfundim të auditimit bazuar në ISSAI/IFPP 400 "Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë", standardet e auditimit të përputhshmërisë, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë si dhe në kuadrin ligjor mbi të cilin ka ushtruar veprimtarinë DP e FSDKSH, për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2022 deri në 31.12.2022, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 282/1, datë 03.04.2023, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Grupi i auditimit ka arritur në konkluzionin se, në përgjithësi subjekti i audituar ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit me përjashtim të disa raseve të cilat janë vlerësuar materiale, por jo të përhapura dhe që janë përshkruar në bazën për opinionin e modifikuar me rezervë. Mangësitë e konstuara janë evidentuar në: Drejtorinë e Kujdesit Parësor dhe Spitalor; menaxhimin e burimeve njerëzore dhe procedurat e prokurimeve publike. Përsa i përket përputhshmërisë në menaxhimin financiar dhe kontrollin; planifikimin dhe realizimin e buxhetit të FSDKSH dhe financimin e paketave shndetësore; zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, ligjshmërinë e vendimeve të Këshillit Administrativ dhe të Drejtorit të Përgjithshëm, subjekti i audituar përgjithësisht ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit. Përsa ju përket financimit të kontratave PPP, pavarësisht se nga FSDKSH janë respektuar tavanet buxhetore, likuidimi i shpenzimeve ka vijuar të kryhet edhe për shërbime të pakryera, konkretisht për PPP "Kontrolli Mjekësor Bazë" dhe PPP "Shërbimi i Hemodializës", pasi pagesat kanë vijuar të kryhen kundrejt numrit të shërbimeve të projektuara, refreruar kushteve të përcaktuara në kontratat përkatëse. Për PPP "Sterilizimi i pajisjeve dhe instrumenteve mjekësore" dhe PPP "Laboratorë", është evidentuar se vendosja e tavaneve buxhetore, kufizon dhënien e këtij shërbimi sipas nevojave të pacientëve, si dhe trendi i këtyre shpenzimeve është në rritje nga vitit në vit, ç'ka tregon se në vijimësi kërkohen më tepër angazhim fondesh buxhetore për financimin e tyre, deri në përfundim të kontratave.

Opinioni i auditimit:

I. <u>Opinion mbi auditimin e përputhshmërisë:</u>
Ne kemi audituar zbatueshmërinë e akteve ligjore dhe nën ligjore, gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të FSDKSH, në lidhje me planifikimin dhe zbatimin e buxhetit të sigurimeve shëndetësore, të ardhurat nga kontributet dhe

financimin nga buxheti i shtetit për vitin 2022, si dhe realizimin e shpenzimeve me ekonomicitet dhe efektivitet; veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit Parësor dhe Spitalor; menaxhimin dhe administrimin e burimeve njerëzore; menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm, si dhe procedurat e prokurimit publik.

Opinion i modifikuar, i kualifikuar.
Sipas opinionit tonë, përveç rasteve të cilësuara në paragrafin e "Baza për opinionin me rezervë" subjekti i audituar, Drejtoria e Përgjithshme e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, përgjithësisht ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit të nxjerra nga aktet ligjore dhe nënligjore, mbi të cilën ka ushtruar veprimtarinë e tij, si: Ligji nr. 10383 datë 24.02.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë"; Ligji nr. 115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022"; VKM nr. 124, datë 05.03.2014, "Për miratimin e statutit të FSDKSH", i ndryshuar; Rregulloren nr. 1, "Për funksionimin e FSDKSH-së", miratuar me Urdhrin nr. 277 datë 06.07.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm; Rregullore nr. 2 "Mbi organizimin, funksionimin dhe përshkrimet e punës së Drejtorisë së Përgjithshme të FSDKSH, miratuar me Urdhrin nr. 277 datë 06.07.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm, etj..

Baza për opinionin e modifikuar kualifikuar:
Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për përputhshmërinë.
Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme, e plotë, e saktë dhe e përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, Drejtoria e Përgjithshme (DP) e FSDKSH në përgjithësi kanë vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit. Mangësitë e evidentuara në disa çështje të audituara sipas përshkrimit të mëposhtëm, **nuk janë të përhapura, por janë materiale** dhe për këtë arsye kemi dhënë opinion të modifikuar të kualifikuar.

Përshkrimi i çështjeve:
1. Nga verifikimi i Disponibilitetit të barnave në treg, alternativë e parë dhe e vetme, rezultoi mungesë e tyre e reflektuar kjo në uljen e ndjeshme të recetave. **Kjo tregon që mungesa e disponibilitetit të këtyre barnave ka ndikuar tek një numër i konsiderueshëm pacientësh.**
2. Nga verifikimi i disponibilitetit të barnave alternativë e parë dhe e vetme në treg rezultoi se në vitin 2022, në mungesën e barnave kanë ndikuar dhe dy raste të pezullimeve të kontratave me importuesit farmaceutikë bazuar në vendimet gjyqësore. **Në lidhje me pezullimet e kontratave, nga Fondi nuk janë marrë masa për të ndaluar mungesën e disponibilitetit të barnave, alternativë e parë dhe e vetme e LBR.**
3. Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit në FSDKSH, janë konstatuar mangësi në mënyrën e përzgjedhjes së subjekteve për ushtrim të kontrollit. Kjo si rrjedhojë e mos përcaktimit të procedurave dhe hapave që duhet të ndiqen për mbledhjen e të dhënave dhe informacionit; përcaktimin e kritereve të riskut; afateve në zbatimin e procedurave të kontrollit, të cilat në disa raste, nuk janë të përcaktuara në Rregulloren nr. 3, miratuar me Vendimin e Këshillit Administrativ nr. 101, datë 22.10.2014 "Për procedurën dhe mënyrën e kontrollit të dhënësve të shërbimit të kontraktuara me Fondin". **Mos përcaktimi i kritereve të qarta të përzgjedhjes së subjekteve depo farmaceutike për kontroll, bazuar**

në një analizë risku, krijon premisa për favorizim dhe shmangie të kontrolleve ndaj tyre.

4. Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit përkatës të vënë në dispozicion mbi vendimet gjyqësore për të larguarit nga puna rezulton se, në fund të vitit 2022, janë në proces gjyqësor 4 çështje me objekt "Dëmshpërblim page". **Sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme e FSDKSH, janë kryer pagesa në shumën 2,361,187 lekë, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për largimet e padrejta nga puna**. Gjithashtu, rezulton se gjatë vitit 2022, në 1 rast pagesa për vendimin gjyqësor nuk është bërë në mënyrë vullnetare, por është pritur urdhri i shërbimit përmbarimor, duke rënduar më tej buxhetin me shpenzime përmbarimore në vlerën **145,479 lekë, shpenzime të cilat përbëjnë efekt financiar negativ për buxhetin e institucionit.** Nga auditimi nuk rezulton të jenë nxjerrë përgjegjësi apo të jenë marrë masa administrative në lidhje me vendimet gjyqësore për largimet nga puna, veprime jo në përputhje me pikën 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit.

5. Nga auditimi mbi saktësinë e raportimit të planit dhe faktit të të ardhurave dhe shpenzimeve të FSDKSH, ka rezultuar se ka mospërputhje midis të dhënave të rakorduara dhe raportuara nga FSDKSH dhe të dhënave të raportuara nga MFE, referuar Tabelës së Treguesve Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, Kapitulli II.3 "Të ardhurat nga fondet speciale", në lidhje me faktin e të ardhurave të realizuara nga derdhja e kontributeve dhe të tjera. Sipas të dhënave, fakti i të ardhurave nga fondet speciale (sigurimet shëndetësore) nga MFE paraqitet në vlerën 16,266 milionë lekë, ndërsa nga FSDKSH, janë deklaruar 16,164 milionë lekë, me një diferencë në **shumën 102 milionë lekë, të deklaruara më shumë nga MFE.**

6. Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm, ka rezultuar se, disa rekomandime kërkojnë miratim në Këshillin Administrativ të FSDKSH. Për këtë arsye pavarësisht se nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme janë marrë masa për realizimin e tyre, këto rekomandime rezultojnë në proces, për shkak të mosveprimit nga ana e Këshillit Administrativ.

Çështje të tjera:

Nga auditimi i zbatimit të kontratave koncesionare, të lidhura midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) dhe Shoqërive Koncesionare ka rezultuar si më poshtë:

- Sipas të dhënave të vendosura në dispozicion në lidhje me financimin e Kontratës së Koncesionit të Kontrollit Mjekësor Bazë (Check-up), nr. 3082/20, datë 07.01.2015, të lidhur midis MSHMS dhe Shoqërisë Koncesionare "3P." SHPK, ka rezultuar se edhe në vitin 2022, janë kryer **pagesa për shërbim të pakryer** për 20,172 raste, me një kosto në shumën 31,004 mijë lekë pa TVSH dhe **37,198 mijë lekë me TVSH.**
- Nga auditimi mbi zbatimin e Kontratës Koncesionare nr. 1503/44, datë 10.02.2016 "Për ofrimin e hemodializës", të lidhur midis MSHMS dhe Shoqërisë "DV" SHPK, ka rezultuar se edhe për vitin 2022, pagesa e koncesionarit nuk kryhet për shërbim të kryer, por për shërbim të faturuar, i cili përfshin likuidimin e rasteve të pakryera ose shprehur ndryshe nën projeksion vjetor, si dhe të rasteve të realizuara mbi projeksion mujor, të secilës qendër dialize, **në total 8,854 raste, nga të cilat 6,918 raste nën projeksion dhe 1,936 raste mbi projeksion, në shumën 99,191 mijë lekë, që përfaqëson pagesë për shërbim të pa kryer.**
- Nga auditimi i shpenzimeve të kryera për financimin e Kontratës Koncesionit nr.1440/33, datë 10.12.2015 "PPP-Sterilizimi i pajisjeve mjekësore", të lidhur midis MSHMS Shoqërisë Koncesionare "S." SHPK, sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga FSDKSH, për ndërhyrjet kirurgjikale të kryera gjatë vitit 2022, në tre llojet e spitaleve, universitare, rajonale dhe bashkiake, ka rezultuar se ka përdorim të seteve të

ndryshme për të njëjtën tipologji kirurgjikale, në 15,339 raste në Spitalet Universitare; në 8,708 raste në Spitalet Rajonale dhe në 55 raste në Spitalet Bashkiake. Niveli i lartë i deviacioneve, ku për të njëjtën tipologji kirurgjikale përdoren nivele të ndryshme të kompleksitetit të seteve, ku në spitalet universitare arrin deri në 52 % të rasteve, në spitalet rajonale deri në 48.5 % të rasteve, kundrejt totalit të ndërhyrjeve, **reflekton mangësitë në përfshirjen e kirurgjive sipas tipologjisë, referuar nivelit të seteve, por dhe të përmbajtjes me instrumente mjekësorë të seteve referuar nivelit të kompleksitetit**, **gjë e cila shoqërohet me rritje të shpenzimeve referuar çmimeve sipas kompleksitetit të seteve.** Ri konfigurimi i tyre në vitin 2020, nuk ka minimizuar problematikën e evidentuar edhe në auditimin e mëparshëm të kryer nga KLSH.

- Nga auditimi i Kontratës koncesionare/PPP "Shërbimi laboratorik" ofrimi i këtij shërbimi është i kufizuar, nga kushtet e kontratës nr. 1924/2, datë 10.04.2019, pika 22.4 "Tavanet e buxhetit". **Kufizimet buxhetore për financimin e shërbimit të analizave laboratorike janë të lidhura me tavanin buxhetor të secilit spital, të sanksionuar në kontratën koncesionare të laboratorëve, duke rrezikuar ofrimin e analizave laboratorike, në masën e duhur, sipas nevojave spitalore dhe duke sjellë për pasojë drejtimin e pacientëve në marrjen e këtij shërbimi tek subjektet private, me kosto për qytetarët, si dhe përkeqësim të shëndetit nga moskryerja në kohë e analizave përkatëse.**
- Nga auditimi i financimit të kontratave koncesionare në vitin 2022, ka rezultuar që ecuria e shpenzimeve të kryera për këto kontrata, si dhe tendenca në rritje, e cila reflektohet edhe në PBA 2022-2024, tregon se deri në përfundimin e tyre, kërkon fonde për mbështetje buxhetore përtej parashikimeve në kontratat respektive të PPP-Dializa, PPP-Sterilizimi dhe PPP-Laboratorë.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të FSDKSH:

Strukturat drejtuese të FSDKSH, janë përgjegjëse për hartimin e politikave në fushën e sigurimeve shëndetësore, realizimin e të ardhurave nga kontributet, si dhe mbulimin e popullsisë me elementë të sigurimeve shëndetësore, përdorimin me efektivitet, eficencë dhe ekonomicitet të fondeve publike, në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit).

Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullator në fushën e mbulimit të popullatës me kujdes shëndetësor, menaxhimin e të ardhurave të Fondit. Gjithashtu, strukturat drejtuese të FSDKSH janë përgjegjëse për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, hartimin e procedurave, aktiviteteve të kontrollit, gjurmës së auditimit për të aktivitet kryesore të saj.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi, që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatueshmërinë e kritereve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim, që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 282/1, datë 03.04.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 03.04.2023 deri në datë 14.07.2023 në subjektin Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH), për periudhën e veprimtarisë së subjektit nga data 01.01.2022 deri në 31.12.2022, u krye auditimi "Mbi përputhshmërinë", nga grupi i auditimit me përbërje:

1. B.Z., Përgjegjës Grupi
2. T.A., Auditues i I-rë
3. B.P., Auditues i I-rë
4. M.V., Audituese e I-rë
5. K.N., Audituese e II-të

Objektivat, fushëveprimi dhe metodologjia:

1. Objektivat e auditimit.

Objekt i këtij auditimit është auditimi i përputhshmërisë, ku do të përcaktohet niveli i zbatimit të kritereve të vlerësimit referuar kuadrit ligjor në fuqi si, Ligji 10383, datë 24.02.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në RSH", me ndryshime, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të cilat rregullojnë fushën e sigurimeve shëndetësore në RSH.

2. Qëllimi i auditimit:

- Dhënien e një vlerësimi objektiv e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kritereve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.
- Aspektet e përputhshmërisë (respektimi i kritereve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe korrektësisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë veprimtarinë dhe sjelljen e zyrtarëve publik), referuar ISSAI/IFPP 4900 të INTOSAI-t.
- Promovimin e qeverisjes së mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikohen personat përgjegjës për veprimet e tyre.
- Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve, nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik.

3. Identifikimi i çështjes.

Referuar analizës së riskut, në fazën e planifikimit dhe auditimit në terren, u identifikuan fushat me risk më të lartë. Gjithashtu, sigurojmë që vlerësimi fillestar i riskut në fazën e planifikimit si dhe ai i aplikuar gjatë fazës së auditimit në terren, vijon të mbetet i vlefshëm.

Sa më sipër, fushat me risk më të lartë u përcaktuan si drejtimet e auditimit të miratuara me Programin e Auditimit nr. 282/1 prot., datë 03.04.2023 dhe të trajtuara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

- Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm;

- Përputhshmëria me aktet ligjore dhe rregullatore në fuqi e organizimit dhe funksionimit të organeve drejtuese të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;
- Auditimi mbi programimin, zbatimin dhe raportimin e buxhetit të sigurimeve shëndetësore për vitin 2022 si dhe financimin e aktiviteteve të rimbursimit të barnave, kontratave koncesionare/PPP dhe paketave shëndetësore.
- Vlerësimi i përputhshmërisë së aktivitetit të Drejtorisë e Kontrollit, Drejtorisë e Rimbursimit, Drejtorisë e Kujdesit Parësor dhe Spitalor;
- Auditimi i përputhshmërisë së prokurimeve publike;
- Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave duke përfshirë efektet e largimeve, rekrutimet dhe transferimet, llogaritjen e përfitimeve dhe çështjeve gjyqësore.
- Mbi auditimin e brendshëm dhe vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Strukturat drejtuese të FSDKSH, janë përgjegjëse për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, për përdorimin e burimeve financiare me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet, në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), për fushat e veprimtarisë së FSDKSH në drejtim të mirë administrimit të fondeve buxhetore të përdorura për financimin e shërbimeve shëndetësore.

5. Përgjegjësitë e audituesve.

- Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.
- Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.
- Audituesit në të gjithë llojet e auditimit, kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik", paragrafi 44-51.

6. Kriteret e vlerësimit.

- Ligji nr. 10383 datë 24.02.2011 “Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar;
- Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;
- Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, etj.
- VKM nr. 124, datë. 5.3.2014, “Për Miratimin e Statutit të FSDKSH”, i ndryshuar;

- VKM nr. 308, datë 21.5.2014 “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në shërbimin spitalor”, i ndryshuar;
- VKM nr. 101, datë 04.02.2015 “Për miratimin e paketës së shërbimeve shëndetësore, në kujdesin shëndetësor parësor publik, që financohet nga fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor”;
- VKM nr. 489, datë 30.07.2021 “Për miratimin e listës së barnave që rimbursohen nga FSDKSH-ja dhe të masës së mbulimit të çmimit të tyre”;
- VKM nr. 230, datë 13.04.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr.489, datë 30.07.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së barnave që rimbursohen nga fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor dhe masën e mbulimit të çmimit të tyre”;
- VKM nr. 61, datë 03.02.2017 “Për miratimin e paketave të pajisjeve mjekësore të rimbursueshme”, ndryshuar;
- VKM nr. 229, datë 13.04.2022 “Për një ndryshim në VKM nr. 61, datë 03.02.2017 “Për miratimin e paketave të pajisjeve mjekësore të rimbursueshme”;
- VKM nr. 43/2022 datë 19.01. 2022 “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2022”;
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik";
- Udhëzimet standarde të MFE për procedurat planifikimit, monitorimit, zbatimit dhe mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2022”;
- Rregullore nr. 3, datë 22.10.2014 “Për procedurën dhe mënyrën e kontrollit të dhënësve të shërbimit të kontraktuara me Fondin”;
- Rregullore nr. 1, “Për funksionimin e FSDKSH-së”, miratuar me Urdhrin nr. 277 datë 06.07.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm;
- Rregullore nr. 2 “Mbi organizimin, funksionimin dhe përshkrimet e punës së DP të FSDKSH, miratuar me Urdhrin nr. 277 datë 06.07.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm, etj.

7. Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës. Auditimi është kryer, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), përkatësisht në: Nivelin e parë “Parimet INTOSAI-t” ku përfshihet: ISSAI-P-1 “Deklarata e Limës”, ISSAI-P-10 “Deklarata e Meksikos”; Nivelin e dytë “Standardet e INTOSAI-t” ku përfshihen: ISSAI 100 - Parimet bazë në auditimin e sektorit publik, ISSAI 400-499 “Parimet bazë të auditimit të përputhshmërisë”.
Gjithashtu janë zbatuar dhe aplikuar standardet si më poshtë:
- ISSAI-140 “Sigurimin e cilësisë”
- ISSA 130 “Kodin Etik”
- ISSAI 2315 “Risku”
- ISSAI 2320-2450 “Materialiteti”
- ISSAI 2500 “Dokumentimi”

8. Metodat e auditimit.
Përzgjedhja e metodave të përdorura, u mbështetet ne vlerësimin e riskut, materialitetit, kostos dhe efiçencës së auditimit, duke patur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit. Përsa i përket funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, zbatueshmërisë nga ana e subjektit të audituar të MFK-së, Grupi i auditimit ka kryer intervista verbale dhe teste kontrolli. Nga vlerësimi i riskut në fazën e planifikimit dhe në fazën e auditimit në terren, ka rezultuar se sistemi i kontrollit të brendshëm, ka funksionuar në mënyrën e duhur, si dhe është

konsideruar me risk të ulët, për këtë arsye për dhënien e një vlerësimi sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë për zbatimin e ligjshmërisë dhe korrektësisë (në auditimin e përputhshmërisë) nga ana e subjektit të audituar, janë aplikuar:

- Verifikimi i transaksioneve, është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre;
- Intervistimi, është përdorur intervistimi verbal i marrjes së informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet;
- Raporte dhe informacione, janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe problemet që lidhen me të;
- Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm - audituesi ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

9. Dokumentimi i auditimit, është mbështetur në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 245, datë 29.12.2022, Manualin mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 23.06.2020, si edhe në Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 107, datë 08.08.2017, me ndryshime, Grupi i auditimit ka dokumentuar punën audituese në të gjitha fazat e ezauruara (planifikim dhe auditim në terren). Nga Grupi i auditimit janë plotësuar të gjitha dokumentet standarde të auditimit, si dhe është dokumentuar gjurma e auditimit për të gjitha procedurat e kryera nga Grupi i auditimit.

III. PËSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

FSDKSH ushtron veprimtarinë, në bazë të Ligjit nr. 10383, datë 24.02.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar. Fondi organizohet dhe funksionon në bazë të statutit të Fondit, i cili është miratuar me VKM nr. 124, datë 05.03.2014 "Për miratimin e statusit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Fondi drejtohet nga Këshilli Administrativ dhe Drejtori i Përgjithshëm. Këshilli Administrativ përbëhet nga 7 anëtarë, të cilët përfaqësojnë palët e interesuara në zhvillimin e skemës. Këshilli zgjedh Drejtorin e Përgjithshëm, me votim të fshehtë, me 2/3 e votave të gjithë anëtarëve të Këshillit Administrativ.
Modeli i skemës së sigurimeve shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, është një model mix (Bismark dhe Beveridge), i cili bazohet në kontributet e detyrueshme dhe ato vullnetare, si dhe në financimin nga buxheti i shtetit. Nga skema e sigurimeve përfiton çdo shtetas që paguan kontribut për sigurim shëndetësor ose për të cilin paguan shteti, është i siguruar dhe përfiton nga skema e sigurimeve shëndetësore.
Sigurimi i detyrueshëm i kujdesit shëndetësor financon paketat e shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm, ku përfshihen: Vizitat, ekzaminimet dhe trajtimet mjekësore në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor publik dhe në spitalet publike; vizitat, ekzaminimet dhe trajtimet mjekësore në dhënës privat të kujdesit parësor dhe spitale private; barnat, produktet dhe trajtimet mjekësore nga dhënës të kontraktuar shërbimesh shëndetësore.

2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

2.1. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën shkresën nr.18/10 prot., datë 28.07.2022 për Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi auditimin e përputhshmërisë" të ushtruar në FSDKSH sipas programit të auditimit nr.18/1 prot., datë 14.01.2022, për veprimtarinë nga data 01.01.2021 deri më datën 31.12.2021, në lidhje mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre, si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.
Nga grupi i auditimit u krye verifikimi mbi statusin e rekomandimeve në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, dërguar me shkresën nr.18/10 prot., datë 28.07.2022 dhe administruar në FSDKSH me nr.34/48 prot., datë 01.08.2022, ku është kërkuar zbatimi i rekomandimeve për 31 (tridhjetenjë) "Masa Organizative", 2 (dy) "Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike", si dhe i është rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH, fillimi i procedurave për shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore nga "Vërejtje" deri në "Largim nga Puna" për punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas sistemeve apo fushave të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit mbështetur në Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.
FSDKSH me shkresën nr.34/51 prot., datë 18.08.2022 me lëndë "Shkresë Përcjellëse" ka dërguar pranë KLSH, Urdhrin me nr.259, datë 18.08.2022 të Drejtorit Përgjithshëm të Fondit ku është paraqitur plani veprimi me të cilin ngarkon strukturat përgjegjëse të varësisë të marrin masa mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH. Plani veprimit është paraqitur **brenda afatit 20 ditë,** në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 15, shkronja (j) të Ligjit nr.154 datë 27.1.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".
FSDKSH me shkresën nr.712 prot., datë 17.02.2023 me lëndë "Mbi progresin e zbatimit rekomandimeve" ka dërguar pranë KLSH, informacion mbi zbatimin e rekomandimeve **brenda afatit 6 mujor,** në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 30, pika 2 e Ligjit nr.154 datë 27.1.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".
Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se janë lënë 31 "Masa Organizative", 2 "Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me 3-E, të fondeve publike, 1 masë "Shpërblim dëmi" si dhe "Masa disiplinore" ku i kërkohet Drejtorit të Përgjithshëm për fillimin e dhënies së masave disiplinore nga "Vërejtje" deri në "Largim nga puna" për punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.
Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të 34 rekomandimeve është si më poshtë:
Rekomanduar 31 masa organizative, pranuar 31 masa organizative, nga të cilat 26 masa organizative rezultojnë të zbatuara plotësisht; 1 masa organizative rezultojnë të zbatuara pjesërisht (Rekomanimi nr. 2.1) dhe 5 masa organizative rezultojnë në proces zbatimi (Rekomanimi nr. 3.1; 4.1; 9.1; 18.1 dhe 21.2);
Rekomanduar 2 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike, nga të cilat janë pranuar të 2 masa dhe rezultojnë 1 zbatuar plotësisht dhe 1 në proces zbatimi.
Është rekomanduar 1 masë shpërblim dëmi, e cila rezulton e pazbatuar.

Masa disiplinore janë lënë në kompetencë të titullarit, për fillimin e dhënies së tyre nga "Vërejtje" deri në "Largim nga puna" për punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas

çështjeve të trajtuara në RPA, e cila është pranuar, **por rezulton se nuk është dhënë asnjë masë nga titullari.**

Në mënyrë të detajuar rekomandimet e zbatuara pjesërisht dhe në proces zbatimi, paraqitet si më poshtë:

B. Masa organizative:

2.1. Rekomandimi: Këshilli Administrativ, nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masa për propozimin e ndryshimeve përkatëse ligjore të nenit 16 të ligjit nr.10383, datë 24.02.2011 mbi përbërjen e Këshillit Administrativ, si dhe të ushtrojë kompetencat e tij për zgjedhjen dhe emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm.
Nga auditimi ka rezultuar: FSDKSH dhe MSHMS ka vepruar në linjë me rekomandimin e KLSH mbi plotësimin e vendit vakant të anëtarit të KA kjo nëpërmjet shkresave me nr.5443 prot., datë 06.09.2022, me lëndë "Mbi zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit" drejtuar MSHMS, ku kërkohet bashkëpunimi për zbatimin e këtij rekomandimi nga ana e FSDKSH dhe shkresa me nr.3490/1 prot., datë 03/10/2022 me lëndë "Kthim Përgjigje" administruar në Fond me nr.5443/1 prot., datë 04.10.2022 ku ndër të tjera bëhet me dije plotësimi i vendit vakant të anëtarit të Këshillit Administrativ me zonjën M. Sh., por ende nuk ka kryer emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH.
Statusi: Rekomandimi konsiderohet i **zbatuar pjesërisht**, pasi nuk është vepruar nga ana e Këshillit Administrativ për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm.

3.1. Rekomandimi: Këshilli Administrativ, në bashkëpunim me Drejtorin Përgjithshëm të hartojë dhe të miratojë një procedurë administrative të mirë përcaktuar për përzgjedhjen dhe nominimin e anëtarëve të komisioneve teknike, si për anëtarët e Fondit ashtu dhe për ata të jashtëm, bazuar në pozicionet e punës apo grupin e interesit që përfaqësohet.
Nga auditimi ka rezultuar: FSDKSH ka vepruar ne linjë me rekomandimin e KLSH duke nxjerrë Urdhrin e Drejtorit Përgjithshëm të FSDKSH me nr.290, datë 09.09.2022 dhe nr.5571 prot., datë 09.09.2022 me lëndë: Për ngritjen e grupit të punës, "Për hartimin e rregullores për përzgjedhjen dhe nominimin e anëtarëve të komisioneve teknike të paketave të shërbimeve". Grupi punës ka përgatitur draftin i cili është për miratim në Këshillin Administrativ të radhës.
Statusi: Rekomandimi nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të FSDKSH është zbatuar, por rekomandimi në tërësi konsiderohet **në proces zbatimi**, pasi nuk është vepruar ende nga ana e Këshillit Administrativ.

4.1. Rekomandimi: Këshilli Administrativ të marrë masa për realizimin e vendim-marrjes së LBR të mbështetur në të gjithë dokumentacionin e domosdoshëm dhe analitik mbi listën e barnave të përfshira, sipas alternativës më të lirë, si dhe në bashkëpunim me Drejtorin e përgjithshëm të hartojë dhe të miratojë një akt rregullativ mbi procedurën dhe afatet e ndryshimit të çmimit të barnave të LBR në sistem, me qëllim parandalimin e efekteve negative financiare nga vonesa në korrespondencën zyrtare ndërinstitucionale.
Nga auditimi ka rezultuar: FSDKSH ka vepruar ne linjë me rekomandimin e KLSH duke nxjerr Urdhrin e Drejtorit Përgjithshëm të FSDKSH me nr.290, datë 09.09.2022 dhe nr.5571 prot., datë 09.09.2022 me lëndë: Për ngritjen e grupit të punës, "Për hartimin e rregullores për përzgjedhjen dhe nominimin e anëtarëve të komisioneve teknike të paketave të shërbimeve". Grupi punës ka përgatitur draftin i cili është për miratim në Këshillin Administrativ të radhës.
Statusi: Rekomandimi nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të FSDKSH është zbatuar, por rekomandimi në tërësi konsiderohet **në proces zbatimi**, pasi nuk është vepruar ende nga ana e Këshillit Administrativ.

9.1. Rekomandimi: FSDKSH t'i sugjerojë dhe të bashkëpunojë me MSHMS, e cila është Autoriteti Kontraktor për koncesionin e sterilizimit, me qëllim rishikimin e aneks-kontratës për të përcaktuar protokolle të ndërhyrjeve me një nivel të caktuar komplesiteti, përfshirë dhe numrin e instrumenteve për kompleksitet, duke krijuar mundësi për monitorimin e plotë të zbatimit të kontratës, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe eficiencës së fondeve publike të angazhuara në këtë kontratë koncesionare.
Nga auditimi ka rezultuar: FSDKSH ka vepruar në linjë me rekomandimin duke dërguar shkresë MSHMS me nr.34/52 prot., datë 07.09.2022 me lëndë "Mbi zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit" edhe pse nga MSHMS nuk ka patur reagim për këtë shkresë deri në momentin e hartimit të këtij akt-verifikimi.
Statusi: Rekomandimi nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të FSDKSH është zbatuar, por rekomandimi në tërësi konsiderohet **në proces zbatimi**, pasi nuk është vepruar ende nga ana e MSHMS.

18.1 Rekomandimi: Sektori i Kontrollit të Farmacive dhe Agjencive Farmaceutike të marrë masa që të vendosen në Rregulloren përkatëse procedurat e përzgjedhjes së subjekteve për kontroll, në planet e punës të përfshihen subjektet farmaceutike me rimbursim më të lartë se 2 milion lekë, si dhe gjatë kontrollit të administrohet i gjithë dokumentacioni siç është përcaktuar në Rregulloren nr. 3, datë 22.10.2014.
Nga auditimi ka rezultuar: FSDKSH ka vepruar ne linjë me rekomadimin e KLSH duke hartuar rregulloren sipas Urdhrit nr.415, datë 19.12.2022 me nr.7129/1 prot., datë 09.12.2022 i Drejtorit të Përgjithshëm për ngritjen e grupit të punës për rishikimin e Rregullores nr.3 datë 22.10.2014 "Për procedurën dhe mënyrën e kontrollit të dhënësve të shërbimit të kontraktuara me Fondin" të ndryshuar", ku Grupi punës ka përgatitur draftin i cili është për miratim në Këshillin Administrativ të radhës.
Statusi: Rekomandimi nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të FSDKSH është zbatuar, por rekomandimi në tërësi konsiderohet **në proces zbatimi**, pasi nuk është vepruar ende nga ana e Këshillit Administrativ.

21.2 Rekomandimi: FSDKSH në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masa për hartimin e LBR, të argumentojë dhe saktësojë çmimet për barna me gramaturë të ndryshme por me princip aktiv, doza, forma dhe emër tregtar të njëjtë, me çmime të pa ndryshueshme (të barabartë), si dhe për barna me gramatura më të mëdha të cilat kanë çmime më të ulta se barnat me gramaturë më të vogël.
Nga auditimi ka rezultuar: FSDKSH në bashkëpunim me Këshillin Administrativ ka vepruar në linjë me rekomandimin e KLSH dhe pse në momentin e kryerjes së këtij akt verifikimi procesi i hartimit të LBR së re ende nuk ka përfunduar pasi është brenda afateve të zbatimit. Subjekti na paraqiti Vendimin e Këshillit Administrativ të FSDKSH me nr. 23, datë 11.11.2022 "Për krijimin e komisionit teknik të Listës së Barnave të rimbursuara për vitin 2023" ku ndër të tjera thuhet në këtë vendim që lista e barnave të rimbursuara të hartohet nga komisioni teknik në bazë të kritereve të miratuara dhe të paraqitet në këshillin administrativ së bashku me relacionin shoqërues dhe raportin financiar me efektet ekonomike dhe mundësinë e mbulimit nga skema e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor.
Statusi: Rekomandimi konsiderohet **në proces zbatimi**.

C. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike.

2.1. Rekomandimi: FSDKSH të komunikojë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për një planifikim të saktë të numrit të pacientëve të projektuar për secilën qendër me ato që ju mundësohet shërbimi, me qëllim që të mos krijohen diferenca për faturime për shërbime të pakryera, si dhe nga ana e saj të negociohet kontrata për pagesën vetëm për shërbimet e kryera.

Nga auditimi ka rezultuar: FSDKSH dhe MSHMS kanë vepruar në linjë me rekomandimin e KLSH bazuar edhe në shkresat sa më poshtë:

1-Shkresa e FSDKSH me nr.34/53 prot., datë 07.09.2022 me lëndë "Mbi zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit" drejtuar MSHMS ku kërkohet bashkëpunimi për zbatimin e këtij rekomandimi.

2-Shkresa e MSHMS me nr.307/9 prot., datë 17.10.2022 ku ka dalë Urdhri me nr.584, datë 17.10.2022 me lëndë "Për ngritjen e grupit të punës për negocimin e kontratës koncesionare nr.1503/44, datë 10.02.2016 "Për shërbimin e hemodializës në pesë qendra pranë Spitaleve Rajonale të Vlorës, Shkodrës, Elbasanit, Korçës dhe Lezhës". Ndër të tjera, në pikën 2 të këtij Urdhri me nr. Ref 581/2022 më sipër cituam grupi punës ngarkohet me detyrën e negocimit me përfaqësuesit e shoqërisë koncesionare "DV" shpk për:

- Rishikimin e projeksionit sipas rajoneve në bazë të historikut që disponon MSHMS dhe FSDKSH;
- Rishikimin e kushteve të kontratës në lidhje me pagesat që në vijim të kryhen sipas parimit (pay x use) me qëllim që të paguhen vetëm shërbimet e kryera.

Statusi: Rekomandimi konsiderohet në **proces zbatimi**, gjatë vitit 2022 paraqitet e njëjta situatë.

D. Masa disiplinore

Mbështetur në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm fillimin e dhënies së masave disiplinore nga "Vërejtje" deri në "Largim nga puna" për punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi ka rezultuar: Nga FSDKSH nuk u vu në dispozicion asnjë dokumentacion që provon kryerjen e këtij rekomandimi dhe pse është i pranuar në plan veprimin e dërguar në KLSH.

Tabela nr. II.2.1.1 "Statusi i zbatimit të rekomandimeve"

Lloji i masave	Masa të dhëna (numër)	Statusi i zbatimit të rekomandimeve				Pranuara
		Zbatuar plotësisht	Zbatuar Pjesërisht	Në proces Zbatimi	Pa zbatuar	
Masa organizative	31	25	1	5	0	31
Masa 3-E	2	1		1		2
Masa Shpërblim Dëmi	1				1	1
Totali	**34**	**26**	**1**	**6**	**1**	**34**

Burimi i të dhënave FSDKSH përpunoi Grupi i Auditimit të KLSH

Konkluzion: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve është evidentuar se nga subjekti i audituar është raportuar në KLSH, brenda afateve ligjore, si dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve është në nivele të larta. Nga subjekti janë pranuar të gjithë rekomandimet e dhëna, si dhe janë marrë masa konkrete për zbatimin e tyre. Nga Drejtoria e Përgjithshme e FSDKSH nga 34 rekomandime, janë pranuar 34, si dhe janë zbatuar 31, ose 92 % e tyre**, por 5 prej tyre nuk kanë marrë zgjidhje përfundimtare, pasi kërkojnë miratim të KA, nga i**

cili nuk është vepruar ende. Për këtë arsye janë zbatuar plotësisht 26 rekomandime, është zbatuar pjesërisht 1, janë në proces 6, pazbatuar 1 rekomandim.

Titulli i gjetjes:	**Mos marrja e masave nga KA për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH.**
Situata:	Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm, ka rezultuar se, disa rekomandime kërkojnë bashkëpunim me Këshillin Administrativ të FSDKSH. Për këtë arsye pavarësisht se nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme janë marrë masa për realizimin e tyre, këto rekomandime rezultojnë të pa finalizuara, për shkak të mosveprimit nga ana e Këshillit Administrativ, si: -Nuk është vepruar nga ana e Këshillit Administrativ për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm. -FSDKSH ka vepruar ne linjë me rekomandimin e KLSH duke nxjerrë Urdhrin e Drejtorit Përgjithshëm të FSDKSH me nr. 290, datë 09.09.2022 dhe nr.5571 prot., datë 09.09.2022 për ngritjen e grupit të punës, "Për hartimin e rregullores për përzgjedhjen dhe nominimin e anëtarëve të komisioneve teknike të paketave të shërbimeve". Grupi punës ka përgatitur draftin, i cili nuk është miratuar nga Këshilli Administrativ; -FSDKSH, ka vepruar ne linjë me rekomandimin e KLSH, duke nxjerrë Urdhrin e Drejtorit Përgjithshëm të FSDKSH me nr.290, datë 09.09.2022 dhe nr.5571 prot., datë 09.09.2022 për ngritjen e grupit të punës, "Për hartimin e rregullores për përzgjedhjen dhe nominimin e anëtarëve të komisioneve teknike të paketave të shërbimeve" dhe për ngritjen e grupit të punës, "Për hartimin e rregullores për përzgjedhjen dhe nominimin e anëtarëve të komisioneve teknike të paketave të shërbimeve". Grupet e punës kanë përgatitur draftet të cilat nuk janë shqyrtuar nga Këshilli Administrativ; -FSDKSH ka vepruar ne linjë me rekomandimin e KLSH duke hartuar rregulloren sipas Urdhrit nr.415, datë 19.12.2022 me nr.7129/1 prot., datë 09.12.2022 i Drejtorit të Përgjithshëm për ngritjen e grupit të punës për rishikimin e Rregullores nr.3 datë 22.10.2014 "Për procedurën dhe mënyrën e kontrollit të dhënësve të shërbimit të kontraktuara me Fondin" të ndryshuar", ku Grupi punës ka përgatitur draftin i cili është miratuar ende nga Këshilli Administrativ.
Kriteri:	VKM-së nr.124 datë 5.3.2014 "Për miratimin e Statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", neni 5.
Ndikimi/Pasoja:	Mos zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH.
Shkaku:	Mos marrja e masave nga KA për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Këshilli Administrativ, të marrë masa të menjëhershme për shqyrtimin dhe miratimin e dokumenteve të mësipërme, të përgatitura nga Drejtoria e Përgjithshme, në zbatim të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Për sa është trajtuar më lart për këtë drejtim auditimi, nuk janë paraqitur observacione për Projekt Raportin e Auditimit.

2.2. Përputhshmëria me aktet ligjore dhe rregullatore në fuqi e organizimit dhe funksionimit të organeve drejtuese të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe vendimmarrja për çështje kryesore objekt auditimi. (Këshilli Administrativ dhe Drejtori i Përgjithshëm)

Auditimi i pikës 2 të programit të auditimit nr. 282/1 prot, datë 03.04.2023, është kryer në bazë të dokumentacionit sa më poshtë:

- Vendimet e Këshillit Administrativ (KA) 2022 dhe dosjet e mbledhjeve KA;
- Urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm 2022;

Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi si më poshtë:

Këshilli Administrativ:

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor zhvillon veprimtarinë e tij bazuar në Ligjin nr.10383, datë 24.02.2011, "Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Bazuar në nenin 15 të këtij ligji organet drejtuese të Fondit janë Këshilli Administrativ dhe Drejtori i Përgjithshëm, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre bazuar në nenet 18, 20 dhe 21 të këtij ligji, si dhe në bazë të neneve 5, 6 dhe 10 të VKM-së nr.124 datë 5.3.2014 "Për miratimin e Statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë".

Bazuar në Ligjin nr.10383, datë 24.02.2011, të ndryshuar, neni 16, Këshilli Administrativ është organi më i lartë vendimmarrës i Fondit dhe duhet të ketë në përbërjen e tij 7 anëtarë që janë:

a) Ministri i Shëndetësisë ose përfaqësuesi i tij;
b) Ministri i Financave ose përfaqësuesi i tij;
c) Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ose përfaqësuesi i tij;
ç) Drejtori i Përgjithshëm i Fondit ose përfaqësuesi i tij;
d) Drejtori i Institutit të Sigurimeve Shoqërore ose përfaqësuesi i tij;
dh) Një përfaqësues i sindikatës së të punësuarve;
e) Një përfaqësues i organizatës së profesionistëve të shëndetësisë.

Nga auditimi është konstatuar se edhe pse Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nuk ekziston më që prej ristrukturimit të qeverisë në vitin 2017, e për pasojë edhe përfaqësuesi i saj në këtë Këshill, ende nuk janë marrë masat e nevojshme dhe bërë propozimet përkatëse nga KA për rregullimin e nenit 16 të ligjit nr.10383, datë 24.02.2011, "Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe nenit 3 të VKM-së nr. 124 datë 5.3.2014 "Për miratimin e Statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", në mos përmbushje të detyrimit parashikuar në nenin 20, pika "gj" e ligjit të sipër cituar dhe nenin 5, pika "l" e VKM-së sipër cituar.

Bazuar në rekomandimin e lënë nga ana e KLSH-së me shkresën nr. 18/10 prot., datë 28.07.2022, konkretisht në pikën B. Masa Organizative, rekomandimi 2.1, FSDKSH me shkresën nr. 5443 prot, datë 06.09.2022, ka kërkuar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale përfaqësimin me dy anëtar në KA duke qenë se vendi vakant në KA, është krijuar nga mungesa e anëtarit të ish- Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

-Sa më sipër MSHMS është përgjigjur me shkresën nr. 3490/1 prot, datë 03.10.2022, duke e plotësuar vendin vakant të krijuar që prej ristrukturimit të qeverisë në vitin 2017, ndërsa përsa i përket emërimit të Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH, nuk është ndërmarrë asnjë veprim nga KA, trajtuar më poshtë.

Titulli i gjetjes 1: **Mbi mungesën e veprimit të Këshillit Administrativ për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm, si dhe mos kryerja e mbledhjeve të Këshillit Administrativ në intervale kohore jo më pak se një herë në dy muaj**.

Situata: -Nga auditimi është konstatuar se edhe përgjatë vitit 2022 funksioni i Drejtorit të Përgjithshëm në FSDKSH është kryer nga Znj. A.Ç., bazuar në VKA nr.22, datë 03.12.2020, për "Komandim në detyrë". Theksojmë se baza ligjore e përcaktuar në vendimin e sipërcituar, Ligji nr.10383, datë 24.02.2011 dhe VKM nr.124, datë 05.03.2014, nuk ka parashikuar "Komandimin në detyre" si një nga format e emërimit për ushtrimin e veprimtarisë së Drejtorit të Përgjithshëm në FSDKSH.

Sa më sipër, është konstatuar se gjatë vitit 2022 Këshilli Administrativ nuk ka ndërmarrë asnjë masë në përputhje me nenin 20 germa (a) të Ligjit nr.10383, datë 24.02.2011, "Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ku përcaktohet se "Këshilli administrativ kryen funksionet e mëposhtme:

a) zgjedh, emëron dhe shkarkon Drejtorin e Përgjithshëm për shkaqe të parashikuara në këtë ligj si dhe nenin 19 "1. Drejtori i Përgjithshëm zgjidhet nga këshilli administrativ ndërmjet jo më pak se tri kandidaturave të paraqitura nga anëtarët e këtij këshilli, sipas kritereve dhe rregullave të përcaktuara në statutin e Fondit. 2. Këshilli zgjedh Drejtorin e Përgjithshëm, me votim të fshehtë, me 2/3 e votave të të gjithë anëtarëve të tij." Zgjedhja e Drejtorit të Përgjithshëm është një ndër vendimmarrjet e parashikuara në ligj me votim të fshehtë të Këshillit Administrativ.

- Këshilli Administrativ i FSDKSH gjatë vitit 2022 ka zhvilluar në total 8 mbledhje, në të cilat është respektuar kuorumi dhe janë marrë 29 vendime lidhur me miratimin dhe ndryshimin e buxhetit, ngritjen e komisioneve teknike, miratimin e LBR, miratimin e kontratave tip etj. Për vitin 2022, pavarësisht se janë kryer 8 mbledhje rezulton se nuk është ndjekur intervali një mbledhje në dy muaj, kjo në kundërshtim me Ligjin nr.10383 datë 24.02.2011 neni 18, "Mbledhjet dhe vendimet e këshillit administrativ", pika 1, ku përcaktohet se: "Mbledhjet e zakonshme të këshillit administrativ thirren nga Drejtori i Përgjithshëm, jo më pak se një herë në dy muaj", si dhe VKM nr. 124, datë 5.3.2014, "Për Miratimin e Statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor" në Republikën e Shqipërisë, neni 6, pika 1, "Mbledhjet, kuorumi dhe vendimet e Këshillit Administrativ", ku përcaktohet se: "Mbledhjet e zakonshme të Këshillit Administrativ thirren nga drejtori i përgjithshëm, jo më pak se një herë në dy muaj. Rendi i ditës propozohet nga drejtori i përgjithshëm dhe miratohet nga Këshilli Administrativ. Kuorumi i mbledhjeve të zakonshme është 2/3 e anëtarëve të Këshillit. Vendimet miratohen me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm". Konkretisht, pas mbledhjes së datës 15.02.2022, mbledhja e radhës është zhvilluar më 13.05.2022, me një vonesë gati një muaj dhe pas mbledhjes së datës 13.05.2022 mbledhja e radhës është zhvilluar më 19.07.2022, me një vonesë gati një javë.

Kriteri: Ligji nr.10383, datë 24.02.2011, "Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", neni 19;

	VKM nr. 124, datë 05.03.2014, "Për Miratimin e Statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor" neni 5.
Ndikimi/pasoja:	Drejtimi i FSDKSH nga Drejtor i Përgjithshëm i komanduar, mund të ndikojë në nivelin e përgjegjshmërisë dhe ushtrimin e kompetencave; Moskryerja e mbledhjeve në intervalet e përcaktuar ndikon në mos diskutim e çështjeve dhe problematikave në kohën e duhur.
Shkaku:	Mos veprim nga ana e Këshillit Administrativ; Mos veprim nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi 1:	Këshilli Administrativ i FSDKSH, si organ kompetent i përcaktuar në bazë të Ligjit nr. 10383, datë 24.02.2011, "Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM 124, datë 05.03.2014, "Për Miratimin e Statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor", të marrë masa të menjëhershme për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH.
Rekomandimi 2:	Drejtori i Përgjithshëm i FSDKSH, të marrë masa që në vijimësi të zbatojë diskrecionin e tij, për thirrjen e mbledhjeve të Këshillit Administrativ, në intervale kohore jo më pak se një herë në dy muaj.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: Këshilli Administrativ: Znj.O..M, Kryetar i Këshillit Administrativ, si dhe Anëtarët e Këshillit Administrativ znj.A.Ç., znj.Xh.A, z.A.H, z.F.B., z.F.Sh., znj.M.Sh., për mos emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH dhe Drejtori i Përgjithshëm (i komanduar), për mos mbledhjen e Këshillit Administrativ sipas intervaleve kohore të përcaktuara.

Nga grupi i auditimit është audituar zbatimi i ligjshmërisë dhe korrektësisë në marrjen e vendimeve nga Këshilli Administrativ i FSDKSH, ku nga 29 vendime të marra gjatë vitit 2022 në mbledhjet e zhvilluara, të detajuara në Tabelën anekse nr. 2.2.1, ka rezultuar se, në përgjithësi vendimmarrjet janë në përputhje me kriteret ligjore dhe kompetencat e KA, me përjashtim të VKA nr. 22 "Për krijimin e komisionit teknik të listës së pajisjeve mjekësore të rimbursuara për vitin 2023" dhe VKA nr. 23 "Për krijimin e komisionit teknik të LBR për vitin 2023", ku nga verifikimi i dokumentacionit në dosje është konstatuar se, mungon dokumentacioni që vërteton konfirmimet e përfaqësuesve të institucioneve të tjera për Komisionin Teknik (KT) dhe përzgjedhjen e tre emrave nga DP për çdo pozicion të pa mbuluar nga anëtarët e Fondit, në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr.124, datë 05.03.2014 "Për miratimin e statutit të FSDKSH në RSH", të ndryshuar, neni 18 "Komisionet teknike të paketave të shërbimit" pika 3 dhe 4. Si përfundim është e paqartë se cila ka qenë procedura specifike e ndjekur në përzgjedhjen e emrave konkret të komisionit, vendimmarrja e të cilit ka një efekt të lartë financiar në buxhetin e shtetit.

- Vendimi nr.22 "Për krijimin e komisionit teknik të listës së pajisjeve mjekësore të rimbursuara për vitin 2023". Në këtë vendim, bazuar në Ligjin nr.10383 datë 24.02.2011, i ndryshuar dhe Statutit të Fondit të FSDKSH, ka vendosur që: "Të miratoj krijimin e komisionit teknik i përbërë nga 7 anëtarë, konkretisht: E.R. (MSHMS/Kryetar), D.G. (FSDKSH), S.Z. (FSDKSH), E.A. (FSDKSH), A.Y. (QSUNT/Shërbimi Endrokrinologjisë), J.B. (AKBPM) dhe F.T. (Shoqata e diabetit)".
- Vendimi nr.23 "Për krijimin e komisionit teknik të LBR për vitin 2023".
  Në këtë vendim, bazuar në Ligjin nr.10383 datë 24.02.2011, i ndryshuar dhe Statutit të Fondit të FSDKSH, ka vendosur që:

-Të miratoj komisionin teknik i përbërë nga 9 antarë, konkretisht: M.R. (MSHMS/Kryetar), D.G. (FSDKSH), B.H. (FSDKSH), E.A. (FSDKSH), S.Ç. (QSUT/Shërbimi Onkologjisë), A.S. (FSDKSH), J.B. (AKBPM), A.S. (QSUT) dhe S.B. (SU "Sh. Ndroqi").
-Lista e barnave të rimbursuara të hartohet nga KT në bazë të kritereve të miratuara dhe ta paraqesë në KA se bashku me relacionin shoqërues dhe raportin financiar për efektet ekonomike dhe mundësinë e mbulimit nga skema e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor.

Veprimtaria e Drejtorit të Përgjithshëm:
Ligji nr. 10383, datë 24.02.2011, "Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenet 19 dhe 21, si dhe VKM-së nr. 124, datë 5.3.2014 "Për miratimin e Statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenet 2, 9 dhe 10, përcaktojnë mënyrën e zgjedhjes dhe Funksionet e Drejtorit të Përgjithshëm si një prej organeve drejtues të Fondit.
Grupi i auditimit ka kërkuar dhe i janë vënë në dispozicion Urdhrat dhe Udhëzimet e Drejtorit të Përgjithshëm gjatë vitit 2022 gjithsej 456. Urdhrat e dalë nga DP në funksion të veprimtarisë së Fondit janë:
- 220 urdhra inspektimi dhe grupe pune të ngritura;
- 44 urdhra delegim firme, emërime/komandime/transferime;
- 49 urdhra të ngritura në lidhje me procedurat e prokurimeve;
- 48 urdhra për krijimin e komisioneve;
- 17 ndryshim/shfuqizim të urdhrave;
- 27 urdhra ri klasifikim page, ndihma ekonomike dhe rishikim të rregulloreve;
- 10 udhëzime;
- 41 të tjerë procedural.

Konkluzion:
- Nga auditimi i 29 vendimeve të Këshillit Administrativ ka rezultuar se, përgjithësisht vendimet janë marrë në përputhje me kompetencat e përcaktuara Ligjin nr.10383 datë 24.02.2011, i ndryshuar dhe Statutit të Fondit të FSDKSH, nuk janë konstatuar parregullsi me përjashtim të dy rasteve të trajtuara më lart, VKA nr. 22 dhe 23, ku nuk është përcaktuar qartë procedura e ndjekur në përzgjedhjen e emrave konkret të komisionit, si dhe në ushtrimin e veprimtarisë së tij KA nuk ka ushtruar kompetencat në emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH, si dhe nuk ka vendimmarrje për zbatimin e 5 rekomandimeve të lëna nga KLSH (trajtuar në pikën 1), për të cilat Drejtoria e Përgjithshme ka ndërmarrë hapat e saj, por që KA nuk ka dalë me vendime për finalizim të plotë të tyre.
- Nga auditimi i 55 urdhrave të Drejtorit të Përgjithshëm, të përzgjedhur për auditim sipas Tabelës anekse nr. 2.2.2 u konstatua se, vendimmarrja e tyre është në përputhje me kompetencat e përcaktuara të Drejtorit të Përgjithshëm, ndërsa përsa i përket anës formale u evidentua se, pjesës më të madhe të urdhrave të DP të FSDKSH ju mungon specimenti në lidhje me përcaktimin e emërtesës "Drejtoi i Përgjithshëm" si pozicion i cili ka kompetencën për nxjerrjen e urdhrit apo shkresave, veprim i cili nuk është në përputhje me kërkesat e vendimit nr. 4 datë 19.06.2017 të Këshillit të Lartë të Arkivave për miratimin e "Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë", neni 4 "Dokumentet Administrative", shtojca nr.1.

Për sa është trajtuar më lart për këtë drejtim auditimi, nuk janë paraqitur observacione për Projekt Raportin e Auditimit.

2.3. Auditim mbi programimin, zbatimin dhe raportimin e buxhetit të sigurimeve shëndetësore për vitin 2022 duke përfshirë, detajimin fillestar, rishpërndarjen buxhetore, nivelet e realizimit të planit, konfirmimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara si dhe financimin e aktiviteteve të rimbursimit të barnave, kontratave koncesionare / PPP dhe paketave".

Në zbatim të drejtimit të mësipërm u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Rakordimet me institucionet përkatëse;
- Pasqyrat financiare të FSDKSH-së;
- Raporte vjetore të FSDKSH-së;
- Raporte statistikore të FSDKSH-së dhe analiza statistikore;
- Kontratat PPP, të lidhura me operatorë privatë, etj..

Mbi planifikimin buxhetor afatmesëm (PBA) 2022-2024.

Miratimi i PBA 2022-2024, është kryer me VKA nr. 18, datë 17.09.2021 "Për miratimin e PBA 2022-2024 të FSDKSH", nënshkruar nga Kryetari i KA (Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale).
Për hartimin e PBA, Drejtoria Ekonomike e FSDKSH, mbështetur në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", udhëzimet e MFE mbi hartimin e PBA, si dhe shkresën nr. 3678, datë 09.07.2021 "Për hartimin e treguesve të PBA 2022-2024" të Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH, ju është drejtuar me shkresë të gjitha strukturave (njësive shpenzuese), për hartimin e nevojave duke marrë në konsideratë dhe analizuar ecurinë e treguesve të periudhave të mëparshme dhe projeksionin për tre vitet në vazhdim, përfshirë vitin korrent 2022, si dhe afatet e dorëzimit të PBA-ve, 15 dhe 20 Korrik 2021.
Nga auditimi ka rezultuar se, të gjitha strukturat brenda FSDKSH dhe njësitë shpenzuese të varësisë, kanë hartuar dhe protokolluar PBA përkatëse, brenda afatit të përcaktuar.
Gjithashtu për hartimin e PBA, kanë kthyer përgjigje referuar kërkesave të FSDKSH për informacion dhe të dhëna edhe institucione të tjera si: INSTAT në lidhje me popullsinë banuese; Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, në lidhje me të dhëna statistikore mbi numrin e studentëve të regjistruar në arsimin e lartë; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në lidhje me përfituesit sipas skemës së mbrojtjes sociale; Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në lidhje me kontribute të mbledhura dhe numrin e të punësuarve për vitin 2021; Ministria e Brendshme, në lidhje me numrin e banorëve sipas NJA, numri i shtetasve të huaj me leje qëndrimi dhe leje pune në RSH, numri i shtetasve të huaj që kanë aplikuar për azil në RSH, etj., dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në lidhje me numrin e të para burgosurve dhe të burgosurve për 6 mujorin e parë 2021 dhe parashikimi për 2022-2024.

PBA 2022-2024, relacioni me pasqyrat përkatëse, pas miratimit nga GMS, me shkresën nr. 4643, datë 01.09.2021 i është dërguar MSHMS dhe MFE. Ky dokument është ri-dërguar me shkresën nr. 5007, datë 21.09.2021, për shkak të reflektimit të disa ndryshimeve mbi projektbuxhetin e propozuar.
Parashikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për PBA 2022-2024 sipas zërave paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.3.1 "Parashikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve të FSDKSH, PBA 2022-2024"

Në mijë lekë

Përshkrimi	2022	2023	2024
I. Te ardhurat gjithsej	**50,706,000**	**51,106,000**	**53,072,000**
1. Kontributi i sigurimeve shëndetësore	15,096,000	16,151,000	17,172,000
2. Kontribut i Buxhetit te Shtetit	35,610,000	34,955,000	35,900,000
- parësor	7,785,140	7,645,009	7,650,000
- spitalor	27,824,860	27,309,991	28,250,000
II. Shpenzimet gjithsej	**50,706,000**	**51,106,000**	**53,072,000**
1. Rimbursimi i barnave e pajisjeve	11,020,000	11,370,000	12,140,000
- Likuidimi i rimbursimit te barnave	11,000,000	11,350,000	12,120,000
- fisha diabeti (0-25) vjeç	20,000	20,000	20,000
2. Shpenzime për kujdesin shëndetësor parësor	10,618,140	11,176,090	11,376,090
- Financim i QSH	9,742,050	10,300,000	10,500,000
- Kontrolli baze	876,090	876,090	876,090
3. Shpenzimet administrative	1,070,000	1,149,919	1,205,910
4. Investime	173,000	100,000	100,000
5. Financimi për shërbimin spitalor	27,824,860	27,309,991	28,250,000
- spitalet	20,394,389	19,569,631	20,189,547
- paketat	3,492,230	3,710,230	3,941,230
- rimbursime VKM	30,000	30,000	30,000
- transferta për individë (mjeke specialiste)	30,000	30,000	30,000
- pagesa për marrëveshje ndërkombëtare	3,000	3,000	3,000
- pagesa e sherb. PPP (dialize)	835,000	887,000	946,000
- pagesa e sherb. PPP (Sterilizim)	1,750,000	1,770,000	1,790,000
- pagese spitalet PPP laboratorët	1,290,241	1,310,130	1,320,223

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2022 në PBA 2022-2024, janë planifikuar në shumën 50,706 milionë lekë, ndërsa në buxhetin e vitit 2022 janë planifikuar në shumën 52,836 milionë lekë ose me një ndryshim në masën 4.2 % më shumë se PBA. Sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve ky ndryshim paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr.3.2 "Ndryshimi i planit të vitit 2022 sipas PBA dhe buxhetit vjetor 2022"

Në mijë lekë

Përshkrimi	2022	2022	Ndryshimet
	PBA	Buxhet vjetor	PBA-Vjetor
I. Te ardhurat gjithsej	**50,706,000**	**52,836,000**	**2,130,000**
1. Kontributi i sigurimeve shëndetësore	**15,096,000**	**14,985,000**	**(111,000)**
2. Kontribut i Buxhetit te Shtetit	**35,610,000**	**37,851,000**	**2,241,000**
- parësor	7,785,140	8,385,140	600,000
- spitalor	27,824,860	29,465,860	1,641,000
II. Shpenzimet gjithsej	**50,706,000**	**52,836,000**	**2,130,000**
1. Rimbursimi i barnave e pajisjeve	**11,020,000**	**11,020,000**	**0**
- Likuidimi i rimbursimit te barnave	11,000,000	11,000,000	0
- fisha diabeti (0-25) vjeç	20,000	20,000	0
2. Shpenzime për kujdesin shëndetësor parësor	**10,618,140**	**11,107,140**	**489,000**
- Financim i QSH	9,742,050	10,231,050	489,000
- Kontrolli baze	876,090	876,090	0
3. Shpenzimet administrative	**1,070,000**	**1,070,000**	**0**
4. Investime	**173,000**	**173,000**	**0**
5. Financimi për shërbimin spitalor	**27,824,860**	**29,465,860**	**1,641,000**
- spitalet	20,394,389	21,803,730	1,409,341
- paketat	3,492,230	3,492,230	0

-	rimbursime VKM	30,000	30,000	0
-	transferta për individë (mjeke specialiste)	30,000	30,000	0
-	pagesa për marrëveshje ndërkombëtare	3,000		(3,000)
-	pagesa e sherb. PPP (dialize)	835,000	835,000	0
-	pagesa e sherb. PPP (Sterilizim)	1,750,000	1,700,000	(50,000)
-	pagese spitalet PPP laboratorët	1,290,241	1,574,900	284,659

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Në planin vjetor të buxhetit të vitit 2022, ka një rritje të planit të treguesve buxhetorë (të ardhura dhe shpenzime) në krahasim me PBA 2022-2024, ku plani i të ardhurave paraqitet me rritje në shumën *2,130 milionë lekë, si rezultat i planifikimit të financimit të buxhetit të shtetit me 2,241 milionë lekë më shumë dhe i uljes së planit të të ardhurave nga kontributet me 111 milionë lekë.* Ndryshimi i planit me rritje të financimit të buxhetit dhe ulje të planit të të ardhurave nga kontributet *nuk është një tregues pozitiv,* pasi ecuria e të ardhurave të FSDKSH duhet të ketë si trend rritjen e të ardhurave nga kontributet dhe uljen e financimit nga buxheti i shtetit. Megjithatë, gjatë vitit 2022 plani fillestar i miratuar me Ligjin nr. 115/2021 datë 25.11.2021 "Për buxhetin e vitit 2022" ka pësuar ndryshime në kah pozitiv, duke ulur financimin e buxhetit dhe rritur planin e të ardhurave nga kontributet. Në krahasim me PBA 2022-2024 dhe plani i shpenzimeve të vitit 2022 paraqitet me rritje si për shërbimin parësor me 489 mijë lekë më shumë dhe shërbimin spitalor me 1,641,000 mijë lekë më shumë, nga të cilat 1,409,341 mijë lekë, për spitalet.

Konkluzion: Procedurat e ndjekura nga FSDKSH për hartimin e PBA 2022-2024, janë në përputhje me kërkesat dhe afatet e përcaktuara në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar si dhe udhëzimet plotësuese të MFE nr. 8, datë 26.02.2021 dhe nr. 19, datë 09.07.2021 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024" si dhe Udhëzimin standard "Mbi përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm nr.7, datë 28.02.2018.

Mbi buxhetin e vitit 2022, të FSDKSH-së.

Me VKA nr. 7, datë 24.04.2023, FSDKSH, ka miratuar Raportin vjetor të vitit 2022, në të cilin paraqiten treguesit e mëposhtëm mbi planin, faktin e të ardhurave dhe shpenzimeve të FSDKSH.

Tabela nr.3.3 "Treguesit e buxhetit mbi të ardhurat dhe shpenzimet e vitit 2022"

Në milionë lekë

Nr.	Zërat e të ardhurave	Viti 2022			Fakt (cash) /Plan viti 2022		Fakt konstatuar/ Plan viti 2022	
		Plani	Fakti cash	Fakti konst.	Diferenca vlerë	Realiz %	Diferenca vlerë	Realiz %
	Të ardhurat gjithsej	**52,836**	**52,456**	**52,928**	**-380**	**99.3**	**92**	**100.2**
I	**Kontributet e sigurimit shëndetësor**	**15,930**	**15,692**	**16,164**	**-238**	**98.5**	**234**	**101.5**
1	nga DPT në BSH	15,625	15,636	16,106	11	100.1	481	103.1
2	nga ISSH (fermerët)	305	56	58	-249	18.3	-247	18.9
II	**Transferta e buxhetit të shtetit, nga këto**	**36,806**	**36,638**	**36,638**	**-168**	**99.5**	**-168**	**99.5**
1	Transfertë për shërbimin parësor	7,340	7,340	7,340	0	100.0	0	100.0
2	Transfertë për shërbimin spitalor	29,466	29,298	29,298	-168	99.4	-168	99.4
3	Spitalet	22,964	22,856	22,856	-108	99.5	-108	99.5
4	Tërheqje nga FSDKSH për paketat, bonus, VKM, PPP	6,502	6,441	6,441	-60	99.1	-60	99.1
III	**Të ardhura të tjera**	**100**	**126**	**126**	**26**	**126.0**	**26**	**126.0**
	Shpenzimet gjithsej	**52,836**	**52,244**	**51,960**	**-592**	**98.9%**	**-876**	**98.3%**
I	**Rimbursimi i barnave e pajisjeve**	**11,820**	**11,808**	**11,506**	**-12**	**99.9%**	**-314**	**97.3%**
II	**Shpenzime për kujdesin shëndetësor parësor**	**10,470**	**10,398**	**10,398**	**-72**	**99.3%**	**-72**	**99.3%**
1	Financimi i QSH	9,594	9,522	9,522	-72	99.2%	-72	99.2%
2	Kontrolli bazë	876	876	876	0	100.0%	0	100.0%
III	**Shpenzimet administrative**	**1,070**	**882**	**889**	**-188**	**82.5%**	**-181**	**83.1%**
IV	**Investime**	10	4	4	-6	37.7%	-6	38.9%
V	**Financime për shërbimin spitalor**	**29,466**	**29,152**	**29,164**	**-314**	**98.9%**	**-302**	**99.0%**

1	Financime për spitalet publike	25,255	25,147	25,147	-108	99.6%	-108	99.6%
2	Shpenzime për paketat spitalore në privat	1,626	1,480	1,470	-146	91.0%	-156	90.4%
3	Shpenzime për trajtim pacienti me VKM	30	12	12	-18	38.8%	-18	38.8%
4	Shpenzimet –Bonusi për mjekët specialistë	20	11	11	-9	53.3%	-9	52.9%
5	Shpenzimet- PPP (dializa,sterilizimi)	2,535	2,503	2,525	-32	98.7%	-10	99.6%

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Tabela nr.3.4 "Realizimi i faktit të të ardhurave dhe shpenzimeve 2022/2021"

Në milionë lekë

Nr.	Përshkrimi	Viti 2021	2022	Viti 2022/2021	
		Fakti (konstatuara)	Fakti (konstatuara)	Diferenca vlerë	Realizimi në %
	Të ardhurat gjithsej	**49,504**	**52,928**	**3,424**	**106.9%**
I	**Kontributet e sigurimit shëndetësor**	**14,504**	**16,164**	**1,660**	**111.4%**
1	nga DPT në BSH	14,450	16,106	1,656	111.5%
2	nga ISSH (fermerët)	54	58	4	106.7%
II	**Transferta e buxhetit të shtetit, nga këto**	**34,913**	**36,638**	**1,725**	**104.9%**
1	Transfertë për shërbimin parësor	8,006	7,340	-666	91.7%
2	Transfertë për shërbimin spitalor	**26,907**	**29,298**	**2,391**	**108.9%**
3	Spitalet	22,623	22,856	234	101.0%
4	Tërheqje nga FSDKSH për paketat, bonus, VKM, PPP	4,284	6,441	2,158	150.4%
III	**Të ardhura të tjera**	**87**	**126**	**39**	**144.5%**
	Shpenzimet gjithsej	**49,692**	**51,960**	**2,268**	**104.6%**
I	**Rimbursimi i barnave e pajisjeve**	**11,057**	**11,506**	**449**	**104.1%**
II	**Shpenzime për kujdesin shëndetësor parësor**	**9,799**	**10,398**	**599**	**106.1%**
1	Financimi i QSH	9,507	9,522	15	100.2%
2	Kontrolli bazë	292	876	584	300.0%
III	**Shpenzimet administrative**	**878**	**889**	**11**	**101.3%**
IV	**Investime**	**22**	4	-18	17.8%
V	**Financime për shërbimin spitalor**	**27,936**	**29,164**	**1,228**	**104.4%**
1	*Financime për spitalet publike*	*24,138*	25,147	1,009	104.2%
2	*Shpenzime për paketat spitalore në privat*	*1,472*	1,470	-2	99.9%
3	*Shpenzime për trajtim pacienti me VKM*	*16*	12	-5	70.6%
4	*Shpenzimet –Bonusi për mjekët specialistë*	*13*	11	-2	82.8%
5	*Shpenzimet- PPP (dializa,sterilizimi)*	*2,297*	2,525	228	109.9%

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Nga auditimi mbi saktësinë e treguesve të buxhetit të vitit 2022, ka rezultuar:

Buxheti për FSDKSH është miratuar me Ligjin nr. 115/2021 datë 25.11.2021 "Për buxhetin e vitit 2022" ku në nenin 5 të tij, është përcaktuar që të ardhurat gjithsej dhe shpenzimet gjithsej, **janë të barabarta ne shumën 52,836 milionë lekë.** Të ardhurat e FSDKSH, përbëhen nga derdhja e kontributeve dhe të tjera në shumën 14,985 milionë lekë dhe transferta nga buxheti i shtetit në shumën 37,851 milionë lekë.

Gjithashtu, fondi për rimbursimin e medikamenteve nuk duhet të tejkalojë tavanin prej 11,000 milionë lekë, përfshirë detyrimet e prapambetura dhe rimbursimin e medikamenteve për kurimin e COVID-19. Fondi për shërbimin spitalor detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave.

Me VKM nr. 43, datë 19.01.2022 "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2022", është përcaktuar detajimi i transfertës për shërbimin spitalor në shumën 29,466 milionë lekë.

Buxheti i FSDKSH, referuar akteve të mësipërme është miratuar me VKA nr. 1, datë 15.02.2022 "Për miratimin e buxhetit të FSDKSH për vitin 2022" dhe VKA nr. 2, datë 15.02.2022 "Për financimin shtesë të spitaleve publike për realizimin e paketave të shërbimeve të miratuara me VKM të ofruara nga shërbimet spitalore për vitin 2022", në zbatim të VKM nr. 43, datë 19.01.2022 "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2022", ku financimi për paketat shëndetësore, të miratuara me VKM nr. 308, datë 21.05.2014 "Për miratimin e paketave të

shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga FSDKSH në shërbimin spitalor" është parashikuar në shumën 3,492 milionë lekë, nga e cila 1,326 milionë lekë për spitalet publike dhe 2,166 milionë lekë për spitalet jo publike. **Vendimmarrjet e KA, për miratimin e buxhetit të FSDKSH janë marrë 26 ditë pas miratimit të buxhetit të spitaleve me VKM.**

Mbi ndryshimet e buxhetit të vitit 2022, të FSDKSH:

Tabela nr.3.5 "Plani fillestar, ndryshimet dhe plani përfundimtar"

Në mijë lekë

Përshkrimi	Plan fillestar Miratuar me VKA nr. 1, datë 15.02.2022	Ndryshime me AN nr.12, datë 29.07.2022 VKA nr.11, datë 30.8.2022	Ndryshime me AN nr.17, datë 01.12.2022 VKA nr. 24, datë 19.12.2022	Ndryshime me VKA dhe VKM	Plan përfundimtar	Diferenca përfundimtar/Plan fillestar
I. Te ardhurat gjithsej	**52,836,000**	**0**	**0**	**0**	**52,836,000**	**0**
1. Kontributi i sigurimeve shëndetësore e të tjera	**14,985,000**	**775,000**	**270,000**		**16,030,000**	**1,045,000**
2. Kontribut i Buxhetit te Shtetit	**37,851,000**	**-775,000**	**-270,000**		**36,806,000**	**-1,045,000**
- *Parësor*	8,385,140	-775,000	-270,000		7,340,140	-1,045,000
- *Spitalor*	29,465,860				29,465,860	0
II. Shpenzimet gjithsej	**52,836,000**	**0**	**800,000**	**-800,000**	**52,836,000**	**0**
1. Rimbursimi i barnave e pajisjeve	**11,020,000**	**0**	**800,000**	**0**	**11,820,000**	**800,000**
Likuidimi i rimbursimit te barnave	11,000,000		800,000		11,800,000	800,000
Fisha diabeti (0-25) vjeç	20,000				20,000	0
2. Shpenzime për kujdesin shëndetësor parësor	**11,107,140**	**0**	**0**	**-637,000**	**10,470,140**	**-637,000**
- *Financim i QSH*	10,231,050			-637,000	9,594,050	-637,000
- *Kontrolli baze*	876,090				876,090	0
3. Financimi për shërbimin spitalor	**29,465,860**	**0**	**0**	**0**	**29,465,860**	**0**
- *Paketat e shërbimeve*	3,492,230			-416,695	3,075,535	-416,695
- *Trajtime me VKM*	30,000			0	30,000	0
- *Transferta për individë*	30,000			-10,000	20,000	-10,000
- *Pagesa të shërbimeve PPP-Dializa*	835,000			0	835,000	0
- *Pagesa të shërbimeve PPP-Sterilizim*	1,700,000			0	1,700,000	0
- *Pagesa të shërbimeve PPP-Laborator*	1,574,900			64,102	1,639,002	64,102
- *Shpenzime 600, 601, 602*	21,803,730			362,593	22,166,323	362,593
4. Shpenzime administrative	**1,070,000**				**1,070,000**	**0**
5. Investime	**173,000**			**-163,000**	**10,000**	**163,000**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Nga grupi i auditimit u shqyrtuan të gjitha aktet të cilat kanë sjellë ndryshim të planit të buxhetit të vitit 2022. Buxheti fillestar nuk ka pësuar ndryshime në totalin e të ardhurave dhe shpenzimeve, të cilat paraqiten në shumën 52,836,000 mijë lekë, por fondet sipas programeve, institucioneve shëndetësore, shërbimeve si dhe zërave buxhetore kanë pësuar ndryshimet si më poshtë:

- Gjatë vitit 2022, buxheti fillestar i FSDKSH ka pësuar dy ndryshime me AN, të cilat nuk kanë prekur të ardhurat dhe shpenzimet në total. Konkretisht në planin e të ardhurave:

- Me Aktin Normativ nr. 12, datë 29.07.2022, janë rritur të ardhurat nga kontributet shëndetësore e të tjera me 775 milionë lekë dhe është pakësuar transferta e buxhetit (programi i shërbimit parësor) me të njëjtën vlerë. Ndryshimi është reflektuar në Vendimin e Këshillit Administrativ nr. 11, datë 30.08.2022.
- Me Aktin Normativ nr. 17, datë 01.12.2022, janë rritur të ardhurat nga kontributet shëndetësore e të tjera me 270 milionë lekë dhe është pakësuar transferta e buxhetit (programi i shërbimit parësor) me të njëjtën vlerë. Gjithashtu, është rritur tavani për rimbursimin e medikamenteve me 800 milionë lekë. Sipas këtij Akti: "Fondi për rimbursimin e barnave nuk tejkalon tavanin prej 11,800 milionë lekësh, përfshirë detyrimet

e prapambetura dhe rimbursimin e barnave për kurimin e Covid-19.” Ndryshimi është reflektuar në Vendimin e Këshillit Administrativ nr. 24, datë 19.12.2022.

- Gjithashtu gjatë vitit 2022 kanë në ndodhur transferime fondesh të cilat kanë prekur si shërbimin parësor po ashtu dhe shërbimin spitalor. Të përmbledhura, këto ndryshime sipas akteve përkatëse që kanë ndryshuar buxhetin paraqiten:

- VKA nr. 12, datë 30.08.2022 “Për shpërndarje të buxhetit të shërbimit spitalor për vitin 2022”. Rezerva e krijuar nga fondet e pa shpenzuara është ri shpërndarë për shërbimin spitalor në shumën 657,700 mijë lekë, në total për 29 spitale. Kjo shpërndarje ka të bëjë me pakësim në artikullin 600 (paga) në shumën 123,000 mijë lekë; shtesë në artikullin 601 (sigurime) në shumën 20,270 mijë lekë; shtesë në artikullin 602 (mallra, shërbime) në shumën 760,430 mijë lekë, për barna, mjekime, shpenzime transporti, mirëmbajtje aparaturash, detyrime për vendime gjyqësore etj.
- VKA nr. 17, datë 04.10.2022 “Për shpërndarje nga rezerva e buxhetit të shërbimit spitalor për vitin 2022”. Rezerva e krijuar nga fondet e pa shpenzuara është ri shpërndarë për shërbimin spitalor në shumën 938,133 mijë lekë në total për 29 spitale, e cila ka të bëjë me shpërndarje në 29 spitalet në shumën 938,133 mijë lekë, shtim në artikullin (602) mallra e shërbime.
- VKA nr. 20, datë 11.11.2022 “Për rishpërndarje të fondeve nga buxheti shërbimit spitalor për vitin 2022 dhe shpërndarje të fondeve të buxhetit të shërbimit spitalor”. Kjo rishpërndarje ka të bëjë me pakësim në artikullin (600) paga në shumën 241,276 mijë lekë, shtesë në artikullin (601) sigurime në shumën 780 mijë lekë; shtesë në artikullin (602) mallra e shërbime në shumën 322,035 mijë lekë dhe shtesë në artikullin (604) transfertë e brendshme në shumën 110,696 mijë lekë.

- Ndryshimet me VKM paraqiten si më poshtë:

- VKM nr. 615, datë 22.09.2022, janë prekur artikujt 600, 601 dhe 602 (Paketat) të cilat janë pakësuar dhe janë shtuar fonde në 602, përfshirë dhe Laboratorët, dhe 604 (Paketa), në shumën totale 1,391,740 mijë lekë.
- VKM nr. 898, datë 29.12.2022 “Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe institucionet e arsimit të lartë”, miratuar me VKA nr. 29, datë 30.12.2022, sipas të cilit kanë përfituar shpërblim 12 mijë punonjës të shërbimit spitalor dhe 9,200 punonjës të shërbimit parësor. Fondet janë siguruar nga fonde të papërdorura për shërbimin spitalor si dhe fondi i veçantë për shërbimin parësor. Transferimet janë në shumën 153,120 mijë lekë.

- Plani i të ardhurave në total është 52,836,000 mijë lekë dhe nuk ka pësuar ndryshime. Ndryshimet e planit fillestar të të ardhurave janë sipas AN nr. 12 dhe 17, me rritje të planit të kontributeve me 1,045,000 lekë dhe pakësim të financimit nga buxheti i shtetit në ketë vlerë.
- Plani i shpenzimeve në total është 52,836,000 mijë lekë dhe nuk ka pësuar ndryshime, por referuar detajimit të tij sipas destinacionit, ky plan ka ndryshuar si më poshtë:

a. *Plani i shpenzimeve për rimbursim barnash me 800,000 mijë lekë më shumë, sipas AN nr. 17, datë 01.12.2022;*

Ky plan është shpërndarë gjithë DRF, sipas detajimit përkatës.

b. *Planin e shërbimit parësor me 637,000 mijë lekë më pak;*

Plani fillestar i buxhetit për shërbimin parësor është në shumën 11,107,140 mijë lekë, duke përfshirë dhe KMB në shumën 876,0902 mijë lekë, ndërsa plani përfundimtar është në shumën 10,470,140 mijë lekë, nga e cila fondet e KMB në shumën 876,090 mijë lekë. Ndryshimi kundrejt planit fillestar të fondeve për financimin e qendrave shëndetësore (Shërbimi parësor) është në shumën 637,000 mijë lekë më pak, referuar VKA nr. 24, datë 19.12.2022, në zbatim të AN nr. 17, datë 01.12.2022.

Tabela nr.3.6 "Ndryshimi i planit të shërbimit parësor në vitin 2022"

Në mijë lekë

DRF	Plan fillestar	Plan përfundimtar	Ndryshimi plan përfundimtar/plan fillestar
Berat	570,892	572,852	1,960
Dibër	587,656	593,587	5,931
Durrës	937,883	957,961	20,078
Elbasan	946,263	952,525	6,262
Fier	530,034	531,578	1,544
Lushnje	348,224	349,274	1,050
Gjirokastër	441,756	446,064	4,308
Korçe	539,261	550,761	11,500
Pogradec	207,682	210,675	2,993
Kukës	252,889	257,668	4,779
Tropoje	143,688	146,018	2,330
Lezhe	467,593	474,793	7,200
Shkodër	802,619	811,938	9,319
Tirane	1,727,444	1,643,566	(83,878)
Kamez-vore	337,439	330,042	(7,397)
Vlore	515,515	518,805	3,290
Sarande	185,855	197,767	11,912
FSDKSH	50,000	46,000	(4,000)
Kontrolli baze	876,090	876,090	0
Rezerve	638,358	2,176	(636,182)
TOTALI	**11,107,140**	**10,470,140**	**(637,000)**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Nga shqyrtimi i transferimeve buxhetore ndërmjet DRF, ka rezultuar se gjatë vitit janë kryer shtesa dhe pakësime fondesh ndërmjet DRF-ve dhe respektivisht qendrave shëndetësore që mbulojnë. Kështu në DRF Dibër, Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Kukës, Tiranë janë kryer mbi 10 transferime fondesh buxhetore (shtesa dhe pakësime), sipas *Tabelës anekse nr.3.1 "Transferimet buxhetore ne QSH".*

c. *Plani i paketave shëndetësore ka ndryshuar me 416,000 mijë lekë më pak;*
Sipas VKA nr. 2, datë 15.02.2022 "Për financimin shtesë të spitaleve publike për realizimin e paketave të shërbimeve të miratuara me VKM të ofruara nga shërbimet spitalore për vitin 2022", fondi për financimin e paketave është parashikuar në shumën 3,492 milionë lekë, nga e cila 1,326 milionë lekë për spitalet publike dhe 2,166 milionë lekë për spitalet jo publike, ndërsa në planin përfundimtar, financimi i paketave për spitalet publike është në shumën 1,626 milionë lekë dhe për paketat në spitalet publike në shumën 1,449 milionë lekë. Financimi i paketave, përveç pakësimit të fondit total në shumën 416 milionë lekë, ka rritje të financimit për spitalet publike me 123 milionë lekë dhe ulje të financimit të paketave në spitalet jo publike me 540 milionë lekë, krahasuar me planin fillestar.

d. *Plani për shërbimin spitalor në total nuk ka pësuar ndryshime, por sipas destinacionit brenda programit ndryshimet paraqiten si më poshtë:*
Gjatë vitit 2022, buxheti i shërbimit spitalor ka pësuar ndryshime referuar institucioneve të shërbimit spitalor, llojit të shërbimeve të ofruara, si dhe zërave buxhetorë, por duke mos ndryshuar totalin e shpenzimeve në shumën 29,465,860 mijë lekë të miratuar me VKM nr. 43, datë 19.01.2022. Këto ndryshime paraqiten në tabelat e mëposhtme.

Tabela nr. 3.7 "Buxheti i shërbimit spitalor me ndryshime 2022"

Në mijë lekë

Institucionet	Plan fillestar	Plan përfundimtar	Ndryshimi
Spitalet publike	20,774,400	22,964,073	2,189,673
Spitali Fier dhe Durrës	2,004,800	2,290,462	285,662
Paketat spitalore total	3,492,230		(1,865,905)
Paketat spitale privat		1,626,325	
Transferta për mjekë	30,000	20,000	(10,000)
Trajtime me VKM	30,000	30,000	0
Pagesa PPP	2,535,000	2,535,000	0
Fondi rezervë	599,430	0	(599,430)
Totali	**29,465,860**	**29,465,860**	**0**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Referuar të dhënave të planit përfundimtar të shpenzimeve për shërbimin spitalor, gjatë vitit 2022, ka patur këto ndryshime:

- shpenzimet sipas destinacionit gjatë vitit 2022 kanë pësuar ndryshime me rritje të planit për spitalet publike në shumën 2,190 milionë lekë, ku pjesën kryesore e zë transferta për spitalet publike i buxhetit të paketave për spitalet publike në shumën 1,449 milionë lekë, transferuar nga buxheti i paketave tek spitalet publike dhe rishpërndarja e fondit rezervë në shumën 599,430 mijë lekë, referuar pikës 9 të VKM-së 43/2022;
- pakësim të buxhetit të paketave spitalore në total, me 416 milionë lekë dhe transferim të buxhetit të paketave për spitalet publike te buxheti i tyre, pasi në plan përfundimtar ky zë përfaqëson vetëm buxhetin e paketave për spitalet private në shumën 1,626 milionë lekë.

Konkluzion: Transferimet e fondeve buxhetore gjatë vitit 2022, si në shërbimin spitalor dhe atë parësor kryesisht janë për shkak të:

- Ndryshime në artikujt 600, 604 dhe 606 si rezultat i shpërblimit, sipas VKM nr. 898, datë 29.12.2022 "Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe institucionet e arsimit të lartë", miratuar me VKA nr. 29, datë 30.12.2022, të cilat kanë prekur shërbimin spitalor dhe parësor;
- Ndryshime në artikullin 600 dhe 601 për shkak të ndryshimit të pagës bazë për disa kategori të punonjësve, sipas VKA përkatëse, të cilat kanë prekur shërbimin spitalor dhe parësor;
- Shtesat në artikullin 604 "PPP e sterilizimit", për shkak të shpërndarjes së fondit, nga fondi i planifikuar por i pashpërndarë në fillim të vitit buxhetor të cilat kanë prekur DRF;
- Shtesat në artikullin 602 "Laboratori", për shkak të shpërndarjes së fondit, nga fondi i planifikuar por i pashpërndarë në fillim të vitit buxhetor, të cilat kanë prekur shërbimin spitalor;
- Shtesat në artikullin 606 "transfertë e mjekëve specialistë", për shkak se çelja e fondeve bëhet rast pas rasti sipas kontratave të lidhura dhe masës së shpërblimit;
- Shtesat në artikullin 606 "Rimbursim barnash", për shkak të shpërndarjes së fondeve për rimbursimin e barnave të shtesës me AN nr. 17, datë 01.12.2022, në shumën 800 milionë lekë miratuar me VKA nr. 24, datë 19.12.2022. Ky fond shtesë për rimbursimin e barnave i është shpërndarë secilës DRF me shkresat përkatëse më datë 22.12.2022;
- Rishpërndarjes së rezervës së krijuar gjatë vitit.

Ndryshimet në buxhetin e FSDKSH janë miratuar me VKA.

Ndryshimet që kanë prekur llogarinë 600 dhe 601 (paga dhe sigurime shoqërore):

VKA-të nr.8, datë 19.07.2022, nr. 19, datë 04.10.2022 dhe nr. 21, datë 11.11.2022 "Për miratimin e disa ndryshimeve në udhëzimin për mënyrën e pagesës dhe shpërblimit për

punonjësit e qendrave shëndetësore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor".

Rishpërndarje nga rezerva e krijuar, me VKA e mëposhtme:

VKA-të nr.12, datë 30.08.2022, nr. 17, datë 04.10.2022, nr. 20, datë 11.11.2022 dhe nr. 29, datë 30.12.2022 "Për shpërndarjen nga Rezerva e Buxhetit të shërbimit spitalor për vitin 2022".

Mbi treguesit e buxhetit të FSDKSH për vitin 2022, të ardhurat, shpenzimet dhe rakordimi i tyre.

Të ardhurat dhe shpenzimet e FSDKSH në total janë planifikuar në shumën 52,836 milionë lekë. Në totalin e të ardhurave, Financimi nga buxheti i shtetit në shumën 36,806 milionë lekë, zë 69.6 % dhe të ardhurat nga kontributet në shumën 16,030 milionë lekë, zënë 30.4 %. Shpenzimet janë planifikuar në shumën 52,836 milionë lekë. Shpenzimet për shërbimin spitalor zënë 55,7 %; shpenzimet për rimbursimin e barnave dhe pajisjeve mjekësore zënë 22.4 %, shpenzimet për shërbimin parësor zënë 19.8 % të totalit të shpenzimeve, si dhe shpenzimet administrative dhe investime zënë 2 % të totalit të shpenzimeve.

Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave të FSDKSH, për vitin 2022.

Të ardhurat e FSDKSH, përbëhen nga tre grupe, nga të ardhurat e mbledhura nga derdhja e kontributeve në shumën 15,930,000 mijë lekë (të ardhura nga kontributet) të ardhurat nga financimi i buxhetit të shtetit në shumën 36,806,000 mijë lekë, si dhe të ardhura të tjera (jo tatimore) të krijuara gjatë vitit (interesa, gjoba e kamatëvonesa, qira, shërbime administrative, etj.), të cilat janë planifikuar në shumën 100,000 mijë lekë. *Në nivel DRF paraqiten në Tabelën anekse nr.3.2 "Të ardhura të realizuara në nivel DRF, për vitin 2022".*

Tabela nr.3.8 "Treguesit e buxhetit mbi të ardhurat e vitit 2022"

Milionë lekë

Nr.	Zërat e të ardhurave	Viti 2022			Fakt (cash) /Plan viti 2022		Fakt konstatuar/ Plan viti 2022	
		Plani	Fakti cash	Fakti konst.	Diferenca vlerë	Realiz %	Diferenca vlerë	Realiz %
	Të ardhurat gjithsej	**52,836**	**52,456**	**52,928**	**-380**	**99.3**	**92**	**100.2**
I	**Kontributet e sigurimit shëndetësor**	**15,930**	**15,692**	**16,164**	**-238**	**98.5**	**234**	**101.5**
1	nga DPT në BSH	15,625	15,636	16,106	11	100.1	481	103.1
2	nga ISSH (fermerët)	305	56	58	-249	18.3	-247	18.9
II	**Transferta e buxhetit të shtetit, nga këto**	**36,806**	**36,638**	**36,638**	**-168**	**99.5**	**-168**	**99.5**
1	Transfertë për shërbimin parësor	7,340	7,340	7,340	0	100.0	0	100.0
2	Transfertë për shërbimin spitalor	29,466	29,298	29,298	-168	99.4	-168	99.4
3	Spitalet	22,964	22,856	22,856	-108	99.5	-108	99.5
4	Tërheqje nga FSDKSH bonus mjekë, VKM trajtim	6,502	6,441	6,441	-60	99.1	-60	99.1
III	**Të ardhura të tjera**	**100**	**126**	**126**	**26**	**126.0**	**26**	**126.0**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Tabela nr.3.9 "Të ardhurat sipas burimit 2022/2021"

Në milionë lekë

Nr.	Të ardhurat sipas burimit	Viti 2021	Viti 2022	Raporti në % të ardhura 2022/2021
1	Financimi nga buxheti	34,913	36,638	104.9
2	Të ardhura nga kontributet	14,616	15,692	107.4
3	Të ardhura të tjera	87	126	144.8
4	**Totali**	**49,616**	**52,456**	**105.7**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Siç shihet nga të dhënat realizimi i të ardhurave, referuar tre burimeve të krijimit është në rritje me 5.7 % krahasuar me vitin 2021.

Financimi nga buxheti i shtetit në vitin 2022, kundrejt vitit 2021 është rritur me 4.9 %; të ardhurat nga kontributet në vitin 2022 kundrejt vitit 2021, janë rritur me 7.4 %; si dhe të ardhurat e tjera janë rritur me 44.8 %.

Financimi nga buxheti i shtetit:

Financimi nga buxheti i shtetit, në total nga 36,806 milionë lekë të planifikuara, është përdoruar në shumën 36,638 milionë lekë dhe zë peshën specifike kryesore kundrejt totalit të planifikuar të të ardhurave me 69.9 % dhe 69.2 % kundrejt faktit të të ardhurave në total. Mospërdorimi në shumën 168 milionë lekë është rezultat i tejkalimit të të ardhurave nga kontributet e të tjera, si dhe i mosrealizimit të shpenzimeve. Përdorimi i financimit nga buxheti i shtetit në shumën 36,638 milionë lekë, është konfirmuar me akt rakordimet përkatëse.

Sipas destinacionit fakti (përdorimi i këtyre të ardhurave) paraqitet:

a. Transferta për shërbimin parësor u realizua në vlerën 7,340 milionë lekë, ose në masën 100% të planit. Me transfertën e shërbimit parësor është mbuluar financimi i Qendrave Shëndetësore, si dhe pagesat e kontrollit mjekësor bazë për grup moshat 35-70 vjeç;
b. Transferta për shërbimin spitalor (publik dhe privat) nga 22,964 milionë lekë të planifikuara, u realizuan në vlerën 22,856 milionë lekë, ose në masën 99.5 % të planit, me mos realizim 108 milionë lekë;
c. Tërheqje nga FSDKSH për bonuse, trajtime me VKM etj., nga 6,502 milionë lekë të planifikuara u realizuan në shumën 6,441 milionë lekë, ose në masën 99 %, me mosrealizim në shumën 61 milionë lekë.

Të ardhurat nga kontributet dhe të tjera:

Sipas Ligjit nr. 115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022", këto të ardhura janë planifikuar në shumën 16,030 milionë lekë. Të cilat sipas VKA nr. 1, datë 15.02.2022 "Për miratimin e buxhetit të FSDKSH për vitin 2022" janë detajuar në të ardhura nga kontributet në shumën 15,930 milionë lekë dhe të ardhura të tjera në 100 milionë lekë. Realizimi i tyre kundrejt planit dhe të ardhurat e transferuara në llogarinë e FSDKSH paraqiten si më poshtë:

Tabela nr.3.10 "Të ardhurat sipas burimit 2022 "

Në mijë lekë

Të ardhura nga kontributet	Plan	Të realizuara	Të realizuara dhe kaluar në llogarinë e FSDKSH	Diferenca Realizim Plan	Diferenca Realizim kaluar në FSDKSH
	1	2	3	4= (2-1)	5= (2-3)
DPT	15,625,000	16,100,358	15,630,000		**470,358**
ISSH	305,000	57,693	55,807		**1,886**
FSDKSH kontribute naftëtarë		6,067	6,067		**0**
FSDKSH të tjera jo kontributive	100,000	126,000	126,000		**0**
Totali	**16,030,000**	**16,290,118**	**15,692,000**		**472,244**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

- Të ardhurat nga kontributet janë realizuar në shumën 16,290 milionë lekë, nga 16,030 milionë lekë të planifikuara, me një realizim në masën 100.8 %, po ti referohemi të ardhurave të realizuara nga kontributet dhe të ardhurave nga interesa kredie, bono thesari, çdëmtimet etj.. Të ardhurat e mbledhura nga DPT dhe ISSH për llogari të FSDKSH si dhe nga vetë FSDKSH në shumën 16,164 milionë lekë, përbëhen nga 16,100 milionë lekë kontribute DPT; 6 milionë lekë kontribute naftëtarë derdhje nga buxheti (llog. FSDKSH); 58 milionë lekë kontribute ISSH; dhe 0.306 milionë lekë të ardhura të tjera kontribute vullnetare FSDKSH.

- Nga të ardhurat e mbledhura nga kontributet në shumën 16,164 milionë lekë, është transferuar në llogarinë e FSDKSH shuma 15,692 milionë lekë, nga të cilat 15,630 milionë nga DPT, 56 milionë lekë nga ISSH dhe të ardhura të tjera dhe kontribute FSDKSH në shumën 6 milionë lekë.
- Diferenca në shumën 472 milionë lekë midis realizimit të të ardhurave dhe transferimit në llogarinë e FSDKSH (16,164-15,692), përbën të drejta të arkëtueshme të FSDKSH.

Në të ardhurat e tjera përfshihen kontribute vullnetare dhe të ardhura të cilat mblidhen nga strukturat e FSDKSH: Këto të ardhura janë realizuar për 126 milionë lekë nga 100 milionë lekë të planifikuara. Të detajuara paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr.3.11 "Realizimi i të ardhurave të tjera viti 2022"

Në mijë lekë

Nr.	Përshkrimi	Plan	Fakt	Realizimi në vlerë	Në %
1	Sigurime Vullnetare	-	306	-	-
2	Të ardhura nga interesat e depozitave	-	98,074	-	-
3	Të ardhura nga bashkë pagesa	-	672	-	-
4	Të ardhura nga shitja	-	6	-	-
5	Të ardhura nga ç'dëmtimet	-	25,551	-	-
6	Sponsorizime nga të tretë	-	1,390	-	-
7	**Totali**	**100,000**	**125,998**	**+25,998**	**126**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Siç shihet nga të dhënat e tabelës së mësipërme pjesën më të rëndësishme të të ardhurave të tjera e zënë *të ardhurat nga interesat e depozitave* në shumën 98,074 mijë lekë, nga të cilat 96,793 mijë lekë si rezultat i investimit të Fondit Rezervë të FSDKSH në tituj qeverie (bono thesari me afat maturimi 12 mujor), në shumën 3,200,000 mijë lekë, paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.3.12 "Të ardhurat nga investimi në Fondin Rezervë në BTH me afat 1 vjeçar"

Në mijë lekë

Afati i investimit	Vlera e nominale e investimit në bono	Çmimi i blerjes nga banka	Interesi bruto, pallog 15% të tatimit	15% i llog. nga FSDKSH	Interesi neto nga titujt
2021	1,829,300	1,795,283	34,017	5,103	28,914
2022	3,200,000	3,086,126	113,874	17,081	96,793
Diferenca 2022/2021					**67,879**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Përdorimi i fondit rezervë të FSDKSH, është përcaktuar me VKA nr. 10, datë 19.07.2022 "Për mënyrën e përdorimit të fondit rezervë për vitin 2022", ku është vendosur që FSDKSH të investojë dhe ri investojë deri në masën 100 %, fondin rezervë në bono thesari. Të ardhurat nga investimi i fondit rezervë në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021, janë 67,879 mijë lekë më shumë, për shkak të rritjes së vlerës së investimit dhe të çmimit të blerjes.
Me miratimin e Llogarive vjetore të FSDKSH për vitin 2021, me VKA nr. 6, datë 13.05.2022, është vendosur që shuma prej 700 milionë lekë e transferuar në llogari bankare të nivelit të dytë të kthehet në llogarinë Fondit Rezervë në BSH. Llogaria e fondit rezervë nga 3,300 milionë të bëhet 4,000 milionë lekë.
Investimi i fondit rezervë është kryer në muajin shtator 2021, për shkak se investimi i vitit të mëparshëm është maturuar më datë 01.09.2022.

Të ardhurat nga ç'dëmtimet paraqiten në shumën 25,551 mijë lekë dhe kanë të bëjnë me arkëtimin e detyrimeve, gjobave dhe penalitete të subjekteve.
Të ardhura nga sigurimi vullnetar të realizuara nga FSDKSH përgjatë vitit 2022, paraqiten në shumën 306 mijë lekë. Këto të ardhura zënë peshë specifike të ulët me 0.24 % të të ardhurave të tjera.

Mbi rakordimin e të ardhurave:

Rakordimi i financimit nga buxheti i shtetit:

FSDKSH, sipas strukturave të mbledhjes së të ardhurave kryen dhe rakordimet mbi realizimin faktik të tyre, të cilët në fund të vitit 2022 paraqiten:

Tabela nr.3.13 "Transferta e buxhetit të shtetit"

Në milionë lekë

Përshkrimi	Plan	Fakt total	Fakt total nga i cili:	
			Fakt FSDKSH Degë thesari	Fakt spitale Transfertë e brendshme
Transfertë për shërbimin parësor	7,340	7,340	7,340	-
Transfertë për shërbimin spitalor	**29,466**	**29,298**	**-**	**-**
Spitalet	22,964	22,856	-	22,856
Tërheqje nga FSDKSH për trajtime VKM, Bonus mjekë	6,502	6,442	6,442	-
Totali	**36,806**	**36,638**	**13,782**	**22,856**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Rakordimi me Degën e Thesarit Tiranë. Financimi nga buxheti, sipas shkresës nr. 384 prot., datë 30.01.2023 "Rakordimi për transfertat nga kontributi i buxhetit të shtetit për periudhën Janar-Dhjetor 2022", të përdorur nga FSDKSH, konfirmuar nga Dega e Thesarit Tiranë dhe sipas nxjerrjes së llogarisë është në shumën 13,782 milionë lekë sipas tabelës së mëposhtme dhe rakordimi i buxhetit të financimit të spitaleve sipas *tabelës anekse nr. 3.2.*

Tabela nr.3.14 "Aktrakordimi më Degën e Thesarit Tiranë"

Në mijë lekë

	Përshkrimi	Transferta e buxhetit		
		Plani arkës	Realizimi faktik	Fakt Thesari
I	**Transferta e buxhetit për parësorin**	**7,340,140**	**7,340,140**	**7,340,140**
	Vizita në kujdesin parësor	1,378,171	1,378,171	1,378,171
	Check up	876,090	876,090	876,090
	Trajtim me rimbursim recete	5,085,879	5,085,879	5,085,879
II	**Transferta e buxhetit për spitalorin**	**6,501,787**	**6,501,787**	**6,441,482**
	Pacientë të trajtuar me shërbim spitalor	3,834,496	3,834,496	3,834,496
	Pacientë të trajtuar me dializë	2,429,325	2,369,020	2,369,020
	Pacientë të trajtuar me paketa të kardiologjisë	127,300	127,300	127,300
	Pacientë të trajtuar me paketa të transplanteve	30,000	30,000	30,000
	Pacientë të trajtuar me katarakte	7,000	7,000	7,000
	Ekzaminime laboratorike	73,666	73,666	73,666
	Pacientë të trajtuar me radioterapi	0	0	0
III	**Limiti**	**13,841,927**		
IV	**Totali i transfertës**		**13,781,622**	**13,781,622**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Rakordimi i të ardhurave nga kontributet:

Rakordimi me DPT, sipas shkresës së FSDKSH nr. 165 prot., datë 13.01.2023 "Dërgohet aktrakordimi për arkëtimet dhe transferimet e të ardhurave nga kontributet e sigurimit

shëndetësor për vitin 2022", e konfirmuar me shkresën e MFE nr. 1372/1 prot., datë 26.01.2023, ku të ardhurat nga kontributet e mbledhura nga DPT janë në shumën 16,100,359 mijë lekë dhe transferuar nga TSA janë në shumën 15,630,000 mijë lekë.

Tabela nr.3.15 "Aktrakordimi me DPT-TSA"

Në lekë

Të ardhura nga kontributet	Gjendje 01.01.2022	Të ardhura nga kontributet	Transferta nga TSA	Gjendje 31.12.2022
DPT	168,256,503	16,100,358,425	**15,630,000,000**	638,614,928

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore në total janë në shumën 16,100,359 mijë lekë dhe përbëhen nga të ardhura tatimore në shumën 16,027,495 mijë lekë dhe të ardhura jo tatimore (nga gjoba dhe penalitete) në shumën 72,864 mijë lekë.
Shuma e transfertës nga TSA rakordon me faktin e të ardhurave të raportuara nga FSDKSH, në shumën 15,630,000 mijë lekë. Gjendja në 31.12.2022 në shumën 638,614 mijë lekë është e paraqitur në pasqyrat financiare të vitit 2022 dhe përfaqëson të drejta të arkëtueshme, nga e cila 168,256 mijë lekë të mbartura dhe 470,358 mijë lekë të krijuara në vitin 2022, si diferencë midis të ardhurave nga kontributet dhe transfertës nga TSA (16,100,358-15,630,000). Kjo vlerë derdhet në vitin pasardhës në llogarinë e FSDKSH.

Rakordimi me ISSH, sipas aktrakordimit të ISSH, kontributet e mbledhura dhe të transferuara në FSDKSH nga ISSH, janë në shumën respektive 57,693,336 lekë dhe 55,806,530 lekë.

Tabela nr.3.16 "Aktrakordimi me FSDKSH-ISSH"

Në lekë

Të ardhura nga kontributet	Gjendje 01.01.2022	Të ardhura nga kontributet	Transferta nga ISSH	Gjendje 31.12.2022
Kontribute Fermerët (ISSH)	6,111,095	**57,693,336**	**55,806,530**	7,997,901
Buxheti i përgjithshëm	215,495,313			215,495,313
Totali	221,606,408	**57,693,336**	**55,806,530**	223,493,214

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Gjendja në 31.12.2022, në shumën 223,493 mijë lekë është e paraqitur në pasqyrat financiare të vitit 2022 dhe përfaqëson të drejta të arkëtueshme, nga e cila 221,606 mijë lekë të mbartura dhe 1,887 mijë lekë të krijuara në vitin 2022, si diferencë midis të ardhurave nga kontributet dhe derdhjes në llogarinë e FSDKSH (57,693-55,806). Kjo vlerë derdhet në vitin pasardhës në llogarinë e FSDKSH.

Konkluzion: Të ardhurat e alokuara nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat e realizuara nga kontribute e të tjera, janë të rakorduara me strukturat përgjegjëse për mbledhjen e tyre, si DPT, ISSH dhe Degë Thesari. Të ardhurat nga financimi i buxhetit të shtetit sipas planit përfundimtar në shumën 36,806 milionë lekë dhe rakordimit të faktit në shumën 36,638 milionë lekë, janë realizuar në masën 99.5 %, për rrjedhojë shpenzuar 168 milionë lekë më pak fonde të buxhetit të shtetit.
Të ardhurat e FSDKSH, nga realizimi i të ardhurave nga kontributet dhe të tjera, të planifikuara në shumën 16,030 milionë lekë, janë realizuar në shumën 16,164 milionë lekë, nga të cilat 16,100 milionë (DPT); 58 milionë lekë (ISSH) dhe 6 milionë (FSDKSH, kontribute e të tjera), ose në masën 100.8 %.
Gjithashtu, u verifikua saktësia e raportimit në raport me Treguesit Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, ku rezultoi se plani i të ardhurave nga kontributet, plani dhe realizimi i shpenzimeve është i njëjtë, ndërsa përsa i përket realizimit të të ardhurave, nga FSDKSH të

ardhura të realizuara në total janë raportuar në shumën 16,164 milionë lekë të mbledhura dhe 15,692 milionë lekë të hyra në llogarinë e FSDKSH, ndërsa nga MFE realizimi i tyre sipas Treguesve Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, është raportuar në shumën 16,266 milionë lekë, ose në masën 101.47 % kundrejt planit, me një diferencë midis raportimeve (MFE/FSDKSH) në shumën 102 milionë lekë më shumë, referuar të ardhurave të mbledhura nga kontributet dhe *të tjera.*

Titulli i gjetjes:	**Mbi përputhshmërinë e treguesve buxhetorë të FSDKSH në raport me Treguesit Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit të vitit 2022.**
Situata:	Nga auditimi mbi saktësinë e raportimit të planit dhe faktit të të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe rezultatit fiskal të FSDKSH ka rezultuar mospërputhje midis të dhënave të rakorduara dhe raportuara nga FSDKSH dhe të dhënave të raportuara nga MFE, në Tabelën e Treguesve të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, në lidhje me faktin e të ardhurave të realizuara nga derdhja e kontributeve dhe të tjera. Nga krahasimi i të ardhurave të realizuara nga FSDKSH, kontributet dhe të tjera referuar akt rakordimeve të mbajtura me DPT, ISSH dhe derdhje direkte në llogarinë e FSDKSH me të dhënat e Tabelës së "Treguesve Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit", pjesë e Ligjit nr. 115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022", Kapitulli II.3 "Të ardhurat nga fondet speciale", **rezulton se fakti i të ardhurave ka mos përputhje për shumën 102 milionë lekë, të deklaruara më shumë nga MFE.** Sipas të dhënave të MFE fakti i të ardhurave nga fondet speciale (sigurimet shëndetësore) paraqiten në vlerën 16,266 milionë lekë, ndërsa nga FSDKSH, janë deklaruar 16,164 milionë lekë (të konstatuara), si dhe lëvizje cash në llogarinë e FSDKSH në shumën 15,692 milionë lekë.
Kriteri:	- Ligji 115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022" dhe VKM si më poshtë: - Aktrakordimi me DPT nr. 165 prot., datë 13.01.2023 "Dërgohet aktrakordimi për arkëtimet dhe transferimet e të ardhurave nga kontributet e sigurimit shëndetësor për vitin 2022", e konfirmuar me shkresën e MFE nr. 1372/1 prot., datë 26.01.2023; - Akt rakordimi nr.1372/3 prot., datë 27.01.2023 të MFE dhe nr. 738/1, datë 27.01.2023 të ISSH, për periudhën 12 mujore 2022, të konfirmuara nga dy institucionet, për të ardhurat nga sigurimet shëndetësore dhe shoqërore.
Ndikimi/pasoja:	Mos raportim dhe analizë jo e saktë e treguesve buxhetorë.
Shkaku:	Mungesë ndërveprimi midis institucioneve, në saktësimin e shifrave të buxhetit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Titullari i FSDKSH dhe Drejtoria e Financës, të marrin masa që në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të shqyrtojnë mospërputhjet me Treguesit e Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, përsa i përket fondeve për sigurimet shëndetësore, të raportuara në Kapitullin II "Të ardhurave tatimore"; II.3.1 "Të ardhura nga Fondet Speciale", për të ardhurat nga kontributet shëndetësore dhe të tjera (FSDKSH).

Mbi debitorët, të drejta të arkëtueshme, FSDKSH.

Nga rakordimet e mësipërme ka rezultuar se kontributet shëndetësore të mbledhura dhe të pa kaluara në llogarinë e FSDKSH, deri me datë 31.12.2022 janë në shumën 862 milionë lekë dhe përfaqësojnë llogari të arkëtueshme, të detajuar si më poshtë.

Shuma e pa kaluar në llogarinë e FSDKSH për të ardhurat nga kontributet e mbledhura nga DPT në shumën 638,614,928 lekë sipas rakordimit me DPT dhe të ardhura nga kontributet e mbledhura sipas rakordimit me ISSH, por të pa kaluara në llogarinë e FSDKSH në shumën 223,493,214 lekë (shuma totale 862,108,142 lekë). Kjo shumë është e pasqyruar në aktiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar të FSDKSH, në klasën 4 "Llogari të arkëtueshme", llogaria 411 "Klientë dhe llogari të ngjashme", në shumën 862,108,142 lekë dhe paraqet gjendjen debitore të FSDKSH, e cila sipas rajoneve paraqitet në tabelën nr. 3.18.

Tabela nr. 3.17 "Detyrimet"

Në lekë

DRF/Degët	Llog.411			
	Klientë e llogari të ngjashme (ISSH/DPT)	**ISSH detyrim mbartur**	**Ministria e Financave (DPT)**	**ISSH - kontribut i fermerëve 2022**
Dr. Qendrore	854,110,240	215,495,312	638,614,928	
DR Berat	369,405	369,405		
DR Dibër	514,349	514,349		
DR Durrës	726,214	726,214		
DR Elbasan	1,085,006	1,085,006		
DR Fier	981,715	981,715		
DR Gjirokastër	394,209	394,209		
DR Korçë	913,896	913,896		
D. Pogradec	214,838	214,838		
DR Kukës	232,938	232,938		
D. Tropojë	130,781	130,781		
DR Lezhe	475,647	475,647		
DR Shkodër	608,264	608,264		
DR Tirane	471,183	471,183		
DR Vlore	412,858	412,858		
D. Sarande	466,599	466,599		
D. Lushnje	-			
Dr. Kamëz-Vore	-			
Dr.SHSU	-			
	862,108,142	**215,495,312**	**638,614,928**	**7,997,902**

Gjendja tjetër e llogarive debitorë paraqet detyrime "llogari personeli"; subjekte farmaceutike (depo dhe farmaci për penalitete dhe gjoba), etj. në shumën 107,394,779 lekë, të cilat së bashku me debitorë ISSH/DPT, përbëjnë llogaritë e arkëtueshme në shumën totale 969,502,921 lekë.

<u>Mbi planifikimin, realizimin e shpenzimeve të FSDKSH, për vitin 2022.</u>

Shpenzimet në vitin 2022, janë realizuar në shumën 52,244 milionë lekë nga 52,836 milionë lekë të planifikuara, ose në masën 98.9 %, me një mosrealizim në shumën 592 milionë lekë. Shpenzimet për shërbimin spitalor zënë 55,7 %; shpenzimet për rimbursimin e barnave dhe pajisjeve mjekësore zënë 22.4 %, shpenzimet për shërbimin parësor zënë 19.8 % të totalit të shpenzimeve, si dhe shpenzimet administrative dhe investime zënë 2 % të totalit të shpenzimeve.

Shpenzimet e FSDKSH, për vitin 2022 janë realizuar si më poshtë:

- Realizimi i shpenzimeve për rimbursimin e barnave dhe pajisjeve mjekësore është 11,808 milion lekë, realizuar më pak se plani për 12 milion lekë;
- Realizimi i shpenzimeve të kujdesit spitalor është 10,398 milion lekë, me një mos realizim nga plani i ndryshuar për 72 milion lekë;
- Realizimi i shpenzimeve të kujdesit spitalor është 29,152 milion lekë, me një mos realizim nga plani i ndryshuar për 314 milion lekë;
- Realizimi i shpenzimeve administrative dhe për investime është 10,080 milion lekë, me një mos realizim nga plani i ndryshuar për 194 milion lekë;

Të analizuara në nivel zëri buxhetor të miratuar sipas VKA-ve, për detajimin dhe ndryshimet e buxhetit gjatë vitit, realizimi i shpenzimeve përgjatë vitit 2022 paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.3.18 "Treguesit e buxhetit mbi shpenzimet e vitit 2022"

Milionë lekë

Nr.	Zërat e shpenzimeve	Viti 2022			Fakt (cash) /Plan viti 2022		Fakt konstatuar/ Plan viti 2022	
		Plani	Fakti cash	Fakti konst.	Diferenca vlerë	Realiz %	Diferenca vlerë	Realiz %
	Shpenzimet gjithsej	**52,836**	**52,244**	**51,960**	**-592**	**98.9%**	**-876**	**98.3%**
I	**Rimbursimi i barnave e pajisjeve**	**11,820**	**11,808**	**11,506**	**-12**	**99.9%**	**-314**	**97.3%**
II	**Shpenzime për kujdesin shëndetësor parësor**	**10,470**	**10,398**	**10,398**	**-72**	**99.3%**	**-72**	**99.3%**
1	Financimi i QSH	9,594	9,522	9,522	-72	99.2%	-72	99.2%
2	Kontrolli bazë	876	876	876	0	100.0%	0	100.0%
III	**Financime për shërbimin spitalor**	**29,466**	**29,152**	**29,164**	**-314**	**98.9%**	**-302**	**99.0%**
1	Financime për spitalet publike	25,255	25,147	25,147	-108	99.6%	-108	99.6%
2	Shpenzime për paketat spitalore në privat	1,626	1,480	1,470	-146	91.0%	-156	90.4%
3	Shpenzime për trajtim pacienti me VKM	30	12	12	-18	38.8%	-18	38.8%
4	Shpenzimet - Bonusi për mjekët specialistë	20	11	11	-9	53.3%	-9	52.9%
5	Shpenzimet - PPP (dializa,sterilizimi)	2,535	2,503	2,525	-32	98.7%	-10	99.6%
IV	**Shpenzimet administrative**	**1,070**	**882**	**889**	**-188**	**82.5%**	**-181**	**83.1%**
V	**Investime**	10	4	4	-6	37.7%	-6	38.9%

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Sipas zërave të shpenzimeve të cilësuar në tabelën e mësipërme në mënyrë analitike realizimi i tyre paraqitet si më poshtë.

Mbi shpenzimet për rimbursimin e barnave e pajisjeve mjekësore.

Sipas VKA nr. 1, datë 15.02.2022, ndryshuar me VKA nr. 24, datë 19.12.2022, shpenzimet e rimbursimit gjithsej janë planifikuar në shumën 11,820 milionë lekë, nga të cilat 11,800 milionë lekë sipas përcaktimeve në Ligjin nr. 115/2021, ndryshuar me AN nr. 17, datë 01.12.2022, për rimbursim barnave duke përfshirë likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe barnat për Covid-19, dhe 20 milionë lekë janë planifikuar për rimbursim fisha diabeti për moshën 0-25 vjeç.

Sipas të dhënave, pagesat e realizuara nga fondi për rimbursimin e barnave dhe pajisjeve mjekësore, gjatë vitit 2022, kanë patur destinacion rimbursimin e barnave dhe fishave të diabetit, ku sipas DRF paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.3.19 "Rimbursimi sipas destinacionit"

Në mijë lekë

Nr.	DRF	Rimbursimi në total			Rimbursimi barna			Rimbursim fisha diabeti		
		Plani	Fakti	Realizimi	Plani	Fakti	Realizimi	Plani	Fakti	Realizimi
1	Berat	352,019	351,893	100.0	351,389	351,387	100.0	630	506	80.3
2	Diber	254,880	254,453	99.8	254,580	254,273	99.9	300	180	60.0
3	Durres	651,237	649,581	99.7	648,887	648,784	100.0	2,350	797	33.9
4	Elbasan	679,931	679,706	100.0	678,991	678,991	100.0	940	715	76.1
5	Fier	494,278	493,897	99.9	492,778	492,746	100.0	1,500	1,151	76.7
16	Lushnje	436,109	436,109	100.0	436,109	436,109	100.0			
6	Gjirokastër	158,981	158,609	99.8	158,321	158,317	100.0	660	292	44.2

7	Korçë	540,359	540,244	100.0	539,669	539,669	100.0	690	575	83.3
17	Pogradec	180,908	180,906	100.0	180,908	180,906	100.0			
8	Kukës	117,600	117,482	99.9	117,350	117,350	100.0	250	132	52.8
14	Tropoje	41,644	41,645	100.0	41,644	41,645	100.0			
9	Lezhe	421,776	421,709	100.0	421,526	421,525	100.0	250	184	73.6
10	Shkodër	619,505	619,274	100.0	618,535	618,535	100.0	970	739	76.2
11	Tirane	2,678,669	2,678,669	100.0	2,678,669	2,678,669	100.0			
15	Kamez Vore	424,869	424,769	100.0	424,869	424,769	100.0			
12	Vlore	392,302	392,200	100.0	391,642	391,642	100.0	660	558	84.5
13	Sarande	102,557	102,502	99.9	102,557	102,502	99.9			
18	QSUT/DAPSHET	3,268,356	3,264,584	99.9	3,261,576	3,261,574	100.0	6,780	3,010	44.4
	rezervë	4,020						4,020		
	Totali	**11,820,000**	**11,808,232**	**99.9%**	**11,800,000**	**11,799,393**	**100.0%**	**20,000**	**8,839**	**44.2**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Nga auditimi mbi realizimin e shpenzimeve të rimbursimit, bazuar në të dhënat dhe informacionin e marrë konstatohet se, janë respektuar kufijtë e rimbursimit përcaktuara në ligjin e buxhetit të vitit, i ndryshuar, ku cilësohet se *fondi për rimbursimin e medikamenteve* nuk tejkalon tavanin prej 11,800,000 mijë lekë.

Pavarësisht se sipas të dhënave mbi planifikimin e PBA 2022-2024, vërehet se për këtë zë në krahasim me vitin 2022, është parashikuar një rritje në vitin 2023 me 3.2 % dhe në vitin 2024 një rritje me 10.2 %, përsëri vendosja e tavaneve buxhetore në lidhje me këto shpenzime, si dhe mos përfshirja në LBR e gamës së nevojshme të medikamente, së pari jetësore dhe të kushtueshme, do të ndikonte negativisht nivelin shëndetësor të popullatës.

Rimbursimi i barnave mbështetet në VKM nr. 489, datë 30.07.2021 "Për miratimin e listës së barnave që rimbursohen nga FSDKSH, masën e mbulimit dhe çmimit të tyre", ndryshuar me VKM nr. 230, datë 13.04.2022 "Për disa ndryshime në vendimin nr.489, datë 30.07.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së barnave që rimbursohen nga fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor dhe masën e mbulimit të çmimit të tyre", nuk ka ndryshuar listën e LBR, por çmimet referuese, të cilat janë më të ulta se në vitin 2021, sipas listës së barnave nr. I dhe nr. II. Ndryshimi i çmimeve të referencës i cili është me ulje të tyre, pavarësisht se nuk ka ndryshuar masa e mbulimit të çmimit të barnave në %, ka sjellë uljen e masës së masës së rimbursimit në vlerë.

Rimbursimi i fishave të diabetit mbështetet në VKM nr. 61 datë 03.02.2017 "Për miratimin e paketave të pajisjeve mjekësore të rimbursueshme", ndryshuar me VKM nr. 229, datë 13.04.2022 "Për një ndryshim në VKM nr. 61, datë 03.02.2017 "Për miratimin e paketave të pajisjeve mjekësore të rimbursueshme".

Realizimi i rimbursimit të barnave në vitin 2022, është në shumën 11,799,393 mijë lekë, ose 100 % dhe për fishat e diabetit 8,839 mijë lekë nga 20,000 mijë lekë të planifikuara, ose 44.2 %. Në mosrealizmin e fondeve të planifikuara për fishat e diabetit ka ndikuar:

- Në planifikimin e fondeve të rimbursimit për fishat e diabetit është marrë në konsideratë numri i pacientëve diabetikë të trajtuar në vitin 2021, si dhe numri mesatar i konsumit ditor të fishave për një pacient, për grup moshat nga 0-25 vjeç, i cili referuar përcaktimit të standardit nga Departamenti i Endokrinologjisë është 4 fisha në ditë, por që gjatë vitit 2022 rezulton me mesatare të konsumit ditor të fishave 2.3 fisha në ditë.
- Ndryshimet sipas VKM nr. 229 datë 13.04.2022 "Për një ndryshim në VKM nr. 61, datë 03.02.2017 "Për miratimin e paketave të pajisjeve mjekësore të rimbursueshme", sipas të cilit vlera e rimbursueshme e fishave të diabetit nga 19 lekë është bërë 14 lekë.

Tabela nr.3.20 "Realizimi i shpenzimeve të rimbursimit të barnave Fakt/Plan për vitin 2022"

Në mijë lekë

DRF	Plani	Fakti	Realizimi në %
Berat	351,389	351,387	100
Diber	254,580	254,273	99.9
Durres	648,887	648,784	100.0

Elbasan	678,991	678,991	100.0
Fier	492,778	492,746	100.0
Lushnje	436,109	436,109	100.0
Gjirokaster	158,321	158,317	100.0
Korce	539,669	539,669	100.0
Pogradec	180,908	180,906	100.0
Kukes	117,350	117,350	100.0
Tropoje	41,644	41,645	100.0
Lezhe	421,526	421,525	100.0
Shkoder	618,535	618,535	100.0
Tirane	2,678,669	2,678,669	100.0
Kamez vore	424,869	424,769	100.0
Vlore	391,642	391,642	100.0
Sarande	102,557	102,502	99.9
QSUT/DAPSHET	3,261,576	3,261,574	100.0
Totali	**11,800,000**	**11,799,393**	**100.0**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për rimbursimin e barnave në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021, ka rezultuar një rritje e planit të shpenzimeve të rimbursimit të barnave në shumën 1,100,000 mijë lekë dhe një rritje e shpenzimeve të kryera në shumën 1,148,831 mijë lekë, ose në masën 11.2 % më shumë, referuar të dhënave të tabelës nr. 3.22.

Tabela nr.3.21 "Realizimi i shpenzimeve të rimbursimit të barnave në total sipas DRF, 2022/2021"

Në mijë lekë

DRF/Dege	2021		2022		Diferenca 2022/2021		Raporti në % fakt 2022/2021
	Plani	Fakti	Plani	Fakti	Plan	Fakti	
Berat	298,460	290,777	351,389	351,387	52,929	60,610	20.8
Dibër	233,390	233,235	254,580	254,273	21,190	21,038	9.0
Durrës	587,220	591,993	648,887	648,784	61,667	56,791	9.6
Elbasan	635,740	625,350	678,991	678,991	43,251	53,641	8.6
Fier	423,600	420,536	492,778	492,746	69,178	72,210	17.2
Lushnje	361,920	359,831	436,109	436,109	74,189	76,278	21.2
Gjirokastër	154,320	154,161	158,321	158,317	4,001	4,156	2.7
Korçë	469,240	469,240	539,669	539,669	70,429	70,429	15.0
Pogradec	155,870	155,278	180,908	180,906	25,038	25,628	16.5
Kukës	114,970	104,183	117,350	117,350	2,380	13,167	12.6
Tropoje	41,680	40,657	41,644	41,645	-36	988	2.4
Lezhe	395,470	368,655	421,526	421,525	26,056	52,870	14.3
Shkodër	549,080	544,691	618,535	618,535	69,455	73,844	13.6
Tirane	2,600,180	2,600,180	2,678,669	2,678,669	78,489	78,489	3.0
Kamez Vore	369,380	368,226	424,869	424,769	55,489	56,543	15.4
Vlore	347,570	335,039	391,642	391,642	44,072	56,603	16.9
Sarande	99,710	96,336	102,557	102,502	2,847	6,166	6.4
QSUT/DAPSHET	2,856,200	2,856,194	3,261,576	3,261,574	405,376	405,380	14.2
Rezerve	6,000				-6,000		
Totali	**10,700,000**	**10,614,562**	**11,800,000**	**11,799,393**	**1,100,000**	**1,184,831**	**11.2**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Sipas të dhënave të mësipërme, shpenzimet e rimbursimit të barnave kanë pësuar rritje në krahasim me një vit më parë në të gjitha DRF, ku me rritje më të ndjeshme paraqiten DRF Lushnjë, Berat, Fier, Vlorë, Pogradec, Korçë, QSUT/DSHSU nga 14-21 % rritje të shpenzimeve të rimbursimit.

Rimbursimi i barnave kryhet nga Fondi, për të gjitha subjektet farmaceutike, të cilat kanë lidhur kontratë me Fondin. Rimbursimi i barnave, kryhet sipas Listës së Barnave të Rimbursuara

(LBR) dhe referuar masës së mbulimit sipas kategorive të caktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave. LBR për vitin 2022, deri në muajin Prill është e miratuar sipas VKM nr. 489, datë 30.07.2021, e cila ka filluar efektet në Gusht të vitit 2021 dhe me VKM nr. 230 datë 13.04.2022, është miratuar LBR me çmime të indeksuara CIF 2022 e cila ka hyrë në fuqi në datë 01.05.2022. Fondet e rimbursimit të barnave në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021, kanë pësuar një rritje në masën 4.3 %, si dhe sipas grupimit spitale dhe rrjet farmaceutik paraqiten më poshtë.

Tabela nr.3.22 "Fondet e rimbursimit sipas grupeve, pesha specifike 2022/2021"

Në mijë lekë

Grupet e barnave të LBR	Viti 2021	Viti 2022	Rritja në % 2022/2021
Barnat Spitalore	3,423,541	3,694,117	7.9
Barnat e farmacive të rrjetit të hapur	7,596,844	7,802,770	2.7
Barnat në total	**11,020,385**	**11,496,887**	**4.3**
% e barnave Spitalore ndaj totalit	31.1 %	32.1%	1.1
% e barnave të farmacive ndaj totalit	68.9 %	67.9 %	(1.5 %)

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Siç shihet nga të dhënat e tabelës së mësipërme, në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021, kemi një rritje të shpenzimeve të rimbursimit të barnave me 4.3 %, si dhe një rritje të peshës specifike të rimbursimit të barnave nga grupi "Spitale" dhe rënie të rimbursimeve të grupit "Rrjeti i hapur/Farmaci" ndaj totalit të shpenzimeve, krahasuar me vitin 2021. *(Tabela anekse nr.4.2.1 "Rimbursimi sipas kategorive").*

- Faktorët që kanë ndikuar në rritjen e peshës specifike të farmacive të spitaleve dhe rritjen e shpenzimeve në krahasim me vitin 2021 është rritja e numrit të LBR për barnat që tregtohen në farmacinë e spitaleve (QSUT apo Spital Rajonal/Bashkiak). Drejtori i Përgjithshëm i Fondit me Urdhrin nr. 36, datë 23.08.2021, "Për tregtimin e disa barnave nga Lista e Barnave të Rimbursueshme në shërbimin spitalor në QSUT dhe farmacitë e spitaleve Rajonale/ Bashkiake", mbështetur në VKM nr. 489, datë 30.07.2021, "Për miratimin e listës së barnave që rimbursohen nga Fondi dhe masën e mbulimit të çmimit të tyre", ka përcaktuar listën e barnave që tregtohen në farmacinë e QSUT, si dhe barnat që do të tregtohen në farmacinë e spitaleve rajonale/bashkiake.
- Gjithashtu, të dy grupet kanë rezultuar me rritje të shpenzimeve në krahasim me vitin e mëparshëm, pavarësisht se ka një rënie të çmimeve të referencës dhe për rrjedhojë dhe të vlerës së rimbursimit, shtuar këtu dhe faktin që numri i pacientëve të cilët kanë përfituar nga rimbursimi i barnave në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 është 8,954 pacientë më pak. Në vitin 2022, janë rimbursuar 400,825 pacientë dhe në vitin 2021 janë rimbursuar 409,779 pacientë.

Në rritjen e shpenzimeve për rimbursimin e barnave në rrjetin e hapur kanë ndikuar:

- Rritja e rasteve më ndryshim terapie dhe rasteve të reja të trajtuara me barna të rimbursueshme, të cilat në vitin 2022 rezultojnë me një rritje 5.4 % në krahasim me vitin 2021;
- Rritja e diagnozave si diabeti mellitus, hipertensioni esencial, aritmi kardiake, çrregullime mendore të lidhura dhe me periudhën post covid.

Faktorët e mësipërm, pavarësisht se nuk kemi rënie të numrit të pacientëve që kanë përfituar rimbursim, kanë sjellë rritjen së numrit të recetave 4,334 raste, të vlerës mesatare të rimbursimit për recetë me 109 lekë më shumë, si dhe vlerës së rimbursimit për pacient me 1,690 lekë më shumë, të cilat përkthehen në rritje të shpenzimeve totale. Sipas të dhënave të Drejtorisë së Kujdesit Parësor dhe Spitalor, në raport me vitin 2021, këta tregues paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr.3.23 "Tregues mbi rimbursimin e barnave, sipas faturimit nga koncesionari"

Periudha	Fakti (në 000/Lekë)	Recetat	Rimb/recete	Rimb.mes./pacient
Viti 2022	11,496,887	3,902,795	2,946	28,683
Viti 2021	11,061,181	3,898,461	2,837	26,993
Dif.2022-2021	435,706	4,334	109	1,690

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Mbi likuidimin e shpenzimeve për rimbursimin e barnave dhe fishave të diabetit.

Mbulimi i shpenzimeve të rimbursimit, referuar rimbursimeve të vitit ushtrimor 2022, shlyerjes së detyrimeve të mbartura nga viti 2021, si dhe detyrime të pashlyera në vitin 2022 dhe të trashëguara në vitin 2023, përfshirë dhe shpenzimet e rimbursimit të fishave të diabetit, sipas DRF paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr.3.24 "Analizë e likuidimeve dhe detyrimeve, gjatë vitit 2022"

Në mijë lekë

DRF	Viti 2022				Totali i pagesave në vitin 2022	Detyrime të trashëguara në vitin 2023
	Detyrime të mbartura nga viti 2021, gjendje në fillim të vitit	Detyrime të likuiduara të vitit 2021	Detyrime të palikuidura nga viti 2021	Rimbursime të vitit 2022 të likuiduara		
Berat	35,340	35,323	-17	316,570	351,893	13,750
Dibër	21,287	21,287	0	233,166	254,453	14,057
Durrës	64,881	64,881	0	584,700	649,581	50,682
Elbasan	47,932	47,932	0	631,774	679,706	32,330
Fier	55,722	55,722	0	438,175	493,897	39,240
Lushnjë	66,746	66,746	0	369,363	436,109	14,107
Gjirokastër	9,133	9,133	0	149,476	158,609	8,851
Korçë	61,596	61,596	0	478,648	540,244	27,095
Pogradec	19,300	19,300	0	161,606	180,906	11,467
Kukës	9,113	9,113	0	108,369	117,482	2,403
Tropojë	1,762	1,762	0	39,883	41,645	1,396
Lezhë	40,760	40,760	0	380,949	421,709	16,001
Shkodër	64,116	64,116	0	555,158	619,274	27,410
Tiranë	159,508	150,364	-9,144	2,528,305	2,678,669	122,677
Kamëz-vorë	44,478	44,478	0	380,291	424,769	21,316
Vlorë	34,226	34,226	0	357,974	392,200	16,232
Sarandë	9,622	9,622	0	92,880	102,502	5,136
DSHSU	293,374	293,374	0	2,971,210	3,264,584	312,043
Totali	**1,038,896**	**1,029,735**	**-9,161**	**10,778,497**	**11,808,232**	**736,193**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Sipas të dhënave të marra nga Drejtoria Ekonomike, Sektori i Kontabilitetit gjatë vitit 2022, janë likuiduar për rimbursimin e barnave dhe pajisjeve mjekësore/fisha diabeti, në total 11,808,232 mijë lekë, nga të cilat 1,029,735 për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, ndërsa 10,778,496 mijë lekë për shlyerjen e detyrimeve të vitit 2022.

Vlera e barnave dhe fishave të rimbursueshme për vitin 2022 rezulton në shumën 11,505,529 mijë lekë *(10,778,497 të likuiduara për vitin 2022 (+) 736,193 të mbartura në total në vitin 2023 (-) 9,161 mijë lekë të mbartura të vitit 2021, të cilat janë në proces gjyqësor).*

Detyrimet e trashëguara në vitin 2023 në shumën 736,193 mijë lekë në krahasim me fund vitin e 2021 janë ulur me 302,703 mijë lekë, në mënyrë të detajuar sipas DRF, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.3.25 "Detyrimet e pa likuiduara sipas periudhave në vitin 2022, të mbartura në vitin 2023"

Në mijë lekë

DRF	Detyrimi mbetur nga viti 2020	Detyrimi mbetur nga vit 2021	Detyrimi i rimbursimit mbetur nga viti 2022 (barna+fisha diabeti)				Detyrimi gjithsej
			Nga tetori	Nga nëntori	Nga dhjetori	Gjithsej	
Berat		17			13,733	13,733	13,750
Dibër				308	13,749	14,057	14,057
Durrës				13,852	36,830	50,682	50,682
Elbasan				1	32,329	32,330	32,330
Fier				9,731	29,508	39,240	39,240
Lushnjë				42	14,065	14,107	14,107
Gjirokastër				0	8,851	8,851	8,851
Korçë				0	27,095	27,095	27,095
Pogradec				0	11,467	11,467	11,467
Kukës				1	2,402	2,403	2,403
Tropojë				0	1,396	1,396	1,396
Lezhë				0	16,001	16,001	16,001
Shkodër				0	27,410	27,410	27,410
Tiranë	9,144		7	0	113,527	113,533	122,677
Kamëz-Vorë				0	21,316	21,316	21,316
Vlorë				10	16,222	16,232	16,232
Sarandë			54	0	5,083	5,136	5,136
DSHSU				121,060	190,983	312,043	312,043
Totali	**9,144**	**17**	**60**	**145,004**	**581,967**	**727,032**	**736,193**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Financimi për kujdesin parësor.

Gjatë vitit 2022, nga ana e FSDKSH është financuar aktiviteti i qendrave shëndetësore, në zbatim të VKM nr. 737, datë 5.11.2014 "Për financimin e shërbimeve shëndetësore publike të kujdesit shëndetësor parësor nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor" të cilat funksionojnë si njësi shpenzuese më vete me llogari bankare në bankat e nivelit të dytë. Ky shërbim në zbatim të Ligji nr. 10 383, datë 24.02.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe VKM nr. 101, datë 04.02.2015 "Për miratimin e paketës së shërbimeve shëndetësore, në kujdesin shëndetësor parësor publik, që financohet nga fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor", përfshin 7 shërbime:

- Kujdesi në rastet e urgjencës;
- Kujdesi shëndetësor për fëmijët;
- Kujdesi shëndetësor për të rriturit;
- Kujdesi shëndetësor për gratë dhe shëndeti riprodhues;
- Kujdesi shëndetësor për të moshuarit;
- Kujdesi shëndetësor mendor;
- Promocioni dhe edukimi shëndetësor.

Financimi i tyre është kryer me anë të transfertave në DRF-të, të cilat më tej kanë kryer transfertën e mjeteve monetare në llogaritë bankare të qendrave shëndetësore. Në këtë zë të shpenzimeve është financuar gjithashtu edhe aktiviteti i kontratës koncesionare të kontrollit bazë mjekësor.

Shpenzimet për kujdesin parësor në vitin 2022, paraqiten me realizim në shumën 99.3 % kundrejt planit përfundimtar i cili në raport me planin fillestar është pakësuar në shumën 637,000 mijë lekë. Pjesë e këtij plani është dhe financimi i Kontrollit Mjekësor Bazë (KMB), në shumën 876,090 mijë lekë dhe realizuar në shumën 876,083 mijë lekë ose afërsisht në masën 100 %, i evidentuar në të gjitha DRF.

Realizimi i financimit për kujdesin parësor në shumën 10,397,757 mijë lekë, është paraqitur sipas DRF në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.3.26 "Realizimi i financimit për kujdesin parësor, sipas DRF për vitin 2022"

Në mijë lekë

DRF	Plan fillestar	Plan përfundimtar	Fakt	Realizimi %
Berat	570,892	572,852	572,852	100.0%
Dibër	587,656	593,587	593,137	99.9%
Durrës	937,883	957,961	957,961	100.0%
Elbasan	946,263	952,525	952,525	100.0%
Fier	530,034	531,578	531,565	100.0%
Lushnje	348,224	349,274	349,274	100.0%
Gjirokastër	441,756	446,064	446,065	100.0%
Korçe	539,261	550,761	506,378	91.9%
Pogradec	207,682	210,675	186,565	88.6%
Kukës	252,889	257,668	257,457	99.9%
Tropoje	143,688	146,018	146,013	100.0%
Lezhe	467,593	474,793	474,306	99.9%
Shkodër	802,619	811,938	811,939	100.0%
Tirane	1,727,444	1,643,566	1,643,567	100.0%
Kamez-Vore	337,439	330,042	330,041	100.0%
Vlore	515,515	518,805	518,805	100.0%
Sarande	185,855	197,767	197,767	100.0%
FSDKSH	50,000	46,000	45,457	98.8%
Kontrolli baze	876,090	876,090	876,083	100.0%
rezerve	638,358	2,176		
TOTALI	**11,107,140**	**10,470,140**	**10,397,757**	**99.3%**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Në krahasim më vitin 2021 në vitin 2022, sipas të dhënave të tabelës së mëposhtme, kemi një rritje të planit të buxhetit të kujdesit parësor në shumën 249,550 mijë lekë dhe kundrejt faktit në shumën 647,637 mijë lekë.

Tabela nr.3.27 "Realizimi i financimit për kujdesin parësor, sipas DRF 2022/2021"

Në mijë lekë

DRF	Viti 2021		Viti 2022		Diferenca 2022/2021	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Berat	576,356	576,356	572,852	572,852	-3,504	-3,504
Dibër	596,261	594,069	593,587	593,137	-2,674	-932
Durrës	969,262	923,430	957,961	957,961	-11,301	34,531
Elbasan	944,348	915,654	952,525	952,525	8,177	36,871
Fier	538,438	537,721	531,578	531,565	-6,860	-6,156
Lushnje	344,686	344,687	349,274	349,274	4,588	4,587
Gjirokastër	453,219	453,219	446,064	446,065	-7,155	-7,154
Korçe	555,434	534,678	550,761	506,378	-4,673	-28,300
Pogradec	206,446	204,756	210,675	186,565	4,229	-18,191
Kukës	253,897	247,978	257,668	257,457	3,771	9,479
Tropoje	149,897	143,686	146,018	146,013	-3,879	2,327
Lezhe	469,606	469,606	474,793	474,306	5,187	4,700
Shkodër	804,499	804,499	811,938	811,939	7,439	7,440
Tirane	1,724,682	1,724,681	1,643,566	1,643,567	-81,116	-81,114
Kamez-Vore	334,170	334,170	330,042	330,041	-4,128	-4,129
Vlore	501,973	501,974	518,805	518,805	16,832	16,831
Sarande	195,835	195,834	197,767	197,767	1,932	1,933
FSDKSH	50,000	24,100	46,000	45,457	-4,000	21,357
Kontrolli baze	366,090	219,021	876,090	876,083	510,000	657,062
rezerve	140,491		2,176		-138,315	

Totali	**10,175,590**	**9,750,120**	**10,470,140**	**10,397,757**	**294,550**	**647,637**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Sipas të dhënave dhe informacionit të marrë nga Drejtoria e Kujdesit Parësor dhe Spitalor në FSDKSH, gjatë vitit 2022, janë financuar qendrat shëndetësore për aktivitetin e tyre vjetor, përfshirë financimin shtesë për qendrat që ofrojnë shërbim të pandërprerë gjatë sezonit veror, si dhe paketën e barnave e materialeve të mjekimit për qendrat shëndetësore që bllokohen gjatë dimrit. Ndikim në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021, ka patur rritja e shpenzimeve për KMB, i cili në vitin 2021 është ofruar vetëm për periudhën Shtator-Dhjetor, si rezultat i masave shtrënguese në periudhën e pandemisë Covid-19.

Sipas të dhënave të raportuara nga FSDKSH në raportet vjetore të veprimtarisë për vitin 2021 dhe 2022, të paraqitura në tabelën e mëposhtme, rezulton se numri i vizitave të kryera nga shërbimi parësor në vitin 2022 rezulton me 68,109 vizita më shumë se në vitin 2021 e reflektuar kjo në rritjen e shpenzimeve të kujdesit parësor. Gjithashtu ky tregues ka ndikuar në rritjen e ngarkesës së një mjeku, ku në vitin 2021 ka qenë 14.2 vizita në ditë dhe në vitin 2022 ka rezultuar 14.9 vizita në ditë, shtuar këtu dhe faktin që numri i MPF dhe MS ka pësuar ulje në krahasim me vitin 2021.

Tabela nr. 28 "Tregues të shërbimit parësor 2022/2021"

Treguesit	2021	2022	Diferenca
Numri i popullsisë së deklaruar nga MPF	4,120,754	4,158,172	37,418
Numri i vizitave të realizuara	7,052,731	7,120,840	68,109
Numri i QSH	407	406	-1
Norma e ngarkesës për MPF (vizita/ditë)	14.2	14.9	0.7
Numri i MPF	1,505	1,451	-54
Numri i laborantëve dhe infermierëve	6,842	6,792	-50
Numri i MS	307	299	-8

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Përsa i përket raportimit të numrit të popullsisë, sipas të dhënave të deklaruara nga FSDKSH në raportet e veprimtarisë së vitit 2021 dhe 2022 ka rezultuar se, popullsia sipas regjistrimit nga MPF në total në vitin 2021 është 4,120,754 banorë dhe në vitin 2022 është 4,158,172 banorë. Ky numër i cili përfaqëson numrin e pacientëve të regjistruar nga MPF, **për dy periudhat e raportuara nuk është i saktë**, pasi nuk është i përditësuar dhe nuk përfaqëson numrin e popullsisë sipas regjistrit të gjendjes civile, që sipas publikimit të INSTAT më 01.01.2022, popullsia është 2,793,592 banorë. Në Relacionin mbi projektvendimin për miratimin e buxhetit të FSDKSH për vitin 2022, cilësohet se njëri nga kriteret për përllogaritjen e financimit të shërbimit parësor është "*Numri i popullsisë së regjistruar nga MPF", i cili* ***duhet ti përafrohet numrit të popullsisë së regjistruar në regjistrat e GJC****".*
Kjo problematikë është evidentuar edhe nga Grupi i auditimit të KLSH, i cili ka audituar Sistemet e Teknologjisë së Informacionit në FSDKSH, ku ka evidentuar faktin se, Sistemi i regjistrit i të siguruarve ka nisur të implementohet që në vitin 2008, me nisjen e procesit të depistimit të banorëve pranë mjekut të familjes dhe është konsoliduar në vitet 2009-2010, kur filloi të përdorej gjerësisht nga të gjithë mjekët e familjes në vend. Mos përputhja e të dhënave është rezultat i mangësive të mëposhtme:

- Në regjistrat e banorëve të mjekëve të familjes kanë ngelur të regjistruar banorë të cilët aktualisht kanë ndërruar jetë. Pasi këta banorë çregjistrohen nga gjendja civile, ndërsa sistemi AHIS nuk të jep mundësinë që mjekët ti çregjistrojnë ata;
- Sistemi nuk të mundëson të gjenerosh raporte të plota dhe këto fenomene mund të verifikohen vetëm një e nga një, duke e bërë sistemin jo efektiv;

- Sistemi nuk jep mundësi për pastrimin apo saktësimin e të dhënave të banorëve të regjistruar gabim nga mjekët e familjes; pacientët të cilët mund të kenë NID gabim ose janë regjistruar manualisht me numër pacienti.

Mbi financimin dhe pagesat e shërbimit të koncesionit të "Kontrollit Mjekësor Bazë (KMB)".
Ofrimi i paketës së Kontrollit Mjekësor Bazë (KMB), realizohet bazuar në VKM nr. 185, datë 02.04.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së realizimit të kontrollit mjekësor bazë për shtetasit e grup moshës 35-70 vjeç", të ndryshuar me VKM nr. 721, datë 12.10.2016. Ky shërbim realizohet nga Shoqëria koncesionare "3P." SHPK, sipas Kontratës PPP nr. 3082/20 prot., datë 07.01.2015, Kontratës për financimin e koncesionarit nr. 1195/2 prot., datë 15.04.2015, me ndryshime përcjellë FSDKSH me shkresën nr. 5318/4 prot., datë 30.11.2016 në zbatim të VKM nr. 721, datë 12.10.2016 me afat 10 vjeçar dhe mbështetje buxhetore të numrin e projektuar prej 475,000 KMB në vit (pika 3.1.4 e kontratës) dhe tarifë 1,844.4 lekë me TVSH, në total në **8,760,900 mijë lekë me TVSH**.
Fondet buxhetore të planifikuara për KMB, sipas PBA-së 2022-2024, nuk parashikojnë ndryshim të buxhetit, pasi plani për këtë PPP i referohet financimit të garantuar të koncesionarit bazuar në projeksionin vjetor të KMB. Për tre vitet 2022-2024, fondet e planifikuara rezultojnë në shumën 876,090 mijë lekë, duke përfshirë dhe pagesën e TVSH. {(475,000 * 1844.4 lekë (çmimi me TVSH)}. Kjo kontratë përfundon në vitin 2024.
Gjatë vitit 2022, janë realizuar 454,828 KMB, me një përqindje realizimi kundrejt projeksionit me 96%. Sipas ndarjes administrative në zona urbane dhe rurale, kontrolli mjekësor bazë për periudhën Janar-Dhjetor 2022, është kryer në masën 42 % në zonat rurale dhe në masën 58 % në zonat urbane dhe sipas gjinisë struktura e kryerjes së kontrollit mjekësor bazë, është në masën 60 % nga femrat dhe 40 % nga meshkujt.
Gjithashtu, nga analizimi i disa treguesve ka rezultuar se, pavarësisht shtimit të numrit të KMB në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021, sëmundjet kronike janë shtuar me 8,603 raste, vlera e rimbursimit të barnave për shkak të rritjes së sëmundshmërisë dhe kompleksitetit të tyre me 1,184,831 mijë lekë më shumë; rritja e numrit të shtrimeve në spitale me 18,979 raste më shumë, rritja e vizitave ambulatore në Spitalet Universitare dhe Bashkiake me 123,354 raste më shumë etj., **tregojnë se efektet e masës profilaktike "Kontrolli Mjekësor Bazë", nuk janë reflektuar në rezultat konkrete, në uljen e sëmundshmërisë së popullatës, duke cenuar efektivitetin e përdorimit të këtyre fondeve.**

Ky shërbim edhe gjatë vitit 2022 është likuiduar referuar nivelit të projeksionit prej 475,000 KMB dhe jo realizimit faktik të tyre, duke sjellë <u>shpenzime për shërbim të pa përfituar në shumën 37,198 mijë lekë me TVSH</u>, referuar të dhënave dhe përllogaritjeve të tabelave nr. 3.30 dhe 3.31.

Realizimi i KMB sipas rajoneve, shprehur në numër raste dhe vlerë referuar çmimit për njësi prej 1,537 lekë, paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr.3.29 "Realizimi i kontrollit bazë"

DRF	Projeksioni		Kontrolle të realizuara		Realizimi %	
	Raste	Vlerë pa TVSH	Raste	Vlerë pa TVSH	Raste	Vlerë
	(Numër)	(000/lekë)	(Numër)	(000/lekë)	(Numër)	(000/lekë)
Berat	22,800	35,044	22,286	34,254	98	98
Dibër	15,600	23,977	14,507	22,297	93	93
Durrës	66,996	102,973	67,837	104,265	101	101
Elbasan	48,600	74,698	45,365	69,726	93	93
Fier	38,000	58,406	38,896	59,783	102	102

Lushnje	23,900	36,734	22,839	35,104	96	96
Gjirokastër	13,000	19,981	11,858	18,226	91	91
Korçë	27,096	41,647	27,947	42,955	103	103
Pogradec	9,600	14,755	10,023	15,405	104	104
Kukës	6,000	9,222	6,258	9,619	104	104
Tropoje	2,500	3,843	2,544	3,910	102	102
Lezhe	14,900	22,901	12,583	19,340	84	84
Shkodër	33,000	50,721	31,310	48,123	95	95
Tirane	111,996	172,138	102,911	158,174	92	92
Vore-Kamez	15,996	24,586	16,774	25,782	105	105
Vlore	19,000	29,203	16,625	25,553	88	88
Sarande	6,000	9,222	4,265	6,555	71	71
Totali	**475,000**	**730,075**	**454,828**	**699,071**	**96**	**96**
Totali me TVSH	**475,000**	**876,090**	**454,828**	**838,885**	**96**	**96**
Për tu likuiduar me TVSH	**475,000**	**876,090**	**454,828**	**876,083**	**96**	**99.9**
Diferenca				**(37,198)**		**(3.9)**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Tabela nr.3.30 "Realizimi i KMB sipas muajve, referuar projeksionit mujor"

Periudha mujore	**Kontrolle të kryera**	**Projeksioni mujor**	**Diferenca Fakt/Projeksion**	**Në vlerë (numër*çmim 1,537 lekë)**
	(1)	**(2)**	**(3=1-2)**	**(4=3*çmim)**
Janar	31,654	39,583	-7,929	(12,186,873)
Shkurt	39,940	39,583	357	548,709
Mars	40,241	39,583	658	1,011,346
Prill	38,859	39,583	-724	(1,112,788)
Maj	39,662	39,583	79	121,423
Qershor	38,270	39,583	-1,313	(2,018,081)
Korrik	31,733	39,583	-7,850	(12,065,450)
Gusht	36,198	39,583	-3,385	(5,202,745)
Shtator	39,659	39,583	76	116,812
Tetor	41,120	39,583	1,537	2,362,369
Nëntor	39,727	39,583	144	221,328
Dhjetor	37,765	39,583	-1,818	(2,794,266)
Totali	**454,828**	**474,996**	**-20,168**	**(30,998,216)**
Totali me TVSH				**(37,197,859)**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Titulli i gjetjes: **Mbi financimin e shërbimit të Kontrollit Mjekësor Bazë (KMB)**

Situata: Nga të dhënat e vendosura në dispozicion në lidhje me financimin e kontratës së koncesionit të kontrollit bazë, të përpunuara në dy tabelat e mësipërme, rezulton të jetë kryer pagesa në shumën 876,083 mijë lekë për 454,828 kontrolle të kryera, nga 876,090 mijë lekë për 475,000 seanca, të planifikuara referuar projeksionit.

Nga auditimi ka rezultuar se janë kryer 454,828 raste të KMB, me kosto në shumën 839,158 mijë lekë, referuar çmimit për njësi 1,844 lekë me TVSH, ndërkohë që janë likuiduar 876,083 mijë lekë në total në vitin 2022.

Edhe në vitin 2022, si në vitet e mëparshme, që prej fillimit të zbatimit të kësaj kontrate rezulton se janë likuiduar fatura referuar numrit të projektuar të KMB sipas kontratës dhe jo sipas numrit faktik të kryer dhe shpenzimeve sipas parimit "Pay x Use", **për rrjedhojë është faturuar shërbim i pakryer për 20,172 raste, me një kosto në shumën 37,198 mijë lekë me TVSH.**

Projeksioni dhe realizimi mujor i KMB, si dhe deviacioni mujor dhe në nivel vjetor paraqitet në tabelën nr. 3.32.

Gjithashtu, nga analizimi i disa treguesve ka rezultuar se, pavarësisht shtimit të numrit të KMB në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021, sëmundjet kronike janë shtuar me 8,603 raste, vlera e rimbursimit të barnave për shkak të rritjes së sëmundshmërisë dhe kompleksitetit të tyre me 1,184,831 mijë lekë më shumë; rritja e numrit të shtrimeve në spitale me 18,979 raste më shumë, rritja e vizitave ambulatore në Spitalet Universitare dhe Bashkiake me 123,354 raste më shumë etj., **tregojnë se efektet e masës profilaktike "Kontrolli Mjekësor Bazë", nuk janë reflektuar në rezultat konkrete, në uljen e sëmundshmërisë së popullatës, duke cenuar efektivitetin e përdorimit të këtyre fondeve.**

Ndikimi/pasoja: Kryerja e pagesave në nivel projeksioni, duke përfshirë dhe likuidimin e shërbimit të pa kryer, shoqërohet me shpenzime buxhetore të pajustifikuara në shumën 37,198 mijë lekë.

Shkaku: Kushtet e kontratës së PPP së Kontrollit Mjekësor Bazë, ku është përcaktuar likuidimi i koncesionarit në nivel projeksioni dhe jo sipas kontrolleve të kryera, duke favorizuar partnerin privat. Kontrata për financimin e koncesionarit nr. 1195/2, datë 15.04.2015, pika 3.4.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, si përfaqësues në lidhjen e Kontratës Financiare të Koncesionit të përgatisë një relacion informues drejtuar MSHMS, si autoritet kontraktor, që në bashkëpunim me Shoqërinë Koncesionare "3P." SHPK, të rishikojnë kushtet e kontratës, pika 3 "Pagesa dhe mënyra e shlyerjes" me qëllim eliminimin e pagesave për shërbim të pakryer, si rezultat i likuidimit të rasteve të cilat janë nën projeksion vjetor, kryerjen e tyre në vijimësi sipas parimit (Pay x Use) me qëllim që të paguhen vetëm shërbimet e kryera.

Realizimi i shërbimit në raport me vitin 2021.

Planifikimi dhe realizimi i KMB në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021, ka patur një rritje me 289,846 raste, por kjo për shkak të pezullimit të zbatimit të kontratës deri në shtator 2021. Projeksioni dhe zbatimi për vitin 2021 i referohen periudhës 01.09.2021-31.12.2021. Realizimi ne nivel 4 mujor (shtator-dhjetor 2021 dhe shtator-dhjetor 2022) paraqitet me 158,271 kontrolle në vitin 2022 dhe 158,332 kontrolle në vitin 2021, duke paraqitur të njëjtin trend për këtë periudhë.

Tabela nr.3.31 "KMB realizimi Fakt/Plan, 2021/2022, raste dhe vlerë"

DRF	Projeksioni				Realizimi faktik			
	2021		2022		2021		2022	
	Raste	Vlerë pa TVSH	Raste	Vlerë pa TVSH	Raste	Vlerë pa TVSH	Raste	Vlerë
	Numër	000/lekë	Numër	000/lekë	Numër	000/lekë	Numër	000/lekë
Berat	7,600	11,681	22,800	35,044	7,826	12,029	22,286	34,254
Dibër	5,200	7,992	15,600	23,977	4,198	6,452	14,507	22,297
Durrës	22,332	34,324	66,996	102,973	23,478	36,086	67,837	104,265
Elbasan	16,200	24,899	48,600	74,698	17,375	26,705	45,365	69,726
Fier	12,668	19,471	38,000	58,406	14,103	21,676	38,896	59,783
Lushnje	7,968	12,247	23,900	36,734	8,344	12,825	22,839	35,104
Gjirokastër	4,332	6,658	13,000	19,981	4,662	7,165	11,858	18,226
Korçë	9,032	13,882	27,096	41,647	10,326	15,871	27,947	42,955

Pogradec	3,200	4,918	9,600	14,755	3,213	4,938	10,023	15,405
Kukës	2,000	3,074	6,000	9,222	2,215	3,404	6,258	9,619
Tropoje	832	1,279	2,500	3,843	859	1,320	2,544	3,910
Lezhe	4,968	7,636	14,900	22,901	4,182	6,428	12,583	19,340
Shkodër	8,444	12,978	33,000	50,721	12,377	19,023	31,310	48,123
Tirane	37,332	57,379	111,996	172,138	38,761	59,576	102,911	158,174
Vore-Kamez	5,332	8,195	15,996	24,586	6,042	9,287	16,774	25,782
Vlore	6,332	9,732	19,000	29,203	5,194	7,983	16,625	25,553
Sarande	2,000	3,074	6,000	9,222	1,827	2,808	4,265	6,555
Totali	**158,332**	**243,356**	**475,000**	**730,075**	**164,982**	**253,577**	**454,828**	**699,071**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Mbi monitorimin dhe likuidimin e shpenzimeve.

Zbatimi i kësaj kontrate kryhet sipas Udhëzimit të Ministrit të MSHMS nr. 12, datë 18.05.2015 "Për procedurat e pagesës së Shoqërisë "3P." SHPK.

Nga auditimi ka rezultuar se gjatë vitit 2022, është likuiduar vlera e projeksionit të garantuar sipas kontratës së PPP dhe financimit të saj. Likuidimi i shpenzimeve të faturuara është kryer në përputhje me pikën 7 të këtij udhëzimi, pas konfirmimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga Drejtoria e Kujdesit Parësor dhe Spitalor. Drejtoria e Kujdesit Parësor dhe Spitalor, ka administruar dokumentacionin e paraqitur nga DRF dhe ka kryer rakordimin me raportin përmbledhës të nxjerrë nga administratori i sistemit të shoqërisë koncesionare. Gjatë vitit 2022, nuk ka patuar kërkesa për pagesa të identifikuara si të tepërta apo të parregullta, referuar dokumentacionit të administruar nga DKPS. Drejtoria Ekonomike, bazuar në pikën 8 dhe 9 të udhëzimit, duke zbatuar likuidimin e shërbimit dhe aplikimin e çmimit për njësi të përcaktuar në kontratën koncesionare ka kryer likuidimin e faturave brenda afatit të përcaktuar prej 30 ditësh nga data e dorëzimit të faturës.

Në vitin 2022, është kryer likuidimi i shpenzimeve për shërbimin e Kontrollit Mjekësor Bazë në shumën 803,076 mijë lekë, të detajuar si më poshtë.

Tabela nr.3.32 "Likuidimi i faturave"

Në mijë lekë

Të dhëna mbi likuidimin e shpenzimeve për PPP-KMB	**Viti**	
	2021	**2022**
Plani përfundimtar	366,090	876,090
Fakti total	219,021	876,083
Likuidimet për efekt te detyrimeve te prapambetura	0	73,007
Vlera e faturuar nga koncensionari me TVSH	292,028	876,083
Vlera e faturuar nga koncensionari pa TVSH	243,356	730,075
Pranuar për likuidim (detyrim i njohur)	292,028	876,083
Likuiduar	219,021	803,076
Detyrim i vitit pa likuiduar dhe kaluar ne vitin pasardhës	73,007	73,007

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Vlera e likuiduar gjatë vitit 2022 është në shumën 803,076 mijë lekë dhe përfshin likuidimin e muajit dhjetor të vitit 2021 si dhe periudhën janar-nëntor 2022.

Tabela nr.3.33 "Projeksioni, fakti dhe likuidimi i faturimit mujor të check-up për vitin 2022"

Periudha mujore	**Kontrolle të kryera**	**Projeksioni mujor**	**Faturuar për kontrollet e kryera**	**Fatura mbështetëse financiare (Diferenca fakt-projeksion)**	**Faturuar**	**Likuiduar gjatë vitit 2022**		**Detyrim**
					Gjithsej	**Detyrim në çelje 2022**	**Likuiduar të vitit 2022**	**për vitin 2023**
	Raste	**Raste**	**Mijë lekë**	**Mijë lekë**	**Mijë lekë**	**Mijë lekë**	**Mijë lekë**	**Mijë lekë**
Janar	31,654	39,583	58,383	14,624	73,007	73,007		
Shkurt	39,940	39,583	73,665	-658	73,007		0	
Mars	40,241	39,583	74,221	-1,214	73,007		73,007	

Prill	38,859	39,583	71,672	1,335	73,007		73,007	
Maj	39,662	39,583	73,153	-146	73,007		146,014	
Qershor	38,270	39,583	70,585	2,422	73,007		73,007	
Korrik	31,733	39,583	58,528	14,479	73,007		73,007	
Gusht	36,198	39,583	66,763	6,244	73,007		73,007	
Shtator	39,659	39,583	73,147	-140	73,007		73,007	
Tetor	41,120	39,583	75,842	-2,835	73,007		0	
Nëntor	39,727	39,583	73,272	-266	73,006		73,007	
Dhjetor	37,765	39,583	69,654	3,353	73,007		146,014	73,007
Totali	**454,828**	**474,996**	**838,885**	**37,198**	**876,083**	**73,007**	**803,076**	**73,007**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

3. Mbi financimin për shërbimin spitalor:

Sipas buxhetit të FSDKSH, shpenzimet për financimin e shërbimit spitalor, **janë planifikuar në shumën 29,466 milionë lekë.**

Financimi i shërbimit spitalor është bërë me VKM nr. 43, datë 19.01.2022, ku është përcaktuar se fondi i buxhetit për spitalet përdoret për shpenzime për paga, sigurime, mallra e shërbime, buxhetimin e paketave shëndetësore, etj..

Gjithashtu, në këtë vendim përcaktohet se, rishpërndarja e buxhetit ndërmjet spitaleve lejohet deri në 3 % të buxhetit të secilit spital dhe deri në 30 % e fondit total të shërbimit spitalor mund të krijohet rezervë për rishpërndarje gjatë vitit. Sipas këtij vendimi buxhetimi i shërbimit spitalor sipas spitaleve dhe artikujve buxhetorë paraqitet në *tabelën anekse nr.3.3.*

Gjatë vitit 2022, buxheti i shërbimit spitalor ka pësuar ndryshime referuar institucioneve të shërbimit spitalor, llojit të shërbimeve të ofruara, si dhe zërave buxhetorë, por duke mos ndryshuar totalin e shpenzimeve në shumën 29,465,860 mijë lekë të miratuar me VKM nr. 43, datë 19.01.2022. Buxheti për shërbimin spitalor ka si destinacion mbulimin e disa shpenzimeve, ku përfshihen spitalet publike, spitalet private sipas kontratave të lidhura për ofrimin nga ana e tyre të një sërë shërbimesh, trajtimet e pacientëve për raste të veçanta sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave, financimin e shpenzimeve për bonuset e mjekëve rast pas rasti, si dhe shpenzimet për PPP të cilat janë pjesë e buxhetit të shërbimit spitalor, në raport me vitin 2021 dhe fakt/plan 2022, paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr.3.34 "Shpenzimet për shërbimin spitalor në vitin 2022 dhe raporti me vitin 2021" 24138

Milionë lekë

Nr.	Financime për shërbimin spitalor	Fakt 2021	Viti 2022		Realizimi Fakt 2022/2021		Realizimi Fakt/Plan 2022	
			Plan	Fakt	Vlerë	Në %	Vlerë	Në %
1	Financime për spitalet publike	24,138	25,255	25,147	1,009	104.18	-108	99.57
2	Shpenzime për paketat spitalore në privat	1,454	1,626	1,480	26	101.79	-146	91.02
5	Shpenzime për trajtim pacienti me VKM	17	30	12	-5	70.59	-18	40.00
6	Shpenzimet-Bonusi për mjekët specialistë	13	20	11	-2	84.62	-9	55.00
7	Shpenzimet-PPP (Sterilizimi & Dializa)	2,248	2,535	2,503	255	111.34	-32	98.74
10	**Totali**	**27,870**	**29,466**	**29,152**	**1,282**	**104.60**	**-314**	**98.93**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Sipas të dhënave në vitin 2022, shpenzimet për shërbimin spitalor, janë realizuar në shumën 29,152 milionë lekë, nga 29,466 milionë lekë të planifikuara, ose me 98.9 % dhe në krahasim me vitin 2021, fakti i shpenzimeve të shërbimit spitalor është rritur me 1,282 milionë lekë.

Shpenzimet faktike për financimin e spitaleve publike rezultojnë në shumën 25,147 milionë lekë, nga të cilat 22,856 milionë lekë, janë shpenzime të kaluara nëpërmjet skemës së thesarit, dhe 2,291 milionë lekë janë shpenzime të kryera nëpërmjet sistemit bankar, jashtë skemës së thesarit. Kjo shumë përfaqëson "Transferime korrente të brendshme", transferime për Spitalin e Durrësit dhe Spitalin Memorial Fier. Pjesa tjetër e buxhetit të shërbimit spitalor është zbatuar nëpërmjet sistemit të thesarit për aktivitetin e spitaleve të të tre sistemeve (universitar, rajonal dhe bashkiak), përfshirë sipas planit të buxhetit të vitit 2022.

Në krahasim me vitin 2021, shpenzimet për shërbimin spitalor janë rritur me 1,282 milionë lekë, ose me 4.6 % ku shpenzimet për PPP (sterilizim dhe dializë) janë rritur me 11 % më shumë, shpenzimet për spitalet publike ku bën pjesë dhe financimi i PPP laboratorë dhe paketat e spitaleve të ofruara nga publiku, janë rritur me 4.2 %, si dhe shpenzimet për paketat shëndetësore të ofruara nga privati janë rritur me 1.8 % më shumë.

Mbi shpenzimet për paketat shëndetësore të mbuluara nga shërbimi spitalor:

Pjesë e shpenzimeve të përfshirë në shërbimin spitalor është dhe mbulimi i shpenzimeve të paketave shëndetësore të ofruara, sipas VKM nr. 308, datë 21.05.2014 "Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga FSDKSH në shërbimin spitalor" i ndryshuar me VKM nr. 102, datë 05.02.2020, bashkëlidhur të të cilit gjendet Lista e paketave dhe që do të mbulohen nga fondi dhe çmimet respektive. Fondi në vitin 2022 ka lidhur kontrata me institucionet shëndetësore publike dhe jopublike dhe financoi paketat shëndetësore në shumën 3,075,535 mijë lekë.

Buxheti i paketave përfshin financimin nga FSDKSH të atyre paketave të kostifikuara për spitalet publike dhe private. Paketat përfshijnë shërbime për kardiologjinë, kardiokirurgjinë, dializën etj. Regjistri kombëtar i paketave administrohet nga DSHSU, sipas VKA nr. 88, datë 09.07.2014 "Për rregullat, kriteret dhe mënyrën e organizimit të regjistrit kombëtar të paketave të financuara nga fondi", Udhëzimin nr. 3, datë 09.01.2019 "Për administrimin e Regjistrit Kombëtar të paketave" dhe Udhëzimin nr. 18, datë 23.01.2019 "Për monitorimin e paketave shëndetësore të financuara nga FSDKSH në institucionet publike dhe jo publike."

Në vitin 2022, plani fillestar i financimit të shpenzimeve për paketat është në shumën 3,492 milionë lekë, ku plani sipas VKA nr. 2, datë 15.02.2022 "Për financimin shtesë të spitaleve publike për realizimin e paketave shëndetësore të përcaktuara me VKM të ofruara për shërbimet spitalore publike", për paketat e spitaleve publike është 1,326 milionë lekë dhe për diferencë plani i financimit të spitaleve private është në shumën 2,166 milionë lekë, përfshirë këtu edhe financimin e shërbimit të dializës në institucionet jo publike.

Tabela nr.3.35"Buxheti fillestar i paketave për vitin 2022, sipas VKA nr. 2, datë 15.02.2022"

Në mijë lekë

Institucionet spitalore	600	601	602	604	Total
QSUT	163,286	27,492	960,132		1,150,910
SU "Shefqet Ndroqi"	7,500	1,150	35,000		43,650
SR Fier	1,000	250	4,750		6,000
Spitali Memorial Fier				79,300	79,300
SR Shkodër	3,000	350	25,000		28,350
SR Vlorë	1,000	250	4,750		6,000
SR Korçë	1,000	250	4,750		6,000
SR Durrës				6,000	6,000
Totali	**176,786**	**29,742**	**1,034,382**	**85,300**	**1,326,210**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Plani përfundimtar i buxhetit të paketave sipas llojit dhe realizimi i tyre paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr.3.36 "Buxheti përfundimtar i paketave"

Në mijë lekë

Lloji i paketës	Spitale publike		Spitale private		Total	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Paketa Dializës	122,000	130,333	1,596,325	1,450,662	1,718,325	1,580,995
Paketa Kardiologji	780,576	787,371			780,576	787,371
Pak. Kardiokirurg	367,330	375,926			367,330	375,926
Paketa Implant koklear		33,159			0	33,159
Pak e transp.renal & terapi			30,000	15,449	30,000	15,449
Paketa e Fist. dhe Graftit		2,127		2,668	0	4,795
Paketa e kataraktës	60,000	82,508			60,000	82,508
Paketa e radioterapise	119,304	113,270			119,304	113,270
Totali	**1,449,210**	**1,524,694**	**1,626,325**	**1,468,779**	**3,075,535**	**2,993,473**

PPP-Dializa			**835,000**	**708,948**	**835,000**	**708,948**
					3,910,535	**3,702,691**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Monitorimi dhe analizimi i paketave shëndetësore nga institucionet shëndetësore publike dhe private të kontraktuara dhe të financuara nga Fondi bëhet në zbatim të VKM nr. 308, datë 21.05.2014, "Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në shërbimin spitalor", i ndryshuar. Gjatë vitit 2022 institucionet shëndetësore publike, private dhe shoqëria koncesionare, të kontraktuara nga Fondi kanë ofruar shërbimet e paketave shëndetësore pacientëve.
Sipas VKM nr. 308/2014 me ndryshime, paketat shëndetësore të ofruara gjatë vitit 2022, realizimi i tyre fakt/plan 2022, si dhe në raport me vitin 2021, paraqiten në tabelat e mëposhtme.

Tabela nr.3.37 "Të dhëna mbi shpenzimet sipas paketave shëndetësore"

Në mijë lekë

Nr.	Paketat shëndetësore	Plan 2022	Fakt 2022	Diferenca F/P 2022	Realizimi në %
1	Paketa e dializës	1,718,325	1,580,995	-136,330	92
2	Paketa kardiokirurg	780,576	787,371	6,795	101
3	Paketa kardiologji	367,330	375,926	8,596	102
4	Paketa implant koklear interventi	0	33,159	33,159	
5	*Paketa e Transplantit të Veshkës dhe Terapisë*	*30,000*	*15,449*	*-14,551*	*51*
6	Paketa e vendosjes së Fistulës dhe Graftit	0	4,795	4,795	
7	Paketa e kataraktës	60,000	82,508	21,508	135
8	Paketa e Radioterapisë, Trajt. me akselerator linear	119,304	113,270	-6,034	95
	Totali	**3,075,535**	**2,993,473**	**-82,062**	**97**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Tabela nr.3.38 "Numri i paketave të realizuara në vitin 2022/2021"

Nr.	Numri i Paketave Shëndetësore të realizuara	Viti 2021	Viti 2022	Rritja në % në vitin 2022
1	Paketat e Kardiologjisë	7,103	8,572	20.6
2	Paketat e Kardiokirurgjisë	654	793	21.2
3	Transplanti i veshkës	23	13	-43.5
4	Seanca të dializës	190,766	193,878	1.6
5	Seanca të Radioterapisë	22,961	24,933	8.5
6	Kataraktës	3,018	3,790	25.5
7	Numër Pacient Dializës (Dhjetor)	1,334	1,423	6.6
8	Vendosje Fistulës	192	255	32.8
9	Vendosje Graftit	35	34	-3
10	Numër i terapisë së flakjes akute	0	1	100

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Në vitin 2022, me mosrealizim të dukshëm kundrejt planit, rezulton paketa e "Transplantit të Veshkës dhe "Paketa e Terapisë" me 51 %, kjo për shkak se janë kryer 10 ndërhyrje kirurgjikale më pak, nga sa ishte parashikuar në plan duke ju referuar faktit të vitit 2021.
Në krahasim me vitin 2021 në të gjitha paketat kemi rritje të numrit të tyre me përjashtim të Transplantit të veshkave dhe "Vendosje e Graftit", ndërhyrje e cila është e lidhur me transplantin e veshkave.

Mbi financimin e paketave shëndetësore.

Gjatë vitit 2022, janë likuiduar për shpenzimet e paketave shëndetësore në total 2,993,473 mijë lekë, nga të cilat 1,524,694 mijë lekë për spitalet publike dhe 1,468,779 mijë lekë për spitalet private.

- *Paketa e Dializës*

Në vitin 2022 nga institucionet shëndetësore publike dhe private të kontraktuara nga Fondi për ofrimin e shërbimit të hemodializës u kryen 193,878 seanca hemodialize në total, nga të cilat 10,766 seanca nga institucionet shëndetësore publike, 119,830 seanca nga institucionet shëndetësore jopublike *dhe 63,282 seanca dialize nga kontrata me PPP (koncesionari "DV" SHPK).*

Tabela nr.39 "Realizimi i seancave sipas muajve"

Institucionet Shëndetësore	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Institucione Publike	110	119	113	120	119	99	103	102	121	114	114	137
Institucione Jopublike	810	812	815	827	829	835	850	864	834	841	827	839
PPP	407	407	416	418	424	430	445	467	448	441	438	447
Totali	**1327**	**1338**	**1344**	**1365**	**1372**	**1364**	**1398**	**1433**	**1403**	**1396**	**1379**	**1423**

Burimi i të dhënave FSDKSH

Për paketën e dializës janë planifikuar 1,718,325 mijë lekë, nga e cila PPP-Dializë në shumën 835,000 mijë lekë, si dhe janë realizuar 1,580,995 mijë lekë shpenzime, **me një mosrealizim kundrejt planit në shumën 137,330 mijë lekë.**

Në këto spitale në vitin 2022, janë trajtuar 447 pacientë dhe në vitin 2021 janë trajtuar 410 pacientë. Shpërndarja e kryerjes së seancave të dializës për vitin 2022, sipas institucioneve shëndetësore është realizuar në 61.8 % në institucionet jo publike, në 5.5 % në institucionet publike dhe në 32.7 % të rasteve nga "DV" SHPK. *(trajtuar të seksioni i PPP).*

- *Paketa e Kardiologjisë*

Shërbimi për paketën shëndetësore të Kardiologjisë është mbuluar nga:

Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, e cila ka kryer numrin më të madh të procedurave mjekësore, Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi" Tiranë, Spitali Rajonal Memorial Fier dhe Spitali Rajonal Shkodër.

Për vitin 2022, sipas të dhënave të FSDKSH, janë kryer në total 8,572 procedura të kardiologjisë, si dhe të gjitha nevojat janë mbuluar 100% nga spitalet publike. Për mbulimin e shpenzimeve të këtyre paketave janë planifikuar 367,330 mijë lekë dhe janë realizuar shpenzime në shumën 375,926 mijë lekë, **më një tejkalim në shumën 8,596 mijë lekë.**

Në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021, janë ofruar 1,469 paketa më shumë.

- *Paketa e Kardiokirurgjisë*

Shërbimi për paketën shëndetësore të kardiokirurgjisë për vitin 2022, është mbuluar nga Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë dhe Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi". Për periudhën Janar-Dhjetor 2022, janë kryer 793 procedura mjekësore, të cilat janë kryer të gjitha në institucionet shëndetësore publike. (687 procedura janë kryer në Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë dhe 106 procedura janë kryer në Spitalin Universitar "Shefqet Ndroqi"). Për mbulimin e shpenzimeve të këtyre paketave janë planifikuar 780,576 mijë lekë, si dhe janë shpenzuar në fakt 787,371 mijë lekë, me një tejkalim të shpenzimeve të planifikuara në shumën 6,795 mijë lekë. Sipas të dhënave të FSDKSH, në vitin 2022 janë ofruar 793 paketa të kardiokirurgjisë, nga 628 të ofruara në vitin 2021.

- *Paketa e Transplantit Renal të Veshkës dhe Paketa e Terapisë së Flakjes Akute*

Paketa e Transplantit Renal të Veshkës dhe Paketa e Terapisë së Flakjes Akute është mbuluar nga institucionet shëndetësore jopublike të kontraktuara me Fondin.

Sipas të dhënave të FSDKSH, për periudhën Janar-Dhjetor 2022, janë kryer gjithsej 13 transplante dhe 1 procedurë terapi e flakjes akute të veshkës nga të cilat, **7** transplante renale të kryera në spitalin jopublik "A" dhe 1 terapi e flakjes akute; 6 transplante renale të kryera në spitalin jopublik "H". Në spitalet universitare publike nuk ofrohet ende paketa e transplantit të veshkës dhe terapisë së flakjes akute.
Për mbulimin e shpenzimeve të kësaj paketave janë planifikuar 30,000 mijë lekë, si dhe janë shpenzuar në fakt 15,449 mijë lekë, kjo për faktin se referuar vitit të mëparshëm numri i ndërhyrjeve kirurgjikale është ulur me 10 raste më pak, në vitin 2021 janë trajtuar 23 raste dhe në vitin 2022 janë trajtuar 13 raste.

- *Paketa e Implantit Koklear*

FSDKSH gjatë vitit 2022 ka lidhur kontratë me Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë dhe dy spitale jopublike, spitalin jopublik "A" Tiranë dhe spitalin jopublik "H", që e ofrojnë këtë shërbim. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022, janë realizuar 12 paketa të implantit koklear në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë.
Gjatë vitit 2022, janë shpenzuar për ofrimin e kësaj pakete 33,159 mijë lekë. Në çelje të buxhetit nuk është planifikuar fond për këtë lloj pakete, por është realizuar me transferim të tyre gjatë vitit, sipas nevojës, bazuar në VKA nr. 2, datë 15.02.2022 "Për financimin shtesë të spitaleve publike për realizimin e paketave shëndetësore të përcaktuara me VKM, të ofruara për shërbimet spitalore publike", pika 4.

- *Paketa e vendosjes së Fistulës dhe Graftit*

Në vitin 2022 FSDKSH ka lidhur kontratë me Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, me spitalin jopublik "A 1" dhe spitalin jopublik "H", që e ofrojnë këtë shërbim duke plotësuar nevojat e pacientëve. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 janë realizuar gjithsej 255 vendosje fistule, nga të cilat në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë 137 vendosje fistule, në spitalin jopublik "A" 81 vendosje fistule dhe në spitalin jopublik "H" 37 vendosje fistule. Gjithashtu janë realizuar në total 34 grafte, nga të cilat 10 grafte në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, 17 grafte në spitalin jopublik "A" dhe 7 grafte në spitalin jopublik "H".
Sipas të dhënave të FSDKSH, në vitin 2022 kemi rritje të rasteve të trajtuara me këto paketa në krahasim me dy vitet e mëparshme. Në vitin 2022, janë trajtuar 289 raste, në vitin 2021 janë trajtuar 216 raste, ose 73 raste më shumë të vendosjes së graftit.
Gjatë vitit 2022, janë shpenzuar për ofrimin e kësaj pakete 4,795 mijë lekë. Në çelje të buxhetit nuk është planifikuar fond për këtë lloj pakete, por është realizuar me transferim të tyre gjatë vitit, sipas nevojës.

- *Paketa e Kataraktës*

Paketa e kataraktës është ofruar nga spitalet publike të kontraktuara nga Fondi si Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, Spitali Universitar i Traumës dhe Spitalet Rajonale Fier, Vlorë dhe Durrës.
Për periudhën Janar-Dhjetor 2022, janë trajtuar në total 3,790 pacientë me paketën e kataraktës, nga të cilët në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë 2,829 raste, në Spitalin Rajonal Fier 302 raste, në Spitalin Rajonal Vlorë 303 raste, në Spitalin Rajonal Durrës 127 raste dhe në Spitalin Universitar të Traumës 229 raste. Buxheti në dispozicion të kësaj pakete ka qenë në shumën 61,000 mijë lekë dhe janë shpenzuar 82,508 mijë lekë, me një tejkalim në shumën 21,508 mijë lekë.
Sipas të dhënave të FSDKSH, në vitin 2022 janë trajtuar me këtë paketë 3,790 raste, në vitin 2021 janë trajtuar 3,018 raste, ose 772 raste më shumë.

- *Paketa e Radioterapisë, Trajtimi me akselerator linear*

Paketa e radioterapisë, trajtimi me akselerator linear është ofruar vetëm nga Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë. Në periudhën Janar-Dhjetor 2022, janë realizuar gjithsej

24,933 seanca radioterapie sipas llojit të paketave. Buxheti në dispozicion për këtë paketë ka qenë në shumën 119,304 mijë lekë dhe janë shpenzuar në fakt 113,270 mijë lekë, me një mosrealizim shpenzimesh në shumën 6,034 mijë lekë. Në vitin 2022 janë trajtuar 24,933 raste, nga 22,961 raste të trajtuara në vitin 2021, ose 1,972 raste më shumë.

Mbi monitorimin dhe likuidimin e shpenzimeve të paketave.

Monitorimi i paketave shëndetësore kryhet në DAPSHET/DSHSU dhe DRF, sipas Udhëzimit nr.18, datë 23.12.2019 "Për monitorimin e paketave shëndetësorë të financuara nga FSDKSH në institucionet publike dhe jo publike", ku në pikën I.3 cilësohet: *"Monitorimi i paketave shëndetësore kryhet në DAPSHET/DSHSU dhe Drejtoritë Rajonale të Fondit (DRF)"*

Në lidhje me monitorimin e paktave në pikën II.5 cilësohet: *"Struktura monitoruese (personat përgjegjës të caktuar për verifikim) dorëzojnë me procesverbal gjithë dokumentacionin (origjinal) bashkë me akt verifikimin e mbajtur nga grupi i verifikimit në sektorin e financës, duke autorizuar kryerjen e pagesës"*. Në fund të vitit 2022, rezultojnë shpenzime të pa likuiduara në shumën 128,329 mijë lekë që i përkasin detyrimeve të muajit dhjetor për 5 DRF, si më poshtë:

Tabela nr. 3.40 "Detyrimet"

Në mijë lekë

DRF	Detyrime të pa likuiduara kaluar në vitin 2023	Detyrimi mbetur për në vitin 2023	
		Detyrimi nga dhjetori 2022	Detyrimi total
Berat	11,585	11,585	11,585
Durrës	21,125	21,125	21,125
Fier	16,936	16,936	16,936
Gjirokastra	8,595	8,595	8,595
DSHSU	70,087	70,087	70,087
Totali	**128,329**	**128,329**	**128,329**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Shpenzimet e kryera mbi koncesionet dhe PPP-të.

Mbi koncesionin e dializës

Një pjesë e shërbimi i dializës, ose 32.6 % e rasteve kundrejt totalit për vitin 2022, është realizuar sipas Kontratës Koncesionare nr. 1503/44, datë 10.02.2016 "Për ofrimin e hemodializës" me shoqërinë "DV" SHPK. Ky shërbim mundësohet nga 5 rajone, Shkodër, Lezhë, Elbasan, Korçë dhe Vlorë dhe financohet nga Fondi në bazë të Kontratës së Financimit nr. 710, datë 10.02.2016, e cila është lidhur në vijim të Kontratës së Koncesionit të nënshkruar ndërmjet shoqërisë "DV" SHPK dhe Ministrisë së Shëndetësisë si autoritet kontraktor me një afat 10 vjet.

Referuar dokumenteve të kontratës, mbështetja buxhetore sipas parashikimeve duhet të jetë në shumën 7,221,364 mijë lekë. Sipas kontratës është përcaktuar:

- numrin e seancave për pacient, në total 156 seanca në vit;
- çmimi për seancë hemodialize për shërbimin e ofruar 11,203 lekë pa TVSH;
- numri i pacientëve në 10 vite dhe për çdo qendër të hemodializës është përcaktuar në Aneksi nr. 7 "Çështje financiare", dhe parashikimi është si më poshtë:

Tabela nr. 3.43 "Projeksioni i hemodializës sipas qendrave dhe viteve"

Vitet	Shkodër		Lezhë		Elbasan		Vlorë		Korçë		Totali vjetor	
	Nr. Pac.	Nr. Se.	Nr. Pac.	Nr. Se.	Nr. Pac.	Nr. Se.	Nr. Pac.	Nr. Se.	Nr. Pac.	Nr. Se.	Nr. Pac.	Nr. Se.
2016	62	9,672	40	6,240	81	12,636	46	7,176	77	12,012	306	47,736
2017	66	10,296	43	6,708	87	13,572	49	7,644	81	12,636	326	50,856
2018	71	11,076	46	7,176	93	14,508	52	8,112	85	13,260	347	54,132
2019	76	11,856	49	7,644	99	15,444	56	8,736	90	14,040	370	57,720
2020	81	12,636	52	8,112	106	16,536	60	9,360	95	14,820	394	61,464

2021	86	13,416	56	8,736	114	17,784	64	9,984	100	15,600	420	65,520
2022	**93**	**14,508**	**60**	**9,360**	**122**	**19,032**	**69**	**10,764**	**106**	**16,536**	**450**	**70,200**
2023	99	15,444	64	9,984	130	20,280	73	11,388	112	17,472	478	74,568
2024	106	16,536	69	10,764	139	21,684	78	12,168	118	18,408	510	79,560
2025	109	17,004	72	11,232	145	22,620	83	12,948	122	19,032	531	82,836
Total	**849**	**132,444**	**551**	**85,956**	**1,116**	**174,096**	**630**	**98,280**	**986**	**153,816**	**4,132**	**644,592**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Për rrjedhojë mbështetja buxhetore sipas këtyre treguesve është 644,592 seanca * 11,203 lekë/seanca=**7,221,364 mijë lekë.**

Tabela nr. 3.41 "Projeksioni mbi seancat dhe mbështetjen buxhetore sipas viteve"

Periudha	Seanca sipas viteve	Financimi sipas viteve
2016	47,736	534,786,408
2017	50,856	569,739,768
2018	54,132	606,440,796
2019	57,720	646,637,160
2020	61,464	688,581,192
2021	65,520	734,020,560
2022	**70,200**	**786,450,600**
2023	74,568	835,385,304
2024	79,560	891,310,680
2025	82,836	928,011,708
Totali	**644,592**	**7,221,364,176**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Sipas Kontratës, mënyra e pagesës është mbi nivelin e shërbimit të ofruar, por duke garantuar njëkohësisht edhe një minimum sipas projeksioneve dhe pagesë për mbi projeksionet të evidentuara në nivel mujor, ç'ka ka sjellë tejkalim të fondeve të parashikuara për mbështetje buxhetore të kësaj kontrate.

Fillimi i këtij shërbimi daton në vitin 2016 me qendrën e dializës në Vlorë.

Planifikimi i fondeve buxhetore për financimin e shërbimit të dializës, përllogaritet si projeksion i numrit të pacientëve, seancave dhe tarifës së shërbimit për seancë të përcaktuar në Aneksin nr. 7 "Çështje financiare" të kontratës që për vitin 2022, e shprehur në vlerë totale shërbimi rezulton në shumën 786,450 mijë lekë (70,200 seanca * 11,203 lekë), paraqitur sipas rajoneve në tabelën e mëposhtme. Në buxhet janë planifikuar 835,000 mijë lekë për shpenzimet e PPP-Dializë, të destinuara për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe shpenzimet e vitit 2022.

Tabela nr.3.42 "Projeksioni i dializës për vitin 2022, sipas qendrave"

Rajonet	Numër pacientë	Numër seanca/vit	Vlera në mijë lekë pa TVSH projeksioni	Realizimi faktik
Shkodër	93	14,508	162,533	226,491
Lezhë	60	9,360	104,860	184,379
Elbasan	122	19,032	213,215	110,674
Korçë	106	16,536	185,253	161,178
Vlorë	69	10,764	120,589	119,861
Total	**450**	**70,200**	**786,450**	**802,583**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i auditimit të KLSH

Në vitin 2022, sipas të dhënave të tabelës së mëposhtme, janë realizuar 63,282 seanca, kundrejt 70,200 seanca të projektuara për vitin 2022, ose më një realizim në masën 90.1 %. Referuar seancave faktike të kryera dhe pacientëve të trajtuar, rezulton se numri i seancave të kryera nga një pacient është rreth 148 seanca në vit, nga 156 seanca sipas projeksionit.

Tabela nr.3.43 "Numri i seancave të dializës sipas projeksionit vjetor dhe realizimit për PPP"

Dializa PPP	Nr. i pacientëve sipas projeksionit 2022	Nr. i seancave sipas projeksioni 2022	Nr. mesat i pacientëve Fakti 2022	Nr. i seancave të realizuara 2022	% e realizimit të nr. të pacientëve 2022	% e realizimit të nr. të seancave 2022
DV Shkodër	93	14,508	80	11,525	86	79.4
DV Lezhë	60	9,360	65	9,912	105	105.9
DV Vlorë	69	10,764	52	7,503	74	69.7
DV Elbasan	122	19,032	137	20,156	104	105.9
DV Korçë	106	16,536	95	14,186	84	85.8
Totali	**450**	**70,200**	**429**	**63,282**	**91**	**90.1**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i auditimit të KLSH

Tabela nr. 3.44 "Numri i pacientëve dhe numri i seancave të dializës sipas muajve të ofruar nga Shoqëria Tregtare "DV SHPK".

Periudha	Projeksioni mujor i numrit të pacienteve	Numri i pacientëve fakt	Diferenca	Projeksioni mujor i numrit të seancave	Numri i seancave faktike	Diferenca e numrit të seancave
	(a)	(b)	(c) =a-b	(d)	(e)	(f)=d-e
Janar	450	407	43	5850	5012	838
Shkurt	450	407	43	5850	4651	1199
Mars	450	416	34	5850	5307	543
Prill	450	418	32	5850	5151	699
Maj	450	424	26	5850	5209	641
Qershor	450	430	20	5850	5263	587
Korrik	450	445	5	5850	5338	512
Gusht	450	467	-17	5850	5729	121
Shtator	450	448	2	5850	5329	521
Tetor	450	441	9	5850	5342	508
Nëntor	450	438	12	5850	5363	487
Dhjetor	450	447	3	5850	5588	262
Totali	**5,400**	**5,188**	**212**	**70,200**	**63,282**	**6,918**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i auditimit të KLSH

Titulli i gjetjes: **Mbi zbatimin e kontratës së shërbimit të hemodializës dhe mënyrën e pagesës.**

Situata: Sipas të dhënave të paraqitura në tabelat e mësipërme numri i pacientëve të trajtuar me dializë në nivel vjetor paraqitet nën projeksionin mujor me përjashtim të muajit Gusht, ndërsa numri faktik i seancave të dializës në total për 5 qendrat nuk e ka tejkaluar projeksionin mujor. Pavarësisht këtij fakti pagesat për dializën mbulojnë mbi projeksionet mujore të çdo qendre veçmas, si dhe nën projeksionet të cilat në total janë 8,854 raste (6,918+1,936=8,854).
Gjithashtu, rezulton se në vitin 2022, tre rajone paraqiten nën projeksion vjetor me 8,854 raste dhe dy rajone paraqiten mbi projeksion vjetor me 1,936 raste, të detajuar në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr.3.45 "Devijimi mbi dhe nën projeksion i seancave në nivel rajonal"

Rajonet	Numër seanca/vit sipas projeksionit 156 seanca/pacient	Numër seanca të realizuara në vitin 2022	Mbi projeksion	Nën projeksion

Shkodër	14,508	11,525		2,983
Lezhë	9,360	9,912	624	72
Elbasan	19,032	20,156	1,312	188
Korçë	16,536	14,186		2,350
Vlorë	10,764	7,503		3,261
Total	**70,200**	**63,282**	**1,936**	**8,854**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i auditimit të KLSH

Sipas kontratës, pagesa për seancë dialize është në shumën 11,203 lekë, ç' ka do të thotë se shpenzimet për seanca të kryera përllogariten në shumën 708,948 mijë lekë pa TVSH.

- Në 5 rajonet "Qendra dialize" në vitin 2022, janë kryer 1,936 seanca dialize të faturuara mbi projeksionin e përcaktuar në kontratën koncesionare për ofrimin e shërbimit, pasi niveli i shërbimit të përfituar mujor ka qenë mbi vlerat e projektuara. Tejkalimi i numrit të seancave të dializës mbi projeksionin mujor të planifikuar në vitin 2022 i përket Qendrës së dializës Elbasan dhe Qendrës së dializës Lezhë të cilat në 5 muaj kanë tejkalim projeksioni mujor, **në total 1,936 seanca dialize mbi projeksion.**
- Referuar të dhënave të mësipërme, konstatohet se **kemi nivel të faturimit të shërbimit për shërbime të pakryera për 8,854 raste (72,136-63,282=8,854 raste, ose 6,918 + 1,936=8,854) në shumën 99,191 mijë lekë pa TVSH.**

Për shmangien e pagesave për shërbim të pakryer, referuar rekomandimit të KLSH të lënë në auditimin e mëparshëm nga FSDKSH dhe MSHMS, nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve ka rezultuar se janë ndërmarrë disa masa cilat konsistojnë në:

FSDKSH me shkresën nr. 34/53 prot., datë 07.09.2022 "Mbi zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit" i është drejtuar MSHMS, ku kërkohet bashkëpunimi për zbatimin e rekomandimit të lënë nga KLSH.

MSHMS me nr. 307/9 prot., datë 17.10.2022, ka nxjerrë Urdhrin nr.584, datë 17.10.2022 "Për ngritjen e grupit të punës për negocimin e kontratës koncesionare nr.1503/44, datë 10.02.2016 "Për shërbimin e hemodializës në pesë qendra pranë Spitaleve Rajonale të Vlorës, Shkodrës, Elbasanit, Korçës dhe Lezhës". Ndër të tjera, në pikën 2 të këtij Urdhri me nr. Ref 581/2022, grupi punës ngarkohet me detyrën e negocimit me përfaqësuesit e shoqërisë koncesionare "DV" shpk për:

- Rishikimin e projeksionit sipas rajoneve në bazë të historikut që disponon MSHMS dhe FSDKSH;
- Rishikimin e kushteve të kontratës në lidhje me pagesat që në vijim të kryhen sipas parimit (Pay x Use) me qëllim që të paguhen vetëm shërbimet e kryera.

Pavarësisht sa më sipër, nuk ka hapa konkretë në lidhje me rishikimin e kësaj kontrate dhe për rrjedhojë, likuidimi i shpenzimeve të koncesionarit edhe gjatë vitit 2022, është kryer edhe për rastet e nën projeksionit vjetor dhe mbi projeksionit mujor, pra situata vazhdon të jetë e njëjtë.

Gjithashtu, mënyra e likuidimit të kësaj kontrate, ka efekte negative në angazhimin e fondeve shtesë për mbështetje buxhetore, pasi referuar dokumenteve të kontratës, mbështetja buxhetore sipas parashikimeve

duhet të jetë në shumën 7,221,364 mijë lekë në total, referuar elementëve të mëposhtëm:

- *numrin e seancave për pacient, në total 156 seanca në vit;*
- *çmimi për seancë hemodialize për shërbimin e ofruar 11,203 lekë pa TVSH;*
- *numri i pacientëve në 10 vite, përcaktuar në Aneksi nr. 7 "Çështje financiare", është 4,132 pacientë.*

Aktualisht shpenzimet për financim janë në rritje nga viti në vit, kështu në vitin 2021 fatura të pranuara në shumën 749,918 mijë lekë; në vitin 2022 fatura të pranuara në shumën 807,647 mijë lekë, si dhe planifikuar në PBA, për vitin 2023 shuma 887,000 mijë lekë dhe për vitin 2024 shuma 946,000 mijë lekë, nga 835,385 mijë lekë dhe 891,310 mijë lekë të parashikuar në kontratë për mbështetje buxhetore për vitet 2023 dhe 2024.

Ndikimi/pasoja: Kryerja e pagesave në nivel projeksioni, duke përfshirë dhe likuidimin e shërbimit të pa kryer, **shoqërohet me shpenzime buxhetore në shumën 99,191 mijë lekë.**

Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga FSDKSH, niveli i realizimit të kësaj kontrate nga viti 2016 deri në vitin 2022, ka rezultuar i dis balancuar midis rajoneve. Hartimi i projeksioneve nuk është në përputhje me nevojat reale për kryerjen e shërbimit, mjafton të evidentojmë faktin që rajonet Shkodër dhe Vlorë, që prej fillimit të këtij shërbimi në vitin 2016, paraqiten me realizim nën projeksion konkretisht në Rajonin Vlorë me 12,091 seanca nën projeksion ose 162,546 mijë lekë të paguara për shërbim të pakryer; Rajoni Shkodër me 15,805 seanca nën projeksion, ose 212,476 mijë lekë shpenzime për shërbim të pa kryer, ndërkohë që sipas kontratës i paguhet koncesionarit çdo mbi projeksion mujor.

Nga viti 2016 deri në vitin 2022, rajonet Lezhë, Elbasan dhe Korçë paraqiten me mbi projeksion respektivisht me 2,531 raste; 12,672 raste dhe 481 raste, çka ka sjellë pagesa jo vetëm për nën projeksionin, por dhe pagesa për mbi projeksionin të cilat do të ishin evituar, nëse do të kishim një balancim të nivelit të projeksioneve sipas rajoneve.

Shkaku: Kushtet e kontratës së PPP së Dializës, ku është përcaktuar likuidimi i koncesionarit në nivel projeksioni dhe nën projeksioni në nivel mujor për secilën qendër dialize, duke favorizuar partnerin privat.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të ndjekë zbatimin e Urdhrit nr.584, datë 17.10.2022 "Për ngritjen e grupit të punës për negocimin e kontratës koncesionare nr.1503/44, datë 10.02.2016 "Për shërbimin e hemodializës në pesë qendra pranë Spitaleve Rajonale të Vlorës, Shkodrës, Elbasanit, Korçës dhe Lezhës", mbi kryerjen e negociatave me shoqërinë koncesionare "DV" SHPK, për: Rishikimin e projeksionit sipas rajoneve në bazë të historikut që disponon MSHMS dhe FSDKSH; Rishikimin e kushteve të kontratës në lidhje me pagesat që në vijim të kryhen sipas parimit (Pay x Use), me qëllim **eliminimin e pagesave për shërbim të pakryer, të cilat në vitin 2022 rezultojnë në shumën 99,191 mijë lekë**, si dhe për realizimin e kësaj kontrate brenda mbështetjes buxhetore të planifikuar për 10 vitet e zbatimit.

Realizimi i shpenzimeve në vitin 2022, krahasuar me vitin 2021.

Referuar të dhënave të tabelës nr. 3.49, janë kryer pagesa për një numër më të lartë seancash dialize. Në rajonet Lezhë janë paguar 745 raste nën projeksioni, në Shkodër 1,126 raste nën projeksioni, në Lezhë 142 raste mbi projeksioni, në Rajonin Elbasan 142 raste nën projeksioni dhe në Korçë 686 raste nën projeksioni, më shumë se në vitin 2021, ose 3,297 raste më shumë me efekt në vlerën 36,936,291 lekë pa TVSH.

Tabela nr.3.46 "Seanca mbi dhe nën projeksion sipas qendrave dhe viteve"

Viti	Vlorë		Shkodër		Lezhë		Elbasan		Korçë	
	Nen Proj.	Mbi-Proj.	Nen Proj.	Mbi-Proj.	Nen Proj.	Mbi-Proj.	Nen Proj.	Mbi-Proj.	Nen Proj.	Mbi-Proj.
2022	3,261	0	2,983	0	72	624	188	1,312	2,350	0
2021	2,516	0	1,857	0	165	127	46	1,320	1,664	0
Dif.2022/2021	**745**	**0**	**1126**	**0**	**(93)**	**497**	**142**	**(8)**	**686**	**0**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i auditimit të KLSH

Mbi monitorimin dhe likuidimin e shpenzimeve të faturuara.

Likuidimi i detyrimeve të faturuara nga koncesionari, paraprihet nga kontrolli mbi zbatimin e kontratës i cili realizohet nga DRF përkatëse, ku janë vendosur Qendrat e Dializës. Nga ana e tyre verifikohen shërbimet e kryera për çdo pacient dhe seanca te kryera, referuar protokollit që duhet të zbatojë koncesionari në kryerjen e këtij shërbimi sipas Aneksit nr. 13 "Protokolli i hemodializës", si dhe dokumentacionit të përcaktuar në pikën 7 "Dokumentacioni mbi bazën e të cilit do të bëhet pagesa" (Kërkesë për pagesë dorëzuar nga koncesionari; Raporti përmbledhës mujor i shërbimeve të dhëna sipas pacientëve e nxjerrë nga administratori i sistemit, si dhe fatura tatimore e lëshuar nga koncesionari sipas pikave 5.3; 5.4 dhe 5.5 të Kontratës së financimit). DRF sipas përcaktimeve në Kontratën financiare, pika 8 "Verifikimi i kërkesave për pagesë dhe pagesa" kryejnë verifikimin e dokumentacionit.

Titulli i gjetjes: **Mbi monitorimin dhe kontrollin e zbatimit të kontratës PPP-Dializa për vitin 2022.**

Situata: Në pikën 7.2 të Kontratës Financiare cilësohet se: *"Dokumentacioni i cilësuar në pikën 7, paraqitet një herë në muaj në zyrën përkatëse në Fond, që ngarkohet për ndjekjen e regjistrit të hemodializës*", detyrë kjo që ndiqet nga Drejtoria e Shërbimeve Spitalore Universitare (DSHSU/DAPSHET), bazuar në Udhëzimin nr. 3, datë 09.01.2019 "Për administrimin e Regjistrit Kombëtar të paketave" dhe Udhëzimin nr. 18, datë 23.01.2019 "Për monitorimin e paketave shëndetësore të financuara nga FSDKSH në institucionet publike dhe jo publike.", pika I "Të përgjithshme" ku cilësohet se:

1. *"DAPSHET, është struktura që administron Regjistrin Kombëtar të Paketave Shëndetësore Spitalore në nivel Fondi.*
2. *Rregullat, kriteret dhe mënyra e organizimit të Regjistrit Kombëtar të Paketave bazohet në VKA të Fondit.*
3. *Monitorimi i Paketave Shëndetësore kryhet nga DAPSHET dhe DRF".*

Pavarësisht se kontrolli dhe pranimi i faturave është detyrë e DRF dhe DSHSU-së, edhe FSDKSH ka për detyrë kontrollin e zbatimit të kësaj kontrate nëpërmjet strukturave të saj. Nga auditimi ka rezultuar se, nga strukturat e DQ të FSDKSH, si: Drejtoria e Kujdesit Parësor dhe Spitalor, Drejtoria e Kontrollit gjatë vitit 2022, nuk kanë kryer

inspektime, auditime apo kontrolle në lidhje me koncesionin e hemodializës.

Ndikimi/pasoja: Mos evidentimi i mangësive në zbatimin e kontratës, sjell pasoja në eliminimin e tyre në kohën e duhur.

Shkaku: Mos planifikim dhe mos kryerje e kontrolleve nga këto struktura për monitorimin dhe zbatimin e kësaj kontrate, si rezultat i mungesës së analizave bazuar në kritere risku, si dhe i mungesës së stafit të mjaftueshëm për të mbuluar me kontroll të gjitha subjektet.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i FSDKSH të nxjerrë përgjegjësitë e strukturave përkatëse si dhe të marrë masa që në vijimësi pjesë e planeve të kontrollit të Drejtorisë së Kujdesit Parësor dhe Spitalor dhe Drejtorisë së Kontrollit, të jetë dhe monitorimi dhe kontrolli i zbatimit të kësaj kontrate.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: Znj. A.Ç., Drejtore e Përgjithshme e FSDKSSH, z. Sh.S., Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit, dhe znj. M.M., Drejtore e Drejtorisë së Kontrollit Parësor dhe Spitalor.

Sipas të dhënave të referuara nga Drejtoria Ekonomike në lidhje me pagesat e kryera për shërbimin dializës me PPP konstatohet se sipas rajoneve janë kryer pagesat e mëposhtme:

Tabela nr.3.47 "Pagesat e kryera dhe detyrimet për shërbimin dializës"

Në mijë lekë

Rajonet	Dializa detyrimi mbetur nga viti 2021 (çelja 2022)			Likuidimi në fakt (total)	Dializa e likuiduar e vitit 2022	Detyrimi mbetur për vitin 2023	Total detyrimi 2022
	Detyrimi nga viti 2021	Shlyer detyrimi	Mbetur për shlyerje				
	(1)	*(2)*	*(3=1-2)*	*(4=2+5)*	*(5=4-2)*	*(6)*	*(7=5+6)*
Shkodër	12,525	12,525	-	226,491	148,653	13,544	162,197
Lezhe	8,749	8,749	-	184,379	101,925	9,836	111,761
Vlore	9,321	9,321	-	110,674	110,540	10,049	120,589
Elbasan	18,451	18,451	-	161,178	208,040	19,807	227,847
Korçe	14,564	14,564	-	119,861	169,815	15,438	185,253
Totali	**63,611**	**63,611**	**-**	**802,583**	**738,973**	**68,674**	**807,647**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i auditimit të KLSH

Niveli i pagesave në shumën 802,583 mijë lekë përfshin shlyerjen e detyrimeve të vitit 2021 në shumën 63,611 mijë lekë, pagesat për shërbimin e ofruar në vitin 2022 në shumën 738,973 mijë lekë. Nga detyrimet në total për vitin 2022 në shumën 807,647 mijë lekë, rezultojnë detyrime të pashlyera të mbartura në vitin 2023 në shumën 68,674 mijë lekë të detajuar në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr.3.48 "Detyrime të pa likuiduara të mbartura në vitin 2023"

Në mijë lekë

DRF	Detyrimi mbetur nga viti 2022	
	Nga dhjetori	Gjithsej
Elbasan	19,807	19,807
Korçe	15,438	15,438
Lezhe	9,836	9,836
Shkoder	13,544	13,544

Vlore	10,049	10,049
Totali	**68,674**	**68,674**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i auditimit të KLSH

Tabela nr.3.49 "Likuidimi faturave"

PPP-Dializa	2021	2022
Plani përfundimtar	754,000	835,000
Fakti total	747,195	802,583
Likuidimet për efekt te detyrimeve te prapambetura	60,888	63,611
Vlera e faturuar nga koncesionari për vitin 2022, pa TVSH	750,164	808,072
Pranuar për likuidim (detyrim i konstatuar/i njohur)	749,918	807,647
Likuiduar	686,307	738,972
Detyrim i vitit pa likuiduar dhe kaluar ne vitin pasardhës	63,611	68,674

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i auditimit të KLSH

PPP-Mbi shërbimin e furnizimit me instrumente dhe materiale mjekësore të sterilizuara.

Koncesioni i sterilizimit, ofron shërbimin e furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile dhe furnizim me materiale mjekësore sterile, në zbatim të Kontratës së Koncesionit nr.1440/33 datë 10.12.2015 "Për ofrimin e setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikalë sterilë, furnizimin me material mjekësor steril një përdorimësh në sallat kirurgjikale si dhe trajtimin e mbetjeve më rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale më operatorë të përzgjedhur", me Partneritet Publik Privat (PPP), midis "S." SHPK dhe Ministrisë së Shëndetësisë, si përfituese e shërbimit, me afat 10 vjeçar, me fond limit në vlerën 9,657,000 mijë lekë pa TVSH dhe 11,588,400 mijë lekë me TVSH, me mënyrë pagese sipas parimit "Pay x Use". Kjo vlerë është parashikuar në dokumentet standarde të koncesionit/partneritetit publik privat për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikalë sterilë, furnizimin me material mjekësor steril një përdorimesh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale, konkretisht në Aneksin 1, Kapitulli IV.1.1 "Vlera Totale 9,657,000,000 lekë (pa TVSH)", cilësohet:

"*Vlera e parashikuar në këtë pikë* ***është vlera maksimale e mbështetjes financiare*** *e llogaritur si shuma e pagesave te parashikuara të 10 viteve së bashku pa TVSH, e cila do të kryhen nga Autoriteti Kontraktor në këmbim të shërbimit. Kjo është vlere e parashikuar ne baze te studimit te fisibilitetit dhe planit financiar, te përgatitur nga komisioni për hartimin e këtij dokumenti".*

Referuar ecurisë së zbatimit të kësaj kontrate, si dhe planifikimit të mbështetjes buxhetore, sipas PBA 2022-2024 rezulton se, kemi tejkalim të parashikimeve për mbështetje buxhetore referuar kontratës së lidhur me koncesionarin. Konkretisht, në vitin 2022 ishin parashikuar 1,750,000 mijë lekë sipas PBA dhe 1,700,000 mijë lekë në buxhetin vjetor të 2022, si dhe për vitin 2023 dhe 2024 janë parashikuar përkatësisht 1,770,000 mijë lekë dhe 1,790,000 mijë lekë, ç'ka flet edhe për tendencën në rritje të financimit të kësaj kontrate.

Në vitin 2020, është bërë amendim i kontratës, sipas shkresës nr. 228 prot., datë 15.01.2020, ku është bërë një ndryshim në nenin 7.1 germa (i, ii, iii). Ky ndryshim ka të bëjë me faktin që nëse ka tejkalim të ndërhyrjeve mbi kufirin prej 63,000 raste, për këtë tejkalim do të aplikohet një zbritje në masën 25 % të çmimit referuar nenit 7.1. Në pikën 2.2 të këtij amendimi është cilësuar se: *"Shtesa sipas nenit 2.1, të kësaj marrëveshje amendimi do të shoqërohet me ndryshim të aneksit nr. 6 "Kontrata financimit", e cila është pjesë e kontratës së Koncesionit".*

Ndryshimi "shtesa e pikës 2.2" është nënshkruar nga titullari i FSDKSH dhe Administratori i "S." SHPK. Gjatë zbatimit të kontratës, pas këtij ndryshimi nuk ka patur tejkalim të numrit të ndërhyrjeve prej 63,000 raste.

Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga FSDKSH në lidhje me koncesionin e sterilizimit ka rezultuar se, kjo kontratë ka në përbërje të saj edhe 6 anekse, ku Aneksi 6 përcakton mënyrën e financimit dhe Aneksi nr. 4 përcakton klasat e kompleksitetit (e lartë, e mesme dhe e ulët)

referuar tipologjisë së ndërhyrjeve kirurgjikale, ndryshuar në vitin 2020, referuar shkresës nr. 150/23 prot., datë 16.12.2020 të MSHMS, drejtuar spitaleve, si zbatues të kontratës së koncesionit, për zbatim dokumentin "Konfigurimi i seteve kirurgjikale 2020", bashkëngjitur materiale me emërtimin *"Konfigurimi i seteve 30.11.2020".*

Në vitin 2022, ky shërbim është ofruar në 29 spitale publike (5 Spitale Universitare në Tiranë, 11 Spitale Rajonale dhe 13 Spitale Bashkiake), ku sipas kompleksiteteve të përdorura gjatë ndërhyrjeve kirurgjikale, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.3.50 "Shërbimet sipas spitaleve universitare e rajonale sipas kompleksiteteve"

Spitalet	**Realizimi ndërhyrjeve sipas kompleksiteteve, viti 2022**				**Paketime me avull**	**Sterilizim ne temperatura të ulëta**
	I lartë	**I mesëm**	**I ulët**	**Total**		
QSUT	7,134	6,803	8,267	22,204	30,849	757
SU "Shefqet Ndroqi"	398	163	893	1,454	3,161	1,907
SUOGJ "M Geraldine"	359	2,970	31	3,360	-	38
SUOGJ "Koço Gliozheni"	486	1,956	52	2,494	-	25
Sp.Univers Trauma	3,231	2,009	3,374	8,614	23,914	993
Shkodër	754	1,162	2,099	4,015	4,212	2
Elbasan	173	977	1,513	2,663	-	-
Librazhd	13	257	263	533	-	-
Gramsh	-	3	71	74	-	-
Vlorë	437	891	1,145	2,473	3,318	30
Durrës	763	1,578	957	3,298	3,521	10
Fier	356	919	863	2,138	-	1
Lezhë	304	578	477	1,359	1,856	30
Krujë	11	66	95	172	7	-
Berat	23	682	587	1,292	1,202	-
Lushnje	6	282	502	790	2,157	-
Kavajë	-	-	3	3	-	-
Mirditë	-	10	9	19	-	-
Dibër	120	296	308	724	-	-
Mat	-	10	143	153	329	-
Korçë	316	609	741	1,666	-	4
Kolonjë	-	-	-	-	-	-
Pogradec	2	206	134	342	-	-
Sarandë	2	174	6	182	-	-
Pukë	1	15	13	29	-	-
Kukës	26	229	204	459	1,643	-
Tropojë	1	1	58	60	737	-
Bulqizë	-	-	4	4	14	-
Gjirokastër	20	297	339	656	-	-
Spitali Rajonal Memorial Fier	-	-	-	-	-	-
Totali 2022	**14,936**	**23,143**	**23,151**	**61,230**	**76,920**	**3,797**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i auditimit të KLSH

Referuar kontratës së sterilizimit ky shërbim ofrohet sipas kompleksitetit të ndërhyrjeve dhe çmimeve përkatëse. Në tabelën e mëposhtme paraqitet numri i rasteve të ndërhyrjeve kirurgjikale, referuar tarifës sipas kompleksitetit të setit të instrumenteve kirurgjikale të përdorura, në spitalet universitare dhe ato rajonale dhe bashkiake.

Tabela nr.3.51 "Të dhëna mbi rastet sipas kompleksitetit dhe spitaleve"

Spitali		**Komplek i Lartë (çm. Pa tvsh 37700 lekë)**		**Kompleksi i Mesëm (çmimi Pa tvsh 22,300 lekë)**		**Kompleksiteti i Ulët (çmimi Pa tvsh 13,900 lekë)**		**Steriliz i Inst me Avull (çmimi Pa tvsh 266 lekë)**		**Steriliz i Inst në temp. te ulet (çmimi Pa tvsh 1090 lekë)**	
		Raste numër	**Mijë lekë**	**Raste numër**	**Mijë lekë**	**Raste numër**	**Mijë lekë**	**Raste numër**	**Mijë lekë**	**Raste numër**	**Mijë lekë**
1	QSUT	7,134	268,952	6,803	151,707	8,267	114,911	30,849	8,206	757	825
2	SU "Shefqet Ndroqi"	398	15,005	163	3,635	893	12,413	3,161	841	1,907	2,079
3	SUOGJ "M.G.'	359	13,534	2,970	66,231	31	431		-	38	41
4	SUOGJ "K.G'	486	18,322	1,956	43,619	52	723		-	25	27
5	SU Trauma	3,231	121,809	2,009	44,801	3,374	46,898	23,914	6,361	993	1082
I	**Shuma Spitaleve Universitare**	11,608	437,622	13,901	309,992	12,617	175,376	57,924	15,408	3720	4,055
II	**Spitalet rajonale e bashkiake**	3,328	125,466	9,242	206,097	10,534	146,423	18,996	5,053	77	84
III	**Totali**	**14,936**	**563,087**	**23,143**	**516,089**	**23,151**	**321,799**	**76,920**	**20,461**	**3,797**	**4,139**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i auditimit të KLSH

Në vitin 2022, numrin më të lartë të ndërhyrjeve e ka realizuar QSUT me 22,204 ndërhyrje, e ndjekur nga SU Trauma me 8,614 ndërhyrje; Spitali Rajonal Shkodër dhe Durrës.
Nga spitalet është ofruar shërbimi për 61,230 ndërhyrje kirurgjikale në total, nga 63,608 ndërhyrje kirurgjikale që është projeksioni për vitin 2022. Realizimi i planit të ndërhyrjeve kirurgjikale për vitin 2022 është 96.2 %.
Sipas të dhënave në 7 spitale ka tejkalim të numrit të ndërhyrjeve sipas totalit të kompleksitetit e krahasuar me planin vjetor përkatësisht:

- Spitali Universitar i Traumës ka tejkalim 72 % të planit;
- Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi" ka tejkalim 123 % të planit;.
- Spitali Rajonal i Shkodrës ka tejkalim 8 % të planit;
- Spitali Rajonal i Korçës ka tejkalim 15 % të planit;
- Spitali Rajonal i Dibrës ka tejkalim 3 % të planit;
- Spitali Rajonal i Gjirokastrës ka tejkalim 9 % të planit;
- Spitali Bashkiak i Krujës ka tejkalim 18 % të planit.

Ndërsa me mosrealizim paraqiten spitalet rajonale (Durrës dhe Fier) dhe bashkiake (Librazhd, Gramsh, Berat Lushnjë, Mat, Pogradec, Pukë etj.).
Tejkalimi i planit të ndërhyrjeve vjen si rezultat i parashikimit jo të saktë sëmundshmërisë, pasi referuar të dhënave të Raportit vjetor të veprimtarisë së FSDKSH, një pjesë të konsiderueshme të shtrimeve e zënë urgjencat, respektivisht në spitalet universitare 33.5 % të tyre dhe në spitalet rajonale 81 % të tyre.

Mbi konfigurimin e seteve kirurgjikale.
Referuar kontratës fillestare nr. 1440/33, datë 10.12.2015, neni 9, konfigurimi i seteve është përcaktuar sipas Aneksit nr. 4 "Klasat e kompleksitetit ose intensiteti i ndërhyrjes kirurgjikale", në të cilin janë parashikuar 14 ndarje sipas grup kirurgjive (të pa emërtuara), dhe 121 ndërhyrje/sete, të cilat sipas kompleksitetit janë 37 të kompleksitetit të L; 43 të M dhe 41 të U, si më poshtë:

Tabela nr.3.52 "Të dhëna mbi konfigurimin sipas Aneksit nr. 4 të Kontratës PPP"

Grup kirurgjia	Numri i kirurgjive (seteve)	Numri i instrumenteve	Komleksitet i Lartë	Komleksitet i Mesëm	Komleksitet i Ulët
1	16	603	9	5	2
2	3	137		1	2
3	7	210	2	1	4
4	11	568	5	4	2
5	10	389	3	5	2
6	9	643	4	4	1
7	4	91		1	3
8	7	223	1	2	4
9	10	515	2	5	3
10	13	672	5	5	3
11	5	174		2	3
12	12	515	4	6	2
13	6	410	2	2	2
14	**8**	95			**8**
15	**121**	**5,245**	**37**	**43**	**41**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i auditimit të KLSH

Më tej, Konfigurimi i seteve kirurgjikale, në zbatim të Kontratës 1440/40, datë 10.12.2015 është miratuar nga Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me shkresën nr. 5808 prot., datë 17.11.2016, sipas së cilës janë konfiguruar setet sipas 13 grup kirurgjive, paraqitur më poshtë.

Tabela nr.3.53 "Të dhëna mbi konfigurimin sipas shkresës nr. 5808, datë 17.11.2016"

Nr.	Sterilizimi (PPP)	Numri i seteve	Totali i seteve (set * numër kopje)	Numri total i instrumenteve
1	Kardiokirurgjia	13	44	2,299
2	Kirurgjia vaskolare	14	46	2,126
3	Kirurgjia e përgjithshme (K1)	15	49	2,754
4	Kirurgjia e përgjithshme (K3)	14	54	2,512
5	Urologjia	19	60	2,582
6	Onkologjia	10	31	1,834
7	Kirurgjia plastike	10	42	1,304
8	Neurokirurgjia	10	31	2,620
9	Kirurgjia e bllokut (6)	16	94	4,733
10	Urgjenca kirurgjikale	12	69	3,794
11	Maxillo facciale	8	39	2,007
12	Okulistika	12	98	1,554
13	ORL	8	42	2,265
14	**Totali**	**161**	**699**	**32,384**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i auditimit të KLSH

Ky konfigurim ka pësuar ndryshime në vitin 2020, ku janë bërë ndërhyrje në disa sete përsa i përket instrumenteve përbërës të një seti. Në konfigurimin e seteve kirurgjikale në vitin 2020, nuk është ndjekur e njëjta mënyrë e paraqitjes së të dhënave referuar Aneskit nr. 4. Rezultojnë të dhëna përmbledhëse vetëm për totalin e seteve në përdorim deri më 30.11.2020 me 3,408 sete.

Sipas të dhënave të dy dokumenteve mbi konfigurimin e seteve është përcaktuar:

- Konfigurimi nëntor 2016, totali i seteve 699 dhe vlera e investimit në instrumente në shumën 476,497 mijë lekë;
- Konfigurimi nëntor 2020, totali i seteve 3,408 dhe vlerë e investimit në instrumente në shumën 2,027,720 mijë lekë.

Në vitin 2022, në lidhje me konfigurimin e seteve kirurgjikale, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me nr. 318/20, prot., datë 10.05.2022, i është kthyer përgjigje mbi shkresën FSDKSH nr. 2087/1 prot., datë 29.04.2022, në lidhje me vënien në dispozicion të dokumentit "Konfigurimi i seteve kirurgjikale 2020", i cili është funksional edhe për vitin 2022, pasi gjatë kësaj periudhe nuk është bërë ndërhyrje për konfigurim të seteve kirurgjikale.

- Me shkresën nr. 150/23 prot, datë 16.12.2020, Ministria Shëndetësisë, ju është drejtuar spitaleve, si zbatues të kontratës së koncesionit, për zbatim dokumentin "Konfigurimi i seteve kirurgjikale 2020", bashkëngjitur materiale me emërtimin *"Konfigurimi i seteve 30.11.2020"*, trajtuar nga KLSH në auditimin e mëparshëm.

Pavarësisht se nga KLSH, në auditimin e mëparshëm janë evidentuar mangësi në konfigurimin e seteve kirurgjikale sipas tipologjisë së ndërhyrjeve, nuk është kryer ri konfigurim i tyre në vitin 2022, pasi ende vazhdohet sipas konfigurimit të vitit 2016, me ndryshimet e vitit 2020. Mos rishikimi dhe konfigurimi i duhur i seteve kirurgjikale, në raport me përmbajtjen e instrumenteve të duhura kirurgjikale, edhe gjatë vitit 2022, ka sjellë si pasojë përdorimin e seteve të kompleksiteteve të ndryshme, për të njëjtën tipologji kirurgjikale, trajtuar si më poshtë:

Mbi përdorimin e seteve kirurgjikale:

Sipas kontratës koncesionare, në nenin 10.3 është përcaktuar se "Faturimi i Shërbimeve do të bëhet: "Në baze të numrit dhe Klasës së Kompleksitetit të ndërhyrjeve te kryera në strukturat spitalore (referuar nenit 7.1 (i; ii; iii)". Për të vlerësuar mënyrën e përdorimit të seteve

kirurgjikale referuar tipologjisë së ndërhyrjeve dhe kompleksitetit, u morën të dhëna nga FSDKSH, ku ka rezultuar se edhe këtë vit janë evidentuar një numër i lartë i rasteve kur për të njëjtën ndërhyrje kirurgjikale janë përdorur sete të kompleksiteteve të ndryshme, gjë e cila shoqërohet edhe me efekte financiare, referuar diferencave në çmimet sipas kompleksiteteve.
Nga kryqëzimi i të dhënave të ndërhyrjeve kirurgjikale të kryera gjatë vitit 2022, në tre llojet e spitaleve, universitare, rajonale dhe bashkiake ka rezultuar se ka përdorim të seteve të ndryshme për të njëjtën tipologji kirurgjikale.
Ky fenomen është evidentuar nga KLSH edhe në auditimin e mëparshëm, si dhe është dhënë rekomandim për shqyrtimin e këtyre deviacioneve. Drejtore e FSDKSH, në zbatim të rekomandimit të KLSH, në lidhje me këtë problematikë ka ngritur Grupin e Punës me Urdhrin nr. 429 prot., datë 14.12.2022 "Për verifikimin e zbatimit të kontratës koncesionare në lidhje me nivelin e aplikimit të kompleksitetit gjatë vitit 2021 dhe 2022", ku janë angazhuar 19 specialistë.
Në përfundim të këtij kontrolli, Grupi i punës ka hartuar Informacion përmbledhës nr. 1644, datë 12.05.2023 drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, ku informohet se: "Përdorimi i nivelit të kompleksitetit është kryer në varësi të ndërhyrjes kirurgjikale". Verifikimet e kryera nga DRF janë rast pas rasti, bazuar në skedat dhe kartelat e pacientëve, argumentimit të diagnozës sipas mjekëve me diagnozat përkatëse dhe datat kur është bërë ndërhyrja.

Titulli i gjetjes: **Mbi mangësitë në monitorimin dhe financimin e PPP së shërbimit të integruar të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile dhe furnizim me materiale mjekësore sterile.**

Situata: Nga auditimi i shpenzimeve të kryera për financimin e PPP-Sterilizimi i pajisjeve mjekësore, sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga FSDKSH, ka rezultuar se në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 është përdorur:

- kompleksiteti i lartë me 17 %, më shumë se në vitin 2021;
- kompleksiteti i mesëm me 3 %, më shumë se në vitin 2021;
- kompleksiteti i ulët 16.3 %, më shumë se në vitin 2021.

Nga kryqëzimi i të dhënave të ndërhyrjeve kirurgjikale të kryera gjatë vitit 2022, në tre llojet e spitaleve, universitare, rajonale dhe bashkiake ka rezultuar se, ka përdorim të seteve të ndryshme për të njëjtën tipologji kirurgjikale, të përmbledhura në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr.3.54 "Deviacionet në përdorimin e seteve sipas spitaleve"

Përdorimi i seteve	Spitalet universitare	Spitalet rajonale	Spitalet bashkiake
Kompleksitet i lartë vs i ulët	5,294	1,026	5
Kompleksitet i lartë vs i mesëm	4,539	1,907	7
Kompleksitet i mesëm vs i ulët	5,506	5,775	43
Totali	**15,339**	**8,708**	**55**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i auditimit të KLSH

Deviacionet e mësipërme janë evidentuar nga KLSH edhe në auditimin e mëparshëm, gjë për të cilën është dhënë rekomandim për kryerjen e një verifikimi mbi përdorimin e seteve kirurgjikale. Në përfundim të këtij kontrolli, është konkluduar se përdorimi i nivelit të kompleksitetit është kryer në varësi të ndërhyrjes kirurgjikale. Pavarësisht faktit, që nga kontrolli i kryer nuk janë evidentuar raste të keqpërdorimit të seteve kirurgjikale, **theksojmë se** niveli i lartë i deviacioneve, ku për të njëjtën tipologji kirurgjikale përdoren nivele të ndryshme të kompleksitetit të seteve, ku në spitalet universitare arrin deri në 52 % të rasteve, në spitalet rajonale deri në 48.5 % të rasteve, kundrejt totalit të ndërhyrjeve, reflekton mangësitë në përcaktimin e nivelit të seteve sipas tipologjisë së kirurgjive, por dhe të përmbajtjes me instrumente mjekësorë të seteve

përcaktuar në kontratën koncesionare. Ri konfigurimi i tyre edhe pas ndryshimeve në vitin 2020, të seteve miratuar nga Ministri i MSHMS në vitin 2006, referuar aneksit nr. 4 të kontratës nr. 1440/40, datë 10.12.2015, dhe shkresës nr. 28/20, datë 04.12.2020 të koncesionarit, protokolluar në MSHMS me nr. 150/21, datë 07.12.2020 me objekt "Konfigurim i seteve 30.11.2020", përcjellë për zbatim spitaleve me shkresën nr. 150/23, datë 16.12.2020, ka paraqitur mangësi dhe nuk ka minimizuar problematikën e evidentuar.

Kriteri: Kontrata e koncesionit me nr.1440/33, datë 10.12.2015, midis "S." SHPK dhe Ministrisë së Shëndetësisë, Aneksi 4;
Kontrata e financimit nr. 1440/40 datë 10.12.2015 midis FSDKSH, dhe "S." SHPK;
Konfigurimi i seteve datë 30.11.2020, sipas shkresës përcjellëse nr. 150/23, datë 16.12.2020.

Impakti: Mos përcaktimi i saktë i instrumenteve mjekësore, si dhe mos përfshirja e gamës së nevojshme, sipas llojit të ndërhyrjeve kirurgjikale, referuar setit sipas kompleksitetit të tyre, sjell përdorimin në nivele të larta të seteve të kompleksiteteve të ndryshme, për të njëjtën lloj ndërhyrje e shoqëruar kjo me rritje të kostove të këtij shërbimi.

Shkaku: Mos veprim nga ana e strukturave përkatëse (MSHMS), të cilat nuk kanë marrë masat e duhura për rishikimin dhe konfigurimin e seteve kirurgjikale, në funksion të dhënies së këtij shërbimi duke minimizuar deviacionet në përdorimin e seteve të ndryshme për të njëjtën kirurgji, me pasojë rritjen e kostove, nëpërmjet rishikimit të ri konfigurimit të seteve, në bashkëpunim me koncesionarin "S." SHPK.
Nga FSDKSH, në zbatim të rekomandimit të dhënë nga KLSH në auditimin e mëparshëm, i ka dërguar shkresë MSHMS me nr. 34/52 prot., datë 07.09.2022 me lëndë "Mbi zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit", por nga MSHMS, si palë kontraktore me "S." SHPK, nuk ka patur reagim.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: MSHMS, në bashkëpunim me Strukturat drejtuese të Fondit të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor, të marrin masa që të negociojnë me Shoqërinë Koncesionare "S." SHPK dhe të bëjnë të mundur **rishikimin e kontratës koncesionare të financimit me PPP, në lidhje me ri konfigurimin e seteve kirurgjikale në dy drejtime:**

- nivelin e kompleksitetit referuar llojit të kirurgjisë;
- numrin dhe llojin e instrumenteve dhe pajisjeve mjekësore që duhet të përmbajë një set, për të rritur gamën e tyre me qëllim minimizimin e kostove të këtij shërbimi, duke marrë në konsideratë nivelin e lartë të deviacioneve, për të gjitha rastet e përdorimit të një seti kirurgjikal të nivelit të mesëm, kur mund të përdorim kompleksitetin e ulët dhe të përdorimit të një seti të kompleksitetit të lartë kur mund të përdorim kompleksitet të mesëm ose të ulët, për shkak të mungesës së një ose disa instrumenteve në këto kompleksitete.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pasi nuk ka vepruar në lidhje me rekomandimin e lënë nga KLSH që në auditimin e mëparshëm, pavarësisht njoftimit dhe kërkesës së bërë nga FSDKSH, me shkresën

nr.34/52 prot., datë 07.09.2022 me lëndë "Mbi zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Mbi realizimin e shpenzimeve për sterilizimin në vitin 2022, në krahasim me vitin 2021, respektimi i tavaneve buxhetore.

Shpenzimet për sterilizimin në vitin 2022 rezultojnë në shumën 1,699,975 mijë lekë nga 1,700,000 mijë lekë të planifikuara, si dhe në krahasim me vitin 2021 janë rritur me 199,019 mijë lekë, ku ndikim ka patur rritja e numrit të ndërhyrjeve në total me 11.4 % më shumë, si dhe rasteve të ndërhyrjeve kirurgjikale me përdorim të setit të kompleksitetit të lartë me 17 % më shumë, paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.3.55 "Aktiviteti i "SS" në spitalet publike në vitet 2021/2022"

Nr.	Kompleksiteti i ndërhyrjes	Viti 2021 Numri i ndërhyrjeve	Viti 2022. Numri i ndërhyrjeve	Diferenca viti 2022-2021	Rritja ose ulja në %
1	Kompleksiteti i Lartë	12,753	14,936	2,183	17
2	Kompleksiteti i Mesëm	22,327	23,143	816	3
3	Kompleksiteti i Ulët	19,899	23,151	3,252	16.3
4	**Totali**	**54,979**	**61,230**	**6,251**	**11.4**
5	Paketimi me avull	74,631	76,920	2,289	3.1
6	Sterilizim me temp. të ulët	3,061	3,797	736	24

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i auditimit të KLSH

Në vitin 2022, është respektuar tavani buxhetor për financimin e shërbimit të sterilizimit në shumën 1,700,000 mijë lekë. Megjithatë, po ti referohemi vlerës totale të këtij shërbimi sipas Kontratës në shumën 9,657,000 mijë lekë pa TVSH dhe 11,588,400 mijë lekë me TVSH, për 10 vjet, rezulton se buxheti vjetor duhet të jetë jo më shumë se *1,158,840 mijë lekë me TVSH*, ç'ka do të thotë se kemi tejkalim të tij, pavarësisht se projeksioni për numrin total të ndërhyrjeve me 63,000 raste nuk është tejkaluar. Referuar dhe të dhënave të viteve të mëparshme rezulton se këto shpenzime janë me trend rritës. Kështu, shpenzimet faktike në vitin 2020 janë në shumën 1,288,269 mijë lekë, në vitin 2021, në shumën 1,500,924 mijë lekë dhe në vitin 2022 në shumën 1,699,975 mijë lekë, duke paraqitur rritje të nevojës për financim përtej parashikimeve. Po kështu ky trend është reflektuar edhe në PBA 2022-2024, ku plani buxhetor për PPP-Sterilizimi është planifikuar me 20,000 mijë lekë më shumë nga viti në vit.
Gjithashtu, edhe në nivel spitalor, në vitin 2022, në disa spitale ka patur përdorim të seteve kirurgjikale të kompleksitetit të lartë dhe të mesëm më shumë se në vitin 2021, të cilat të detajuara sipas spitaleve paraqiten në Tabelat anekse nr. 3.4; 3.5 dhe 3.6, ku janë cilësuar dhe ndryshimet 2022/2021, në numrin e përdorimit të seteve kirurgjikale sipas kompleksitetit dhe spitaleve. Konkretisht:

- Spitali Universitar "Nënë Tereza", ka përdorur në ndërhyrjet kirurgjikale 625 sete të kompleksitetit të lartë dhe 1,180 të kompleksitetit të mesëm më shumë se në vitin 2021, SU "Shefqet Ndroqi" 246 sete të kompleksitetit të lartë dhe 104 të mesëm më shumë se në vitin 2021;
- SU "Trauma" ka përdorur 361 sete të kompleksitetit të lartë më shumë se në vitin 2021;
- Spitali Rajonal Vlorë, ka përdorur 250 sete të kompleksitetit të lartë më shumë se në vitin 2021.

Rritja e përdorimit të seteve kirurgjikale të kompleksitetit të lartë dhe të mesëm kanë ndikuar në rritjen e shpenzimeve me 13 % më shumë se në vitin 2021.

(*Në mënyrë analitike paraqiten në tabelat anekse nr. 3.5, 3.6 dhe 3.7)*

Pagesat e realizuara për vitin 2022, sipas drejtorive rajonale të fondit, nga të dhënat e Drejtorisë Ekonomike, janë si në tabelën e mëposhtme, ku evidentohet se realizimi është në masën 100 %.

Tabela nr.3.56 "Pagesat e kryera për sterilizimin fakt/plan 2022 dhe 2022/2021"

Në mijë lekë

Nr.	DRF	Fakt 2021	Viti 2022		Realizimi Fakt 2022/2021	Realizimi Fakt/Plan 2022
			Plan përfundimtar	Fakt	%	%
1	Berat	28,740	30,882	30,882	107	100
2	Dibër	24,242	21,054	21,054	87	100
3	Durrës	97,175	96,593	96,593	99	100
4	Elbasan	69,567	71,496	71,495	103	100
5	Fier	88,523	81,719	81,719	92	100
6	Lushnje	-	0	0		
7	Gjirokastër	13,094	14,425	14,425	110	100
8	Korçe	47,798	51,521	51,519	108	100
9	Pogradec	-	0	0		
10	Kukës	11,147	12,494	12,494	112	100
11	Tropoje	-	0	0		
12	Lezhe	29,709	37,755	37,755	127	100
13	Shkodër	81,808	97,995	97,995	120	100
14	Tirane	-	0	0		
15	Kamez-Vore	-	0	0		
16	Vlore	45,927	67,092	67,082	146	100
17	Sarande	-	0	0		
18	FSDKSH	-	0	0		
19	DSHSU	963,194	1,116,974	1,116,962	116	100
20	**Totali**	**1,500,924**	**1,700,000**	**1,699,975**	**113**	**100**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i auditimit të KLSH

Nga auditimi konstatohet se mënyra e faturimit të shërbimit është në bazë të llojit të ndërhyrjes kirurgjikale të klasifikuar të cilës i aplikohet çmimi sipas llojit të kompleksitetit, përcaktuar në nenin 7.1 dhe mënyrës së pagesës sipas parimit (Pay x Use) të përcaktuar në nenin 7.2, si dhe në nenin 9 të kontratës së koncesionit është përcaktuar se *"Për përcaktimin dhe identifikimin e Klasës së Kompleksitetit të ndërhyrjeve kirurgjikale (Kompleksitet i lartë; Kompleksitet i mesëm; Kompleksitet i ulët), palët bien dakord t'i referohen klasifikimit te përcaktuar ne Aneksi 4 "Klasat e kompleksitetit ose intensiteti i ndërhyrjes kirurgjikale", e cila është pjese integrale e Kontratës.",* **ç'ka do të thotë që likuidimi është kryer sipas shpenzimeve faktike.**

Mbi monitorimin dhe likuidimin e shpenzimeve gjatë vitit 2022.

Kjo kontratë koncesionare ka filluar të zbatohet nga Spitalet Universitare prej vitit 2016, kështu dhe monitorimi dhe likuidimi i saj është bërë në Drejtorinë e Administrimit të Paketave dhe Ekzaminimeve Terciale (DAPSHET), aktualisht Drejtoria e Shërbimeve Spitalore Universitare (DSHSU) për spitalet universitare dhe nga DRF për spitalet rajonale, sipas Udhëzimit të Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH nr. 19, datë 23.12.2019 "Për monitorimin e shërbimit për ofrimin e setit të personalizuar të instrumentave kirurgjikale, furnizimin me material mjekësor steril një përdorimesh në sallat kirurgjikale si dhe trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale", ndryshuar me Udhëzimin nr. 10, datë 25.08.2020.

Likuidimi i detyrimeve të faturuara nga koncesionari, paraprihet nga kontrolli mbi zbatimin e kontratës i cili realizohet nga DRF përkatëse për çdo spital brenda rajonit dhe DSHSU për spitalet universitare. Nga ana e tyre kontrollohen kartelat mjekësore të çdo ndërhyrje kirurgjikale të zhvilluar në spitalet përkatëse, ku përfshihet diagnoza përkatëse, si dhe setet kirurgjikale të përdorura sipas barkodeve të bashkëngjitur në kartelën mjekësore, bazuar në

Udhëzimin nr. 19, datë 23.12.2019 "Për monitorimin e shërbimit për ofrimin e setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterilë, furnizimin me material mjekësor steril një përdorimësh në sallat kirurgjikale si dhe trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik, dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale". Pas këtyre verifikimeve realizohet pagesa për këtë shërbim, sipas planit të akorduar.

Në lidhje me monitorimin e kësaj kontrate nga FSDKSH janë kryer 3 inspektime nga DKPS, në DSHSU, SU "Shefqet Ndroqi" dhe DRF Berat, sipas urdhrave nr. 195, datë 10.06.2022 dhe 278, datë 08.09.2022.

Shuma e likuiduar në vitin 2022, për këtë shërbim i përket likuidimit të shpenzimeve të kryera në vitin 2021, por të pashlyera (detyrime të mbartura) në shumën 141,130 mijë lekë dhe pagesës së detyrimit të vitit 2022 në shumën 1,558,844 mijë lekë. Sipas të dhënave të tabelës së mëposhtme rezulton se, janë trashëguar detyrime të pa likuiduara të vitit 2022 në vitin 2023 në shumën 158,215 mijë lekë, çka do të thotë se detyrimet për vitin 2022 janë në shumën 1,717,059 mijë lekë.

Tabela nr.3.57 "Pagesat e kryera për sterilizimin"

Në mijë lekë

Subjektet	Sterilizimi detyrimi mbetur nga viti 2021 (çelja 2022)		Sterilizimi i likuiduar i vitit 2022	Detyrim i mbetur për vitin 2023
	Detyrimi i mbartur nga viti 2021	Shlyer detyrimi		
Berat	3,041	3,041	27,841	1,625
Dibër	1,842	1,842	19,212	2,053
Durrës	8,113	8,113	88,479	9,155
Elbasan	5,589	5,589	65,907	6,408
Fier	8,554	8,554	73,165	5,661
Gjirokastër	1,079	1,079	13,345	1,162
Korçe	4,717	4,717	46,802	3,960
Kukës	997	997	11,497	1,057
Lezhe	2,621	2,621	35,134	3,028
Shkodër	5,018	5,018	92,977	9,027
Vlore	4,431	4,431	62,651	5,979
DSHSU	95,128	95,128	1,021,834	109,102
Totali	**141,130**	**141,130**	**1,558,844**	**158,215**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i auditimit të KLSH

Tabela nr.3.58 "Detyrimet e pashlyera të mbartura në vitin 2023"

Në mijë lekë

DRF	Detyrimi mbetur nga viti 2022		
	Nga nëntori	Nga dhjetori	Gjithsej
Berat		1,625	1,625
Dibër		2,053	2,053
Durrës		9,155	9,155
Elbasan		6,408	6,408
Fier		5,661	5,661
Gjirokastër		1,162	1,162
Korçe		3,960	3,960
Kukës		1,057	1,057
Lezhe	0.314	3,028	3,028
Shkodër		9,027	9,027
Vlore		5,979	5,979
DSHSU	14,660	94,442	109,102
Totali	**14,660**	**143,555**	**158,215**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i auditimit të KLSH

Tabela nr.3.59 "Likuidimi i faturave"

Në mijë lekë

Sterilizimi	2021	2022
Plani përfundimtar	1,564,982	1,700,000
Fakti total	1,500,956	1,699,975
Likuidimet për efekt te detyrimeve te prapambetura	95,286	141,130
Vlera e faturuar nga koncensionari me TVSH	1,549,487	1,717,122
Vlera e faturuar nga koncensionari pa TVSH	1,291,239	1,430,935
Pranuar për likuidim (detyrim i konstatuar/i njohur)	1,546,800	1,717,059
Likuiduar	1,405,669	1,558,844
Detyrim i vitit pa likuiduar dhe kaluar në vitin pasardhës	141,130	158,215

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i auditimit të KLSH

PPP-Mbi koncesionin e laboratorëve.

Zbatimi i kontratës koncesionare të laboratorëve në vitin 2022, është shtrirë në 18 institucione shëndetësore, të cilat përcaktohen sipas kontratës së koncesionit/PPP me nr. 1924/2 prot., datë 10.04.2019, të lidhur midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe koncesionarit ("L", "E" dhe "A") miratuar me VKM nr. 258, datë 24.04.2019, protokolluar në FSDKSH me nr. 2388, datë 27.05.2019. Kjo kontratë ka hyrë në fuqi më datë 02.05.2019. Vlera fillestare e buxhetuar për PPP të laboratorëve për vitin 2022 është në shumën 1,574,900 mijë lekë, sipas VKM nr. 43 datë 19.01.2022, artikulli 602 "Laboratorët". Kjo kontratë parashikon pagesën e nivelit të shërbimit nga ana e spitaleve publike për një periudhë 10 vjeçare, ku tavani buxhetor sipas pikës 1.1 të kontratës nënkupton *"Shumën maksimale totale të tarifës së shërbimit të pagueshme nga një spital referues për koncesionarin në një periudhë buxhetore gjatë afatit, e cila përfaqëson tavanin buxhetor vjetor për një spital referues në 12 periudha buxhetore (muaj)"*. Ndërsa në Shtojcën 12 të kontratës është përcaktuar se: *"Spitali referues angazhohet për përmbushjen e çdo detyrimi që i ngarkohet nga kontrata por pa kufizim pagesën e tarifave të shërbimit të koncesionarit gjatë afatit të kontratës"*.

Referuar të dhënave mbi shpenzimet e kryera në vitin 2020 dhe 2021, në shumat respektive 1,103,199 mijë lekë dhe 1,612,914 mijë lekë, si dhe ecurisë së planifikimit afatmesëm të buxhetit për financimin e këtij shërbimi rezulton se, vlera e tij do shkojë më tepër se parashikimi, duke kërkuar çdo vit më shumë angazhim fondesh buxhetore. Edhe përcaktimi i tavaneve vjetore buxhetore, për disiplinimin e shpenzimeve, nuk ka arritur të jetë në nivelin e parashikuar, shtuar këtu dhe faktin që ky kufizim ka të bëjë drejtpërsëdrejti me plotësimin e nevojave të pacientëve në kohën e duhur.

Gjatë vitit 2022, plani fillestar për PPP-Laboratorë është në shumën 1,574,900 mijë lekë, si dhe është shtuar gjatë vitit në shumën 64,102 mijë lekë, sipas VKM nr. 615, datë 22.09.2022 "Për një ndryshim në vendimin nr. 43, datë 19.01.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2022". Plani përfundimtar rezulton në shumën 1,639,002 mijë lekë. Financimi i PPP "Laboratorë" është kryer sipas VKM nr. 43/2022, pika 6 është cilësuar: *"FSDKSH financon spitalet në zbatim të VKM nr. 258, datë 24.04.2019 "Për miratimin e kontratës së koncesionit PPP, për ofrimin e shërbimit laboratorik në spitalet universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Lushnjës dhe Sarandës". Fondi rishikon financimin e spitaleve për këtë kontratë gjatë vitit me VKA, me propozim të MSHMS dhe/ose të strukturës së saj përgjegjëse"*.

Tabela nr.3.60 "Buxheti mbi financimin e Laboratorëve dhe realizimi faktik për vitin 2022"

Në mijë lekë

Nr.	Institucionet	Plani fillestar	Ndryshimet	Plan përfundimtar	Fakti	Realizimi F/P
1	Berat	50,000	9,866	59,866	59,408	99.2%

2	Dibër	30,000	-15,353	14,647	14,061	96.0%
3	Elbasan	80,000	9,131	89,131	89,131	100.0%
4	Fier	100,000	21,011	121,011	120,907	99.9%
5	Gjirokastër	30,000	0	30,000	27,099	90.3%
6	Korçë	75,000	7,017	82,017	82,017	100.0%
7	Kukës	30,000	-21,200	8,800	7,408	84.2%
8	Lezhë	50,000	5,977	55,977	55,037	98.3%
9	Lushnjë	30,000	10,461	40,461	37,196	91.9%
10	Sarandë	20,000	6,492	26,492	26,492	100.0%
11	Shkodër	60,000	5,089	65,089	63,622	97.7%
12	QSUT	700,000	64,638	764,638	764,638	100.0%
13	SUOGJ "Mbretëresha Geraldinë"	20,000	-1,369	18,631	17,912	96.1%
14	SUOGJ "Koço Gliozheni"	20,900	-715	20,185	19,235	95.3%
15	SU "Shefqet Ndroqi"	70,000	2,434	72,434	72,434	100.0%
16	SU TRAUMA	43,000	2,957	45,957	45,953	100.0%
17	Vlorë	50,000	0	50,000	48,583	97.2%
18	Durrës	60,000	13,666	73,666	61,781	83.9%
19	Rezervë	56,000	-56,000	0		
20	**Totali**	**1,574,900**	**64,102**	**1,639,002**	**1,612,914**	**98.4%**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i auditimit të KLSH

Nga auditimi është evidentuar se:

Sipas të dhënave të mësipërme, 11 nga 19 spitale (QSU, SU "Shefqet Ndroqi", SU "Trauma", spitalet Elbasan, Fier, Korçë, Sarandë etj.) kanë një nivel të realizimit të këtij shërbimi në masën 97-100 %, kundrejt planit.

Sa më sipër, rezulton se nga ana e spitaleve realizimi i këtij shërbimi, duke patur si kufizim respektimin e tavaneve buxhetore, ka rrezikuar të bëhet pengesë për ofrimin e analizave laboratorike, në masën e duhur, sipas nevojave spitalore, duke sjellë për pasojë drejtimin e pacientëve drejtë laboratorëve privatë, me kosto për qytetarët, si dhe përkeqësim të shëndetit nga moskryerja në kohë e analizave përkatëse.

Ofrimi i këtij shërbimi sipas kërkesës, është i kufizuar, nga kushtet e kontratës nr. 1924/2, datë 10.04.2019, pika 22.4 "Tavanet e buxhetit" ku cilësohet:

"22.4.1. Në çdo periudhë të caktuar buxhetore, koncesionari do të njoftojë drejtorin e spitalit referues, duke vënë në dijeni dhe përfaqësuesin e FSDKSH, brenda dy ditëve kur tarifat e shërbimeve të pagueshme për numrin e përgjithshëm të analizave të kryera nga koncesionari për çdo spital referues tejkalojnë 50 %; 75 % dhe 100 %, përkatësisht të tavanit buxhetor të zbatueshëm për atë spital";

22.4.2. Kur në një periudhë të vetme buxhetore, tarifat e shërbimit të pagueshme për numrin e përgjithshëm të analizave të kryera nga kocesionari, për çdo spital referues, arrijnë 75 % të tavanit të buxhetit dhe koncesionari e ka njoftuar drejtorin e spitali referues në përputhje me nenin 22.4.1, drejtori i spitalit referues brenda 3 ditëve, informon me shkrim koncesionarin duke vënë dijeni autoritetin dhe FSDKSH në lidhje me vendimin e tij për të:

a. vazhduar me marrjen e shërbimeve mjekësore, për të gjithë pacientët e referuar deri sa të arrihet 100 % i tavanit buxhetor (alternativa A)

b. vazhduar me marrjen e shërbimeve mjekësore vetëm për analizat urgjente deri sa të arrihet 100 % i tavanit buxhetor (alternativa B)

Nëse nuk merr përgjigje brenda 3 ditësh, koncesionari zbaton alternativën B.

24.2.3. Kur ka arritur tavanin 100 % të buxhetit, koncesionari ka detyrim të ofrojë analiza urgjente, pa pagesë spitalit referues, brenda një vëllimi të lejuar që mbulon 5 % të vëllimit të analizave urgjente, të kryera për spitalin referues, deri në përmbushjen e tavanit buxhetor".

Nga sa më sipër, rezulton se kufizimet në kryerjen e analizave laboratorike janë të lidhura me tavanin buxhetor të secilit spital dhe janë të sanksionuara në kontratën koncesionare të laboratorëve me pasoja negative në shëndetin e popullatës.

Mbi shpenzimet për PPP Laboratorë të vitit 2022, krahasuar me vitin 2021.

Sipas DRF dhe spitaleve universitare, plani dhe fakti i vitit 2022 krahasuar me vitin 2021 në vlerë, si dhe në numër ekzaminimesh të kryera paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr.3.61 "Shpenzime të likuiduara për PPP "Laboratorë"

Në mijë lekë

Nr.	Institucionet	Viti 2021		Viti 2022		Diferenca 2022/2021	
		Plani	Fakti	Plani	Fakti	Plan	Fakt
1	Berat	33,500	30,623	59,866	59,408	26,366	28,785
2	Dibër	0	0	14,647	14,061	14,647	14,061
3	Durrës	37,000	33,797	73,666	61,781	36,666	27,984
4	Elbasan	51,063	51,063	89,131	89,131	38,068	38,068
5	Fier	84,702	73,061	121,011	120,907	36,309	47,846
6	Gjirokastër	0	0	30,000	27,099	30,000	27,099
7	Korçë	36,725	36,725	82,017	82,017	45,292	45,292
8	Kukës	0	0	8,800	7,408	8,800	7,408
9	Lezhë	29,382	29,223	55,977	55,037	26,595	25,815
10	Lushnjë	18,506	17,978	40,461	37,196	21,955	19,218
11	Sarandë	6,443	6,443	26,492	26,492	20,049	20,049
12	Shkodër	28,015	27,567	65,089	63,622	37,074	36,055
13	QSUT	674,713	674,713	764,638	764,638	89,925	89,925
14	SUOGJ "Mbretëresha Geraldinë"	13,775	12,770	18,631	17,912	4,856	5,143
15	SUOGJ "Koço Gliozheni"	17,775	16,675	20,185	19,235	2,410	2,560
16	SU "Shefqet Ndroqi"	59,087	59,087	72,434	72,434	13,347	13,347
17	SU TRAUMA	39,159	33,475	45,957	45,953	6,798	12,478
18	Vlorë	8,000	0	50,000	48,583	42,000	48,583
	Totali	**1,137,845**	**1,103,199**	**1,639,002**	**1,612,914**	**501,157**	**509,715**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i auditimit të KLSH

Nga analizimi i të dhënave rezulton se plani dhe fakti i shpenzimeve për PPP e laboratorëve në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021, është me rritje në shumat respektive 501,157 mijë lekë dhe 509,715 mijë lekë më shumë. Nga kjo arrihet në konkluzionin se ky koncesion për vitin 2022 është financuar me 46 % fonde shtesë krahasuar me vitin 2021, ndonëse janë shtuar dhe 3 spitale bashkiakë. Pra koncesioni i laboratorëve vazhdon të kërkojë rritjen e financimeve në mënyrë të përvitshme, edhe në kushtet e kufizimeve në ofrimin e shërbimeve për të gjithë pacientët apo vetëm për analizat urgjente.

Faktorët që kanë ndikuar në këtë rritje të shpenzimeve në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 janë:

- Në spitalet Dibër, Gjirokastër, Kukës dhe Vlorë në vitin 2021 nuk është ofruar ky shërbim i cili në vitin 2022 për këto 4 spitale rezulton në shumën 97,151 mijë lekë;
- Rritja e numrit të ekzaminimeve dhe për rrjedhojë e shpenzimeve edhe për të gjitha spitalet e tjera është rezultat i faktit se në vitin 2021 ofrimi i këtij shërbimi, nuk është shtrirë gjatë gjithë vitit, sipas *Tabelës anekse nr.3.6 "Datat e fillimit të shërbimit në spitale";*
- Në shumë Spitale Rajonale, Universitare dhe ato Bashkiake të Lushnjës dhe Sarandës shërbimi laboratorik i koncesionarit ka filluar të ofrohet gjatë vitit 2021 e në vazhdim, pra jo nga fillimi i vitit 2021.

Megjithëse gjatë zbatimit të kontratës nuk ka patur ndryshim të tarifave të shërbimit referuar Shtojcës nr. 3 "Analizat dhe tarifat e shërbimit", të kontratës nr. 1924/2, datë 10.04.2019, mungesa e ofrimit të shërbimit në 4 spitale si dhe mungesa e shtrirjes së ofrimit të këtij shërbimi gjatë gjithë vitit 2021, nuk justifikojnë tendencën në rritje për financime buxhetore të përvitshme të kësaj kontrate.

Tabela nr.3.62 “Raporti i ekzaminimeve të kryera 2022/2021”

Nr.	Spitali	Numër Ekzaminimesh 2021	Numër Ekzaminimesh 2022	Diferenca nr. ekzaminimesh
1	QSUT	1,959,659	1,763,186	-196,473
2	SU “S.N”	162,355	174,795	12,440
3	SU TRAUMA	110,605	162,720	52,115
4	SUOGJ “M.G.	40,189	51,346	11,157
5	SUOGJ “K.G”	52,965	58,644	5,679
6	Berat	104,848	153,217	48,369
7	Dibër	0	47,419	47,419
8	Durrës	105,752	186,263	80,511
9	Elbasan	176,508	260,127	83,619
10	Fier	243,490	316,925	73,435
11	Gjirokastër	0	76,642	76,642
12	Korçë	134,800	250,751	115,951
13	Kukës	0	23,351	23,351
14	Lezhë	101,249	172,373	71,124
15	Shkodër	87,479	187,828	100,349
16	Vlorë	0	141,946	141,946
17	Lushnjë	58,992	105,163	46,171
18	Sarandë	39,259	73,071	33,812
	Totali	**3,378,150**	**4,205,767**	**827,617**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i auditimit të KLSH

Gjatë vitit 2022, referuar të dhënave të tabelave të mëposhtme, ka rezultuar se numri i ekzaminimeve është rritur me 827,617 raste, ndërsa shpenzimet buxhetore me 509,715 mijë lekë, ose thënë ndryshe, niveli i rritjes së numrit të ekzaminimeve në total është 24.5 % më shumë se në vitin 2021, ndërsa niveli i rritjes së shpenzimeve buxhetore 46.2 % më shumë.
Këta tregues demonstrojnë një rritje më të lartë të shpenzimeve buxhetore në krahasim me rritjen e numrit të ekzaminimeve, gjë e cila reflektohet në koston mesatare të ekzaminimit, ku në vitin 2021 rezulton në 326.5 lekë, ndërsa në vitin 2022 në 383.5 lekë, ose 17 % më shumë. Në kushtet kur çmimet referuese nuk kanë ndryshuar, kjo rritje është rezultat i kryerjes së ekzaminimeve me tarifa të larta, kundrejt atyre me tarifa të ulta. Kjo tendencë është identifikuar në të gjitha spitalet me përjashtim të SU “Trauma”, ku rritja e numrit të ekzaminimeve në krahasim me vitin 2021, është më i lartë se rritja e shpenzimeve buxhetore. *(Tabela anekse nr.3.9 “Ndryshimi në % i numrit të ekzaminimeve dhe shpenzimeve 2022/2021”)*

Tabela nr. 3.63 “Numri i ekzaminimeve dhe shpenzimeve 2022/2021”

Nr.	Institucionet	Viti 2021		Viti 2022		Diferenca 2022/2021	
		Ekzaminime Numër	Shpenzime Buxhetore 000/lekë	Ekzaminime Numër	Shpenzime Buxhetore 000/lekë	Ekzaminime Numër	Shpenzime Buxhetore 000/lekë
1	QSUT	1,959,659	674,713	1,763,186	764,638	-196,473	89,925
2	SUOGJ "Mbretëresha Geraldinë"	40,189	12,770	51,346	17,912	11,157	5,143
3	SUOGJ "Koço Gliozheni"	52,965	16,675	58,644	19,235	5,679	2,560
4	SU "Shefqet Ndroqi"	162,355	59,087	174,795	72,434	12,440	13,347
5	SU TRAUMA	110,605	33,475	162,720	45,953	52,115	12,478
6	Berat	104,848	30,623	153,217	59,408	48,369	28,785
7	Dibër	0	0	47,419	14,061	47,419	14,061
8	Durrës	105,752	33,797	186,263	61,781	80,511	27,984
9	Elbasan	176,508	51,063	260,127	89,131	83,619	38,068
10	Fier	243,490	73,061	316,925	120,907	73,435	47,846
11	Gjirokastër	0	0	76,642	27,099	76,642	27,099
12	Korçë	134,800	36,725	250,751	82,017	115,951	45,292
13	Kukës	0	0	23,351	7,408	23,351	7,408
14	Lezhë	101,249	29,223	172,373	55,037	71,124	25,815
15	Lushnjë	58,992	17,978	105,163	37,196	46,171	19,218
16	Sarandë	39,259	6,443	73,071	26,492	33,812	20,049

17	Shkodër	87,479	27,567	187,828	63,622	100,349	36,055
18	Vlorë	0	0	141,946	48,583	141,946	48,583
	Totali	**3,378,150**	**1,103,199**	**4,205,767**	**1,612,914**	**827,617**	**509,715**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i auditimit të KLSH

Mbi monitorimin dhe likuidimin e shpenzimeve.

Sipas buxhetit të FSDKSH për vitin 2022, buxheti për financimin e laboratorëve ju është transferuar spitaleve publike nga FSDKSH, në artikullin 602 "Laboratorë" dhe përdoret prej tyre vetëm për likuidimin e shpenzimeve për ekzaminimet laboratorike, referuar Kontratës së PPP, neni 23, germa b. Ndjekja e kësaj kontrate realizohet nga spitalet referuese, të cilët pas verifikimit të dokumentacionit përkatës kryejnë dhe likuidimin e shpenzimeve.

Në lidhje me zbatimin e kësaj kontrate, spitali dhe personeli shëndetësor (mjekët referues) janë strukturat përgjegjëse, pasi referimi i ekzaminimeve për laboratorët realizohet nga:

- Mjekët specialistë referues të kontraktuar me spitalin;
- Mjekët e përgjithshëm dhe të familjes të kontraktuar me Qendrat Shëndetësore në shërbimin parësor.

Gjithashtu, FSDKSH ka të drejtën e auditimit të zbatimit të kësaj kontrate, sipas pikës 21 "Auditimi i FSDKSH" të kontratës koncesionare ku cilësohet: *"FSDKSH ka të drejtë të kryejë inspektime në vend, verifikime dhe kontrolle në objektet e koncesionarit në çdo kohë në rastet kur mendon se raportet apo informacioni i paraqitur nga koncesionari mund të jetë i paplotë, ose nuk pasqyron drejtë situatën aktuale".* Gjatë vitit 2022, nga Drejtoria e Kontrollit, Sektori i Kontrollit të Shërbimit Spitalor, janë kryer kontrolle mbi zbatimin e kontratës së Laboratorëve në 4 spitale (SR Lezhë, Berat, Shkodër dhe SU "Shefqet Ndroqi"), ndërsa nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm është audituar Spitali Durrës. Gjithashtu, janë kryer inspektime nga DKPS në DSHSU, SU "Shefqet Ndroqi" dhe SB Sarandë dhe Lushnjë, sipas urdhrave nr. 195, datë 10.06.2022 dhe 278, datë 08.09.2022.

Gjatë vitit 2022, nga koncesionari janë kryer 4,205,767 ekzaminime, me një vlerë faturimi dhe pranimi në shumën 1,548,123 mijë lekë. Janë likuiduar shpenzime në shumën 1,612,914 mijë lekë nga 1,639,002 mijë lekë të planifikuara sipas detajimit të mëposhtëm.

Tabela nr.3.64 "Likuidimi i faturave"

Në mijë lekë

PPP-Laboratori (Pa TVSH)	**Viti**	
	2021	**2022**
Plani përfundimtar	1,137,845	1,639,002
Fakti total	1,103,199	1,612,914
Likuidimet për efekt te detyrimeve te prapambetura	0	159,482
Vlera e faturuar nga koncesionari për vitin pa TVSH	1,263,559	1,548,123
Pranuar për likuidim (detyrim i konstatuar/i njohur)	1,263,559	1,548,123
Likuiduar	1,101,258	1,452,730
Detyrim i vitit pa likuiduar dhe kaluar ne vitin pasardhës nga faturat e vitit	162,301	95,392
Detyrim i vitit pa likuiduar dhe kaluar ne vitin pasardhës te prapambetura		2,819

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i auditimit të KLSH

Mbi pagesën e TVSH për shërbimet mjekësore:

Nga auditimi ka rezultuar se, në 4 kontratat koncesionare të lidhura, është përcaktuar mënyra e pagesës "sipas faturës tatimore me TVSH" të paraqitur nga koncesionari. Konkretisht në 4 kontratat PPP, në tre prej tyre është përcaktuar se fatura e lëshuar nga koncesionari do të jetë faturë më TVSH. **Ky kusht i kontratës është zbatuar në dy rastet e trajtuara më poshtë**.

Titulli i gjetjes: **Mbi likuidimin e TVSH-së së PPP "Kontrolli Mjekësor Bazë" dhe Sterilizimi i pajisjeve mjekësore.**

Situata:

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion në lidhje me financimin dhe likuidimin e shpenzimeve për kontratat e PPP "Kontrolli Mjekësor Bazë" dhe PPP-së "Strerilizimit", është evidentuar se vlera e shpenzimeve të kryera për dhënien e këtyre shërbimeve është likuiduar me TVSH, referuar kushteve të mëposhtme të kontratave.

- PPP "Kontrolli mjekësor bazë", sipas Kontratës së Financimit nr. 1195/2, datë 15.04.2015, pika 3 "Pagesa dhe mënyra e shlyerjes" është cilësuar: "Pagesa e koncesionarit do të bëhet bazuar në çmimin për njësi në vlerën 1,537 lekë pa TVSH, për sasinë minimale prej 475,000 kontrolle në vit. *Fatura e lëshuar nga ana e koncesionarit do të jetë faturë tatimore me TVSH e llogaritur mbi çmimin neto".*
- PPP "Sterilizimit të instrumenteve dhe pajisjeve mjekësore", Aneksi 6, pika 2.2 "Çmimet e kontratës", është cilësuar: "Çmimet do të jenë çmime neto pa TVSH dhe do të paguhen "Pay x Use". *Fatura e lëshuar nga koncesionari do të jetë faturë me TVSH e llogaritur mbi Çmimin neto".*

Vlerë e TVSH-së, referuar pagesave të kryera për 2 nga 4 kontratat PPP, për vitin 2022, është si më poshtë:

Tabela nr.3.65 "TVSH sipas kontratave PPP"/ Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi i PPP	Vlera e faturave të paguara me TVSH	TVSH e paguar
1	Kontrolli mjekësor bazë	803,076	133,846
3	Sterilizimi	1,699,975	283,329
5	**Totali**	**2,503,051**	**417,175**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i auditimit të KLSH

Sa më sipër, referuar cilësimeve në kontrata vetëm në kontratën për shërbimin laboratorik janë zbatuar aktet ligjore (cilësuar më poshtë).

Në tre kontratat e tjera, përcaktimi i mënyrës së pagesës, është në kundërshtim me Ligjin nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe PPP", neni 27 "Përmbajtja e kontratës", pika 1, ku cilësohet: "Kontrata përcakton të drejtat dhe detyrimet e autoritetit kontraktues dhe koncesionarit/partnerit privat, në përputhje me dispozitat e këtij ligji ***dhe legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë".***

Përcaktimi i mënyrës së pagesës sipas faturës së lëshuar nga koncesionari me TVSH, nuk është në përputhje me:

Ligji nr. 7928, datë 27.04.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" (i shfuqizuar), neni 25/11 "Barnat dhe shërbimi shëndetësor" ku cilësohet: ***"Nga data 1 prill 2014, furnizimi i barnave dhe i shërbimeve shëndetësore nga institucionet shëndetësore, publike dhe private, është furnizim i përjashtuar.*** *Ministri i Financave përcakton me udhëzim, para datës 01.04.2014, mënyrën se si veprohet lidhur me sasinë e barnave që rezultojnë gjendje në datën 01.04.2014.*

Ligji nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", Kreu VIII "Përjashtimet, furnizimet me shkallë zero, eksportet seksioni 1 "furnizimet e përjashtuara", neni 51 "Përjashtimi i disa veprimtarive me interes të përgjithshëm", germa c, ku cilësohet:

Janë furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja transaksionet me interes të përgjithshëm si më poshtë:

c) furnizimi i shërbimeve shëndetësore dhe veprimeve të lidhura ngushtë me to, që kanë për qëllim mbrojtjen e shëndetit të shtetasve, përfshirë parandalimin, diagnozën, trajtimin, kurimin e sëmundjes apo çrregullimeve shëndetësore dhe rehabilitimin, nga institucionet shëndetësore publike ose private, të njohura si të tilla nga autoriteti kompetent shëndetësor;

Sa më sipër, angazhimi i fondeve buxhetore për likuidim TVSH-je, në masën 20 % të tyre, apo në shumën 417,175 mijë lekë, ka sjellë që përdorimi i këtyre fondeve të mos shkojë në destinacionin e përcaktuar, që është ofrimi i shërbimeve mjekësore. Për rrjedhojë nëse TVSH e paguar për sterilizimin në vitin 2022, do të përdorej në destinacionin e duhur do të ishin kryer edhe 12,705 ndërhyrje kirurgjikale të kompleksitetit të mesëm më shumë. Ndryshimi i destinacionit të fondeve ka sjellë uljen e nivelit të shërbimit, po të konsiderojmë dhe faktin që ky shërbim është realizuar në masën 100 % të buxhetit të planifikuar, ç'ka do të thotë që tavani buxhetor ka kufizuar dhënien e shërbimit.

Kriteri: Ligjin nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe PPP", neni 27 "Përmbajtja e kontratës", pika 1;
Ligji nr. 7928, datë 27.04.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" (i shfuqizuar), neni 25/11 "Barnat dhe shërbimi shëndetësor";
Ligji nr. 92/2014 "Për TVSH-në në Republikën e Shqipërisë", Kreu VIII "Përjashtimet, furnizimet me shkallë zero, eksportet seksioni 1 furnizimet e përjashtuara", neni 51 "Përjashtimi i disa veprimtarive me interes të përgjithshëm", germa c;
Udhëzimi nr. 6, datë 30.01.2015 "Për TVSH-në në Republikën e Shqipërisë" neni 38 "Furnizimet e barnave dhe shërbimeve shëndetësore".

Ndikimi/pasoja: Kryerja e pagesave në kundërshtim me aktet ligjore ka sjellë pagesë të panevojshme të TVSH që në vitin 2022 është në vlerën 417,175 mijë lekë, përdorimin e këtij fondi jashtë destinacionit që është ofrimi i shërbimit mjekësor.

Shkaku: Kushtet e kontratës së PPP së Kontrollit Mjekësor Bazë dhe sterilizimit ku është përcaktuar likuidimi i faturave me TVSH, në kundërshtim me aktet ligjore, në kushtet e njohjes së ligjit dhe zbatimit të tij me dy standarde, nga përfaqësuesi i MSHMS, duke patur në konsideratë faktin që për dy kontrata të shërbimeve në fushën e mjekësisë nuk është aplikuar TVSH.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: MSHMS, në bashkëpunim me Strukturat drejtuese të Fondit të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor, të marrin masa që në bashkëpunim me Shoqërinë Koncesionare "3P." SHPK dhe "S." SHPK, të bëjnë të mundur rishikimin e kushtit të kontratave koncesionare respektive, në lidhje me pagesën dhe mënyrën e shlyerjes, me qëllim kthimin në ligjshmëri dhe ndërprerjen e pagesave të TVSH-së, për këto shërbime të përjashtuara nga ky lloj tatimi, si dhe përdorimin e fondeve me efektivitet, në destinacionin e duhur, që është ofrimi i shërbimit.

Sa më sipër, referuar cilësimeve në kontrata vetëm në kontratën për shërbimin laboratorik janë zbatuar aktet ligjore (cilësuar më poshtë).

Në tre kontratat e tjera (KMB; Sterilizimi dhe Dializa), përcaktimi i mënyrës së pagesës, është në kundërshtim me Ligjin nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe PPP", neni 27 "Përmbajtja e kontratës", pika 1, ku cilësohet: *"Kontrata përcakton të drejtat dhe detyrimet e autoritetit kontraktues dhe koncesionarit/partnerit privat, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë"*, por që për PPP e Dializës nuk është zbatuar. Konkretisht:

- PPP "Dializa", në pikën 16.3 "Çështje financiare", nën pika 16.3.1 cilësohet: *"Çmimi për shërbimet e ofruara do të jetë çmimi i paraqitur nga koncesionari dhe i pranuar nga autoriteti, siç përshkruhet në aneksin nr. 7 (Çështje financiare) Çmimi për shërbimet e ofruara do të jetë çmim neto pa TVSH. Fatura e lëshuar nga koncesionari do të jetë faturë tatimore me TVSH e llogaritur mbi Çmimin neto".* ***Faturimi nga koncesionari dhe likuidimi i faturave të dializës është pa TVSH.***
- Sipas Kontratës së PPP "Laboratorë", në Aneksin nr. 3 të kontratës cilësohet: ***"Çmimet e dhëna më poshtë janë pa TVSH, për shkak të përjashtimit të shërbimeve mjekësore, objekt i kësaj marrëveshje, nga TVSH".***

<u>Mbi shpenzimet administrative dhe investimet.</u>

Shpenzimet administrative në total janë planifikuar në shumën 1,070,00 mijë lekë dhe sipas të dhënave të FSDKSH, janë përdoruar për të financuar aktivitetin e DRF dhe Drejtorisë Qendrore të FSDKSH për paga, sigurime dhe mallra e shërbime sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr.3.66 "Shpenzimet sipas zërave të buxhetit"

Në mijë lekë

Artikull	Përshkrimi	FSDKSH		Raporti Fakt/Plan	
		Plani përfundimtar	Realizimi faktik	Diferenca (vlerë)	Realizimi në %
600	Paga e shtesa	577,366	490,604	86,762	85.0
601	Kontribute të sig.shoq & shënd.	95,948	79,964	15,984	83.3
602	Mallra e shërbime	392,233	311,893	80,340	79.5
	Rezerve	4,453		4,453	
Totali operative		**1,070,000**	**882,461**	**187,539**	**82.5**
23	**Investime**	**10,000**	**3,772**	**6,228**	**37.7**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i auditimit të KLSH

Shpenzimet e planifikuara për llogarinë 600 "paga" në vlerën totale 577,366 mijë lekë, janë realizuar në vlerën 490,604 mijë lekë, ose 85% kundrejt planit. Shpenzimet e planifikuara për llogarinë 601 "sigurime" në vlerën totale 95,948 mijë lekë janë realizuar në vlerën 79,964 mijë lekë, ose 83.3% kundrejt planit. Ndërsa shpenzimet e planifikuara për llogarinë 602 në vlerën totale 392,233 mijë lekë janë realizuar në vlerën 311,893 mijë lekë ose 79.5% kundrejt planit. Shpenzimet për investime janë planifikuar në shumën 10,000 mijë lekë dhe janë realizuar në masën 37.7 %. Referuar të dhënave të mësipërme rezulton se janë respektuar tavanet buxhetor. Në mënyrë analitike sipas DRF realizimi i shpenzimeve administrative dhe investimeve paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr.3.67 "Realizimi i shpenzimeve në nivel DRF"

Në mijë lekë

Drejtoritë Rajonale	600			601			602			23		
	Plan	Fakt	Realizimi ne %	Plan	Fakt	Realizimi ne %	Plan	Fakt	Real.	Plan	Fakt	Realizimi ne %
										0	0	
Berat	18,833	18,916	100.4%	3,126	3,075	98.4%	2,300	2,030	88.3%	0	0	

Dibër	20,600	18,638	90.5%	3,400	3,073	90.4%	7,301	7,300	100.0%	0	0	
Durrës	27,337	18,945	69.3%	4,558	3,074	67.4%	7,403	5,943	80.3%	0	0	
Elbasan	24,328	24,272	99.8%	4,003	4,002	100.0%	2,500	2,436	97.4%	1,073	613	57%
Fier	19,236	19,098	99.3%	3,211	3,131	97.5%	4,805	3,117	64.9%	529	482	91%
Lushnje	10,073	7,507	74.5%	1,682	1,231	73.2%	2,160	1,223	56.6%	1,890	1,886	100%
Gjirokastër	18,696	17,804	95.2%	3,122	2,903	93.0%	3,100	2,745	88.5%	0	0	
Korçe	22,066	22,065	100.0%	3,674	3,625	98.7%	3,115	2,377	76.3%	0	0	
Pogradec	7,300	6,660	91.2%	1,250	1,112	89.0%	1,560	1,545	99.1%	0	0	
Kukës	17,150	17,383	101.4%	2,847	2,823	99.2%	5,273	4,876	92.5%	100	100	100%
Tropoje	7,300	5,830	79.9%	1,250	905	72.4%	1,321	1,243	94.1%	0	0	
Lezhe	19,595	19,315	98.6%	3,272	3,149	96.2%	2,600	2,550	98.1%	0	0	
Shkodër	21,980	18,681	85.0%	3,670	3,064	83.5%	10,714	7,425	69.3%	0	0	
Tirane	45,934	35,947	78.3%	7,671	5,858	76.4%	7,703	7,349	95.4%	0	0	
Kamez-Vore	23,365	15,122	64.7%	3,892	2,499	64.2%	1,737	970	55.8%	0	0	
Vlore	18,700	17,574	94.0%	3,089	2,877	93.1%	5,125	3,978	77.6%	0	0	
Sarande	7,665	6,293	82.1%	1,312	1,029	78.4%	1,361	1,317	96.8%	143	105	73%
FSDKSH	223,436	176,786	79.1%	37,092	28,853	77.8%	319,868	251,869	78.7%	3,461	587	17%
DSHSU	23,772	23,770	100.0%	3,827	3,682	96.2%	2,287	1,600	70.0%	0	0	
Totali	**577,366**	**490,604**	***85%***	**95,948**	**79,964**	***83%***	**392,233**	**311,893**	***80%***	**10,000**	**3,772**	**52%**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i auditimit të KLSH

Plani dhe realizimi i shpenzimeve të DP e FSDKSH për vitin 2022, paraqiten në tabelën e mëposhtme. Niveli i realizimit të tyre është në masën 90 %.

Tabela nr.3.68 "Fakt/Plan shpenzime 2022/2021"

Në mijë lekë

Llog.	Zërat e shpenzimeve	Viti 2021			Viti 2022		
		Plan	Fakt	Realizimi %	Plan	Fakt	Realizimi %
600	Paga, e të tjera shpenzime personeli	200,000	177,403	89%	223,436	176,786	79%
601	Kontribute te sigurimeve (30.7%)	29,500	29,325	99%	37,092	28,853	78%
602	Mallra dhe shërbime te tjera	300,000	242,522	81%	319,868	251,869	79%
604	Transferime për parësorin	50,000	24,100	48%	50,000	45,457	91%
606	Pagesa për shërbime mjekësore e dentare	386,090	235,519	61%	906,090	887,734	98%
	Gjithsej shpenzime klasa 6	965,590	708,868	73%	1,536,486	1,390,699	91%
23	Shpenzime për rritjen e AQ	30,846	24,529	80%	3,461	587	17%
	Gjithsej	**996,436**	**733,397**	74%	**1,539,947**	**1,391,286**	**90%**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i auditimit të KLSH

Titulli i gjetjes: **Mbi planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve administrative dhe investimeve.**

Situata: Nga auditimi mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit për shpenzime administrative dhe investime, ka rezultuar një nivel i ulët i realizimit të tyre në vitin 2022, i cili varion nga 37.7% investimet deri në 85 % shpenzimet për paga. Gjithashtu, pavarësisht se dhe në vitin e mëparshëm paraqitet e njëjta situatë, pra ka nivel të ulët të realizimit të shpenzimeve, ky fakt nuk është marrë në konsideratë gjatë planifikimit të buxhetit për vitin 2022, pasi plani i vitit 2022 është në nivele më të larta se plani i vitit 2021 dhe më i lartë se fakti i vitit 2021, **duke shkaktuar angazhim të fondeve buxhetore më tepër se nevojat reale.** Niveli i ulët i realizimit të shpenzimeve të planifikuara është evidentuar edhe në nivel DRF, në të gjithë zërat e buxhetit paga, sigurime, operative dhe investime.

Kriteri: Udhëzimi nr. 8, datë 26.02.2021 "Për përgatitjen e programit buxhetor PBA-2022-2024", Faza e I-rë, pika 3.

Ndikimi/pasoja: Mos planifikimi i duhur dhe me rezervë i fondeve buxhetore, sjell angazhim të tyre jo ne destinacionin e duhur, si dhe kryerjen e transferimeve gjate vitit për shkak të rishpërndarjes së tyre ku ka nevojë. Cilësojmë se ndaj totalit të fondeve buxhetore në total këto fonde zënë një peshë specifike të ulët.

Shkaku:	Mos analizim i duhur i nevojave për fonde buxhetore gjatë procesit të programimit, për financimin e shpenzimeve administrative dhe investimeve.
Rëndësia:	E ulët
Rekomandimi:	Drejtori i Drejtorisë Ekonomike, të marrë masa që në vijimësi të analizojnë në mënyrën e duhur nevojat për angazhim fondesh buxhetore, me qëllim planifikimin e tyre në masën e duhur.

Konkluzion: Nga FSDKSH janë respektuar tavanet buxhetore mbi kryerjen e shpenzimeve. Nga analiza e realizimit të shpenzimeve të DP së FSDKSH, ka rezultuar se niveli i realizimit të tyre në disa zëra është në nivele të ulta, duke shkaktuar angazhim të fondeve buxhetore më tepër se nevojat reale.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, mbi këtë drejtim auditimi, nuk janë paraqitur observacione.

2.4. Vlerësimi i përputhshmërisë së aktivitetit të Drejtorisë e Kontrollit, Drejtorisë e Rimbursimit, Drejtorisë e Kujdesit Parësor dhe Spitalor si dhe të Drejtorisë e Shërbimit Spitalor Universitar lidhur me ushtrimin e kontrolleve në subjektet me kontratë me FSDKSH, testimin e rimbursimit të barnave dhe disponibilitetin e tyre në treg, realizimin e shërbimit për kontrata koncesionare dhe paketat e shërbimit shëndetësore, etj.

2.4.1 "Mbi vlerësimin e përputhshmërisë së aktivitetit dhe funksionimit të sistemeve të kontrollit në Drejtorinë e Kontrollit, për vitin 2022".

Për auditimin e çështjeve të mësipërme u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Planet e punës dhe realizimi i tyre sipas evidencës përkatëse të specifikuar me programet e kontrollit;
- Dosjet e kontrollit, të kontrolleve të ushtruara në subjekte farmaceutike duke përfshirë akt-rakordimet, procesverbalet, informacionet përmbledhëse mbi rezultatet e kontrolleve, etj.;
- Të dhëna mbi konsumin e barnave sipas farmacive për realizimin e përzgjedhjes nga drejtoria për kontroll;
- Evidenca në lidhje me rezultatet e kontrolleve sipas sektorëve përkatës;
- Të dhëna në lidhje me gjendjen e inventarit, hyrjet, daljet dhe inventarin sipas periudhave të përcaktuara në indeksim/ndryshim të LBR për depot që kanë kontratë me FSDKSH sipas ekstrakteve të nxjerra nga programi informatikë;
- Shkresa dhe dokumente të tjerë shoqërues sipas kërkesës në problematikat e konstatuara të cituara në këtë material; etj.

Objektivi i punës së drejtorisë është kontrolli i zbatimit të detyrimeve kontraktuale të subjekteve të kontraktuara me Fondin duke përfshirë Qendrat Shëndetësore, Farmacitë, Depot Farmaceutike dhe Spitalet.

Mbi organizimin e Drejtorisë së Kontrollit:

Drejtoria e Kontrollit është e organizuar në katër sektorë:

1. Sektori i Kontrollit Parësor;
2. Sektori i Kontrollit të Farmacive dhe Agjencive Farmaceutike;
3. Sektori i Kontrollit të Depove Farmaceutike;
4. Sektori i Kontrollit Spitalor.

Tabela nr. 4.1.1 "Struktura e Drejtorisë së Kontrollit sipas sektorëve"

Nr.	Drejtoria e Kontrollit	Struktura 2022
I	Drejtor Drejtorie	1 (një)
II	Përgjegjës Sektori	4 (katër) 1. Sektori i Kontrollit Parësor 2. Sektori i Kontrollit të Farmacive dhe Agjencive Farmaceutike 3. Sektori i Kontrollit të Depove Farmaceutike 4. Sektori i Kontrollit Spitalor
II	Specialistë	Numri i specialistëve në total 26, nga 29 specialistë sipas strukturës organizative, ose 3 specialistë më pak.

Referuar të dhënave të mësipërme rezulton se, Drejtoria e Kontrollit nga 34 punonjës të miratuar sipas strukturës organizative, ka në total 31 punonjës. Vakancat në strukturë janë, 1 (një) specialist në Sektorin e Kontrollit Parësor dhe 2 (dy) specialistë në Sektorin e Kontrollit Spitalor, gjë e cila ka ndikuar në realizimin e kontrolleve.

Mbi planifikimin e kontrolleve:

Për kontrollin tek dhënësit e shërbimit të kontraktuar me Fondin, Drejtoria e Kontrollit bazohet në Rregulloren nr.3, datë 22.10.2014 "Për procedurën dhe mënyrën e kontrollit të dhënësve të shërbimit të kontraktuara me Fondin". Në këtë rregullore, janë përcaktuar etapat për kontrollin si dhe dokumentacioni përkatës që mbahet për subjektet e kontraktuara. Gjithashtu, është përcaktuar dhe mënyra e përzgjedhjes së subjekteve për kontroll, të dhënat që duhet të shfrytëzohen në bashkëpunim me struktura të tjera brenda FSDKSH, si dhe disa kritere risku për sektorin e kontrollit Parësor, Farmaceutik dhe Spitalor.

Për realizimin e veprimtarisë së vitit 2022, Drejtoria e Kontrollit është mbështetur në Planin Vjetor të Punës për vitin 2022, i miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm me nr. 6880/3, datë 31.12.2021.

Në këtë Plan vjetor janë përfshirë të gjitha detyrat dhe objektivat e kësaj drejtorie përgjatë vitit 2022, ku përfshihen edhe ato organizative, administrative si dhe planifikim i subjekteve që do të kontrollohen sipas sektorëve, me përjashtim të Sektorit të Kontrollit të Depove Farmaceutike, për të cilin nuk ka përcaktim të subjekteve që do të kontrollohen përgjatë vitit 2022, por vetëm përcaktim të llojit/objektit të kontrolleve që do të ushtrohen.

Mbi veprimtarinë kontrolluese:

Për vitin 2022, FSDKSH, ka lidhur kontratë me 38 Depo Importuese dhe 13 Depo Shpërndarëse; 903 Farmaci dhe agjenci farmaceutike; 407 Qendra Shëndetësore; 1,518 MPF dhe 335 MS; 6 Qendra Specialitetesh dhe 49 Spitale (Universitare, Rajonal, Bashkiak, Privat), të cilat janë objekt i kontrollit nga Drejtoria e Kontrollit dhe sipas sektorëve përkatës dhe sipas DRF paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr.4.1.2 "Subjekte që kanë lidhur kontratë me FSDKSH viti 2022 (numër)"

Nr.	DRF Rajoni	Spitale Rajonale	Farmaci/Agjenci Farmaci	Depo farmaceutike		Qendrat Shëndetësore		Mjekë	
				D.Imp	D.Distributorë	QSH	QSH të specialiteteve	MS	MP dhe të familjes
1	Berat	**1**	39			22		0	73
2	Dibër	**1**	23			34		1	60
3	Durrës	**1**	90		1	34		20	197
4	Elbasan	**1**	82			53		3	161
5	Fier	**1**	56	1	4	28		7	101
6	Gjirokastër	**1**	17			31		1	53
7	Korçë	**1**	40		1	31		9	77
8	Pogradec		19			8			32
9	Kukës	**1**	9			19		1	34
10	Tropoje		4			8			13

11	Lezhë	**1**	34			21		4	81
12	Shkodër	**1**	62		1	36		6	103
13	Tiranë		282	36	4	27	5	245	300
14	Kamëz Vorë		38			8	1	32	65
15	Vlorë	**1**	54	1	2	17		4	84
16	Sarande		13			13			29
17	Lushnje		40			17		2	55
18	QSUT	**1**	1						
19	"Shefqet Ndroqi"	**1**							
20	"Mbreteresha Geraldine"	**1**							
21	"Koco Gliozheni"	**1**							
22	Spitale Bashkiake	**24**							
23	Spitale private	**10**							
	Totali	**49**	**903**	**38**	**13**	**407**	**6**	**335**	**1,518**

Burimi i të dhënave FSDKSH[1], përpunuar nga audituesit e KLSH

Sikurse pasqyrohet edhe në tabelën e mësipërme, totali i subjekteve objekt kontrolli nga Drejtoria e Kontrollit është 3,269 subjekte, ku sipas peshës specifike ndaj totalit të subjekteve që kanë lidhur kontratë me FSDKSH, renditen: Mjekët, me 56.7 %; Farmacitë dhe Agjencitë farmaceutike me 27.6 %, Qendrat shëndetësore me 12.6 % dhe Depot farmaceutike më 1.6 % dhe Spitalet me 1.5 %.

Mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Kontrollit për vitin 2022, sipas sektorëve.
Në vitin 2022, sipas sektorëve shpërndarja e kontrolleve ka qenë si më poshtë:
Gjatë vitit 2022, janë ushtruar kontrolle në **668 subjekte, nga 3,269 subjekte më kontratë me FSDKSH, ose 20.4 % e tyre.**

Tabela nr.4.1.3 "Niveli i mbulimit me kontroll gjatë vitit 2022, sipas sektorëve"

Nr.	Sektorët	Subjekte me kontratë	Subjekte të kontrolluar	Mbulimi në %
1	Sektori i Kontrollit të Shërbimit Parësor	2,266	465	20.5
2	Sektori i Kontrollit të Farmacive	903	165	18.3
3	Sektori i Kontrollit të Depove farmaceutike	51	16	31.4
4	Sektori i Kontrollit të Shërbimit Spitalor	49	22	44.9
5	**Totali**	**3,269**	**668**	**20.4**

Burimi i të dhënave Drejtoria e Kontrollit në FSDKSH, përpunuar nga audituesit e KLSH

Sektori i Kontrollit Parësor (SKP):
Detyrat e SKP janë përcaktuar në Rregulloren nr. 2, datë 26.07.2020 "Mbi organizimin, funksionimin dhe përshkrimet e punës në FSDKSH", Kapitulli XI "Sektori i Kontrollit Parësor" si dhe Rregulloren nr. 3/2014, Kapitulli II, ku janë përcaktuar detyrat si më poshtë:

- Sektori i Kontrollit Parësor, kontrollon Qendrat Shëndetësore për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale për dhënien e shërbimit të kujdesit shëndetësor parësor nga mjekët

[1] Raporti vjetor i veprimtarisë së FSDKSH miratuar nme VKA nr. 7, datë 24.04.2023.

e familjes, mjekët specialistë, infermierët dhe stafin mjekësor të punësuar në Qendrën Shëndetësore që ka kontratë me Fondin.

- Grupi i Kontrollit ushtron kontrollin duke u bazuar në detyrimet e përcaktuara në kontratën mes DRF-Qendër Shëndetësore. Kontrolli ushtrohet për të verifikuar zbatueshmërinë e detyrimeve të përgjithshme të QSH dhe të detyrimeve specifike të saj të cilat janë:

- Detyrimet e QSH nëpërmjet MPF të kontraktuar;
- Detyrimet e MPF për recetën dhe formularin e vizitës;
- Detyrimet e QSH nëpërmjet Infermierit të kontraktuar;
- Detyrimet e QSH nëpërmjet MS të kontraktuar të cilat janë të përcaktuara në mënyrë të hollësishme në kontratë;
- Kontrollon planifikimin, dhe zbatueshmërinë e planit të rimbursimit.
- Kontrollon aktivitetin e të gjithë mjekeve të QSH te cilët kanë **vlerën e recetave të rimbursuara me të lartë se 1,000,000 lekë në muaj.**

Sipas të dhënave të Drejtorisë së Kontrollit, gjatë vitit 2022 nga ky sektor janë kontrolluar 334 mjekë nga 1,243 që kanë lidhur kontratë me FSDKSH, ose 27 % e tyre 37 QSH, nga 352 që kanë lidhur kontratë me FSDKSH, ose 37 % e tyre. Sipas Rajoneve të kontrolluara niveli i mbulimit me kontroll paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.4.1.4 "Të dhëna mbi mjekët që kane lidhur kontratë me FSDKSH dhe mjekët e kontrolluar"

Nr.	Rajonet	Subjektet me kontratë		Subjektet e kontrolluara		Mbulimi në %	
		QSH	Mjekë	Q.SH	Mjekë	QSH	Mjekë
1	Lezha	21	81	10	26	48	32
2	Kamëz-Vora	8	63	5	23	63	37
3	Berat	26	62	13	24	50	39
4	Durrës	33	165	14	34	42	21
5	Elbasan	47	146	11	28	23	19
6	Gjirokastër	31	54	9	22	29	41
7	Sarandë	13	28	4	9	31	32
8	Korçë	31	70	11	29	35	41
9	Tiranë	27	258	10	40	37	16
10	MS Kardiologë	10	12	10	12	100	100
11	Fier	28	101	12	26	43	26
12	Kukës	19	30	5	11	26	37
13	Tropojë	8	8	2	4	25	50
14	Vlorë	17	70	10	26	59	37
15	Shkodër	33	95	5	20	15	21
16	**Totali**	**352**	**1,243**	**131**	**334**	**37**	**27**

Burimi i të dhënave Drejtoria e Kontrollit në FSDKSH, përpunuar nga audituesit e KLSH

Meqenëse, me Programin e auditimit nr.733/1 prot., datë 11.09.2023, KLSH është në auditim në FSDKSH për çështjen "Përputhshmëria me aktet ligjore dhe rregullatore në fuqi të veprimtarisë së organeve drejtuese të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, lidhur me rimbursimin e barnave: Këshilli Administrativ, Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtoritë përkatëse në FSDKSH" nuk është finalizuar me gjetje dhe evidentim përgjegjësie mbulimin me kontroll të qendrave shëndetësore, MPF dhe MS nga Drejtoria e Kontrollit.

Bazuar në planin vjetor të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, për Janar-Dhjetor 2022 nga Sektori i Kontrollit Parësor janë planifikuar për kontroll dhe realizuar kontrollet në rajonet si më poshtë vijon:

- Gjatë muajit Janar, ka kryer kontroll në rajonin **Lezhë**, ku janë kontrolluar 10 Qendra Shëndetësore, 10 drejtorë QSH, 26 Mjekë të përgjithshëm e të familjes nga 81 në total, ose

afërsisht 35% të totalit të mjekëve për këtë rajon. Mjekët e kontrolluar kanë shpenzuar 56% të totalit të rimbursimit për këtë Rajon.

- Gjatë muajit Shkurt, ky sektor ka kryer kontroll në rajonin **Kamëz-Vorë**, ku janë kontrolluar 5 QSH, 5 Drejtorë QSH, 23 MPF nga 165 në total, ose 37% te totalit të mjekëve për këtë rajon. Mjekët të kontrolluar kanë shpenzuar 36% të totalit të rimbursimit për këtë Rajon.
- Gjatë muajit Mars, ky sektor ka kryer kontroll në rajonet:

- **Berat**: 13 QSH, 13 Drejtorë QSH, 24 MPF nga 62 në total, ose 39% te totalit të mjekëve për këtë rajon. Mjekët e kontrolluar kanë shpenzuar 64% të totalit të rimbursimit për këtë Rajon.
- **Gjirokastër**: 9 QSH , 9 Drejtorë QSH, 22 MPF nga 54 në total, ose 41% te totalit të mjekëve për këtë rajon. Mjekët e kontrolluar kanë shpenzuar 70% të totalit të rimbursimit për këtë Rajon.

- Gjatë muajve Mars-Prill ka kryer kontroll në rajonin **Durrës**, ku janë kontrolluar, 14 QSH, 14 Drejtorë QSH, 34 MPF nga 165 në total, ose 21 % te totalit të mjekëve për këtë rajon. Mjekët e kontrolluar kanë shpenzuar 40% të totalit të rimbursimit për këtë Rajon.
- Prill-Maj ka kontrolluar ka kryer kontroll në rajonin **Elbasan**, ku janë kontrolluar, 11 QSH, 11 Drejtorë QSH, 28 MPF nga 142 në total, ose 22% te totalit të mjekëve për këtë rajon. Mjekët e kontrolluar kanë shpenzuar 37% të totalit të rimbursimit për këtë Rajon.
- Gjatë muajit Qershor ka kryer kontroll në rajonet:

- **Sarandë**, 4 QSH , 4 Drejtorë QSH, 9 MPF nga 38 në total, ose 24% te totalit të mjekëve për këtë rajon. Mjekët e kontrolluar kanë shpenzuar 60% të totalit të rimbursimit për këtë Rajon.
- **Korçë**, 11 QSH , 11 Drejtorë QSH, 25 MPF nga 70 në total, ose 38.5 % te totalit të mjekëve për këtë rajon. Këta mjekë të kontrolluar kanë shpenzuar 58.5% të totalit të rimbursimit për këtë Rajon.

- Gjatë muajit Korrik ka kryer kontroll në rajonin **Tiranë**, 10 QSH, 10 Drejtorë QSH, 40 MPF nga 258 në total, ose 17% te totalit të mjekëve për këtë rajon. Mjekët e kontrolluar kanë shpenzuar 28 % të totalit të rimbursimit për këtë rajon.
- Gjatë muajit Shtator ka kryer kontroll tematik të mjekëve kardiologë të rajonit **Tiranë**: 10 QSH dhe 12 MS.
- Gjatë muajve Shtator-Tetor ka kryer kontroll në rajonin **Fier**, 12 QSH , 12 Drejtorë QSH, 26 MPF nga 98 në total, ose 27 % te totalit të mjekëve për këtë rajon. Mjekët e kontrolluar kanë shpenzuar 48% të totalit të rimbursimit për këtë rajon.
- Gjatë muajit Tetor ka kryer kontroll në rajonet:

- **Kukës**, 5 QSH, 5 Drejtorë QSH, 11 MPF nga 30 në total, ose 37 % te totalit të mjekëve për këtë rajon. Mjekët e kontrolluar kanë shpenzuar 66% të totalit të rimbursimit për këtë rajon.
- **Tropojë**, 2 QSH, 2 Drejtorë QSH, 4 MPF nga 8 në total, ose 50 % te totalit të mjekëve për këtë rajon. Mjekët e kontrolluar kanë shpenzuar 70% të totalit të rimbursimit për këtë rajon.

- Gjatë muajit Nëntor ka kryer kontroll në rajonin **Vlorë**, 10 QSH, 10 Drejtorë QSH, 26 MPF nga 70 në total, ose 38 % te totalit të mjekëve për këtë rajon. Mjekët e kontrolluar kanë shpenzuar 50% të totalit të rimbursimit për këtë rajon.
- Gjatë muajit Dhjetor ka kryer kontroll në rajonin **Shkodër**, 5 QSH, 5 Drejtorë QSH, 20 MPF nga 95 në total, ose 21 % të totalit të mjekëve për këtë rajon. Mjekët e kontrolluar kanë shpenzuar 45% të totalit të rimbursimit për këtë rajon.

Sipas të dhënave rezulton se përgjithësisht ka një mbulim të mirë me kontroll të subjekteve sipas DRF, referuar tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 4.1.5

Numri	Drejtoritë Rajonale te Fondit	% kundrejt numrit total të subjekteve në nivel rajoni	% kundrejt fondit total të rimbursuar në nivel rajoni
1	Lezha	35	56
2	Kamëz-Vora	37	36
3	Berat	39	64
4	Durrës	21	40
5	Elbasan	22	37
6	Gjirokastër	41	70
7	Sarandë	24	60
8	Korçe	39	59
9	Tirana	17	28
10	MS Kardiologë	(10)	(12)
11	Fier	27	48
12	Kukës	37	66
13	Tropojë	50	70
14	Vlorë	38	50
15	Shkodër	21	45

Burimi i të dhënave Drejtoria e Kontrollit në FSDKSH, përpunuar nga audituesit e KLSH

Nga kontrollet e kryera në 465 subjektet, janë evidentuar shkelje dhe mangësi për të cilat janë rekomanduar sanksionet e mëposhtme, ku pasqyrohen të dhënat e detajuara mbi kontrollet në qendrat shëndetësore sipas secilit rajon.

Tabela nr.4.1.6 "Rezultatet e kontrollit"

Nr.	DRSKSH	Total QSH	Total mjekë	Subjektet e kontrolluara		Lloji i kontrollit	Sanksionet		
				Q.SH	Mjekë		Dëmi ekonomik	Kushte penale	Gjoba
1	Lezha	21	81	10	26	I plotë	47,581	20,000	20,000
2	Kamëz-Vora	8	63	5	23	I plotë	91,338		12,000
3	Berat	26	62	13	24	I plotë	15,569		28,000
4	Durrës	33	165	14	34	I plotë	39,892		24,000
5	Elbasan	47	146	11	28	I plotë	57,264		15,000
6	Gjirokastër	31	54	9	22	I plotë	19,856		6,000
7	Sarandë	13	28	4	9	I plotë	21,564		11,000
8	Korçë	31	70	11	29	I plotë	56,131		21,000
9	Tiranë	27	258	10	40	I plotë	100,950		29,000
10	MS Kardiologë	10	12	10	12	Tematik		18,000	
11	Fier	28	101	12	26	I plotë	15,766		15,000
12	Kukës	19	30	5	11	I plotë	14,410		10,000
13	Tropojë	8	8	2	4	I plotë	7,288		3,000
14	Vlorë	17	70	10	26	I plotë	32,508		18,000
15	Shkodër	33	95	5	20	I plotë	48,370		9,000
16	**Totali**	**352**	**1,243**	**131**	**334**		**568,487**	**38,000**	**221,000**

Burimi i të dhënave Drejtoria e Kontrollit në FSDKSH, përpunuar nga audituesit e KLSH

Sipas tipologjisë problematikat kryesore janë:

- kufizime të listës së barnave të rimbursuara, protokollet e përdorimit të barnave dhe aktet e Fondit për mirë administrimin e shpenzimeve të rimbursimit për mjekimin e të sëmurëve, administrimi i kartelave të pacientëve.
- mos plotësimin saktë me të gjithë elementët të recetës elektronike.

Baza ligjore është referuar sipas mangësive të konstatuara dhe penalitete e vendosura ishin në përputhje me kërkesat ligjore.
Krahasuar me vitin 2021, SKP ka kryer 49 kontrolle me shumë, treguesit mbi kontrollet e kryera dhe rezultatet paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr.4.1.7 "Kontrollet dhe rezultatet 2022/2021"

Viti	DRF/Rajone	Kontroll QSH	Kontroll MPF	Sanksionet		
				Dëmi ekonomik	Kushte penale	Gjoba
2022	15 Rajone	131	334	568,487	38,000	221,000
2021	13 Rajone	122	297	645,715	15,000	293,000
Diferenca	**+ 2**	**+ 9**	**+ 37**	**-77,228**	**+23,000**	**-72,000**

Burimi i të dhënave Drejtoria e Kontrollit në FSDKSH, përpunuar nga audituesit e KLSH

Nga auditimi me zgjedhje i 3 dosjeve të kontrollit, të ushtruar në QSH Tiranë, Shkodër dhe Elbasan, për zbatimin e procedurave të kontrollit referuar Rregullores nr. 3/2014, ka rezultuar:

Qendrat Shëndetësore të Drejtorisë Rajonale Tiranë:
Nga shqyrtimi i dosjes së kontrollit rezulton se është plotësuar dokumentacioni si më poshtë:
Informacioni nr. 4355, datë 29.06.2022 mbi arsyet e përzgjedhjes për kontroll të QSH me kontratë më DRF Tiranë, ku janë përcaktuar kriteret e përzgjedhjes së këtij rajoni që janë:
- Vlera e lartë e rimbursimit për periudhën Janar-Dhjetor 2021;
- Pesha specifike e madhe që zë rimbursimi i barnave në këtë rajon në krahasim me rajonet e tjerë;

Gjithashtu, kontrolli do të kryhet me përzgjedhje në bazë risku për mjekët të cilat kanë:
- Realizuar vlerë më të lartë rimbursimi;
- Tejkalim të planit të rimbursimit;
- Rastet e reja dhe ato me ndryshim terapie.

Kontrolli është ushtruar duke analizuar të dhënat e treguesve për periudhën Janar-Prill 2022. DRF Tiranë, ka realizuar rimbursim barnash në shumën 859,733,518 lekë nga 851,552,326 lekë të planifikuara, ose me realizim mbi 100 %. Në këtë DRF janë 318 mjekë familje dhe pediatër, si dhe janë përzgjedhur të kontrollohen 40 mjekë ose 17 % e totalit. Këta mjekë zënë 30 % të vlerës së rimbursimit, si dhe janë pjesë e 10 QSH, nga 27 qendra që ka në total DRF Tiranë. Pjesë e dokumentacionit është planifikimi i shpenzimeve të rimbursimit dhe projeksioni i KBM, i nënshkruar nga Drejtori i QSH dhe Drejtori i DRF. Në dosje ndodhet plani i shpenzimit për secilin MPF, nënshkruar nga Drejtori i QSH. Për periudhën Janar-Maj, janë realizuar 9,458 KMB, nga 9,298 të planifikuara ose 187 banorë më shumë se planifikimi.
Sipas Njoftimit për kontroll nr. 4355/1, datë 09.06.2022, do të ushtrohet kontroll në QSH (nr. 1, 2, 3, 4, 6, 7, 8, 9, 10 dhe Shkozë), si dhe afati i kontrollit është nga 04.07.2022-29.07.2022.

Tabela nr.4.1.8 "Të dhëna mbi respektimin e afateve të kontrollit sipas subjekteve"

Nr.	DRF Tiranë	Drejtorë QSH	Drejtor i kontrolluar	Mjekë total	Mjekë të kontrolluar	Program Kontrolli Afati i mbylljes	Mbyllja kontrolli terren
1	QSH nr.1	1	1		5	08.07.2022	08.07.2022
2	QSH nr.2	1	1		9	15.07.2022	15.07.2022
3	QSH nr.3	1	1		2	27.07.2022	27.07.2022
4	QSH nr.4	1	1		3	13.07.2022	13.07.2022
5	QSH nr.6	1	1		3	20.07.2022	20.07.2022
6	QSH nr. 7	1	1		2	29.07.2022	29.07.2022
7	QSH nr. 8	1	1		1	25.07.2022	25.07.2022

8	QSH nr. 9	1	1		2	15.07.2022	15.07.2022
9	QSH nr.10	1	1		8	29.07.2022	29.07.2022
10	QSH, Shkozë	1	1		5	22.07.2022	22.07.2022
11	**Totali**	**10**	**10**		**40**		

Burimi i të dhënave Drejtoria e Kontrollit në FSDKSH, përpunuar nga audituesit e KLSH

Në përfundim të kontrolleve në nivel DRF nga grupet e kontrollit më datë 04.01.2023 është hartuar Raporti përfundimtar i kontrollit, i cili është nënshkruar nga gjithë grupi i kontrollit dhe është dërguar në subjekt me shkresën nr. 4355/3, datë 19.09.2022.

Tabela nr.4.1.9 "QSH të kontrolluara dhe afati i evadimit"

Nr.	DRF Tiranë	Raporti kontrollit	Vendimi
1	QSH nr.1	12.09.2022	
2	QSH nr.2	12.09.2022	117, datë 19.09.2022
3	QSH nr.3	12.09.2022	118, datë 19.09.2022
4	QSH nr.4	12.09.2022	119, datë 19.09.2022
5	QSH nr.6	12.09.2022	120, datë 19.09.2022
6	QSH nr. 7	12.09.2022	121, datë 19.09.2022
7	QSH nr. 8	12.09.2022	-
8	QSH nr. 9	12.09.2022	122, datë 19.09.2022
9	QSH nr.10	12.09.2022	123, datë 19.09.2022
10	QSH, Shkozë	12.09.2022	124, datë 19.09.2022

Burimi i të dhënave Drejtoria e Kontrollit në FSDKSH, përpunuar nga audituesit e KLSH

Qendrat shëndetësore të Drejtorisë Rajonale Shkodër:

Nga shqyrtimi i dosjes së kontrollit rezulton se është plotësuar dokumentacioni si më poshtë: Informacioni nr. 7093, datë 09.12.2022 mbi arsyet e përzgjedhjes për kontroll të QSH me kontratë më DRF Shkodër, ku janë përcaktuar kriteret e përzgjedhjes së këtij rajoni që janë:

- Vlera e lartë e rimbursimit për periudhën Janar-Tetor 2022;
- Pesha specifike e madhe që zë rimbursimi i barnave në këtë rajon në krahasim me rajonet e tjerë.

Gjithashtu, kontrolli do të kryhet me përzgjedhje në bazë risku për mjekët të cilat kanë:

- Realizuar vlerë më të lartë rimbursimi;
- Tejkalim të planit të rimbursimit;
- Rastet e reja dhe ato me ndryshim terapie.

Kontrolli është ushtruar duke analizuar të dhënat e treguesve për periudhën Janar-Tetor 2022. DRF Shkodër, ka realizuar rimbursim barnash në shumën 455,319,221 lekë, ose në masën 103.6 % ndaj planit. Në këtë DRF janë 98 mjekë familje dhe pediatër, si dhe janë përzgjedhur të kontrollohen 20 mjekë ose 20.4 % e totalit. Këta mjekë zënë 40 % të vlerës së rimbursimit, si dhe janë pjesë e 5 QSH, nga 33 qendra që ka në total DRF Shkodër. Pjesë e dokumentacionit është planifikimi i shpenzimeve të rimbursimit dhe projeksioni i KMB, i nënshkruar nga Drejtori i QSH dhe Drejtori i DRF. Bashkëngjitur ndodhet plani i shpenzimit për secilin MPF, nënshkruar nga Drejtori i QSH. Për periudhën Janar-Tetor, janë realizuar 9,644 KMB, nga 9,118 të planifikuara ose 526 banorë më shumë se planifikimi.

Sipas Njoftimit për kontroll nr. 7093/1, datë 09.12.2022, do të ushtrohet kontroll në QSH (nr. 1, 2, 3, 4, dhe Rrethinat), si dhe afati i kontrollit është nga 12.12.2022-23.12.2022.

Tabela nr. 4.1.10 "Afatet e realizimit të kontrolleve"

Nr.	DRF Shkodër	QSH të kontrolluara	Drejtor i kontrolluar	Mjekë të kontrolluar	Program Kontrolli Afati i mbylljes	Mbyllja kontrolli terren
1	QSH nr.1	1	1	4	20.12.2022	20.12.2022
2	QSH nr.2	1	1	5	16.12.2022	16.12.2022
3	QSH nr.3	1	1	5	23.12.2022	23.12.2022

4	QSH nr.4	1	1	3	23.12.2022	23.12.2022
5	QSH, Rrethinat	1	1	3	14.12.2022	14.12.2022
6	**Totali**	**5**	**5**	**20**		

Burimi i të dhënave Drejtoria e Kontrollit në FSDKSH, përpunuar nga audituesit e KLSH

Në përfundim të kontrolleve në nivel DRF, nga grupet e kontrollit është hartuar Raporti përfundimtar i kontrollit, i cili është nënshkruar nga gjithë grupi i kontrollit dhe është dërguar në subjekt me shkresën nr. 44/1, datë 06.01.2023. Kontrollet sipas QSH janë përmbyllur në terren brenda afatit të përcaktuar.

Tabela nr. 4.1.11 "QSH të kontrolluara dhe afati i evadimit"

Nr.	DRF Tiranë	Raporti kontrollit	Vendimi
1	QSH nr.1	04.01.2023	Nr. 21, datë 10.02.2023
2	QSH nr.2	04.01.2023	Nr. 1, datë 06.01.2023
3	QSH nr.3	04.01.2023	Nr. 2, datë 06.01.2023
4	QSH nr.4	04.01.2023	-
10	QSH, Rrethinat	04.01.2023	Nr.3, datë 06.01.2023

Burimi i të dhënave Drejtoria e Kontrollit në FSDKSH, përpunuar nga audituesit e KLSH

Referuar të dhënave të tabelës së mësipërme, ka rezultuar se në dosjet e kontrollit për QSH nr.4, nuk kishte në dosje Vendim të Drejtorit të Përgjithshëm, kjo për faktin se nuk kanë rezultuar mangësi.

Qendrat shëndetësore të Drejtorisë Rajonale Elbasan:

Nga shqyrtimi i dosjes së kontrollit rezulton se është plotësuar dokumentacioni si më poshtë:
Informacioni nr. 3115/1, datë 20.04.2022 mbi arsyet e përzgjedhjes për kontroll të QSH me kontratë më DRF Elbasan, ku janë përcaktuar kriteret e përzgjedhjes së këtij rajoni që janë:

- Vlera e lartë e rimbursimit për periudhën Janar-Dhjetor 2021;
- Pesha specifike e madhe që zë rimbursimi i barnave në këtë rajon në krahasim me rajonet e tjerë.

Gjithashtu, kontrolli do të kryhet me përzgjedhje në bazë risku për mjekët të cilat kanë:

- Realizuar vlerë më të lartë rimbursimi;
- Tejkalim të planit të rimbursimit;
- Rastet e reja dhe ato me ndryshim terapie.

Kontrolli është ushtruar duke analizuar të dhënat e treguesve për periudhën Janar-Dhjetor 2021. DRF Elbasan, ka realizuar rimbursim barnash në shumën 542,433,493 lekë, ose në masën 102 % ndaj planit. Me DRF Elbasan kanë lidhur kontratë me FSDKSH 53 QSH dhe 157 mjekë. Janë përzgjedhur për kontroll 11 QSH, ose 21 % e totalit dhe 28 MPF, ose 22 % e totalit. Këta mjekë kanë realizuar 37 % të totalit të rimbursimit. Pjesë e dokumentacionit është planifikimi i shpenzimeve të rimbursimit dhe projeksioni i KBM, i nënshkruar nga Drejtori i QSH dhe Drejtori i DRF. Bashkëngjitur ndodhet plani i shpenzimit për secilin MPF, nënshkruar nga Drejtori i QSH. Për periudhën Janar-Tetor, janë realizuar 9,644 KMB, nga 9,118 të planifikuara ose 526 banorë më shumë se planifikimi.
Sipas Njoftimit për kontroll nr. 3115, datë 20.04.2022, do të ushtrohet kontroll në QSH si më poshtë dhe afati i kontrollit është nga 21.04.2022-13.05.2022.

Tabela nr. 4.1.12 "Afatet e realizimit të kontrolleve"

Nr.	DRF Shkodër	QSH të kontrolluara	Drejtor i kontrolluar	Mjekë të kontrolluar	Program Kontrolli Afati i mbylljes	Mbyllja kontrolli terren
1	QSH nr.1	1	1	5	27.04.2022	27.04.2022
2	QSH nr.2	1	1	3	26.04.2022	26.04.2022
3	QSH nr.3	1	1	5	05.05.2022	23.12.2022

4	QSH nr.4	1	1	5	06.05.2022	06.05.2022
5	Librazhd	1	1	3	13.05.2022	13.05.2022
6	Peqin	1	1	2	13.05.2022	13.05.2022
7	Belsh	1	1	1	28.04.2022	28.04.2022
8	Prrenjas	1	1	1	09.05.2022	09.05.2022
9	Qukës	1	1	1	09.05.2022	09.05.2022
10	Grekan	1	1	1	06.05.2022	06.05.2022
11	Gjocaj	1	1	1	10.05.2022	10.05.2022
12	**Totali**	**11**	**11**	**28**		

Burimi i të dhënave Drejtoria e Kontrollit në FSDKSH, përpunuar nga audituesit e KLSH

Në përfundim të kontrolleve në nivel DRF nga grupet e kontrollit është hartuar Raporti përfundimtar i kontrollit, i cili është nënshkruar nga gjithë grupi i kontrollit dhe është dërguar në subjekt me shkresën nr. 44/1, datë 06.01.2023. Kontrollet sipas QSH janë përmbyllur në terren brenda afatit të përcaktuar.

Tabela nr. 4.1.13 "QSH të kontrolluara, vendimet"

Nr.	DRF Tiranë	Raporti kontrollit	Vendimi
1	QSH nr.1	02.06.2022	Nr. 80, datë 06.06.2022
2	QSH nr.2	02.06.2022	Nr. 81, datë 06.06.2022
3	QSH nr.3	02.06.2022	Nr. 82, datë 06.06.2022
4	QSH nr.4	02.06.2022	Nr. 83, datë 06.06.2022
5	Librazhd	02.06.2022	Nr. 85, datë 06.06.2022
6	Peqin	02.06.2022	Nr. 84, datë 06.06.2022
7	Belsh	02.06.2022	-
8	Prrenjas	02.06.2022	Nr. 86, datë 06.06.2022
9	Qukës	02.06.2022	-
10	Grekan	02.06.2022	-
11	Gjocaj	02.06.2022	-
12	**Totali**		

Burimi i të dhënave Drejtoria e Kontrollit në FSDKSH, përpunuar nga audituesit e KLSH

Referuar të dhënave të tabelës së mësipërme, ka rezultuar se në dosjet e kontrollit për QSH Belsh, Qukës, Grekan dhe Gjocaj, nuk kishte në dosje Vendim të Drejtorit të Përgjithshëm, për shkak se nuk kanë rezultuar problemetika.

Për çdo kontroll të QSH, të DRF Tiranë, Shkodër dhe Fier është plotësuar:

- Program Kontrolli i miratuar nga DP, ku është përcaktuar, Afati i kontrollit; Grupi i kontrollit dhe Pikat e kontrollit, si dhe lista e mjekëve që do të kontrollohen;
- Deklaratat e konfliktit të interesit të grupit të kontrollit;
- Akt verifikimet mbi zbatimin e përgjegjësive dhe detyrimeve kontraktuale, mbajtur me secilin MPF, nënshkruar, vulosur dhe protokolluar nga QSH;
- Akt verifikimi mbi zbatimin e përgjegjësive dhe detyrimeve kontraktuale, mbajtur me infermierët, nënshkruar, vulosur dhe protokolluar nga QSH;
- Procesverbale me mjekët përkatës të cilët kanë rezultuar me shkelje, nënshkruar, vulosur dhe protokolluar nga QSH;
- Akt verifikimi i kartelave personale;
- Procesverbale të mbajtura me të siguruar;
- Evidenca mbështetëse të kontrollit si: Deklarata e aktivitetit mujor, Inventar i medikamenteve; Analiza rimbursimi; Evidencë mbi recetë, medikament, mjek, farmaci:
- Raporti i kontrollit;
- Vendimi i DP mbi kontrollin;
- Vlerësimi i cilësisë së kontrollit.

Sektori i Kontrollit të Farmacive dhe Agjencive farmaceutike:

Sipas Rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të FSDKSH, Sektori i kontrollit të Farmacive dhe agjencive farmaceutike kontrollon përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, në zbatim të skemës së Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor të subjekteve farmaceutike të kontraktuara nga FSDKSH, duke u bazuar në planin vjetor planet mujore të Drejtorisë së Kontrollit si dhe sipas çështjeve specifike.

Veprimtaria e Sektorit bazohet në procedurat e përcaktuara në Rregulloren nr. 3/2014, Kapitulli I "Për kontrollin në farmaci, agjenci farmaceutike me kontratë më FSDKSH", ku është përcaktuar se objekti i kontrollit të këtij sektori është:

- Kontrolli i të gjitha subjekteve farmaceutike të kontraktuara me Fondin, me vlerë mesatare rimbursimi në muaj të barabartë ose më të lartë se 2,000,000 lekë.
- Kontrolli i aktivitetit të subjekteve farmaceutike të kontraktuara, duke u bazuar në luhatjet e vlerave mujore të rimbursimit.
- Kontrollin për verifikimin e problematikave që lidhen me cilësinë e shërbimit dhe performancën e subjekteve farmaceutike për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale.

Numri i subjekteve Farmaci dhe Agjenci farmaceutike me kontratë më FSDKSH në vitin 2022 sipas të dhënave të tabelës së mëposhtme, rezulton në 903 nga 921 subjekte në vitin 2021, ose 18 subjekte më pak.

Tabela nr.4.1.14 "Numri i farmacive me kontratë më FSDKSH; raporti 2022/2021"

Nr.	Farmaci/Agjenci	Farmaci/Agjenci		Diferenca 2022/2021
	DRF	Totali 2021	Totali 2022	
1	Berat	43	39	(4)
2	Fier	51	56	5
3	Vlorë	59	54	(5)
4	Durrës	91	90	(1)
5	Kukës	12	9	(3)
6	Pogradec	17	19	2
7	Tropojë	4	4	-
8	Kamëz Vorë	37	38	1
9	Elbasan	86	82	(4)
10	Tiranë	283	282	(1)
11	Dibër	27	23	(4)
12	Korçë	43	40	(3)
13	Shkodër	63	62	(1)
14	Lezhë	34	34	-
15	Lushnja	40	40	-
16	Gjirokastër	17	17	
17	Sarandë	13	13	
18	QSUT	1	1	
19	**Totali**	**921**	**903**	**(18)**

Burimi i të dhënave, Drejtoria e Kontrollit në FSDKSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Në tabelën e mëposhtme paraqitet pesha specifike e rimbursimit që zë çdo DRF, kundrejt totalit, si dhe planifikimi dhe realizimi i kontrolleve. Peshën specifike më të lartë e ka DAPSHET/QSUT me 28.5 %, DRF Tiranë me 23 %, si dhe DRF Durrës, Elbasan dhe Shkodër me mbi 5 %. DRF e tjera variojnë nga 0.4-4.4 %, kundrejt totalit të rimbursimit. Përsa i përket realizimit të planit, nuk janë ushtruar kontrolle në subjektet farmaceutike nën juridiksionin e DRF Gjirokastër dhe Sarandë, të cilat së bashku kanë një peshë specifike të pa rëndësishme me 2.3 % kundrejt totalit.

Tabela nr.4.1.15 "Realizimi i kontrolleve në nivel DRF, si dhe pesha specifike e tyre kundrejt rimbursimit total"

Nr.	Drejtorite Rajonale te Fondit	Planifikimi	Realizimi	Pesha specifike në % kundrejt vlerës totale të rimbursimitmi
1	Berat			2.9%
2	Durres			5.5%
3	Diber			2.1%
4	Elbasan			5.8%
5	Fier			4.1%
6	Gjirokaster		**X**	1.4%
7	Korce			4.4%
8	Kukes			1%
9	Lezhe			3.5%
10	Shkoder			5.1%
11	Tirane			23%
12	DAPSHET (QSUT)	**X**		28.5%
13	Vlore			3.2%
14	Sarande		**X**	0.9%
15	Tropoje			0,4%
16	Pogradec			1.5%
17	Kamez Vore			3.5%
18	Lushnje			3.3%

Burimi i të dhënave, Drejtoria e Kontrollit në FSDKSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Mbi realizimin e objektivave të sektorit, sipas planit vjetor:

Sipas planit vjetor të miratuar me nr. 6880/3 prot., datë 31.12.2021, të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, Sektori i Kontrollit të Farmacive, ka përcaktuar objektivat për vitin 2022, të cilat janë:

- Mbyllja e dosjeve të kontrolleve të ushtruara nga sektori kontrollit të farmacive dhe plotësimi i regjistrit vjetor të dosjeve të kontrolleve të ushtruara gjatë 2021.
- Përgatitja e analizës vjetore të aktivitetit të sektorit të kontrollit të farmacive.
- Kontrolle të befasishme dhe me inventarizim të barnave tek disa subjekte farmaceutike me kontratë me Drejtoritë Rajonale të Fondit, për zbatimin e detyrimeve kontratuale.
- Kontrolle tematike mbi zbatimin e detyrimeve të përgjithshme dhe specifike të kontratave në fuqi, sipas problematikave nëse paraqiten.

Nga auditimi ka rezultuar:

- Nga SKF, ishin inventarizuar, dosjet e kontrollit të vitit 2021 dhe të përfunduarat e vitit 2022, brenda afateve të përcaktuara në planet e punës.
- Nga SKF, për vitin 2021 është përgatitur Analiza Vjetore e Sektorit e cila është pjesë integrale e Analizës së Drejtorisë se Kontrollit dhe Raportit të analizës institucionale;
- Gjithashtu, sipas planit vjetor për vitin 2022 janë planifikuar për kontroll 17 rajone, nga të cilat nuk janë kryer kontrolle në 2 rajone, DRF Gjirokastër dhe Sarandë, si dhe është kryer kontroll në QSUT, detajuar sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela nr.4.1.16 "Kontrollet planifikuara dhe realizuara nga SKF"

Nr	Farmaci/Agjenci		Numri i subjekteve të kontrolluara			Lloji i kontrollit	Sanksionet		Totali i rimbursimit te rajoneve ne raport me rimbursimin ne subjektet e kontrolluara	Totali i subjekteve me kontrate ne raport me numrin e subjekteve te kontrolluara
							Dëmi ekonomik	Kushte penale		
	DRF	Farmaci/ Agjenci Totali	Totali	Plotë	Tematik					

1	Durrës	90	**17**	13	4	Tematik+ inventar	404,184	92,000	37%	19%
2	Kamëz Vorë	38	**11**	7	4	Tematik+ inventar	347,549	-	44%	29%
3	Fier	56	**11**	7	4	Tematik+ inventar	72,305	-	47%	20%
4	Tiranë	282	**28**	24	4	Tematik+ inventar	1,082,159	38,700	38%	10%
5	Berat	39	**12**	8	4	Tematik+ inventar	137,771	10,000	39%	31%
6	Vlorë	54	**10**	5	5	Tematik+ inventar	65,837	-	24%	19%
7	Elbasan	82	**12**	8	4	Tematik+ inventar	236,970	-	25%	15%
8	Kukës	9	**5**	4	1	Tematik+ inventar	16,540	-	68%	56%
9	Tropojë	4	**2**	2	-	Tematik+ inventar	12,677	-	78%	50%
10	Pogradec	19	**4**	4	-	Tematik+ inventar	30,448	14,000	56%	21%
11	Dibër	23	**10**	5	5	Tematik+ inventar	142,589	-	52%	43%
12	Korçë	40	**11**	8	3	Tematik+ inventar	139,698	-	50%	28%
13	Shkodër	62	**12**	8	4	Tematik+ inventar	117,615	-	30%	19%
14	Lezhë	34	**10**	5	5	Tematik+ inventar	55,745	-	36%	29%
15	Lushnje	40	**10**	5	5	Tematik+ inventar	23,201	2,000	29%	25%
16	Gjirokastër	17	-	-	-	-	-	-	-	-
17	Sarandë	13	-	-	-	-	-	-	-	-
	TOTALI	**902**	**165**	**113**	**52**	-	**2,885,288**	**156,700**		

Burimi i të dhënave, Drejtoria e Kontrollit në FSDKSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Nga auditimi ka rezultuar se nga Drejtori i Kontrollit për çdo DRF janë hartuar memot përkatëse, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, ku është dhënë informacion mbi përzgjedhjen e subjekteve farmaceutike.

Kështu, janë hartuar 15 memo, ku janë përcaktuar subjektet e përzgjedhura, kriteret e përzgjedhjes, si dhe lista e farmacive dhe agjencive brenda juridiksionit të DRF me të dhënat përkatëse mbi numrin e pacientëve, numrin e recetave, vlerë rimbursimi, vlerë pacienti, rimbursim + vlerë pacienti, si dhe mesatarja mujore e rimbursimit.

Argumentimi i përzgjedhjes së subjekteve sipas memove përkatëse ka të bëjë me 4 elementë:

- Vlera mesatare e rimbursimit mujor;
- Luhatjet e rimbursimit;
- Pesha specifike që zë vlera e rimbursuar kundrejt totalit të rimbursimit në nivel rajonal;
- Intervali kohor i pa kontrolluar për subjektet farmaceutike.

Nga auditimi mbi zbatimin e kritereve të përzgjedhjes së përcaktuar në Rregulloren nr. 3/2014, Kapitulli I, për 15 DRF ka rezultuar se është mbuluar me kontroll nga 25-78 % e vlerës së rimbursuar. Nivelet më të larta i ka DRF Tropojë, Kukës, Pogradec për shkak të numrit të vogël të subjekteve farmaceutike.

Tabela nr.4.1.17 "Të dhëna mbi mbulimin me kontroll sipas numrit të subjekteve farmaceutike"

Nr.	**DRF**	**Numër subjektesh të kontraktuara nga FSDKSH**	**Numër subjektesh të kontrolluara**	**Pesha specifike e nurit të subjekteve të kontrolluara kundrejt totalit të rajonit në %**	**Pesha specifike e vlerës së rimbursimit të kontrolluar ndaj totalit të rajonit në %**
1	Durrës	76	10	13	37
2	Kamëz Vorë	38	7	18	44
3	Fier	56	7	13	47
4	Tiranë	297	24	8	38
5	Berat	39	8	21	42
6	Vlorë	54	5	9	25
7	Elbasan	82	8	10	25
8	Kukës	9	4	44	68
9	Tropojë	4	2	50	78
10	Pogradec	19	4	21	56
11	Dibër	23	5	22	52
12	Korçë	40	9	23	50
13	Shkodër	62	8	13	30

14	Lezhë	34	5	15	36
15	Lushnje	40	5	12	37

Burimi i të dhënave, Drejtoria e Kontrollit në FSDKSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Kryerja e kontrolleve në subjektet farmaceutike sipas viteve 2020, 2021 dhe 2022, me qëllim vlerësimin e përzgjedhjes së subjekteve farmaceutike për kontroll paraqitet në tabelat anekese pjesë e RPA. Nga Auditimi i praktikave të 15 DRF ka rezultuar se në përgjithësi përzgjedhja e tyre është bërë në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në rregullore me përjashtim të DRF Vlorë, Elbasan, Kukës dhe Korçë, ku u evidentuan deviacionet e përshkruara në gjetje.

Meqenëse, me Programin e auditimit nr.733/1 prot., datë 11.09.2023, KLSH është në auditim në FSDKSH për çështjen "Përputhshmëria me aktet ligjore dhe rregullatore në fuqi të veprimtarisë së organeve drejtuese të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, lidhur me rimbursimin e barnave: Këshilli Administrativ, Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtoritë përkatëse në FSDKSH" nuk është finalizuar me gjetje dhe evidentim përgjegjësie mbulimin me kontroll të qendrave shëndetësore, MPF, MS dhe DRF nga Drejtoria e Kontrollit.

Mbi auditimin e praktikave (dosjeve) të kontrollit:

Nga të dhënat e marra nga SKF si dhe të raportuar nga FSDKSH në Raportin e veprimtarisë për vitin 2022, nga ky sektor nga 872 farmaci të kontraktuara nga 15 DRF e kontrolluara, është konstatuar një dëm ekonomik në shumën 2,885 mijë lekë si dhe kushte penale në shumën 157 mijë lekë, të detajuara si më poshtë:

Tabela nr.4.1.18 "Të dhëna mbi rezultatet e kontrolleve të kryera"

Nr	**Farmaci/Agjenci**		**Numri i subjekteve të kontrolluara**			**Lloji i kontrollit**	**Sanksionet**		**Totali i rimbursimit te rajoneve ne raport me rimbursimin ne subjektet e kontrolluara**	**Totali i subjekteve me kontrate ne raport me numrin e subjekteve te kontrolluara**
	DRF	**Farmaci/ Agjensi Totali**	**Totali**	**Plotë**	**Tematik**		**Dëmi ekonomik Mijë lekë**	**Kushte penale Mijë lekë**		
1	Durrës	90	**17**	13	4	Tematik+ inventar	404,184	92,000	37%	19%
2	Kamëz Vorë	38	**11**	7	4	Tematik+ inventar	347,549	-	44%	29%
3	Fier	56	**11**	7	4	Tematik+ inventar	72,305	-	47%	20%
4	Tiranë	282	**28**	24	4	Tematik+ inventar	1,082,159	38,700	38%	10%
5	Berat	39	**12**	8	4	Tematik+ inventar	137,771	10,000	39%	31%
6	Vlorë	54	**10**	5	5	Tematik+ inventar	65,837	-	24%	19%
7	Elbasan	82	**12**	8	4	Tematik+ inventar	236,970	-	25%	15%
8	Kukës	9	**5**	4	1	Tematik+ inventar	16,540	-	68%	56%
9	Tropojë	4	**2**	2	-	Tematik+ inventar	12,677	-	78%	50%
10	Pogradec	19	**4**	4	-	Tematik+ inventar	30,448	14,000	56%	21%
11	Dibër	23	**10**	5	5	Tematik+ inventar	142,589	-	52%	43%
12	Korçë	40	**11**	8	3	Tematik+ inventar	139,698	-	50%	28%
13	Shkodër	62	**12**	8	4	Tematik+ inventar	117,615	-	30%	19%
14	Lezhë	34	**10**	5	5	Tematik+ inventar	55,745	-	36%	29%
15	Lushnje	40	**10**	5	5	Tematik+ inventar	23,201	2,000	29%	25%
16	**Totali 2022**	**872**	**165**	**113**	**52**		**2,885,288**	**156,700**		
17	**Totali 2021**	**764**	**190**				**3,200,556**	**54,000**		
18	**Diferenca 2022/2021**						**(315,268)**	**102,700**		

Burimi i të dhënave, Drejtoria e Kontrollit në FSDKSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Sa më sipër, në krahasim më vitin 2021, kemi një rënie të numrit të subjekteve të kontrolluara si dhe të vlerës së dëmit ekonomik të konstatuar me 315 mijë lekë.

Nga Grupi i auditimit u përzgjodhën për auditim procedurat e ndjekura në kontrollin e 4 DRF, si dhe nga 1 praktikë kontrolli farmacish për secilën DRF Fier, Vlorë, Shkodër dhe 2 praktika të DRF Tiranë.

Tabela nr.4.1.19 "Dosjet e kontrollit të subjekteve farmaceutike të audituara"

Nr.	DRF	Subjekti i kontrolluar
I	Fier	Farmaci "V./E. S."
II	Tiranë	
1		Farmaci "S. P. 2"
2		Farmaci "N."
III	Shkodër	Farmaci "B."
IV	Vlorë	Framaci "F."

Burimi i të dhënave, Drejtoria e Kontrollit në FSDKSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Kontroll i ushtruar në DRF Fier.

Nga SKF, rezulton se kryerja e kontrolleve organizohet në nivel rajonal, ku bashkëngjitur programit të kontrollit është dhe lista e farmacive që do të kontrollohen në DRF, pas përzgjedhjes së tyre referuar kritereve dhe argumenteve të përshkruara në Memo nr. 1352, datë 03.03.2022 "Informacion mbi përzgjedhjen e farmacive". Shkresa "Lista e farmacive të përcaktuara për kontroll" me nr. 1352/1 prot., datë 03.03.2022 është nënshkruar nga DP. Gjithashtu, DRF ka drejtuar shkresën nr. 281/1, prot., Fier, datë 03.03.2022 ku i kërkohet informacion mbi subjektet që do të kontrollohen. Informacioni është kthyer me shkresën nr. 281/3, datë 07.03.2022.

Kontrolli i farmacive në DRF Fier është kryer në zbatim të Programit nr. 1352/2, datë 03.03.2022. Pjesë e dosjes është dhe shkresa nr. 1352/3, datë 18.03.2022 "Informacion mbi kontrollin e ushtruar në farmacitë DRF Fier"; Raporti i kontrollit nr. 1352/4, datë 18.03.2022; Vendimi i DP nr. 1352/5, datë 18.03.2022, si dhe Formulari i kontrollit të cilësisë.

Procedurat e ndjekura dhe dokumentacioni përkatës janë në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Rregullores nr. 3/2014.

Kontroll i ushtruar në DRF Shkodër:.

Nga SKF, rezulton se kryerja e kontrolleve organizohet në nivel rajonal, ku bashkëngjitur programit të kontrollit është dhe lista e farmacive që do të kontrollohen në DRF, pas përzgjedhjes së tyre referuar kritereve dhe argumenteve të përshkruara në Memo nr. 6488, datë 02.11.2022 "Informacion mbi përzgjedhjen e farmacive". Shkresa "Lista e farmacive të përcaktuara për kontroll" me nr. 6488/1 prot., datë 02.11.2022 është nënshkruar nga DP. Gjithashtu DRF ka drejtuar shkresën nr. 1195/1, prot., Shkodër, datë 03.11.2022 ku i kërkohet informacion mbi subjektet që do të kontrollohen. Informacioni është kthyer me shkresën nr. 1195/2, datë 07.11.2022.

Kontrolli i farmacive në DRF Shkodër është kryer në zbatim të Programit nr. 6488/2, datë 03.03.2022. Pjesë e dosjes është dhe shkresa nr. 6488/4, datë 25.11.2022 "Informacion mbi kontrollin e ushtruar në farmacitë DRF Shkodër"; Raporti i kontrollit nr. 6488/5, datë 25.11.2022; Vendimi i DP nr. 6488/6 prot., datë 25.11.2022, si dhe Formulari i vlerësimit të cilësisë së kontrollit.

Procedurat e ndjekura dhe dokumentacioni përkatës janë në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Rregullores nr. 3/2014.

Në lidhje me respektimin e afateve ka rezultuar se kontrolli në terren ka përfunduar brenda afatit të caktuar në program Kontrolli 11.11.2022.

Kontroll i ushtruar në DRF Tiranë:

Nga SKF, rezulton se kryerja e kontrolleve organizohet në nivel rajonal, ku bashkëngjitur programit të kontrollit është dhe lista e farmacive që do të kontrollohen në DRF, pas përzgjedhjes së tyre referuar kritereve dhe argumenteve të përshkruara në Memo nr. 1925, datë

05.04.2022 “Informacion mbi përzgjedhjen e farmacive”. Shkresa “Lista e farmacive të përcaktuara për kontroll” me nr. 1925/1 prot., datë 05.04.2022 është nënshkruar nga DP. Gjithashtu DRF ka drejtuar shkresën 475/1, datë 06.04.2022; nr. 475/2, datë 11.04.2022; nr. 475/5, datë 21.04.2022; 475/7, datë 28.04.2022 prot., Tiranë, ku i kërkohet informacion mbi subjektet që do të kontrollohen. Informacioni është kthyer me shkresat nr. 475/3, datë 11.04.2022; nr. 475/4, datë 11.04.2022; nr. 475/6, datë 22.04.2022nr. 475/8, datë 29.04.2022. Kontrolli i farmacive në DRF Tiranë është kryer në zbatim të Programit nr. 1925/2, datë 05.04.2022. Pjesë e dosjes është dhe shkresa nr. 1925/4, datë 13.05.2022 “Informacion mbi kontrollin e ushtruar në farmacitë DRF Tiranë”; Raporti i kontrollit nr. 1925/5, datë 12.05.2022; Vendimi i DP nr. 1925/6 prot., datë 12.05.2022, si dhe Formulari i vlerësimit të cilësisë së kontrollit.
Procedurat e ndjekura dhe dokumentacioni përkatës janë në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Rregullores nr. 3/2014.
Kontroll i ushtruar në DRF Vlorë:
Nga SKF, rezulton se kryerja e kontrolleve organizohet në nivel rajonal, ku bashkëngjitur programit të kontrollit është dhe lista e farmacive që do të kontrollohen në DRF, pas përzgjedhjes së tyre referuar kritereve dhe argumenteve të përshkruara në Memo nr. 3829, datë 30.05.2022 “Informacion mbi përzgjedhjen e farmacive”. Shkresa “Lista e farmacive të përcaktuara për kontroll” me nr. 3829/1 prot., datë 30.05.2022 është nënshkruar nga DP. Gjithashtu nga DRF ka drejtuar shkresën nr. 577/1, prot., Vlorë, datë 31.05.2022 ku i kërkohet informacion mbi subjektet që do të kontrollohen. Informacioni është kthyer me shkresën nr. 577/2, datë 07.11.2022.
Kontrolli i farmacive në DRF Vlorë është kryer në zbatim të Programit nr. 3829/2, datë 30.05.2022. Pjesë e dosjes është dhe shkresa nr. 3829/5, datë 17.06.2022 “Informacion mbi kontrollin e ushtruar në farmacitë DRF Vlorë”; Raporti i kontrollit nr. 3829/7, datë 17.06.2022; Vendimi i DP nr. 3829/6 prot., datë 17.06.2022, si dhe Formulari i vlerësimit të cilësisë së kontrollit.
Procedurat e ndjekura dhe dokumentacioni përkatës janë në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Rregullores nr. 3/2014.

Mbi shqyrtimin e dosjeve të kontrollit të farmacive:
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të kontrollit në 5 farmacitë e listuara në tabelën nr.19 ka rezultuar se ndjekja e procedurave të kontrollit dhe plotësimi i dokumentacionit është bërë në përputhje me kërkesat e rregullores.
Nga ana e Grupit të kontrollit është mbajtur i gjithë dokumentacioni i kërkuar si:
- Program Kontrolli;
- Urdhër Kontrolli, ku është përcaktuar afati;
- Deklarata e konfliktit të interesit;
- Lista e medikamenteve që do të inventarizohen;
- PV mbi zbatimin e detyrimeve kontraktuale; mbi gjendjen fizike, në datën e fillimit të kontrollit; mbi dalje recetash, gjendje ne farmaci në momentin e kontrollit; mbi nxjerrjen e rezultatit; mbi marrjen në dorëzim të dokumentacionit;
- Konsumi i barnave;
- Regjistër i fletëhyrjeve të farmacisë/fletëdalje depo farmaceutike;
- Inventarët e farmacisë të depozituar në DRF;
- Akt akordimet (fletë-inventarizimi);
- Përmbledhëse e mangësive të evidentuara në zbatimin e procedurave të kontrollit, referuar Rregullores nr. 3/2014.

Analiza e veprimtarisë për Sektorin e Kontrollit të Depove farmaceutike.

Sektori i Kontrollit të Depove Farmaceutike, kontrollon përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, në zbatim të skemës së Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit shëndetësor nga Depot Importuese dhe Distributore të barnave, duke u bazuar në planin mujor të DKPF si dhe sa herë që paraqiten problematika të veçanta.

Veprimtaria e Sektorit të Kontrollit të Depove është pjesë e Planit të Punës miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm me nr. 6880/3, prot., datë 31.12.2021.

Bazuar në këtë plan për vitin 2022 nga SKD ka planifikuar për detyrat e mëposhtme.

Tabela nr. 4.1.20

Përshkrimi	Planifikimi	Realizimi
Mbyllja e dosjeve e kontrolleve të ushtruara nga Sektori i kontrollit të depove dhe plotësimi i regjistrit vjetor të dosjeve të kontrolleve të sektorit të ushtruara gjatë vitit 2021	✓	✓
Përgatitja e analizës vjetore të sektorit	✓	✓
Kontroll i plotë me inventarizim mbi zbatimin e detyrimeve kontraktuale me depon Importuese, në depot importuese me kontratë me FONDI-in	✓	✓
Kontroll i plotë me inventarizim mbi zbatimin e detyrimeve kontraktuale me depon Shpërndarëse, në depot Shpërndarëse me kontratë me Drejtoritë Rajonale të Fondit	✓	✓
Kontroll tematik mbi zbatimin e detyrimeve kontraktuale me depot farmaceutike me kontratë me Fondin dhe Drejtoritë Rajonale të Fondit	✓	✓
Kontrolle mbi qarkullimin e disa barnave të reja, barnave të shtrenjta dhe barnave me rimbursim të lartë	✓	✓
Shqyrtim i ankesave, observacioneve dhe vërejtjeve të bëra nga subjekte të kontrolluara	✓	✓
Detyra të tjera të ngarkuara nga Drejtori i Drejtorisë dhe Drejtori i Përgjithshëm	✓	✓

Burimi i të dhënave, Drejtoria e Kontrollit në FSDKSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Nga auditimi u konstatua se plani i kontrollit, konsistonte në përcaktimin e detyrave funksionale të sektorit dhe nuk ka të përfshirë planifikimin konkret të subjekteve për kontroll. Nga ana e grupit të auditimit u auditua realizimi i detyrave të përcaktuara në Planin vjetor, ku rezultoi se janë realizuar detyrat e përcaktuara. Gjithashtu, u analizua mënyra e përzgjedhjes së subjekteve për kontroll, kriteret e riskut, hartimin dhe miratimin e planit vjetor të sektorit, si dhe zbatimin i tij.

Meqenëse, me Programin e auditimit nr.733/1 prot., datë 11.09.2023, KLSH është në auditim në FSDKSH për çështjen "Përputhshmëria me aktet ligjore dhe rregullatore në fuqi të veprimtarisë së organeve drejtuese të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, lidhur me rimbursimin e barnave: Këshilli Administrativ, Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtoritë përkatëse në FSDKSH" nuk është finalizuar me gjetje dhe evidentim përgjegjësie mbulimin me kontroll të farmacive dhe depove farmaceutike nga Drejtoria e Kontrollit.

Mbi realizimin e kontrolleve:

SKD gjatë vitit 2022, ka kryer kontrolle për disponibilitet të barnave të listës së rimbursueshme në 3 Depo farmaceutike, kontroll me inventar në 10 Depo Farmaceutike Importuese dhe në 3 farmacitë e spitali. Në 16 kontrollet e kryera për vitin 2022, nga SKD, në janë dhënë masat e mëposhtme, të cilat ndahen në dëm ekonomik, gjoba dhe kushte penale, të detajuara sipas subjekteve në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 4.1.21 "Të dhëna mbi kontrollet"

Importues farmacetutik dhe farmaci spitali	Urdhra kontrolli	Lloji i kontrollit	Sanksionet		
			Dëm ekonomik	Kushte Penale	Total (Dëm+K.P+Gj)
1	Nr. 760/4 (35) prot.dt. 03.02.2022	Kontroll tematik mbi disponibilietin	-		-
2	Nr. 760/2 (33) prot.dt. 03.02.2022	Kontroll tematik mbi disponibilietin	-	1,000,000	1,000,000
3	Nr. 3220 (136) prot.dt. 26.04.2022	Kontroll tematik mbi disponibilietin	-	1,500,000	1,500,000
4	Nr.3186/3 (174) prot.dt. 26.05.2022	Kontroll I plote me inventar	40,034,764	200,000	40,234,764
5	Nr. 5808/1 prot. datë 22.09.2022	Kontroll I plote me inventar	-	-	-
6	Nr. 6155/1 prot. datë 12.10.2022	Kontroll I plote me inventar	-	-	-
7	Nr. 6156/1 prot. datë 12.10.2022	Kontroll I plote me inventar	-	-	-
8	Nr.6714/1 (378) prot.dt. 15.11.2022	Kontroll I plote me inventar	-	-	-
9	Nr.6713/1 (377) prot.dt. 15.11.2022	Kontroll I plote me inventar	-	401,023	401,023
10	Nr.6715/1 (379) prot.dt. 15.11.2022	Kontroll I plote me inventar	-	-	-
11	Nr.7063 (412) prot.dt. 07.12.2022	Kontroll I plote me inventar	-	-	-
12	Nr.7062 (411) prot.dt. 07.12.2022	Kontroll I plote me inventar	-	-	-
13	Nr. 7348/1 (435) prot.dt. 21.12.2022	Kontroll I plote me inventar	-	-	-
14	Nr. 7349/1 (436) prot.dt. 21.12.2022	Kontroll I plote me inventar	-	-	-
15	Nr. 7350 (436) prot.dt. 21.12.2022	Kontroll I plote me inventar	-	18,986	18,986
16	Nr. 6156/1(324) prot. datë 12.12.2022	Kontroll I plote me inventar	-	-	-
	Totali		**40,034,764**	**3,120,009**	**43,154,773**

Burimi i të dhënave, Drejtoria e Kontrollit në FSDKSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Problematikat Kryesore, të evidentuara nga kontrollet e kryera konsistojnë në:

- Mos deklarimin e saktë të të dhënave në DIAS e cila në bazë të kontratës me Depot neni 16, pika 4 i cili citon: "Kur nga kontrolli rezulton se Importuesi ka dërguar në Fond informacion jo të saktë, ai paguan kusht penal prej 200,000 lekë", evidentuar të M.F.
- Diferencat në (+) gjatë procesit të inventarizimit për periudhën e përcaktuar. Në bazë të kontratës me neni 16 "Kusht Penal", pika 1 që shprehet: ***"****Kur nga verifikimi i gjendjes fizike të barnave të rimbursueshme tek Importuesi rezultojnë diferenca në plus të pajustifikuara (gjendja fizike është më e madhe se gjendja kontabël), Importuesi paguan kusht penal të barabartë me dyfishin e tepricës së konstatuar". Konstatuar te C. Ph. ne shumën 401,023 lekë.*
- Nga kontrollet për disponibilitetin e barnave rezultuan mangësi të barnave ne treg, evidentuar te D. Ph.

Baza ligjore është e referuar sipas mangësive të konstatuara dhe penalitete e vendosura ishin në përputhje me kërkesat ligjore.

Nga krahasimi i kontrolleve të kryera në vitin 2022 dhe rezultateve të tyre në krahasim me vitin 2021, rezultojnë me tregues në rritje përsa i përket numrit të kontrolleve, llojit të kontrolleve të plota të kryera në depo farmaceutike dhe nivelit të masave të ndërmarra.

Tabela nr.4.1.22 "Kontrollet e kryera në vitin 2021-2022*"*

Viti	Depo	Subjekte te kontrolluara	Lloji i kontrollit	SANKSIONET			
				Dëmi ekonomik	Kushte penale	Gjoba	Zgjidhje kontrate
2022	Depo	16	1 farmaci e QSUT, 2 farmaci te spitaleve Rajonale dhe 3 depo me Disponibilitet,10 depo me inventar	40,034,764	3,120,009	-	-

2021	Depo	29	1 farmaci e QSUT, 12 farmaci te spitaleve Rajonale dhe 16 depo me Disponibilitet	41,731	5,000,000	-	-

Burimi i të dhënave, Drejtoria e Kontrollit në FSDKSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Nga Sektori Kontrollit të Depove në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021, janë kryer 13 kontrolle më shumë, si dhe niveli i gjetjeve "Dëm ekonomik", rezulton në shumën 38,107 mijë lekë më shumë.

Nga Grupi i auditimit u përzgjodhën për auditim të procedurave të ndjekura në zbatim Rregullores nr. 3, datë 22.10.2014, miratuar me VKA nr. 101, datë 22.10.2014, pesë depo farmaceutike dhe 1 depo spitali, sipas të dhënave të tabelës ku janë cilësuar grupet e kontrollit dhe afati i kontrollit të kryer në subjekt (depo farmaceutike), referuar afatit të përcaktuar në programin e kontrollit, ose urdhrin e kontrollit.

Tabela nr.4.1.23 "Të dhëna mbi kontrollet e audituara"

Nr.	Depot farmaceutike	Afati	Realizimi
1	I. (I plotë me inventarizim)	30.12.2022	30.12.2022
1/1	I. (Diponibilitet barnash)		
2	I. (I plotë me inventarizim)	17.10.2022	17.10.2022
3	D. Ph. (Disponibilitet barnash)	07.02.2022	07.02.2022
3/1	D. Ph.a (Disponibilitet barnash)	29.04.2022	27.04.2022
3/2	D. Ph. (Iplotë me inventarizim)	25.11.2022	25.11.2022
4	C. Ph. (I plotë me inventarizim)	25.11.2022	25.11.2022
5	R. F. (I plotë me inventarizim)	30.12.2022	30.12.2022
6	Spitali Durrës (I plotë me inventarizim)	30.12.2022	30.12.2022
	Total		

Burimi i të dhënave, Drejtoria e Kontrollit në FSDKSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Dokumentacioni i dosjeve të kontrollit të plotë dhe inventarizimit të audituara paraqitet më poshtë:

- Memo "Informacion mbi përzgjedhjen e depos";
- Programi i Kontrollit, ku është përcaktuar, periudha, afati, drejtimet e kontrollit, etj.;
- Urdhër Kontrolli, ku është përcaktuar Grupi i kontrollit;
- Deklarata të konfliktit të interesit;
- Të dhëna nga DIAS;
- Urdhër kontrolli;
- Kërkesë për dokumentacion dhe kthim përgjigje;
- Procesverbale, të mbajtura sipas çështjeve të trajtuara në zbatim të Programit të Kontrollit;
- Akt rakordimi përfundimtar (Fletë inventarizimi);
- Memo "Informacion për kontrollin";
- Raport Kontrolli;
- Vendim i DP;
- Vlerësim i cilësisë së kontrollit;
- Evidenca e kontrollit;
- Dokumentacion mbi subjektet;

Dokumentacioni i dosjeve të kontrollit mbi disponibilitetin e barnave, të audituara paraqitet më poshtë:

- Urdhër kontrolli, ku është përcaktuar objekti i kontrollit dhe Grupi i kontrollit;
- Deklarata të konfliktit të interesit;

- Informacion nga Drejtoria e Rimbursimit dhe DIAS, mbi disponibilitetin e barnave;
- Dokumentacion mbi subjektin;
- Procesverbale;
- Informacion mbi kontrollin e ushtruar;
- Vendim i DP
- Raport kontrolli;
- Evidenca e kontrollit;
- Vlerësimi i cilësisë së Kontrollit.

Meqenëse, me Programin e auditimit nr.733/1 prot., datë 11.09.2023, KLSH është në auditim në FSDKSH për çështjen "Përputhshmëria me aktet ligjore dhe rregullatore në fuqi të veprimtarisë së organeve drejtuese të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, lidhur me rimbursimin e barnave: Këshilli Administrativ, Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtoritë përkatëse në FSDKSH" nuk është finalizuar me gjetje konkluzione dhe evidentim përgjegjësie veprimtaria e Drejtorisë së Kontrollit në këtë drejtim.

Sektori i Kontrollit Spitalor:
Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit të Kontrollit Spitalor (SKS) janë përcaktuar në Rregulloren për Organizimin, Funksionimin dhe Përshkrimin e Punës së Fondit, Kreu XI "Drejtoria e Kontrollit", sipas së cilës SKS realizon kontrollet në spitalet me kontratë me FSDKSH.
Veprimtaria e kontrolluese zhvillohet sipas Rregullores nr. 3/2014, Kapitulli IV "Për kontrollin e spitaleve që financohen nga skema e fondit të sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor". SKS mbulon me kontroll, spitalet e kontraktuara me Drejtoritë Rajonale të Fondit dhe Drejtorinë Shërbimeve Spitalore Universitare dhe Kontrollit Spitalor.
Veprimtaria e sektorit mbështetet në Planin vjetor të kontrollit, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm me shkresën nr. 6880/3, datë 31.12.2021, ku përcaktohet emërtimi i spitaleve që kontrollohen sipas muajve dhe llojet e kontrolleve të plota ose tematike.
Kontrollet e plota ushtrohen jo më pak se 1 (një) herë në vit në spitalet universitare dhe spitalet rajonale, dhe jo më pak se 1 herë në 2 (dy) vjet në spitalet bashkiakë si dhe përfshin të gjithë aktivitetin spitalor për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, ligjore dhe nën-ligjore.
Kontrolli tematik, realizohet në zbatim të çdo pike të detyrimit kontraktual si dhe zbatimin e detyrave dhe rekomandimeve të lëna nga kontrollet e mëparshme.

Bazuar në planin vjetor të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, për vitin 2022 nga SKS janë realizuar kontrollet në Spitalet si më poshtë vijon:

Tabela nr.4.1.24 "Periudha dhe afatet e realizimit të kontrolleve"

Nr.	Spitali	Periudha	Afati	Planifikuar	Realizimi
1	SU-Koco Gliozheni	1Nëntor 2020-31 Dhjetor 2021	27.01.2022-10.02.2022	Planifikuar	Realizuar
2	SB- Mat	14 Janar 2017-31 Dhjetor 2021	14.02.2022-25.02.2022	Planifikuar	Realizuar
3	SB- Mallakastër	1 Qershor 2016-31 Dhjetor 2021	14.02.2022-25.02.2022	Planifikuar	Realizuar
3	SB-Lushnjë	1Janar 2020-28 Shkurt 2022	24.03.2022-15.04.2022	Planifikuar	Realizuar
4	SU-Traumës	1Janar 2020-28 Shkurt 2022	23.03.2022-22.04.2022	Planifikuar	Realizuar
5	SR- Fier	1Janar 2020-31 Mars 2022	26.04.2022-20.05.2022	Planifikuar	Realizuar
6	SB- Librazhd	Dhjetor 2019-Mars 2022	26.04.2022-20.05.2022	Planifikuar	Realizuar

7	SR- Vlorë	1 Tetor 2020-30 Prill 2022	24.05.2022-17.06.2022	Planifikuar	Realizuar
8	SB- Pogradec	1Qershor 2020-31 Maj 2022	20.06.2022-08.07.2022	Planifikuar	Realizuar
9	SB- Gramsh	1Korrik 2017-31 Maj 2022	20.06.2022-08.07.2022	Planifikuar	Realizuar
10	SB- Pukë	1Korrik 2020-31 Korrik 2022	07.09.2022-23.09.2022	Planifikuar	Realizuar
11	SB- Tropojë	1Korrik 2020-31 Korrik 2022	07.09.2022-23.09.2022	Planifikuar	Realizuar
12	SB- Krujë	1 Janar 2021-31 Gusht 2022	05.10.2022-19.10.2022	*Pa planifikuar*	Realizuar
13	SB- Kavajë	1 Janar 2021-31 Gusht 2022	05.10.2022-19.10.2022	*Pa planifikuar*	Realizuar
14	SB- Has	1 Prill 2017-31 Gusht 2022	24.10.2022-16.11.2022	*Pa planifikuar*	Realizuar
15	SR-.Korcë	1 Shtator 2020-31 Gusht 2022	24.10.2022-16.11.2022	Planifikuar	Realizuar
16	SR-Elbasan	01 Maj 2021-30 Shtator 2022	21.11.2022-06.12.2022	*Pa planifikuar*	Realizuar
17	SR- Berat	01 Janar 2021-30 Tetor 2022	12.12.2022-23.12.2022	Planifikuar	Realizuar
18	SR- Lezhe	1 Janar 2021-30 Tetor 2022	12.12.2022-23.12.2022	Planifikuar	Realizuar
19	SU-Shefqet Ndroqi	1 Janar 2018-30 Nentor 2022	28.12.2022-25.01.2023	Planifikuar	Realizuar
20	SR-Berat (Lab)	14 Qershor 2021-31 Janar 2022	03.03.2022-11.03.2022	*Pa planifikuar*	Realizuar
21	SR- Lezhe (Lab)	21 Qershor 2021-31 Janar 2022	03.03.2022-11.03.2022	Planifikuar	Realizuar
22	SR- Shkodër (Lab)	02 Gusht 2019-31 Janar 2022	03.03.2022-11.03.2022	Planifikuar	Realizuar
23	SU- Sh. Ndroqi (Lab)	25 Mars 2021-31 Janar 2022	03.03.2022-11.03.2022	Planifikuar	Realizuar

Burimi i të dhënave, Drejtoria e Kontrollit në FSDKSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Referuar Planit vjetor, për Sektorin e Kontrollit Spitalor, ka rezultuar se janë planifikuar për kontroll 16 spitale, nga të cilat 3 universitare, 5 rajonale dhe 8 bashkiake, si dhe janë evaduar 21 kontrolle në spitale nga të cilat 3 SU; 7 SR dhe 11 SB, si dhe kontrolli i laboratorëve në 4 spitale. *(Të detajuara në Tabelën anekse nr.4.1).*

Sipas Rregullores pjesë e planit vjetor duhet të ishin domosdoshmërisht 16 spitalet Universitare dhe Rajonale, si dhe 13 spitale bashkiake referuar të dhënave të mëposhtme, ku cilësohet periudha e kontrollit për secilin spital.

Tabela nr. 4.1.25 "Kontrolle të kryera 2020-2022"

Nr.	**Subjekti i Kontrollit**	**Kontrolle të kryera**		
I	**Universitare (Çdo vit)**	**2020**	**2021**	**2022**
1	SUOGJ "Koço Gliozheni"	-	-	√
2	Spitali Universitar Trauma	-	-	√
3	Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi"	-	-	√
4	Spitali Universitar "Nënë Tereza "	-	√	-
5	SUOGJ "Geraldinë"	√	√	-
II	**Rajonale (Çdo vit)**			
1	Berat	-	√	√
2	Dibër	-	√	-

3	Shkodër	-	√	-
4	Lezhë	-	√	√
6	Fier	√	-	√
7	Elbasan	-	√	√
8	Korçë	√	-	√
9	Gjirokastër	-	√	-
10	Kukës	-	√	-
11	Vlorë	√	-	√
III	**Bashkiake (Çdo dy vjet)**			
	Bulqizë	-	√	-
	Delvinë	-	-	-
	Devoll	-	√	-
	Gramsh	-	-	√
	Has	-	-	√
	Kavajë	-	√	√
	Kolonjë	-	√	-
	Krujë	-	√	√
	Kuçovë	-	√	-
	Kurbin	-	-	-
	Librazhd	√	-	√
	Lushnjë	√	-	√
	Mallakastër	-	-	√
	Malësi e Madhe	-	-	-
	Mat	-	-	√
	Mirditë	-	√	-
	Peqin	-	√	-
	Përmet	-	√	-
	Pogradec	√	-	√
	Pukë	√	-	√
	Sarandë	-	-	-
	Skrapar	-	√	-
	Tepelenë	-	√	-
	Tropojë	√	-	√
IV	**Spitale jopublike**			
1	A Hospital nr. 1 Tirana	-	√	-
2	A Hospital nr.2 Tirana	-	√	-
3	A Hospital nr. 3 Tirana	-	√	-
4	Hospital Hygea	-	√	-
5	A Hospital-Fier	-	-	-
6	A Hospital-Durrës	√	-	-
7	AKS Berat	√	-	-

Burimi i të dhënave, Drejtoria e Kontrollit në FSDKSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme, evidentohet fakti se nga SKS nuk janë mbuluar me auditim gjithë spitalet sipas frekuencës referuar llojit të tyre, sipas përcaktimeve ne Rregulloren n. 3/2014.

Kështu nuk është kryer kontroll në dy SU; në 4 SR, të cilat duhet të kontrollohen periodikisht çdo vit, si dhe nuk janë kryer kontrolle 1 herë në dy vjet në SB si, Gramsh, Has, Mallakastër, Mat dhe rezultojnë pa kontrolluar për një periudhë tre vjeçare SB si, Delvinë, Kurbin, Malësi e Madhe, dhe Sarandë, në kundërshtim me kërkesat e Rregullores nr. 3/2014, Kapitulli IV.

Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e kontrolleve referuar Planit vjetor, por dhe përzgjedhjes së tyre sipas përcaktimeve të Rregullores nr. 3/2014 ka rezultuar se nga SKS, planifikimi vjetor nuk është kryer sipas kërkesave të Rregullores nr. 3/2014, ku është cilësuar se Spitalet Universitare dhe Spitalet Rajonale, duhet të kontrollohen çdo vit, çka do të thotë se

pjesë e planit vjetor duhet të ishin edhe spitalet SU "Nënë Tereza", si dhe SR Dibër, Shkodër, Durrës, Gjirokastër, Kukës dhe Elbasan.
Gjithashtu, në planin vjetor, nuk ishin planifikuar, por që janë realizuar kontrollet në spitalet bashkiake Has, Krujë, Kavajë, si dhe Laboratorët (Berat, Shkodër, Lezhë dhe SU "Shefqet Ndroqi"), ku me miratim të Drejtorit të Përgjithshëm, është kryer vetëm ndryshimi "hequr nga plani i kontrollit Spitali Sarandë dhe është shtuar Spitali Kavajë dhe Krujë". Ndryshimet në planin e kontrolleve të pa miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm, janë në kundërshtim me kërkesat e rregullores.

Nga kontrollet e kryera në sistemin spitalor, nga SKS janë evidentuar shkelje dhe mangësi për të cilat janë marrë masa organizative, disiplinore, administrative dhe masa shpërblim dëmi e kushte penale, sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr.4.1.26 "Masat e propozuara nga SKS"

Nr.	Spitalet	Masa organizative	Masat disiplinore	Masat administrative (gjoba)	Masat detyrim për shpërblim demi (Vlerë)	Kushte penale	Ndërprerje kontrate
1	Spitali Kukës	16	-	-	104,784	60,000	-
2	Spitali Shkodër	18	-	-	356,069	40,000	-
3	SUOGJ "Koco G.	6	-	-	-	-	-
4	Spitali Mallak.	4	-	-	-	-	-
5	Spitali Mat	9	-	1 pagë	-	-	-
6	SUTrauma	13	-	-	517,038.5	-	-
7	Spitali Lushnje	14	-	-	-	100,000	-
8	Spitali Fier	15	-	1 pagë	-	80,000	-
9	Spitali Librazhd	6	-	-	-	-	-
10	Spitali Vlorë	19	15	1 pagë	12,000	130,000	-
11	Spitali Gramsh	9	-	-	-	-	-
12	Spitali Pogradec	3	-	-	310,238	-	-
13	Spitali Pukë	4	-	-	-	-	-
14	Spitali Tropojë	14	-	-	-	-	-
15	Spitali Krujë	20	-	-	-	-	-
16	Spitali Kavajë	6	-	-	34,770	65,000	-
17	Spitali Korçë	14				115000	-
18	Spitali Has	4	-	-	-	20,000	-
19	Spitali Elbasan	9	-	-	-	-	-
20	Spitali Berat	11	-	-	-	-	-
21	Spitali Lezhë	5	-	-	-	-	-
22	SU "Sh. Ndroqi"	Vazhdim	-	-	-	-	-
23	Lab. SR-Berat	6	-	-	-	-	-
24	Lab. SR-Lezhë	6	-	-	-	40000	-
25	Lab. SR-Shkodër	6	-	-	-	-	-
26	Lab. SU "Sh. N."	6	-	-	-	-	-
27	**Totali**	**243**	**15**	**3 paga**	**1,334,899**	**650,000**	**-**

Burimi i të dhënave, Drejtoria e Kontrollit në FSDKSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Referuar të dhënave të tabelës së mësipërme, nga 26 kontrollet, 2 prej tyre, kontrolli në Spitalin Kukës dhe Shkodër janë të mbartur nga viti 2021 dhe evaduar në vitin 2022, si dhe kontrolli në SU "Shefqet Ndroqi", është planifikuar dhe nisur në vitin 2022, por evadimi i tij është kryer në vitin 2023. Në total në vitin 2022 rezultojnë të evaduara 25 kontrolle, nga të cilat 21 spitale dhe 4 kontrolle tematikë "Laboratorët".
Në krahasim me vitin 2021, masat e rekomanduara paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.4.1.27 "Masat e propozuara nga SKS"

Nr.		2021	2022	Diferenca 2022/2021
1	Organizative (numër)	160	243	+44
2	Disiplinore (numër)	4	15	+11
3	Administrative (raste paga)	1	3	+2
4	Shpërblim dëmi (lekë)	2,076,091	1,334,899	-741,192
5	Kushte penale (lekë)	1,095,500	650,000	-600,500

Burimi i të dhënave, Drejtoria e Kontrollit në FSDKSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Nga Grupi i auditimit, u audituan me zgjedhje 3 dosje kontrolli të ushtruara nga SKS, nga 23 të kryera, në lidhje me zbatimin e procedurave të kontrollit të përcaktuara në Rregulloren nr. 3/2014, Kapitulli IV "Për kontrollin e spitaleve që financohen nga skema e fondit të sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor", **konkretisht:**

1. Spitali Universitar i Traumës;
2. Spitali Bashkiak Librazhd;
3. Spitali Rajonal Korçë.

Për tre spitalet e përzgjedhura u bë verifikimi i zbatimit të procedurave të kontrollit, të përcaktuara në Rregulloren nr. 3, datë 22.10.2014. Sipas kësaj rregullore dokumentacioni në lidhje me proceduat e kontrollit, pjesë e dosjes së kontrollit, duhet të përmbajë elementët si më poshtë:

- Njoftim për fillim kontrolli;
- Programi i kontrollit;
- Procesverbal i takimit fillestar;
- Ndarja e detyrave;
- Akt verifikimet;
- Procesverbal i takimit përmbyllës;
- Shkresa për dërgimin e Projekt Raportit të Kontrollit
- Projekt Raporti i kontrollit;
- Shkresa për dërgimin e raportit të kontrollit;
- Raporti Përfundimtar i Kontrollit;
- Vendimi;
- Vlerësimi i cilësisë;
- Deklaratat e konfliktit të interesit;
- Evidenca e Kontrollit;
- Informacion për Drejtorin e Drejtorisë;
- Observacione.

Nga verifikimi i tri dosjeve të përzgjedhura të kontrollit rezultoi se dokumentacioni, pjesë e dosjeve të kontrollit është i plotë dhe në përputhje me formatet e Dokumenteve të Unifikuara (DU), bashkëlidhur Rregullores nr.3/2014. Gjithashtu u bë verifikimi i dokumentacionit të dosjes, ku u konstatua se akt verifikimet, procesverbalet, Projekt raporti i Kontrollit dhe Raporti Përfundimtar i Kontrollit ishin në përputhje me drejtimet e kontrollit të përcaktuara në Programet e Kontrollit dhe dokumentacionet ishin të nënshkruara nga palët përkatëse.

Në lidhje me verifikimet për zbatueshmërinë dhe respektimin e afateve të përcaktuara në Rregulloren nr. 3/2014 rezultoi si më poshtë:

Spitali Universitar i Traumës

Periudha e kontrollit 01.01.2020-28.02.2022

Afati i kontrollit, i caktuar në Programin e Kontrollit nr.1746/1, datë 23.03.2022 është 23.03.2022-22.04.2022. Nga verifikimi rezultoi se Akt verifikimet dhe procesverbalet në subjekt janë dorëzuar brenda kësaj periudhe, të nënshkruara nga personat përgjegjës dhe të protokolluar në subjekt.

Projekt Raporti i Kontrollit është dërguar në subjekt me anë të shkresës së titullarit nr. 1746/3, datë 13.06.2022, ky afat është **në tejkalim me afatin të përcaktuar** në pikën 20 të Rregullores nr.3/2014, ku përcaktohet se: "*Projekt/raporti i dërgohet subjektit brenda 2 javëve pas përfundimit të kontrollit me një shkresë përcjellëse të Drejtorit të Drejtorisë"*.
Sa më sipër rezulton së dërgimi i Projekt Raportit të kontrolli është dërguar 5 javë me tejkalim afati. (data e fundit e dërgimit duhet të ishte 06.05.2022). Subjekti i kontrolluar ka dërguar një kopje të Projekt Raportit të firmosur me anë të shkresës nr.1290/2, datë 21.06.2022, pra brenda afatit të përcaktuar në pikën 21 të Rregullores nr.3/2014.
Raporti përfundimtar i kontrollit dhe Vendimi nr. 102, datë 29.07.2022 janë dërguar në subjekt me anë të shkresës përcjellëse nr. 1746/8, datë 29.07.2022, afat i cili është 38 ditë më vonë se afati i përcaktuar në pikën 23 të rregullores nr.3/2014 ku përcaktohet se: "*Raporti i kontrollit hartohet brenda **10 ditëve** nga data e kthimit te projekt/raportit nga subjekti i kontrolluar, nga përgjegjësi i grupit të kontrollit në bashkëpunim me grupin e kontrollit dhe nënshkruhet nga ata…".*
Spitali Bashkiak Librazhd
Periudha e kontrollit: Dhjetor 2019-Mars 2022.
Drejtimet e Kontrollit në këtë program, janë të përcaktuara sipas kërkesave të rregullores (Aneksi nr. "Drejtimet e Kontrollit) dhe janë të trajtuara në akt verifikimet, Projekt Raportin e Kontrollit dhe në Raportin Përfundimtar të Kontrollit.
Afati i kontrollit, i caktuar në Programin e Kontrollit nr.3187/1, datë 22.04.2022 është 26.04.2022-20.05.2022. Nga verifikimi rezultoi se akt verifikimet dhe procesverbalet në subjekt janë dorëzuar brenda kësaj periudhe, të nënshkruara nga personat përgjegjës dhe janë të protokolluara në subjekt.
Projekt Raporti i Kontrollit është dërguar në subjekt me anë të shkresës së titullarit nr. 3187/3 datë 27.06.2022, **3 javë me tejkalim afati**. (data e fundit e dërgimit duhet të ishte 03.06.2022).
Subjekti i kontrolluar ka dërguar një kopje të Projekt Raportit të firmosur me anë të shkresës nr.211/25, datë 01.07.2022, pra brenda afatit të përcaktuar në pikën 21 të Rregullores nr.3/2014.
Raporti përfundimtar i kontrollit dhe Vendimi nr. 101, datë 21.07.2022 janë dërguar në subjekt më anë të shkresës përcjellëse nr. 3187/5, datë 21.07.2022, afat i cili është 9 ditë më vonë se afati i përcaktuar në pikën 23 të rregullores nr.3/2014.
Spitali Rajonal Korçë
Periudha e kontrollit: 01.09.2020-31.08.2022
Drejtimet e Kontrollit në këtë program, janë të trajtuara në akt verifikimet, Projekt Raportin e Kontrollit dhe në Raportin Përfundimtar të Kontrollit.
Afati i kontrollit, i caktuar në Programin e Kontrollit nr.6350/1, datë 21.10.2022 është 24.10.2022-16.11.2022. Nga verifikimi rezultoi se akt verifikimet dhe procesverbalet në subjekt janë dorëzuar brenda kësaj periudhe, të nënshkruara nga personat përgjegjës dhe të protokolluar në subjekt.
Projekt Raporti i Kontrollit është dërguar në subjekt me anë të shkresës së titullarit nr. 6350/5 datë 30.12.2022, ky afat është në tejkalim **4 javë me tejkalim afati**. (data e fundit e dërgimit duhet të ishte 30.11.2022). Subjekti i kontrolluar ka dërguar një kopje të Projekt Raportit të firmosur me anë të shkresës nr.60, datë 12.01.2023, pra brenda afatit të përcaktuar në pikën 21 të Rregullores nr.3/2014.
Raporti përfundimtar i kontrollit dhe Vendimi nr. 18, datë 21.02.2023 janë dërguar në subjekt më anë të shkresës përcjellëse nr. 758, datë 21.02.2023 afat i cili është 29 ditë më vonë se afati i përcaktuar në pikën 23 të rregullores nr.3/2014.
Nga kontrollet e kryera mangësitë e konstatuara janë trajtuar në përputhje me bazën ligjore dhe rregullative.

Sa më sipër;

- Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e kontrolleve referuar Planit vjetor, por dhe përzgjedhjes së tyre sipas përcaktimeve të Rregullores nr. 3/2014 ka rezultuar se nga SKS, planifikimi vjetor nuk është kryer sipas kërkesave të Rregullores nr. 3/2014, ku është cilësuar se Spitalet Universitare dhe Spitalet Rajonale, duhet të kontrollohen çdo vit, çka do të thotë se pjesë e planit vjetor duhet të ishin edhe spitalet SU "Nënë Tereza", si dhe SR Dibër, Shkodër, Durrës, Gjirokastër, Kukës dhe Elbasan. Gjithashtu, në planin vjetor, nuk ishin planifikuar, por që janë realizuar kontrollet në spitalet bashkiake Has, Krujë, Kavajë, si dhe Laboratorët (Berat, Shkodër, Lezhë dhe SU "Shefqet Ndroqi"), ku me miratim të Drejtorit të Përgjithshëm, është kryer vetëm ndryshimi "hequr nga plani i kontrollit Spitali Sarandë dhe është shtuar Spitali Kavajë dhe Krujë".
- Ndryshimet në planin e kontrolleve të pa miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm, janë në kundërshtim me kërkesat e rregullores.
- Përsa i përket zbatimit të procedurave të kontrollit nga auditimi i dosjeve të kontrollit të tre spitaleve ka rezultuar se, projekt raportet e kontrollit dhe raportet përfundimtare, janë dërguar me vonesë, në kundërshtim me kërkesat e rregullores.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, mbi këtë drejtim auditimi, nuk janë paraqitur observacione.

Meqenëse, me Programin e auditimit nr.733/1 prot., datë 11.09.2023, KLSH është në auditim në FSDKSH për çështjen "Përputhshmëria me aktet ligjore dhe rregullatore në fuqi të veprimtarisë së organeve drejtuese të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, lidhur me rimbursimin e barnave, si Këshilli Administrativ, Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtoritë përkatëse në FSDKSH" nuk është finalizuar me gjetje dhe evidentim përgjegjësie mbulimin me kontroll të qendrave shëndetësore, MPF dhe MS DRF Vlorë nga Drejtoria e Kontrollit.

2.4.2.Vlerësimi i përputhshmërisë së aktivitetit të Drejtorisë së Rimbursimit në lidhje me zbatimin e skemës së sigurimit për hartimin e listës së barnave, hartimin e kontratave, etj.)

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion ka rezultuar:

Drejtoria e Rimbursimit, pranë Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (në vijim, Fondi) ka si mision të sajin përmirësimin dhe zhvillimin e skemës së sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor, lidhur me listën e barnave të rimbursuara, listën e pajisjeve mjekësore të rimbursuara si dhe marrëdhëniet kontraktuale me subjektet farmaceutike. Ajo përbëhet nga dy sektorë: Sektori i Monitorimit dhe Analizës së Rimbursimit dhe Sektori i Listës së Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. Në strukturën e miratuar të Fondit, kjo drejtori ka 10 punonjës dhe gjatë vitit 2022 ka pasur 1 pozicion vakant, konkretisht nuk ka qenë i plotësuar pozicioni *Përgjegjës Sektori*, në Sektorin e Monitorimit dhe Analizës së Rimbursimit. Struktura dhe pozicionet vakante, gjatë vitit 2022 paraqiten në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 4.2.1 "Struktura dhe vakancat e Drejtorisë së Rimbursimit gjatë 2022"

Pozicioni	Struktura 2022	Të punësuar gjatë 2022	Vakanca
Drejtor Drejtorie	1	1	-
Përgjegjës Sektori	2	1	1
Specialist	7	7	0
Totali	**10**	**9**	**1**

Burimi i të dhënave: FSDKSH, Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Pozicioni vakant, i paraqitur në tabelën më sipër është që prej që prej datës 03.11.2020.

Planifikimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Rimbursimit

Nga grupi i auditimit, u bë verifikimi i hartimit të planeve mujore dhe atij vjetor, ku përcaktohen detyrat që pritet të kryhen dhe për secilën paraqitet afati kohor i realizimit, veprimet për realizimin, personat përgjegjës, rezultatin e pritshëm dhe mënyrën e raportimit. Nga verifikimi i detyrave të përcaktuara në plane rezultoi se, ato janë në përputhje me detyrat e Drejtorisë së Rimbursimit të përcaktuara në Kreun V, të Rregullores nr. 2 "*Për organizimin, funksionimin dhe përshkrimet e punës për drejtorinë e përgjithshme të Fondit*", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr.277 datë 06.07.2020.

Planifikimi i shpenzimeve të rimbursimit për vitin 2022

Drejtoria e Rimbursimit, bazuar në rregulloren për funksionimin e Fondit ka detyrë të bashkëpunojë me Drejtorinë Ekonomike për hartimin e buxhetit dhe planit të shpenzimeve të rimbursimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore. Së bashku me DKPS, me anë të memos nr. 132/2, datë 26.01.2022 i është dërguar Drejtorisë Ekonomike detajimi i Buxhetit të rimbursimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore për vitin 2022, në vlerën 10,545 milionë lekë. Referuar rimbursimit të barnave një vit më parë dhe parashikimit vjetor të rritjes së sëmundshmërisë, me rreth 4.64%, [2]është bërë detajimi i buxhetit të rimbursimit sipas njësive shpenzuese në shumën **10,400 milionë lekë** ndërsa shuma 145 milionë lekë është mbajtur rezervë, kjo në zbatim të nënpikës 4 të pikës 15, të seksionit B, të Kreut III, të "*Rregullores Financiare të FSDKSH-së*", të ndryshuar me Vendimin e KA nr. 33, datë 24.07.2015, ku përcaktohet "*…drejtoritë e mësipërme brenda afateve të përcaktuara, dorëzojnë pranë Drejtorisë Ekonomike planin vjetor të rimbursimit, të detajuar për çdo njësi vartëse, brenda kufijve buxhetorë të miratuar, duke lënë një rezervë të mjaftueshme për ndryshueshmëri të situatave, apo rasteve emergjente gjatë vitit*". Detajimi i buxhetit për vitin 2022 paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr.4.2.2 "Shpërndarja e Buxhetit të rimbursimit për vitin 2022 në nivel DRF/DSHSU"

Në mijë lekë

DRF dhe Degët	Rimbursimi vjetor 2021	Rritje e pritshme nga sëmundshmëria	Rimbursimi 2022	Ndarja e Buxhetit për çdo DRF/Degë/ DSSHU	% e Shp të rimburs/totalit
Berat	314,491	14,592	329,083	287,000	3%
Dibër	241,011	11,183	252,194	228,000	2%
Durrës	622,309	28,875	651,184	567,000	5%
Elbasan	642,955	29,833	672,789	620,000	6%
Fier	453,047	21,021	474,069	420,000	4%
Gjirokastër	155,314	7,207	162,521	146,000	1%
Korçë	491,408	22,801	514,210	470,000	5%
Kukës	108,245	5,023	113,268	102,000	1%
Lezhë	393,290	18,249	411,539	360,000	3%
Shkodër	582,719	27,038	609,757	540,000	5%
Tiranë	2,646,167	122,782	2,768,949	2,510,000	24%
Vlorë	355,367	16,489	371,856	330,000	3%
Sarandë	101,788	4,723	106,511	90,000	1%
Tropojë	41,232	1,913	43,146	40,000	0%
Kamëz	392,826	18,227	411,053	360,000	3%
Lushnjë	402,961	18,697	421,658	350,000	3%
Pogradec	165,330	7,671	173,001	150,000	1%
DSHSU	2,950,546	136,905	3,087,451	2,830,000	27%
Totali	**11,061,006**	**513,231**	**11,574,237**	**10,400,000**	**100%**

Burimi i të dhënave: FSDKSH, Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Siç vihet re në tabelën më sipër, për vitin 2022 shuma e shpenzimeve të planifikuara nga DKPS dhe Drejtoria e Rimbursimit paraqitet në shumën 11,574,237 mijë lekë duke arsyetuar se

[2] Bazuar në analizat e rimbursimit dhe sëmundshmërisë, të përgatitura nga DKPS.

rimbursimit të vitit 2021 në masën 11,061,006 mijë lekë duhet t'i shtohet dhe rritja e pritshme nga sëmundshmëria në shumën 513,231 mijë lekë, sipas këtij arsyetimi në memo paraqitet dhe shënimi "*.... bazuar në trendin e shpenzimeve faktike të dy viteve të fundit, si dhe trendin e rritjes së sëmundshmërisë vjetore, buxheti i akorduar për shpenzimet e rimbursimit të barnave për vitin 2022, nuk është i mjaftueshëm për të përballuar nevojat reale të DRF/DSHSU".* Për të respektuar shumën e rimbursimit të miratuar me Ligjin e Buxhetit është bërë shpërndarja e shumës 10,400,000 mijë lekë, ku peshën specifike më të lartë të totalit të rimbursimit e zë DSHSU, me 27% të shpenzimeve totale të rimbursimit dhe DRF Tiranë, me 24% të shpenzimeve totale të rimbursimit. Ndërsa në lidhje me rimbursimin e pajisjeve mjekësore (fishat e diabetit), planifikimi i shpenzimeve të rimbursimit i është referuar studimit të Shërbimit të Endikronologjisë në QSUT, të dhjetorit të vitit 2017, mbi incidencën e diagnozës Diabet Mellitus, ku një pacient merr 4 fisha në ditë, ose 1,460 fisha në vit dhe numrit të pacientëve të rimbursuar për vitin 2021. Për vitin 2022 janë planifikuar 576 pacientë, që do të konsumojnë 840,960 fisha diabeti me një kosto totale 15,978,240 [3] lekë, buxheti i rimbursimit për pajisjet mjekësore i shpërndarë sipas DRF-ve paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.4.2.3 "Shpërndarja e Buxhetit të rimbursimit për pajisje mjekësore për vitin 2022 në nivel DRF/DSHSU"

DRF	Shpenzime për pajisje mjekësore(mijë lekë)
Berat	630
Dibër	300
Durrës	2,350
Elbasan	940
Fier	1,500
Gjirokastër	660
Korçë	690
Kukës	250
Lezhë	250
Shkodër	970
Vlorë	660
DSHSU	6,780
Totali	**15,980**

Burimi i të dhënave: FSDKSH, Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga tabela më sipër rezulton se, DSHSU është planifikuar të shpenzojë rreth 42% të fondit total të shpenzimeve të rimbursimit në lidhje me pajisjet mjekësore, kjo bazuar në numrin e pacientëve me diabet të një viti më parë, pas saj vjen DRF Durrës me afërsisht 15%, ndërsa DRF-të e tjera, janë planfikuar të kryejnë më pak shpenzime rimbursimi, ndaj totalit.

Me Aktin Normativ nr.17, datë 01.12.2022, buxheti për rimbursimin e medikamenteve është rritur me 800,000,000 lekë dhe Drejtoria Ekonomike me anë të memos nr.7505, datë 06.12.2022 i ka kërkuar DKPS dhe Drejtorisë së Rimbursimit detajimin e kësaj shume dhe të rezervës të pashpërndarë për rimbursimin e medikamenteve, në total 949,771,000 lekë si dhe të rezervës së pashpërndarë për pajisjet mjekësore në shumën 4,020,000 lekë.

DKPS dhe Drejtoria e Rimbursimit me anë të memos nr. 7299, datë 16.12.2022 kanë detajuar shtesën e fondit të rimbursimit, bazuar në perfomancën 11 mujore të vitit 2022, ku situata financiare në lidhje me shpenzimet e barnave me rimbursim ka qenë si më poshtë:

- Shpenzime të planifikuara rreth 9,916 milionë lekë;

[3] Bazuar në Listën e Pajisjeve Mjekësore të vitit 2019, çmimi i rimbursimit të fishës alternativë e parë është 19 lekë/fishë.

- Shpenzime të realizuara rreth 10,915 milionë lekë;
- Realizimi total 11 mujor, afërsisht 110%, pra me një tejkalim të planit me 10% ose shprehur në vlerë absolute 1 miliardë lekë.

Bazuar në faktin 11 mujor, nga Drejtoria e Rimbursimit dhe DKPS, rimbursimi i pritshëm për vitin 2022 dhe propozimi për shpërndarjen e shtesës, u paraqit si më poshtë:

Tabela nr.4.2.4 "Shpërndarja e shtesës së buxhetit të rimbursimit, të miratuar me AN nr. 17 në nivel DRF/DSHSU"

Në mijë lekë

DRF dhe degët	Ndarja e Buxhetit fillestar për çdo DRF/Degë/ DSSHU	Shtesa+Rezerva pashp. e Rimburs	Plani përfundimtar 2022
Berat	287,000	35,000	322,000
Dibër	228,000	18,000	246,000
Durrës	567,000	53,000	620,000
Elbasan	620,000	38,000	658,000
Fier	420,000	43,000	463,000
Gjirokastër	146,000	10,000	156,000
Korçë	470,000	38,000	508,000
Kukës	102,000	9,000	111,000
Lezhë	360,000	30,000	390,000
Shkodër	540,000	42,000	582,000
Tiranë	2,510,000	160,000	2,670,000
Vlorë	330,000	32,000	362,000
Sarandë	90,000	7,000	97,000
Tropojë	40,000	1,000	41,000
Kamëz	360,000	34,000	394,000
Lushnjë	350,000	32,000	382,000
Pogradec	150,000	17,000	167,000
DSHSU	2,830,000	350,771	3,180,771
Totali	**10,400,000**	**949,771**	**11,349,771**

Burimi i të dhënave: FSDKSH, Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga DKPS dhe Drejtoria e Rimbursimit është ndarë shtesa dhe rezerva e pashpërndarë në shumën totale 949,771 mijë lekë, në nivel DRF/DSHSU, ku më pas këto njësi shpenzuese kanë hartuar planet mujore të detajuara në nivel qendre shëndetësore, mjeku, spitali (për barnat e listës, që tregtohen në farmacitë e spitaleve) kategorie përfituesish, bazuar në negocimin e bërë me ofruesit e shërbimit, për lëshimin e recetës me rimbursim. Në lidhje me rezervën e paisjeve mjekësore në shumën 4,020,000 lekë, nuk është bërë detajim prej tyre, pasi shpenzimet faktike të periudhës janar-nëntor 2022, kanë qenë brenda kufijve fillestarë të planifikuar.

Realizimi dhe analiza e shpenzimeve të rimbursimit dhe konsumit të barnave.

Në Rregulloren nr.2, datë 06.07.2020 "*Për organizimin, funksionimin dhe përshkrimet e punës për drejtorinë e përgjithshme të Fondit*" përcaktohet se: *"Drejtoria e Rimbursimit duhet të realizojë analizimin e shpenzimeve për rimbursimin e barnave, në bazë të evidencave të përpunuara nga Drejtoria e Informacionit dhe Analizës Statistikore (DIAS)"*. Në lidhje me këtë detyrë, detajet mbi mënyrën e analizës përcaktohen në Udhëzimin nr.2, datë 09.01.2019 "*Për analizën e shpenzimeve të rimbursimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore në strukturat e Fondit*". Nga verifikimi i realizimit të analizave të shpenzimeve të rimbursimit, nga Drejtoria e Rimbursimit rezultoi se:

- Analizat e rimbursimit 2 mujore dhe ajo vjetore janë përgatitur, sipas afatit të përcaktuar në Udhëzimin nr.2, datë 09.01.2019 të analizës së rimbursimit (*Sektori i Monitorimit dhe analizës së Rimbursimit, duhet të kryejë analiza përmbledhëse 2 mujore, brenda 10 ditëve*

punë pas marrjes së të dhënave nga DIAS, e cila sipas pikës 5 të udhëzimit duhet të dërgojë të dhënat brenda datës 28 të muajit pasardhës).

- Analizat e rimbursimit dhe konsumimit të barnave, të realizuara nga Drejtoria e Rimbursimit, të përcjella pranë Drejtorit të Përgjithshëm, janë paraqitur sipas kërkesave të pikës 7 të Kreut IX të Udhëzimit nr. 2, datë 09.01.2019 të FSDKSH-së, gjithashtu periodiciteti i paraqitjes së tyre është respektuar, përveç analizës të 6-mujorit të parë, e **cila nuk është paraqitur**, në kundërshtim kjo me pikën 4, të Kreut IX të udhëzimit të sipër cituar.

Nga analizat e rimbursimit dhe konsumit të barnave, të përgatitura nga Drejtoria e Rimbursimit, realizimi i shpenzimeve të rimbursimit në nivel DRF/DSHSU për vitin 2022 paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.4.2.5 "Realizimi i shpenzimeve të rimbursimit për vitin 2022"

DRF/DSHSU	Plani 2022	Fakti 2022	Diferenca fakt-plan (mijë lekë)	% e realizimit
Berat	322,000	329,790	7,790	102%
Dibër	246,000	247,022	1,022	100%
Durrës	620,000	634,594	14,594	102%
Elbasan	658,000	663,415	5,415	101%
Fier	463,000	476,223	13,223	103%
Gjirokastër	156,000	158,038	2,038	101%
Korçë	508,000	505,158	-2,842	99%
Kukës	111,000	110,646	-354	100%
Lezhë	390,000	396,756	6,756	102%
Shkodër	582,000	581,828	-172	100%
Tiranë	2,670,000	2,641,838	-28,162	99%
Vlorë	362,000	373,648	11,648	103%
Sarandë	97,000	98,015	1,015	101%
Tropojë	41,000	41,279	279	101%
Kamëz- Vorë	394,000	401,608	7,608	102%
Lushnjë	382,000	383,470	1,470	100%
Pogradec	167,000	173,073	6,073	104%
QSUT	3,180,771	3,280,487	99,716	103%
Total	**11,349,771**	**11,496,887**	**147,116**	**101%**

Burimi i të dhënave: FSDKSH, Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga tabela më sipër rezulton se tejkalimin më të lartë dhe shpenzimet më të larta të rimbursimit i kanë DSHSU dhe Drejtoritë Rajonale si, Pogradec, Fier, Vlorë, etj. Nga analizat e bëra nga Drejtoria e Rimbursimit, rezulton se tejkalimet e shpenzimeve në këto DRF kanë ardhur si rezultat i rritjes së numrit të recetave, konkretisht për DSHSU-në 2,756 receta më shumë se një vit më parë, për DRF Pogradec 5,222 receta më shumë, DRF Fier me 10,145 receta më shumë; DRF Vlorë me 4,719 receta më shumë, etj, ndërsa vlera mesatare e recetës është rritur mesatarisht me 109 lekë/recetë krahasuar me vitin 2021.

Shpenzimet e rimbursimit janë tejkaluar në shumën 147,116 mijë lekë ose me 1%, ky tejkalim ka ardhur si rezultat i rritjes së rasteve me ndryshim terapie, të cilat për vitin 2022 janë rritur me 5.44% krahasuar me vitin 2021; rritjes së rasteve të trajtimit të pacientëve post covid; rritjes së diagnozave si diabet mellitus, hipertension esencial, ç'rregullime të ritmit të zemrës, ç'rregullime mendore, etj. Krahas rritjes së shpenzimeve të rimbursimit për vitin 2022 është vënë re dhe një rritje në treguesit e rimbursimit, të cilët paraqiten në mënyrë të detajuar si më poshtë:

Tabela nr.4.2.6 "Treguesit e rimbursimit për periudhën 2021-2022"

Periudha	Fakti (mijë lekë)	Recetat	Rimb/recetë	Rimbursim mes/pacient
Viti 2022	11,496,887	**3,902,795**	**2,946**	**28,683**
Viti 2021	11,061,181	3,898,461	2,837	26,993
Diferenca 2022-2021	**435,706**	**4,334**	**109**	**1,690**

Burimi i të dhënave: FSDKSH, Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga tabela më sipër rezulton se rritja e shpenzimeve të rimbursimit me 435,706 mijë lekë krahasuar me një vit më parë ka ardhur si rezultat i rritjes së treguesve të rimbursimit si më poshtë:

- Rritjes së numrit të recetave me 4,334 receta ;
- Rritjes së vlerës mesatare të recetës me 109 lekë.
- Rritjes së vlerës mesatare të rimbursimit për pacient me 1,690 lekë/pacient.

Sipas të dhënave dhe analizës së rimbursimit rezulton se, kjo rritje ka ardhur për shkak të rritjes në shpenzimet e rimbursimit për disa kategori të veçanta, konkretisht:

Sëmundjet kronike: Numri i pacientëve, për këtë kategori është rritur me 8,603 pacientë më shumë se një vit më parë, shpenzimet e rimbursimit janë rritur me 433 milionë lekë ose rreth 99% e rritjes totale, recetat e rimbursuara janë rritur me 83,555 receta, gjithashtu numri i diagnozave të trajtuara ka qenë më i lartë si dhe terapitë me një kosto më të lartë.

Pensionistë pa afat: Shpenzimet e rimbursimit për këtë kategori kanë pasur një rritje me 111.7 milionë lekë më shumë se viti paraardhës. Për këtë kategori është ulur numri i recetave të rimbursuara dhe është rritur vlera mesatare për recetë, duke trajtuar më pak diagnoza dhe terapi me kosto me të lartë.

Analiza e konsumit të barnave

Drejtoria e Rimbursimit së bashku me analizën e rimbursimit të barnave ka realizuar dhe analizën e konsumin të tyre, e cila sipas detyrave funksionale të kësaj drejtorie është paraqitur e krahasuar me vitin 2021, sipas grupit ATC (anatomik, terapeutik kimik) të barnave; 20 barnat me rimbursimin më të lartë të ndara në ambulatore dhe spitalore, analiza e konsumit të barnave të reja, që kanë hyrë në LBR dhe analiza e shpenzimeve të fishave të diabetit. Konsumi i barnave sipas grupit ATC, ka pasur pothuajse të njëjtën strukturë konsumi si një vit më parë, për vitet 2022-2021 paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 4.2.7 "Përqindja e shpenzimeve të rimbursimit të barnave ndaj totalit, sipas grupeve ATC për vitet 2022-2021"

Grupi	Grupet Anatomike	% ndaj total 22	% ndaj total 21
A	Trakti degjestiv dhe metabolizmi	20.3%	19.9%
B	Gjaku dhe organet e hemopojezes	8.0%	8.9%
C	Sistemi kardiovaskular	24.1%	23.5%
D	Dermatologjiket	0.0%	0.0%
G	Sistemi urogjenital dhe hormonet seksuale	0.5%	0.5%
H	Preparatet hormonale sistemike	2.0%	2.1%
J	Antiinfetkivët e përgjithshëm	1.0%	0.5%
L	Barnat antineoplazike dhe imunosupresoret	23.6%	21.9%
M	Sistemi Muskolo skeletik	1.5%	1.7%
N	Sistemi Nervor	6.2%	7.1%
P	Barnat Aniparazitarë	0.0%	0.0%
R	Sistemi Respirator	7.4%	7.8%
S	Organet e shqisave	3.2%	3.2%
V	Të ndryshme	2.1%	3.0%
Totali		**100.0%**	**100.0%**

Burimi i të dhënave: FSDKSH, Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Drejtoria e Rimbursimit, paraqet gjithashtu dhe analizën e konsumit të pajisjeve mjekësore.

Nga verifikimi i analizës së konsumit të pajisjeve mjekësore (fishave të diabetit) të paraqitur nga Drejtoria e Rimbursimit, bazuar në të dhënat e marra nga DIAS, rezultoi se gjatë vitit 2022 numri i pacientëve me diabet të grup-moshës 0-25 vjeç është rritur në 623 pacientë, nga 576 pacientë në një vit më parë (shifër e marrë për bazë për të planifikuar shpenzimet e rimbursimit për vitin 2022), konsumi i fishave të diabetit ka qenë në total 533,606 fisha nga 840,960 fisha të planifikuara dhe shpenzimet e rimbursimit kanë qenë afërsisht në shumën 8.9 milionë lekë, nga 20 milionë të planifikuara. Nga analiza e paraqitur prej Drejtorisë së Rimbursimit, rezultoi se gjatë vitit 2022 dhe pse numri i pacientëve me diabet është rritur me 47, numri i fishave të konsumuara dhe shpenzimet e rimbursimit kanë rezultuar më të ulëta se plani i rimbursimit të pajisjeve mjekësore. Në plan, një pacient është planifikuar se i nevojiten 4 fisha diabeti në ditë ose 1,460 fisha në vit (referuar studimit të Shërbimit të Endikronologjisë në QSUT, të dhjetorit të vitit 2017). Në analizën vjetore të rimbursimit dhe konsumit të pajisjeve mjekësore për vitin 2022, mungon analiza e kësaj situate, por vetëm paraqiten të dhënat mbi shumën e rimbursimit dhe numrin pacientëve e të fishave për dy vitet, veprim ky në kundërshtim më detyrën e Drejtorisë së Rimbursimit, të përcaktuar në pikën 5, të kreut III, të kapitullit VI të Rregullores nr.2/2020, ku përcaktohet: "*Analizimi i konsumit të barnave, veçanërisht konsumin e barnave të rimbursueshme që tregtohen në farmacitë e spitalore, në bazë të evidencave të konsumit të përpunuara nga DIAS*".

Në analizën e rimbursimit dhe konsumit të barnave, trajtohen dhe shpenzimet e rimbursimit për 23 barnat e reja të LBR 2021, ku 11 prej tyre i përkasin grupit të barnave spitalore dhe të tjerat grupit të barnave ambulatore të cilat i kanë shpenzimet e rimbursimit në shumën 357.6 milionë lekë, ose 3.1% të rimbursimit total vjetor.

Veprimtaria e Drejtorisë së Rimbursimit në drejtim të Listës së Barnave të Rimbursueshme (LBR)

Një nga detyrat e Drejtorisë së Rimbursimit, përcaktuar në pikën 1 të kapitullit V, të Rregullores nr. 2 "Për organizimin, funksionimin dhe përshkrimet e punës për drejtorinë e përgjithshme të Fondit"është: "*Përgatitja e draft-listave me çmimet e reja të barnave dhe pajisjeve mjekësore të rimbursuara nga Fondi, që pas miratimit në Këshillin Administrativ, paraqiten për miratim në Këshillin e Ministrave*". Nga verifikimi i rishikimit të Listës së Barnave të Rimbursueshme (LBR) rezultoi se ajo ka hyrë në fuqi, që prej datës 01.08.2021 dhe zërat e saj nuk kanë ndryshuar, por nga Fondi bazuar në informacionet mbi çmimet e deklaruara të barnave të përcjella nga Komisioni i Çmimit të Barnave (në vijim "KÇB"), dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me anë të shkresës të protokolluar në Fond me nr. 472 prot., datë 21.01.2022, është bërë indeksimi i çmimeve të saj. Lista e indeksuar është miratuar me Vendimin e Këshillit Administrativ të FSDKSH nr.3 datë 15.02.2022 "Për një ndryshim në vendimin nr. 489 datë 30.07.2021 të Këshillit të Ministrave "*Për miratimin e listës së barnave që rimbursohen nga FSDKSH dhe masën e mbulimit të tyre*", më pas lista e indeksuar e miratuar VKA-në e sipërcituar është miratuar me VKM nr. 230 datë 13.04.2022 për periudhën nga 01.05.2022 deri më 01.05.2023. Gjithashtu përgjatë vitit 2022 ka ndryshuar dhe lista e fishave të rimbursueshme, që qarkullojnë në tregun farmaceutik dhe rimbursohen për pacientët e grup moshës 0-25 vjeç, pranë farmacive të rrjetit spitalor, në QSUT dhe Spitalet Rajonale. Lista e ndryshuar është miratuar me anë të VKM-së nr. 229, datë 13.04.2022 "*Për një ndryshim në Vendimin nr.61 datë 3.2.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e paketave të pajisjeve mjekësore të rimbursueshme",* të ndryshuar", ku numri i fishave të rimbursueshme nga 5 u bë 11 dhe shuma e rimbursueshme për çdo fishë nga 19 lekë/fishë u bë 14 lekë/fishë.

Verifikimi i disponibilitetit të barnave të rimbursuara

Në rregulloren nr.2 "*Për organizimin, funksionimin dhe përshkrimet e punës për drejtorinë e përgjithshme të Fondit"* një nga detyrat funksionale të Drejtorisë së Rimbursimit, konkretisht

e Sektorit të Listës së Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore është edhe "*Verifikimi i disponibilitetit të barnave të rimbursuara dhe pajisjeve mjekësore*".
Gjatë vitit 2022 nga ana e Sektorit të Listës së Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore pranë Drejtorisë së Rimbursimit në Fond është verifikuar disponibiliteti i barnave të rimbursueshme në tregun farmaceutik. Realizimi i këtij procesi kryhet në zbatim të Rregullores Funksionale të Fondit dhe bazuar në Udhëzimin nr. 16, datë 13.12.2019 "*Për realizimin e monitorimit dhe verifikimit të disponibilitetit të barnave të rimbursuara në tregun farmaceutik*".
Për disponibilitetin e barnave të rimbursuara, alternativa të para dhe të vetme të LBR-së në fuqi, Drejtoria e Rimbursimit ka përgatitur informacion të përmuajshëm gjatë vitit 2022, me lëndë "*Mbi monitorimin dhe verifikimin e disponibilitetit të barnave të rimbursuara në tregun farmaceutik*". Në informacion paraqiten të dhëna mbi:

- Barnat, që mungojnë në farmacitë e rrjetit të hapur, raportuar nëpërmjet akt-konstatimeve;
- Barnat, që mungojnë në farmacitë e spitaleve, sipas njoftimeve të bëra prej tyre;
- Lajmërimet, vetë deklarimet, lajmërimet paraprake, nga importuesit farmaceutikë të kontraktuar me Fondin.

Procesi i monitorimit dhe verifikimit bëhet për barnat, pjesë LBR, alternativa të para dhe të vetme, në lidhje më këtë Drejtori i Përgjithshëm nxjerr Urdhër Verifikimi dhe një grup i përbërë, nga jo më pak se dy persona, ku njëri duhet të jetë specialist, farmacist bën verifikimin në terren. Informacioni i përgatitur nga grupi i punës "*Mbi monitorimin dhe verifikimin e disponibilitetit të barnave të rimbursuara në tregun farmaceutik*" i përcillet dhe Drejtorisë së Kontrollit në Fond, për procedim të mëtejshëm.
Nga verifikimi i monitorimeve dhe verifikimeve të kryera nga Sektorit të Listës së Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore rezultoi:

- Gjatë vitit 2022, urdhrat e titullarit për monitorimin e disponibilitetit të barnave të rimbursueshme, në të 12 muajit e vitit 2022 janë nxjerrë në përputhje me pikat 3 dhe 4 të seksionit A, të Udhëzimit nr. 16/2019.
- Numri i farmacive të përzgjedhura për të kryer verifikimin fizik të disponibilitetit të barnave të rimbursueshme rezulton të jetë sipas përcaktimeve të pikës 5 të Udhëzimit nr.16/2019 (*farmaci që zhvillojnë aktivitetin e tyre në DRF Tiranë, jo më pak se 10*), në të 12 muajt janë përzgjedhur 10 farmaci për verifikim.
- Informacioni i përgatitur, në lidhje me procesin e monitorimit dhe verifikimit të disponibilitetit të barnave është bërë jo më vonë se data 10 e muajit pasardhës dhe paraqitja e informacionit është sipas pikës B të udhëzimit nr.16/2019.

Në lidhje me procesin e verifikimit të disponibilitetit të barnave, nga grupi i auditimit u evidentuan mungesat e paraqitura nga verifikimet e Drejtorisë së Rimbursimit sipas tri burimeve: nga akt konstatimet e specialistëve të Sektorit të Listës së Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore; nga njoftimet e bëra prej spitaleve dhe farmacive të tyre dhe nga vetë deklarimi i importuesve, ku situata për 12 muajt e vitit 2022 paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 4.2.8 "Barnat e evidentuara me mungesë sipas tri burimeve gjatë vitit 2022"

Sipas verifikim	Njoftimet e spitaleve	Vetëdeklarim i Importuesve
Janar		
534/405	662/237	464/405
535/405	578/325	664/48a
204/36	631/335	623/193
	486/455	630/181
	682/14	623/193
		Budesonide 100mg/dose 10 ml nasal spray
		denerel 1 mg
		pegasys 180 m dhe copegus 20 mg
Shkurt		
578/325	Capecitabine Açord	actemra 0.9 ml/162 mg
710/96	710/96	216/41

752/41	752/41	623/193
631/335	628/378	630/181
723/92	776/191	Duphalac
628/378		Cellcept 250mg
776/191		
Mars 2022		
515/284	452/191	623/193
706/311	578/325	529/92
746/311	272/73	216/41
204/36	413/358	Abiraterone acetate 25 mg
		Acetazolamide 250 mg
		fludarabine 10 mg
Prill 2022		
617/363	578/325	216/41
559/398	726/418	Duphalac
683/398		Clarithromycine 125mg/5 ml
706/311		haloperidol 50mg-1ml
746/311		Cellcept 250mg
254/38		nifedipin R 20 mg
611/311		Klacid paediatric suspension 125 mg/5 ml
508/107a		
512/474		
Maj 2022		
19/193	576/455	Clarithromycine 250mg
530/411	707/284	Clarithromycine 125mg/5 ml
558/398	708/325	272/73
706/311	769/41	fromilid 250mg
746/311	216/41	Cellcept 250mg
611/311	631/456	Duphalac
272/73	726/430	Klacid paediatric suspension 125 mg/5 ml
Qershor		
19/193	576/455	Cellcept 250mg
448/193	707284	Clarithromycine 125mg/5 ml
617/363	708/325	tritace 5 & 10mg
558/398	487/325	insuman Rapid
683/398	631/456	Fluticapen 250 mcg
734/337	628/378	
570/96		
706/311		
377/159		
Korrik 2022		
11/178	707/284	Duphalac
617/363	708/25	mycofenolste mofetil 250 mg
556/224	487/325	Cellcept 250mg
559/398	578/325	nifedipin R 20 mg
283/55	462/325	mesaflor 50 mcg/ml x 50 tab
		Fludarabine 10 mg
Gusht 2022		
556/224		216/41
558/398		fludsrsbine 10 mg
559/398		Lixisenatide 10 & 20 mg
		Abiraterone acetate 250 mg
		120/363
		agnis plus 50/850
Shtator 2022		
670/404	578/325	Duphalac
558/398	628/378	abiraterone acetate 250 mg
559/398		Cellcept 250mg
Tetor 2022		
559/398	487/325	fludara oral tablet
368/193		Lixisenatide 10 & 20 mg
522/26		Lyxumia
		ciprofibrate 100 mg
Nëntor 2022		
617/363		Mesaflor
368/193		mycofenolate mofetil
559/398		Lixisenatide
133/16		Fludara
603/398		
527/107		
527/461		

204/36		
Dhjetor		
616/363	639/444	abiraterone acetate 250 mg
617/363		mycofenolate mofetil 250 mg
368/193		agnis plus 50/850 mg
383/398		Cellcept 250mg
559/398		Valcyte
500/478		Klacid paediatric suspension 125 mg/5 ml
		fluvoxamine maleate 100 mg (Faverin)

Burimi i të dhënave: FSDKSH, Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga tabela më sipër rezulton, se pavarësisht burimit të deklarimit të këtyre mungesave gjatë gjithë vitit, ka pasur barna, pjesë të LBR, të cilat kanë munguar, ku përmendim: Clarithromycine 250 mg; Duphalac; Cellcept 250 mg, etj.
Në lidhje me barnat, për të cilat Fondi është njoftuar nga vetë subjektet importuese për mungesat e tyre, nga grupi i auditimit u verifikua sa është konsumi i tyre, bazuar në të dhënat e konsumit, që përgatiten nga Drejtoria e Rimbursimit, nga ku situata paraqitet si në tabelën nr. 4.2.9 të Aneksit 4.2.

Për verifikimin e disponibilitetit të barnave alternativë e parë dhe e vetme në treg, nga grupi i auditimit u evidentuan barnat e raportuara si mungesë nga ana e importuesve farmaceutikë, në zbatim të pikës 3, të nenit 6, të kontratës 2021 mes tyre dhe Fondit, ku përcaktohet: *"Në rast se, Importuesi, konstaton ose parashikon mungesa të barit për periudha dhe sasi më të mëdha se një muaj, është i detyruar të lajmërojë paraprakisht Fondin, në adresën…. Lajmërimi të shoqërohet me argumente dhe dokumente justifikues për vonesën e pritur".* Arsyet e mungesave të tyre rezultuan kryesisht për shkak të prodhuesve, vonesave në transport dhe prodhim apo dhe ç'rregjistrime të barnave. Për disa barna njoftimi ishte bërë, që prej fundit të vitit 2021 dhe në fillim të vitit 2022, gjë e cila nuk është reflektuar në LBR. Nga auditimi rezultoi se dhe pse prej importuesve janë dhënë arsyetime, kjo nuk i ka dhënë zgjidhje mungesës së disponibilitetit të barnave.
Barnat e vetë deklaruara si mungesë, nga vetë shoqëritë importuese kanë ndikuar dhe në konsumin e tyre vjetor, ku krahasuar me një vit më parë rezulton se diferencat në konsumin e tyre paraqiten si më poshtë: [4]

Tabela nr. 4.2.10 "Krahasimi i konsumit të barnave të vetë deklaruara, që mungojnë nga importuesit për vitet 2021-2022 "

Emri Tregtar	Diferenca (22-21)		
	Sasia	Rimbursim(lekë)	Receta
Cellcept	-19,340	-697,626	-82
Duphalac	1,337	1,671,903	550
Klacid	-87	-56,752	-84
Fludara Oral	-2,893	-4,808,769	-95
Zytiga	-41,520	-123,377,098	-296
Mesaflor	-138,675	-3,191,230	-659
Agnis Plus	-2,580	-190,183	-60
Fromilid	-236	-3,555	-16
Insuman Rapid Solostar	-27,687	-14,316,330	-7,367
Ëarfarin 1mg	-11,468	-143,213	-193
Pronipin	-141,445	-360,341	-1,813
Nifelat R	215,280	637,159	2,579
Tritace	108,903	2,018,883	2,073
Tritace	16,391	311,197	291
Lipanor	16,740	222,240	-35

[4] Në aneksin nr.4.2, të tabelës nr.4.2.1 paraqitet tabela e plotë me të dhënat e konsumit dhe diferencat përkatëse për të dy vitet.

Pegasys	-924	-4,689,172	-233
Actemra	-192	-4,060,256	-21
Haloperidol	4,052	788,174	-116
Haldol Depo	-6,632	-2,010,174	-2,510
Fevarin	40,864	1,076,481	-1
Resata	-5,751	-4,232,066	-3,460
Denerel	-6,738	-27,434	-116
Galvus Met	-1,740	-212,616	-35
Tansulosina Reliva	-85,689	-626,072	-2,310
Fluticapen	-890	-948,593	-620
Acetozolamide	15,082	368,293	286
Totali	**-75,838**	**-156,857,151**	**-14,343**

Burimi i të dhënave: FSDKSH, Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Në lidhje me analizën e disponibilitetit, më tej nga Drejtoria e Kontrollit janë bërë verifikime të mëtejshme në lidhje me disponibilitetin e barnave dhe në 2 muaj, janë marrë masa administrative, pasi nuk është njoftuar paraprakisht në lidhje me mungesën e barnave, siç parashikohet në pikën 3, të nenit 6 të Kontratës 2021, që Fondi ka me importuesit farmaceutikë, ku përcaktohet: "*Në rast se importuesi, konstaton ose parashikon mungesa të barit për periudha dhe sasi më të mëdha së një muaj, është i detyruar të lajmërojë paraprakisht Fondin, në adresën…… Lajmërimi të shoqërohet dhe me dokumente justifikues për vonesën e pritur*". Masat administrative i përkasin muajve si më poshtë:
Në muajin janar 2022: kanë rezultuar dy barna me mungesë "*Capecitabine 500 mg*" dhe "*Inflixinab 100 mg*", pluhur për injeksion, për të cilët nuk është njoftuar me email dhe nuk janë paraqitur dokumente justifikues nga importuesi "*M.*",
Në muajin mars 2022, nuk është njoftuar në lidhje me mungesat e barnave: "*Naproxen Sodium + Codein Phospate 550+30 mg*" dhe "*Acid Alendronic 70 mg + Colecalciferol 5600 IU*", nga subjekti mbajtës i autorizimit për tregtim "*A. I. I.S. V*".

Kontratat me shpërndarësit dhe importuesit farmaceutikë.
Drejtoria e Rimbursimit, sipas detyrave të përcaktuara në Rregulloren nr.2, bën: "A*dministrimin e dokumentacionit të Depove farmaceutike të kontraktuara në përputhje me praktikën dhe kriteret e lidhjes së kontratave, sipas akteve ligjore në fuqi"*. Për vitin 2022 kanë vijuar të mbeten në fuqi kontratat e lidhura prej momentit të hyrjes në fuqi të LBR-së, më 01.08.2021, me 42 importues farmaceutikë dhe 14 shpërndarës farmaceutikë. Në vitin 2022 janë lidhur kontrata të reja me dy shpërndarës farmaceutikë, me kërkesën e tyre, konkretisht kontrata nr. 55225/3 datë 09.09.2022 me subjektin "*R. Ph*", Tiranë dhe kontrata nr. 6362/2, datë 15.11.2022 me subjektin "*S.*", Fier.
Nga grupi i auditimit u bë verifikimi i dokumentacionit, për dy kontratat e lidhura në vitin 2022, nga ku rezultoi se dokumentacioni për secilën prej tyre ishte në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 8 të Udhëzimit nr. 4 datë 27.07.2021 *"Për lidhjen e kontratave me importuesit dhe shpërndarësit farmaceutikë*". Kontratat e lidhura me shpërndarësit farmaceutikë janë sipas formatit tip, të kontratës së miratuar me VKA të Fondit nr. 13, datë 19.07.2021, nga verifikimi i tyre rezulton se, ato nuk kanë afat të përcaktuar dhe nuk përmbajnë kushte, që të garantojnë sigurimin e ofrimit të barnave në treg, për të evituar mungesat në treg.

Nga verifikimi i disponibilitetit të barnave alternativë e parë dhe e vetme në treg rezultoi se në vitin 2022, në mungesën e barnave kanë ndikuar dhe dy raste të pezullimeve të kontratave me importuesit farmaceutikë bazuar në vendimet gjyqësore, konkretisht më datë 14.10.2021 është pezulluar kontrata me subjektin "*E.*" SHPK, e cila ka vijuar sërish më 23.03.2022, si dhe kontrata me subjektin "*F.N.A*" e pezulluar më 14.10.2021 duke vijuar sërish më 13.10.2022. Me importuesin "*E.*" SHPK kontrata dy palëshe ka qenë për 33 barna, pjesë e LBR, prej të

cilave 4 barna kanë qenë alternativë e parë, për 3 prej tyre për shkak të ofrimit dhe nga importuesi "T." nuk është shkaktuar mungesë disponibiliteti në farmaci, në lidhje me barin "*Haloperidol 500 mg-1 ml*", importuesi ka qenë i vetmi ofrues, prandaj ka shkaktuar mungesë të disponibilitetit të barit . Në lidhje me kontratën me importuesin "*F.N.A*", kontrata në aneksin e saj kishte 2 barna, që ishin alternativë e vetme, duke shkaktuar mungesë disponibiliteti në lidhje me këto 2 barna. Në lidhje me pezullimet e kontratave, nga Fondi nuk janë marrë masa për të ndaluar mungesën e disponibilitetit të barnave, alternativë e parë dhe e vetme e LBR.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, mbi këtë drejtim auditimi, nuk janë paraqitur observacione.

Meqenëse, me Programin e auditimit nr.733/1 prot., datë 11.09.2023, KLSH është në auditim në FSDKSH për çështjen "Përputhshmëria me aktet ligjore dhe rregullatore në fuqi të veprimtarisë së organeve drejtuese të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, lidhur me rimbursimin e barnave: Këshilli Administrativ, Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtoritë përkatëse në FSDKSH" nuk është finalizuar me gjetje, konkluzione dhe evidentim përgjegjësie analizën e shpenzimeve të rimbursimit dhe konsumit të barnave, veprimtarinë e Drejtorisë së Rimbursimit në drejtim të Listës së Barnave të Rimbursueshme, verifikimin e disponibilitetit të barnave të rimbursuara etj., që kanë të bëjnë me këtë çështje.

2.4.3. Vlerësimi i përputhshmërisë së aktivitetit të Drejtorisë së Kujdesit Parësor Spitalor në lidhje me zbatimin e skemës së sigurimit për hartimin e listës së barnave, hartimin e kontratave, etj.)

Struktura e DKPS

Drejtoria e Kujdesit Parësor Spitalor (DKPS, këtu e më poshtë) është strukturë pranë Fondit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (Fondi, këtu e në vijim) e cila përbëhet nga 4 sektorë: Sektori i Monitorimit të Shërbimit Parësor; Sektori i Monitorimit të Indikatorëve dhe Kontrollit Mjekësor Bazë; Sektori i Monitorimit të Shërbimit Spitalor; Sektori i Monitorimit dhe Kostifikimit të Shërbimit Spitalor. Gjatë vitit 2022 struktura e kësaj drejtorie ka rezultuar si më poshtë:

Tabela nr.4.3.1 "Struktura dhe vakancat e DKPS për vitin 2022"

Pocizioni i punës	Struktura 2022	Vakanca 2022
Drejtor Drejtorie	1	0
Përgjegjës Sektori	4	1
Specialist	10	1
Total	**15**	**2**

Burimi i të dhënave: FSDKSH, Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga tabela më sipër rezulton se gjatë vitit 2022 në strukturën e DKPS ka pasur 2 pozicione vakante gjatë gjithë vitit, konkretisht Sektori i Monitorimit të Shërbimit Parësor nuk ka pasur përgjegjës sektori, Sektori i Monitorimit dhe Kostifikimit të Shërbimit Spitalor ka pasur mungesë të një specialisti, ndërsa Sektori i Monitorimit të Indikatorëve dhe Kontrollit Mjekësor është plotësuar me një specialist, mjek në muajin maj 2022.

Në rregulloren nr.2, datë 06.07.2020 "Për organizimin, funksionimin dhe përshkrimet punës në Drejtorinë e të FSDKSH", në lidhje me DKPS përcaktohet se: "*Objekti i punës i DKPS është zbatimi i skemës së sigurimit shëndetësor në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për hartimin e kontratave të shërbimit parësor dhe spitalor, ndjekjen e treguesve të rimbursimit e sëmundshmërisë, të indikatorëve të aktivitetit dhe kontrollit mjekësor bazë dhe të paketave të shërbimeve shëndetësore spitalore të financuara nga Fondi".*

Për të gjykuar në lidhje me realizimin e veprimtarisë së DKPS nga grupi i auditimit janë kryer verifikime mbi realizimin e detyrave të përcaktuara në Kapitullin VI, të Rregullores nr. 2/ 2020, përfshirjen e këtyre detyrave në planet mujore dhe vjetore, realizimin dhe mënyra e realizimit të tyre, nga ku rezultoi:

4.3.Planifikimi i Drejtorisë së Kujdesit Parësor Spitalor dhe realizimi i veprimtarisë.

Nga grupi i auditimit u bë verifikimi i hartimit dhe miratimit të planeve mujore, nga titullari i institucionit nga ku rezultoi se plani vjetor i punës për vitin 2022 është hartuar nga Drejtoresha e Drejtorisë së Kujdesit Parësor dhe Spitalor znj. M.M. dhe është miratuar nga Drejtoresha e Përgjithshme, e komanduar Znj. A. Ç, më datë 29.12.2021. Plani i punës vjetor përmban detyrat e pritshme për realizim përgjatë vitit 2022 dhe përcakton për secilën prej tyre: veprimet për realizimin e tyre, personat përgjegjës, afatin kohor, rezultatin e pritshëm dhe mënyrën e raportimit. Detyrat e pritshme për realizim janë në përputhje me detyrat kryesore të kësaj drejtorie, të përcaktuara në pikën III, të Kapitullit VI, të Rregullores nr.2, të miratuar me Urdhrin nr.277, datë 06.07.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm "*Për organizimin/funksionimin dhe përshkrimet e punës në Drejtorinë e Përgjithshme të FSDKSH*".

Nga verifikimi i përgatitjes dhe përmbajtjes së planeve mujore dhe atij vjetor, të punës ka rezultuar se:

- Në planin e punës vjetor, detyra në pikën 24 "*Analizimi i të dhënave të dërguara nga DRF/DSHU mbi shërbimin e ofruar nga koncensionari DV për shërbimet e ofruara pacientëve të dializës*", e ka periodicitetin e realizimit çdo muaj, por nuk paraqitet në planet mujore të muajve: janar, shkurt dhe mars.
- Nga verifikimi i planeve mujore të punës rezultoi se, realizimi i inspektimeve nga DKPS është planifikuar në 8 muaj, por urdhrat përkatës të inspektimit nuk përkojnë me muajt, në të cilët është planifikuar kjo detyrë, konkretisht në muajin shkurt të vitit 2022 në planin mujor të punës nuk planifikohet inspektim, por me anë të Urdhrit të inspektimit nr. 54, datë 18.02.2022 ka nisur inspektimi në DRF Fier, Lushnjë, Berat dhe Vlorë, ky inspektim është përfshirë në planin e muajit mars 2022, gjithashtu në tetor 2022 është planifikuar të realizohet inspektim, por nuk është realizuar.

Veprimtaria e DKPS gjatë 2022.

Kontribuimi në grupet e punës të ngritura për hartimin e kontratave të shërbimit parësor dhe spitalor.

DKPS kontribuon në hartimin e draft kontratave me dhënësit e shërbimit shëndetësor parësor dhe spitalor, bazuar në to dhe në udhëzimet përkatëse monitoruese të nxjerra nga Fondi ajo realizon veprimtarinë e saj mbi monitorimin e tyre.

Procesi i hartimit të kontratave, planifikohet të realizohet në fund të vitit, konkretisht nga DKPS *"Hartimi i draft kontratave me dhënësit e shërbimit parësor dhe spitalor për vitin 2023*", është përfshirë në planin e muajit tetor 2022 dhe është realizuar në muajin nëntor 2022 (nuk ka pasur afat të përcaktuar kohor, kur duhet të përfundonte në planin e muajit tetor). Me Urdhrin e titullarit të FSDKSH nr. 276, datë 07.09.2022 është ngritur grupi i punës për hartimin e draft kontratave dhe gjatë muajit dhjetor 2022 nga Fondi janë lidhur kontratat me ofruesit e shërbimit spitalor e parësor me objekt si më poshtë:

- "Financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore, për vitin 2023";
- "Financimin e paketave të shërbimeve shëndetësore të ofruara nga institucionet shëndetësore jopublike për vitin 2023";
- "Për lëshimin e rekomandimit për trajtimin ambulator të sëmurëve të shëndetit mendor për vitin 2023";
- "Për lëshimin e recetës me rimbursim nga mjekët e organizatave jofitimprurëse të licencuara, që ofrojnë kujdes paliativ, për vitin 2023";

- "Për financimin e qendrave shëndetësore për vitin 2023";
- "Për financimin e qendrave shëndetësore të specializuara për vitin 2023";
- "Për financimin e shërbimeve shëndetësore të kujdesit parësor të shërbimit onkologjik në banesë për vitin 2023".

Nga auditimi i procesit të hartimit dhe lidhjes së kontratave rezultoi se nga DKPS janë respektuar afatet e përcaktuara në planin vjetor të punës të kësaj drejtorie. Të gjitha kontratat e lidhura nga Fondi janë me afat 1 vjeçar dhe kanë qenë në vijimësi me subjektet përkatëse.
Në aneksin H të kontratës me Qendrat Shëndetësore (QSH) paraqiten indikatorët, që duhet të llogariten prej tyre me bazë mujore dhe paraqitet me detaje mënyra e llogaritjes, standardi i rezultatit dhe objektivi përkatës. Këto indikatorë dhe elementët e tjerë që kërkohen në anekset e kontratës, pasi të llogariten duhet të dërgohen pranë, DRF-ve dhe kjo e fundit pranë DKSP. DKPS bën mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e tyre sipas formatit të përcaktuar për QSH në Udhëzimit nr. 1, datë 12.01.2021 "*Për llogaritjen dhe raportimin e indikatorëve të Qendrës shëndetësore* ", të FSDKSH.
Nga raportimi i DKPS të këtij informacioni, në mënyrë të përmbledhur treguesit e perfomancës së QSH, në rang vendi, kanë rezultuar si më poshtë:

- Gjatë vitit 2022 në Qendrat Shëndetësore të Kujdesit Parësor janë kryer 7,120,840 vizita, ku 6,233,638 vizita janë kryer nga mjekët e përgjithshëm të familjes dhe 887,202 vizita janë kryer nga mjekët specialistë të QSH të Specialiteteve në Tiranë.
- Mesatarja ditore e vizitave për vitin 2022 ka qenë rreth 14.9 vizita/ditë.
- Për periudhën Janar-Dhjetor 2022, janë kryer në total 454,828 kontrolle mjekësore ose 96 % e projeksionit.
- Nga monitorimet e kryera në degët dhe DRF-të, nga Sektori i Analizës, Monitorimit dhe Kontrollit Mjekësor Bazë, gjatë vitit 2022 kanë rezultuar me perfomancë të mirë (mbi 100% nga vlerësimi i indikatorëve) Qendrat Shëndetësore të rajoneve Kamëz-Vorë, Pogradec, Kukës, Korçë, Tropojë, Fier dhe Durrës, ndërsa performancë vjetore më të ulët se 100% kanë pasur DRF-të: Sarandë, Vlorë, Lezhë, Gjirokastër, Tiranë, Dibër, Elbasan, Shkodër, Lushnjë dhe Berat.
- Përqindja e realizimit në total të numrit të vizitave nga infermierët në rang vendi gjatë vitit 2022 ka qenë 114% dhe numri mesatar ditor i vizitave 10.8 vizita/ditë.

Titulli i Gjetjes:	**Mos përfshirje e të gjithë palëve të kontratës në Udhëzimin nr. 1, datë 12.01.2021 "Për llogaritjen dhe raportimin e indikatorëve të Qendrës Shëndetësore ", të FSDKSH.**
Situata:	Nga verifikimi i procesit të monitorimit të kontratave të lidhur me ofruesit e shërbimit parësor dhe spitalor dhe Fondit, rezultoi se DKPS si strukturë, pranë Fondit përgjegjëse për monitorimin e aktiviteteve të shërbimit parësor dhe spitalor, përcaktuar kjo në pikën 13, të Kreut III, Kapitullit VI, të Rregullores nr. 2/2020 ku përcaktohet se DKPS bën: "*Organizmin e punës për monitorimin e aktiviteteve të shërbimit parësor e spitalor, në zbatim të kontratave të lidhura me ofruesit e shërbimeve shëndetësore",* nuk ka një guidë për realizimin e kësaj veprimtarie. Në planin saj vjetor të punës, kjo Drejtori e parashikon në pikën 19: "*Përpunimin e indikatorëve të perfomancës çdo 6 muaj"*. Indikatorët e perfomancës llogariten dhe raportohen nga QSH-të, sipas specifikimeve të aneksit nr. 2, ku në mënyrë të detajuar paraqiten afatet kur duhet të raportohet informacion pranë DRF-ve apo strukturave të Fondit, informacionin që duhet të depozitohet dhe formatet e raportimit. Nga verifikimi i paraqitjes së të dhënave të konsoliduara nga DKPS, rezultoi se procesi i grumbullimit,

	përpunimit dhe raportimit të informacionit të mbledhur prej DRF-ve është konsoliduar çdo 6 muaj sipas formatit të kërkuar në raportim nga QSH, sipas Udhëzimit nr.1, datë 12.01.2021, por në format të konsoliduar. Në lidhje me procesin e raportimit të informacionit nga DKPS mungon në udhëzim, një kapitull i veçantë në lidhje me afatet dhe formën e konsolidimit dhe paraqitjes së këtij informacioni prej DKPS-së. Pika 2, e nenit 12 të kontratave me dhënësit e shërbimit spitalor përcakton se: "*Fondi/DRF bën verifikimin e informacionit, të dërguar nga spitali sipas raportimeve të Aneksit Nr. 2, si pjesë përbërëse e kësaj kontrate*...", por në rregulloret mbi të cilat mbështet veprimtaria e DPKS nuk parashikohet se si duhet të bëhet ky verifikim, gjithashtu në udhëzimet përkatëse të paketave dhe të monitorimeve, nuk parashikohen veprimet e DKPS, si strukturë përgjegjëse për monitorimin e kontratave, por nga DKPS ky monitorim është realizuar në DRF-të e përzgjedhura për inspektim gjatë vitit 2022.
Kriteri:	-Pika 13, e Kreut III, Kapitullit VI, të Rregullores nr. 2/2020; -Pika 19 e planit vjetor të punës së DKPS. -Pika 2, e nenit 12 të kontratave me dhënësit e shërbimit spitalor
Ndikimi/Efekti:	Verifikim jo i plotë i të gjithë elementëve të kontratës.
Shkaku:	Mos përfshirja e udhëzimin e indikatorëve dhe në kontratën me dhënësit e shërbimit parësor e spitalor e detajeve mbi veprimet e Fondit(DKPS) në drejtim të treguesve të performancës së shërbimeve shëndetësore.
Rëndësia:	E ulët.
Rekomandimi:	Drejtori i Përgjithshëm i FSDKSH dhe Drejtori i Drejtorisë së Kujdesit Parësor dhe Spitalor të marrin masa, për të rishikuar dhe bërë disa ndryshime në Udhëzimin nr. 1, datë 12.01.2021 "Për llogaritjen dhe raportimin e indikatorëve të Qendrës Shëndetësore", për të përcaktuar procedurat dhe veprimet që duhet të kryhen nga DKPS, për monitorimin e performancës, afatet kur duhet të raportohet, si dhe të standardizojë formën e raportimit.

Analiza e Treguesve të rimbursimit dhe sëmundshmërisë

DKSP sipas Udhëzimit nr. 1, datë 09.01.2019 të FSDKSH analizon për çdo dy mujor treguesit e rimbursimit dhe të sëmundshmërisë, për çdo mjek dhe qendër shëndetësore/spital.

Nga grupi i auditimit u bë verifikimi i analizave të kryera prej DKPS dhe formateve të tyre, nga ku rezultoi se:

- Gjatë vitit 2022 janë kryer analizat 2 mujore, analiza 6 mujore dhe analiza vjetore për rimbursimin dhe sëmundshmërinë për sektorin shëndetësor parësor dhe për barnat, që ofrohen në farmacitë e spitaleve.
- Analizat e kryera janë sipas kërkesave të Udhëzimit nr.1/2019 të FSDKSH-së. Ato paraqesin informacion mbi treguesit e rimbursimit për çdo DRF, planin/faktin 2 mujor të rimbursimit, përqindjen e realizimit të planit, të dhëna në lidhje me numrin e: sëmundshmërisë kronike, rasteve të reja të sëmundshmërisë dhe rasteve me ndryshim terapie dhe efektet e secilës prej tyre në shumën e rimbursimit.
- Analiza e 2 mujorit aktual është krahasuar me analizën e 2 mujorit respektiv të vitit të mëparshëm, siç kërkohet në pikën pikën 5a, Kapitulli I-rë, i Udhëzimit nr.1/2019 të FSDKSH-së.

- Në analizën e shpenzimeve të rimbursimit dhe sëmundshmërisë kronike në shërbimin shëndetësor parësor është kryer analiza e 10 sëmundjeve me shpenzimet më të larta të rimbursimit , ndërsa në analizën e shpenzimeve të rimbursimit dhe sëmundshmërisë kronike për barnat që tregtohen ne farmacitë e spitaleve është bërë analiza e 20 diagnozave më të kushtueshme dhe janë krahasuar me periudhën përkatëse të një viti më parë, ashtu siç kërkohet në pikën 7 të Kapitullit III, të Udhëzimit nr.1/2019 të FSDKSH-së.

Nga verifikimi i respektimit të afateve për realizimin e analizave të rimbursimit rezultoi se, analizat e rimbursimit (2/6 mujore dhe ajo vjetore) janë dërguar tek Drejtori i Përgjithshëm, brenda afatit të përcaktuar në pikën 9, të kapitullit III, të Udhëzimit nr.1/2019, ku përcaktohet se: "*Konkluzionet me shkrim të analizës së rimbursimit për të gjithë vendin, të raportohen pranë Drejtorit të Përgjithshëm, brenda 10 ditëve pune nga ardhja e analizës së fundit nga DRF/DAPSHET/ DEGËVE. Nga DRF/DAPSHET/Degët analiza e rimbursimit duhet të dërgohet në excel, pranë DKPS brenda datës 20 të muajit pasardhës 2 mujor"*.

Treguesit e rimbursimit dhe sëmundshmërisë kronike në shërbimin spitalor parësor.

DKPS në analizat e saj 2 mujore ka paraqitur shpenzimet faktike, të planifikuara, rastet e reja të sëmundjeve, ndryshimet e terapisë për çdo rajon. Në gjashtë analizat 2-mujore të përgatitura nga DKPS, nga grupi i auditimit u identifikuan DRF-të me tejkalime të shpenzimeve të rimbursimit përgjatë vitit 2022, nga ku shuma progresive e tejkalimeve, për çdo DRF me tejkalim, paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.4.3.2 "Të dhënat në lidhje DRF-të me tejkalim të rimbursimeve gjatë 2-mujorëve "

DRF	Vlera e tejkalimeve	Herë tejkalimi
Berat	52,625,262	5
Lushnjë	42,645,071	5
Fier	45,306,200	5
Pogradec	17,110,100	5
Durrës	55,987,568	5
Elbasan	48,262,648	5
Dibër	19,554,818	5
Kukës	7,098,338	5
Korçë	25,691,038	5
Lezhë	27,217,639	5
Shkodër	15,814,959	5
Tiranë	125,798,256	4
Vlorë	25,710,123	4
Sarandë	4,593,925	4
Gjirokastër	7,417,294	4
Tropojë	912,174	3
Kamëz Vorë	17,305,413	3
Totali	**539,050,826**	**77**

Burimi i të dhënave: FSDKSH, Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga tabela më sipër rezulton se nga 102[5] raportime të DRF-ve të bëra gjatë vitit 2022, 77 raste kanë qenë më tejkalim të shpenzimeve të rimbursimit, në raport me planin e rimbursimit, me një vlerë totale të tyre në shumën 539,050,826 lekë. Nga analizat dymujore, të përgatitura nga ana e DKPS rezulton se rritjet e shpenzimeve të rimbursimit përtej planeve vijnë si rezultat i rasteve të reja të sëmundjeve dhe nga ndryshimet e terapisë, ku për çdo rajon evidentohen këto dy tregues. Dy mujori i fundit i vitit 2022 rezulton me mosrealizim të planit të rimbursimit, realizimi i tij është në masën 79%, ky 2-mujor ka "amortizuar" rastet e evidentuara me tejkalim gjatë dy mujorëve të parë duke bërë që në planin vjetor të mos kenë tejkalim të planit të

[5] 17 DRF *6 dy-mujorë=102 raportime

rimbursimit, kjo për shkak të shtimit të buxhetit të rimbursimit me anë të Aktit Normativ nr.17, datë 01.12.2023.
Shuma e planifikuar për shpenzimet e rimbursimit për shërbimin shëndetësor parësor ka qenë 7,712,125,366 lekë dhe realizimi në shumën 7,802,769,650 lekë ose në masën 101%, nga analiza vjetore rezulton se tejkalimi i planit të rimbursimit ka ardhur për shkak të rasteve të reja të sëmundjeve, të cilat në total kanë qenë 84,337 raste, me një vlerë rimbursimi 111,711,824 lekë, ndërsa rastet me ndryshim terapie përgjatë vitit 2022 kanë qenë 63,014 raste me një kosto totale 222,310,259 lekë.
Situata në lidhje me realizimin vjetor të rimbursimit, rastet dhe vlerat e rimbursimit për sëmundshmërinë kronike, rastet e reja dhe rastet me ndryshim terapie për periudhën 2021-2022 paraqiten si më poshtë:

Tabela nr.4.3.3 "Të dhënat në lidhje me realizimin e rimbursimit të SHSP për vitet 2021-2022

Në milionë lekë

Viti	Realizimi vjetor	% realizim	Sëmundshmëria Kronike		Raste të reja		Ndryshim terapie	
			Nr. i Rasteve	Rimbursimi	Nr. i Rasteve	Rimbursimi	Nr. i Rasteve	Rimbursimi
2021	7,624	106	3,831,923	634	75,919	110	53,386	181
2022	7,803	101	3,836,744	648	84,337	112	63,014	222
∆ 22-21	179		4,821	14	8,418	1	9,628	40

Burimi i të dhënave: FSDKSH, Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga tabela më sipër rezulton se në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021, rritja e shpenzimeve të rimbursimit të shërbimit spitalor me rreth 179 milionë lekë ka ardhur si rezultat i rritjes krahasuar me një vit më parë të: numrit të rasteve me sëmundje kronike me 4,821 raste me një vlerë afërsisht 14 milionë lekë, rasteve të reja të sëmundjeve me 8,418 raste me një vlerë totale afërsisht 1milionë [6]lekë dhe rasteve me ndryshim terapie me 9,628 raste me një vlerë 40 milionë lekë.

Treguesit e rimbursimit dhe sëmundshmërisë kronike për barnat që tregtohen në farmacitë e spitaleve

Në lidhje me treguesit e rimbursimit për barnat, që tregtohen në farmacitë e spitaleve nga DKPS janë kryer gjithashtu analizat 2 mujore, 6 mujore dhe ajo vjetore. Nga analizat e kryera janë evidentuar për çdo DRF realizimet faktike të rimbursimit kundrejt planit, sëmundshmëritë kronike, rastet e reja dhe rastet me ndryshim terapie.
Në total për vitin 2022 shpenzimet e rimbursimit për barnat, që tregtohen në farmacitë e spitaleve janë realizuar në masën 101.6%. Situata në lidhje me rimbursimet për barnat në farmacitë pranë spitaleve, sëmundshmërinë kronike, rastet e reja dhe ndryshimet e terapisë për periudhën 2021-2022 paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 4.3.4 "Analiza vjetore e rimbursimit të barnave në farmacitë pranë spitaleve dhe sëmundshmërisë kronike për vitet 2021-2022"

Në milionë lekë

Viti	Nr. Mjek specialistë	Plani vjetor	Realizimi vjetor	% realizim	Sëmundshmëria kronike		Raste të reja		Raste #mjekim	
					Nr rast	Rimb(lekë)	Nr rast	Rimb(lekë)	Nr. rast	Rimb(lekë)
2021	164	3,264	3,397	104	48,780	3,397	3,379	18	544	36
2022	166	3,638	3,694	102	51,617	3,694	3,568	229,	1,278	64
∆ (22-21)	2	374	297		2,837	297	189	43	734	28

Burimi i të dhënave: FSDKSH, Përpunuar nga Grupi i Auditimit

[6] 1,590 mijë lekë

Nga tabela më sipër në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 rezulton se, shpenzimet e rimbursimit, për barnat që tregtohen në farmacitë e spitaleve janë rritur me 297,437,280 lekë, kjo pasi:

- Recetat e sëmundshmërisë kronike janë rritur me 2,837 receta;
- Rastet e reja të të sëmurëve kronikë janë rritur më 189 raste me një rritje në vlerë të rimbursimit 43,362,995 lekë dhe rastet më ndryshim të mjekimit janë rritur me 734 me një vlerë prej 28,284,073 lekë.

Në lidhje me analizën e rimbursimit në shërbimin parësor spitalor dhe për barnat, që tregtohen në farmacitë e spitaleve rezulton se nga DKPS analizat janë kryer sipas kërkesave të përcaktuara në kapitullin III të Udhëzimit nr.1, datë 09.01.2019 të FSDKSH "*Për analizën e treguesve të rimbursimit dhe sëmundshmërisë në Strukturat e Fondit*", konkretisht është respektuar periodiciteti i paraqitjes dhe përgatitjes së analizave të rimbursimit sipas pikës 3, të kapitullit III të Udhëzimit nr. 1/2019 formati i analizës së rimbursimeve është sipas pikave 6-10 të kapitullit III, të Udhëzimit nr. 1/2019.

Veprimtaria e Drejtorisë së Kujdesit Parësor dhe Spitalor (DPKS) në lidhje më mbledhjen, përpunimin dhe monitorimin e të dhënave për paketat e shërbimeve shëndetësore spitalore, të financuara nga Fondi.

Në drejtim të mbulimit të popullsisë me shërbime shëndetësore ofrohen paketa të shërbimeve spitalore në ofruesit privat dhe publikë, të cilat financohen nga Fondi. Në Rregulloren nr.2/2020, mbi këto paketa përcaktohet se DKPS: *"Mbledh, përpunon dhe monitoron të dhënat që vijnë nga DRF/DSHSU mbi paketat e shërbimeve spitalore të financuara nga Fondi, të ofruara nga dhënësit e shërbimit publik, jopublik dhe partneriteti publik privat".* Kjo detyrë përfshihet dhe në planin vjetor të veprimtarisë, konkretisht në pikën 21 të tij përcaktohet se*: "Sektori Monitorimit dhe Kostifikimit të shërbimit spitalor çdo muaj evidenton paketat e realizuara në spitaleve publike e private dhe bën analizimin e tyre sipas llojit të paketës, gjithashtu bën krahasime, analiza dhe vlerësime përfundimtare mbi numrin e pacienteve që kanë përfituar".*

Nga ana e DKPS janë paraqitur në mënyrë të përmuajshme informacionet e konsoliduara, për çdo paketë të ofruar nga spitalet publike dhe private, gjithashtu në fund të vitit është paraqitur analiza vjetore, në lidhje me këta tregues. Në mënyrë të përmbledhur informacioni mbi numrin e paketave të ofruara me financim nga Fondi në institucionet publike dhe private paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 4.3.5 "Numri i paketave të ofruara për vitet 2020-2022 me financim nga Fondi"

Njësi

Viti	Grafte	Kataraktë	Fistula	Kardiokirurgji	Kardiologjia	Transplante	Flakje Akute e veshkës	Seanca dialize	Shërbime Sterilizimi
2020	32	2,089	170	628	5,484	10	2	178,998	104,868
2021	24	3,018	192	654	7,103	23	-	190,766	133,143
2022	34	3,790	255	793	8,572	13	1	193,878	142,752

Burimi i të dhënave: FSDKSH, Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga tabela më sipër rezulton se numri i paketave të ofruara në spitalet publike dhe private në vitin 2022 ka pasur rritje krahasuar me ato të ofruara vitet 2021 dhe 2020, përveç paketës së transplanteve dhe paketës së flakjes akute.

Rritja e paketave të ofruara është reflektuar dhe në rritjen e ditëve të shtrimit në spital, që janë më të larta në vitin 2022, tregues që gjithashtu monitorohet nga ana e DKPS (në analizat e treguesve të aktivitetit mjekësor në spitale). Në mënyrë të detajuar ditët e shtrimeve në spitale sipas llojit të tyre, shfrytëzimi i shtretërve, numri i vizitave ambulatore dhe ditët mesatare të qëndrimit në spital paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 4.3.6 "Shtrimet sipas llojeve të spitaleve për vitet 2020-2022"

Kategoria e Spitaleve	2022			2021	2020
	Nr. Shtrimeve	Shtrime urgjente	% shtrime urgj/total shtretërish	Nr. Shtrimeve	Nr. Shtrimeve
Bashkiake	25,527	21,742	85%	22,601	22,942
Universitare	159,467	51,109	32%	155,385	126,986
Rajonale	92,878	76,814	83%	79,709	68,480
Totali	**277,872**	**149,665**	**54%**	**257,695**	**218,408**

Burimi i të dhënave: FSDKSH, Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga tabela më sipër rezulton se numri i shtrimeve në të tri kategoritë e spitaleve në vitin 2022 është më i lartë se në dy vitet paraardhëse, konkretisht 20,177 raste më shumë se viti 2021 dhe 59,464 raste më shumë se viti 2020. Situata më e detajuar, në lidhje me treguesit spitalorë për periudhën 2020-2022 paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 4.3.7 "Treguesit spitalorë sipas kategorive të spitaleve për vitet 2020-2022"

VITI	Treguesi	Spitalet		
		Bashkiake	Universitare	Rajonale
2022	Shfrytëzim shtrati	17.2	80.2	30.5
	Ditë qëndrimi mesatar	4.8	3.8	4.2
	Vizita ambulatore	267,672	473,567	761,314
2021	Shfrytëzim shtrati	15.3	69.7	27.2
	Ditë qëndrimi mesatar	4.8	3.8	4.3
	Vizita ambulatore	261,451	431,109	667,059
2020	Shfrytëzim shtrati	15.3	57.0	22.7
	Ditë qëndrimi mesatar	4.7	3.8	4.2
	Vizita ambulatore	213,619	302,614	505,404

Burimi i të dhënave: FSDKSH, Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga tabelat më sipër rezulton se shtrimet janë më të larta në spitalet universitare, duke bërë që dhe treguesi i shfrytëzimit të shtratit të jetë më i lartë në këtë kategori spitalesh, kjo për shkak të specialitetit të tyre[7]. Të gjithë treguesit spitalorë, në vitin 2022 janë rritur krahasuar me dy vitet e mëparshme.

Në lidhje me monitorimin e paketave nga Fondi është nxjerrë Urdhri nr. 18, datë 3.12.2019 "Për monitorimin e paketave shëndetësore të financuara nga FSDKSH në institucionet publike dhe jo publike", ky udhëzim është për DAPSHET dhe DRF-të për mënyrën si duhet të raportojnë dhe të mbajnë të dhënat në lidhje me paketat e financuara nga Fondi, por nuk ka seksion të veçantë mbi mënyrën e raportimit dhe analizimit që duhet të kryhet prej *Sektorit të Monitorimit dhe Kostifikimit të Shërbimit Spitalor, të* DKPS-së.

Përgatitja e dokumentacionin lidhur me paketën e kontrollit mjekësor bazë.

Në lidhje Paketën e Kontrollit Mjekësor Bazë, bazuar në Kontratën e Financimit mes Fondit dhe shoqërisë "3P." SHPK dhe në Udhëzimin Nr. 12 Datë 18.05.2015 "*Për procedurat e pagesës së Shoqërisë "3P." SHPK*", Sektori i Monitorimit të Indikatorëve dhe Kontrollit Mjekësor bazë, pranë DKPS çdo muaj mbledh, verifikon dhe përpunon të dhënat mbi numrin e kontrolleve mjekësore bazë të realizuara nga për çdo Drejtori Rajonale të Fondit(DRF), i verifikon, përgatit dhe dorëzon dosjen për kryerjen e pagesës së Koncesionarit pranë Drejtorisë Ekonomike të Fondit, brenda datës 30 të muajit pasardhës, siç përcaktohet në Udhëzimin nr.12/2015.

[7] Më shumë mjekë specialistë.

Titulli i Gjetjes: **Vonesa nga DRF-të për dërgimin e informacionit mbi Kontrollin Mjekësor Bazë.**

Situata: Nga grupi i auditimit, për verifikimin e realizimit nga DKPS të procedurës së përgatitjes së dokumentacionit në lidhje më Kontrollin Mjekësor Bazë, u përzgjodhën praktikat për 4 muaj të vitit 2022, konkretisht muaji mars, korrik, tetor dhe dhjetor. Në katër praktikat e përzgjedhura u verifikua procesi nga mbledhja e të dhënave prej DRF-ve deri në dërgimin e dosjes me dokumentacionin përkatës, për realizimin e pagesës së Koncesionarit tek Drejtoria Ekonomike e Fondit.

Nga verifikimi i praktikave për 4 muajt e përzgjedhur rezultoi se:

- Nga ana e DRF-ve ka pasur raste të tejkalimit të afatit, të parashikuar në pikën 2 të Udhëzimit të FSDKSH-së nr. 12, datë 18.05.2015, ku përcaktohet se: "....*rezultati i Kontrollit bazë shëndetësor për çdo QSH dhe për të gjithë Rajonin nënshkruhet nga Drejtori i DRF dhe* ***brenda datës 15 të çdo muaji*** *dërgohet në Sektorin e Kontrollit Mjekësor Bazë, pranë DKPS në FSDKSH*". Rastet e vonesave paraqiten si më poshtë:

Në muajin *korrik* tri raste vonesash në dërgimin e informacionit:

- Nga DRF Elbasan informacioni është dërguar me anë të shkresës nr. 840, datë 23.08.2022 , protokolluar në FSDKSH me nr.5258, datë 24.08.2022;
- Nga DRF Dibër informacioni është dërguar me anë të shkresës nr. 855, datë 16.08.2022 , protokolluar në FSDKSH me nr.5198, datë 18.08.2022;
- Nga DRF Tropojë informacioni është dërguar me anë të shkresës nr. 292, datë 23.08.2022 , protokolluar në FSDKSH me nr.5303, datë 26.08.2022.

Në muajin *dhjetor* gjithashtu tri raste vonesash në dërgimin e informacionit:

- Nga DRF Durrës informacioni është dërguar me anë të shkresës nr. 82, datë 16.01.2023, protokolluar në FSDKSH me nr.1/19, datë 20.01.2023;
- Nga DRF Lezhë informacioni është dërguar me anë të shkresës nr. 4/7, datë 16.01.2023, protokolluar në FSDKSH me nr.1/16, datë 18.01.2023;
- Nga DRF Lushnjë informacioni është dërguar me anë të shkresës nr. 119/1, datë 16.01.2023, protokolluar në FSDKSH me nr.1/13, datë 17.01.2023.

Në rastet e mësipërme, data në shkresat e dërguara nga DRF-të janë përtej datës 15, të muajit pasues, gjithashtu datat e mbërritjes së informacionit në Fond janë kryesisht përtej datës 15 të muajit pasues.

Kriteri:

- Pika 2 e Udhëzimit të FSDKSH-së nr. 12, datë 18.05.2015,
- Pika 3 e Udhëzimit të FSDKSH-së nr. 12, datë 18.05.2015 "*DKPS (Sektori i Kontrollit Mjekësor Bazë) pranon dokumentacionin e ardhur nga DRF-të, duke rakorduar të dhënat me raportin përmbledhës të nxjerrë nga administratori i sistemit, dorëzuar nga Shoqëria koncesionare "3P." SHPK, së bashku me dokumentacionin e miratuar për pagesën mujore* ".

Ndikimi/Efekti:	Vonesa në raportimin e të dhënave nga DRF-të, ngushton afatin kohor gjatë të cilit Sektori i Kontrollit Mjekësor Bazë bën verifikimin dhe rakordimin e të dhënave mbi Kontrollin Mjekësor Bazë, siç përcaktohet në pikën 3 të Udhëzimit nr.12/2015, të FSDKSH-së.
Shkaku:	Mos respektimi i afatit, të parashikuar për dërgimin e informacionit nga DRF-të.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtoria e Kujdesit Parësor dhe Spitalor të raportojë në strukturat përgjegjëse, mbi vonesat e pa arsyetuara DRF-ve për dërgimin e informacionit në lidhje me Kontrollin Mjekësor Bazë dhe të përfshijë në Udhëzimin nr. 12 datë 18.05.2015 "Për procedurat e pagesës së Shoqërisë "3P." SHPK, masa për tejkalimin e afateve për çdo strukturë, që raporton sipas udhëzimit.

Nga verifikimet e kryera nga ana e Sektorit të Kontrollit Mjekësor Bazë dhe rakordimet me Koncesionarin "*3P*.", të kryer sipas kontratës se financimit nr.1195/2, datë 15.04.2015 për 4 muajt e përzgjedhur konstatohet se nuk ka diferenca mbi numrin kontrolleve mjekësore bazë, mes raportimeve në Fond nga DRF-të dhe nga koncensionari. Informacioni i rakorduar nga ana e Sektorit të Kontrollit Mjekësor Bazë është dërguar pranë Drejtorisë Ekonomike, në formën e parashikuar në pikën 7 të Udhëzimit nr.12/2015 të FSDKSH-së dhe brenda datës 30 të muajit pasardhës(afat i përcaktuar gjithashtu në pikën 7 të udhëzimit).
Gjatë vitit 2022, situata e realizimit të Kontrolleve Mjekësore Bazë paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.4.3.8 "Kontrollet mjekësore bazë të realizuara sipas DRF-ve kundrejt projeksionit mujor/vjetor për vitin 2022"

Muaji	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Viti 2022
Fakti[8]	31,654	39,940	40,241	38,859	39,662	38,270	31,733	36,198	39,659	41,120	39,727	37,765	454,828
%realizimit[9]	80%	101%	102%	98%	100%	97%	80%	91%	100%	104%	100%	95%	96%

Burimi i të dhënave: FSDKSH, Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga tabela më sipër rezulton së gjatë vitit 2022, janë realizuar në total 454,828 kontrolle mjekësore bazë (Check up), ose 96 % e atyre të parashikuara në nenin 3 dhe 4 të kontratës së financimit mes koncesionarit dhe Fondit, ku dyshemeja, për të cilat bëhet pagesa është 475,000 raste në vit, bazuar në këtë shifër vjetore projektohet me bazë mujore nga ku për çdo muaj të vitit parashikohen të kryhen 39,583 raste minimale. Muajt për të cilat ka pasur tejkalim të projeksioneve kanë qenë 3 (shkurt, shtator, tetor).

Analizimi i treguesve të shërbimeve të koncesionarit të Laboratorit PPP në spitalet publike.
Nga ana e DKS përgjatë vitit 2022 i është dërguar 4 herë informacion, Drejtorit të Përgjithshëm, mbi treguesit e shërbimeve të koncesionarit te laboratorit në spitale publike.
Nga verifikimi i analizave të përgatitura nga DKPS, në lidhje më shërbimet e Laboratorit PPP në spitalet publike rezultoi se ekzaminimet totale për vitin 2022 kanë qenë 4,205,767 me një kosto totale sa 95% e tavanit buxhetor të parashikuar, në vlerën 1,559,630 mijë lekë.

Titulli i Gjetjes:	**Mos rakordim paraprak i të dhënave nga DRF-të dhe Koncesionari i laboratorit mbi treguesit e shërbimeve të koncesionarit.**
Situata:	DKPS sipas pikës 13, të kreut III, të kapitullit VI të Rregullores nr. 2/2020: "*Organizon punën në monitorimin e aktiviteteve të shërbimit*

[8] Numri i Kontrolleve Mjekësore Bazë të realizuara.
[9] Përqindja e realizimit ndaj projeksionit mujor, të parashikuar.

parësor e spitalor, në zbatim të kontratave të lidhura me ofruesit e shërbimeve shëndetësor". Nga grupi i auditimit u verifikuan 4 analizat tremujore, mbi treguesit e shërbimeve të koncesionarit të Laboratorit, nga ku, u evidentuan të dhënat për çdo muaj të analizës si: numri i ekzaminimeve, tavani buxhetor, fakti i realizimit dhe përqindja e realizimit, këto shifra u konsoliduan për vitin 2022 dhe u bë rakordimi me analizën vjetore, ku në mënyrë të detajuar të dhënat e përmbledhura mbi këta tregues për çdo muaj paraqiten si më poshtë:

Tabela nr.4.3.9 "Të dhënat e treguesve të Shërbimeve të Koncesionarit të Laboratorit gjatë vitit 2022"

Mijë lekë

Muaji	Nr. Ekzaminimesh	Tavani Buxhetor	Fakti	% realizim
Janar	479,109	177,343	180,279	102%
Shkurt	434,344	157,882	166,922	106%
Mars	**351,355**	**142,887**	**136,627**	96%
Prill	334,645	138,939	123,877	89%
Maj	343,090	128,450	126,686	99%
Qershor	320,217	113,654	116,848	103%
Korrik	282,303	107,607	101,320	94%
Gusht	281,009	96,809	99,143	102%
Shtator	296,131	108,809	108,088	99%
Tetor	349,581	139,972	129,790	93%
Nëntor	352,056	145,534	130,497	89.7%
Dhjetor	370,916	148,307	139,757	94%
I.Total	4,194,756	1,606,193	1,559,834	97%
II.Realizimi vjetor	4,205,767	1,639,002	1,559,630	95%
III.Diferenca	**11,011**	**32,809**	**(204)**	

Burimi i të dhënave: FSDKSH, Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga tabela më sipër, rezulton se rreshti "*I.Total*", në të cilin paraqitet shuma aritmetike e 12 muajve, ku për çdo muaj janë marrë të dhënat nga analizat 3 mujore nuk rakordon me totalin "*Realizimi vjetor*", të paraqitur në analizën vjetore. Treguesit e Laboratorit të PPP, të paraqitur në analizat përkatëse nuk janë koherente nga një paraqitje në tjetrën, konkretisht:

- Për muajin mars 2022, në memon dërguar Drejtorit të Përgjithshëm nr.3239, datë 27.04.2022 numri i ekzaminimeve paraqitet 351,355 raste, tavani buxhetor 142,887 mijë lekë dhe fakti 142,887 mijë lekë, ndërsa në treguesit e 6 mujorit të parë të vitit 2022, të paraqitur në tabelën nr. 2 të memos drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm nr.4919, datë 29.07.2022 të dhënat muajit mars paraqiten: 363,043 ekzaminime, tavani buxhetor 144,062 mijë lekë dhe fakti i realizimit 136,560 mijë lekë.
- Nga konsolidimi vlerave mujore të treguesve në të dhënat 3, 6, 9 dhe 12 mujore, të bërë nga grupi i auditimit rezulton se totali progresiv i muajve ka një diferencë me shifrat e analizës progresive vjetore të paraqitur me anë të memos nr.412, datë 31.01.2023 (në tabelën më sipër është rreshti "*II. Realizimi vjetor"*), numri i ekzaminimeve paraqitet 11,011 raste më shumë në analizën vjetore, tavani buxhetor 32,809 mijë lekë më shumë në analizën vjetore dhe realizmi (fakt) 204 mijë lekë më pak.

Kjo diferencë sipas DKPS, vjen për shkak se të dhënat që paraqiten në analiza kanë si burim, të dhënat e koncesionarit, pasi nuk kryhen

	rakordime prej DRF-ve në mënyrë periodike, që të mundësohet verifikimi dhe saktësimi i informacioneve.
Kriteri:	*Pika 13 e kreut III, të kapitullit VI të* Rregullores nr. 2 "*Për organizimin, funksionimin dhe përshkrimet e punës për drejtorinë e përgjithshme të Fondit*", miratuar me Urdhrin nr. 277, datë 06.07.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm.
Ndikimi/Efekti:	Paraqitje e pasaktë e analizës së treguesve të shërbimit të laboratorit.
Shkaku:	Mungesa e një udhëzimi në lidhje me monitorimin dhe realizimin e treguesve të shërbimeve laboratorike.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtori i Përgjithshëm i FSDKSH dhe Drejtori i Drejtorisë së Kujdesit Parësor dhe Spitalor, të marrin masa për të nxjerrë një udhëzim në lidhje me analizimin e treguesve të shërbimit laboratorit, ku të përcaktohen me detaje afatet e raportimit nga spitalet, DRF-të dhe nga ofruesi, mënyra si do të bëhen rakordimet e këtyre të dhënave nga Fondi, treguesit që duhen paraqitur në analizat e kryera nga DKPS dhe mënyrën si duhet të kryhet monitorimi i tyre.

Analizimi i aktivitetit të paketave shëndetësore dhe sterilizimit të instrumenteve kirurgjikale.

FSDKSH përgjatë vitit 2022 ka lidhur kontrata me institucionet shëndetësore publike dhe jo publike për ofrimin e paketave të dializës, kardiologjisë, kardiokirurgjisë, transplantit të veshkës, terapisë së flakje akute, fistulës, etj. Në pikën 10, të Kreut III, të Kapitullit VI, të Rregullores nr.2/2020 përcaktohet se "*DKPS bën mbledhjen , përpunimin dhe monitorimin e të dhënave që vijnë nga DRF/ DSHSU mbi paketat e shërbimeve shëndetësore spitalore, të financuara nga Fondi, të ofruara nga dhënësit e shërbimit publik, jo publik dhe partneriteti publik privat"*. Kjo detyrë nga DKPS është përfshirë dhe në planin e saj vjetor të punës, konkretisht në pikën 21 të planit, ku paraqitet "*Evidentimi i paketave të kryera sipas spitaleve publike e private analizimi i tyre sipas llojit të paketës, kohës së kryerjes, shpenzimeve për secilën paketë dhe sipas spitaleve qe e ofrojnë*". Periodiciteti i kësaj detyre në plan, është çdo muaj. Nga verifikimi i realizimit të kësaj detyre rezultoi se në mënyrë të përmujashme nga DKPS është paraqitur informacion mbi paketat e ofruara sipas qendrave të ofrimit. Në periudhën 12 mujore aktiviteti i paketave shëndetësore paraqitet si më poshtë:

Paketa e dializës

Shërbimi i paketës së dializës ofrohet në 1 spital publik (QSUT), 8 institucione shëndetësore jopublike dhe 1 PPP (shoqëri Koncesionare). Gjatë vitit 2022, nga shoqëria "DV[10]" janë realizuar seancat e dializës, sipas institucioneve ofruese , si më poshtë:

Tabela nr.4.3.10 "Numri i pacientëve dhe seancave të dializës për vitin 2022 sipas llojit të institucioneve ofruese"

Institucione	Nr. Pacientëve	Seancat	% ndaj total pacient	% ndaj total seanca
Publike	1,371	10,766	8%	6%
Jo publike	9,983	119,830	60%	62%
PPP	5,188	63,282	31%	33%
Totali	**16,542**	**193,878**	**100%**	**100%**

Burimi i të dhënave: FSDKSH, Përpunuar nga Grupi i Auditimit

[10] Shoqëri e kontraktuar nga Fondi për ofrimin e shërbimit të Dializës.

Nga tabela më sipër rezulton se gjatë vitit 2022 kanë marrë shërbimin e dializës 16,542 pacientë, të cilët kanë kryer 193,878 seanca dialize; 62% e seancave të dializës janë realizuar në institucionet jo publike, 33% nga koncesionari dhe vetëm 6% në instiicionet publike.
Në analizën vjetore të paraqitur nga DKPS trajtohet specifikisht, projeksioni dhe fakti i numrit të seancave të dializës, të numrit të seancave sipas projeksionit, pacientët faktikë dhe realizimi i numrit të pacientëve dhe numrit të seancave ndaj projeksionit. Analiza paraqet të dhëna të detajuara për 12 muajt e vitit, për 5 spitalet rajonale, ku ofrohet shërbimi i dializës nga PPP. Në mënyrë të përmbledhur situata për vitin 2022 në 5 spitalet rajonale, ku ofrohet shërbimi i dializës nga koncesionari, paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 4.3.11 "Seancat dhe pacientët që kanë marr shërbim dialize përgjatë 2022"

Nr. i pacientëve sipas projeksionit vjetor	Nr. seancave të projeksion	Nr. Pacientëve faktik	Nr. seancave faktik	% realizim të nr. të pacient	% e realizim të seancave
450	70,200	429	**63,282**[11]	95%	90%

Burimi i të dhënave: FSDKSH, Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Për vitin 2022 janë planifikuar 450 pacientë dialize, ku secili prej tyre parashikohet të kryejë 13 seanca në muaj, nga ku totali i seancave vjetore të parashikuara ka qenë 70,200 seanca dialize. Numri faktik i pacientëve për vitin 2022 ka qenë 95% e projeksionit vjetor, ndërsa realizimi i seancave, 90% e projeksionit vjetor, kjo ka ardhur pasi jo në të gjithë muajt janë realizuar 13 seanca dialize/pacient.
Nga verifikimi i analizës vjetore të paraqitur nga ana e DPKS, rezultoi se treguesit e shërbimit të dializës janë paraqitur të konsoliduar, por **mungon një analizë e detajuar mbi trendet e ndryshimeve** dhe faktorët që i kanë sjellë, për të mundësuar monitorimin e këtyre treguesve.

Paketa e Sterilizimit me koncensionarin "SS".
Shoqëria Koncesionare "S." ofron në spitalet publike shërbimet e integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me material mjekësor steril një përdorimesh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve biologjike dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale. Gjatë vitit 2022 kanë marrë shërbimin e sterilizimit 63,230 raste të ndërhyrjeve kirurgjikale nga 63,608 të planifikuara ose 97% e projeksionit vjetor. Gjatë vitit 2022 është ofruar shërbimi i sterilizimit në 29 spitale publike (5 Spitale Universitare në Tiranë, 11 Spitale Rajonale dhe 13 Spitale bashkiake). Situata e përmbledhur, për vitin 2022, në lidhje me ndërhyrjet kirurgjikale dhe shërbimet e ofruara nga koncesionari i sterilizimit krahasuar me një vit më parë paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr.4.3.12 "Shërbimet e ofruara nga Koncesionari i sterilizimit për vitet 2021-2022"

Nr.	Kompleksiteti i ndërhyrjes	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca	Rritja ose ulja në %
1	I Lartë	14,936	12,753	2,183	17%
2	I Mesëm	23,143	22,327	816	4%
3	I Ulët	23,151	19,899	3,252	16%
4	Paketimi me avull	**77,584**	74,631	2,953	4%
5	Sterilizim me temp. të ulët	3938	3061	877	29%
Totali		142,752	132,671	10,081	1

Burimi i të dhënave: FSDKSH, Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga krahasimi i ndërhyrjeve kirurgjikale me kompleksitet të lartë të kryera në vitin 2022, rezulton se janë kryer 2,183 ndërhyrje më tepër, kjo rritje vihet re në 4 spitalet universitare: Spitalin Universitar të Traumës; QSUT; Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë" dhe Spitalin Universitar "Shefqet Ndroqi".

[11] Numri seancave të dializës së ofruara në 5 spitalet rajonale nëpërmjet koncensionarit (PPP)

Numri i ndërhyrjeve me kompleksitet të mesëm në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021 në disa spitale ka pësuar rritje, ku përfshihen: Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi", QSUT, spitalet rajonale Shkodër, Elbasan, Vlorë, Lezhë dhe Gjirokastër, si dhe spitali bashkiak Krujë. Në 16 spitale të tjera, numri i ndërhyrjeve me kompleksitet të mesëm ka pësuar ulje në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021.
Në vitin 2022 numri i Paketimeve me avull në total është rritur me 3.2 % ose 2,446 paketime me avull më shumë në krahasim me vitin 2021 (77,086-74,640).
Numri i paketimeve me avull është rritur në: Spitalin Universitar të Traumës, Spitalin Universitar "Shefqet Ndroqi", Spitalin Rajonal Vlorë, Berat, Lezhë, Kukës dhe bashkiak Lushnjë.
Në vitin 2022 numri i Sterilizimeve me temperaturë të ulët është rritur me 758 sterilizime ose 24.7 % më shumë krahasuar me vitin 2021.
Gjatë vitit 2022 ka një rritje të diagnozave të trajtuara në spitale, që kanë marrë shërbime sterilizimi nga "S." krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.
Nga analiza e paraqitur nga ana e DKPS rezulton se në lidhje me këto trende të ndryshimeve të ndërhyrjeve, ka ndikuar rritja e të numrit të pacientëve që kërkojnë trajtim mjekësor në periudhën post covid krahasuar me vitin 2021, reflektuar dhe me rritjen e numrit të shtrimeve, etj.

Realizimi i inspektimeve përgjatë vitit 2022.
Një nga detyrat e DKPS, përcaktuar në kreun III, të Kapitullit VI, të Rregullores nr.2/2020 është organizimi i inspektimeve në DRF, QSH dhe spitale të kontraktuara nga Fondi, në zbatim të akteve nënligjore nga Fondi. Gjatë vitit 2022 nga Drejtori i Përgjithshëm i Fondit janë nxjerrë 8 urdhra inspektimesh, të cilat kanë mbuluar me inspektim 20 subjekte nga ku, 12 DRF; Drejtorinë e Shërbimeve Spitalore Universitare(DSHSU) Tiranë, spitalin Universitar Shefqet Ndroqi; spitalin Rajonal Berat, Institucionin shëndetësor jopublik A. Berat dhe Spitalin A dega Durrës, Gjirokastër, Degën Tirana 1 dhe Tirana 2 si dhe disa qendra shëndetësore. Bazuar në Urdhrat e inspektimit, në të cilat përcaktohet afati i inspektimit rezultoi se në total ditët e punës gjatë të cilave janë realizuar inspektime nga kjo drejtori janë 67 ditë, nga ku llogaritet se për çdo subjekt të inspektuar është shpenzuar 3.35 ditë pune, në mënyrë të detajuar afatet në ditë sipas urdhrave të inspektimit paraqiten si më poshtë:

Tabela nr.4.3.13 "Afatet e inspektimit në ditë punë sipas urdhrave përkatës të inspektimit për vitin 2022"

Nr.	Urdhri i inspektimit(afati i inspektimit)	Afati i inspektimit(ditë/pune)
1	nr.54, datë 18.02.2022(21.02-04.03.22)	10
2	nr.144, datë 06.05.2022 (09.05-20.05.22)	10
3	nr.195, datë 10.06.2022 (13.06-29.06.22)	13
4	nr.232; datë 06.07.2022(12.07-20.07.22)	7
5	nr.233; datë 06.07.2022(12.07-20.07.22)	7
6	nr.278, datë 08.09.2022 (12.09-16.09.22)	5
7	nr.279, datë 08.09.2022 (14.09-23.09.22)	8
8	nr.384, datë 21.11.2022 (21.11-25.11.22)	5
9	Nr.408, datë 02.12.2022 (05.12.-07.12.22)	2
Totali		**67**

Burimi i të dhënave: FSDKSH; Përpunuar nga grupi i auditimit

Nga verifikimi i procesit të inspektimit të realizuar nga DKPS u verifikuan të gjithë dosjet e inspektimeve të kryera gjatë vitit 2022, nga ku rezultoi se:
Të gjithë urdhrat e inspektimit janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr.20, datë 24.12.2019 "*Mbi Metodikën e inspektimit, monitorimit dhe funksionimit të ofruesve të shërbimit shëndetësor parësor dhe spitalor të kontraktuar nga FSDKSH*". Konkretisht në to

përcaktohet subjekti/et që do të inspektohen, tematikat e inspektimit, grupi i punës së inspektimit (mbi 2 anëtarë), afati i inspektimit dhe mënyra e raportimit.
Dosjet përmbajnë dokumentacionet e kërkuara në Udhëzimin nr. 20/2019, afatet e inspektimit janë respektuar dhe forma e raportimit tek titullari, në të gjitha rastet është siç kërkohet në urdhrat e inspektimit.

Titulli i Gjetjes:	**Raporte inspektimi jo në përputhje me Udhëzimin e inspektimit dhe mungesë kriteresh për përcaktimin e subjekteve të inspektuara.**
Situata:	Nga verifikimi i procesit të inspektimit rezultoi se, 5 raporte inspektimi nga 8 të realizuara gjatë vitit 2022, nuk janë të strukturuar sipas kërkesave të pikës 3, të Kapitullit IV të Udhëzimit nr.20/2019 të FSDKSH-së, ku përcaktohet se: "*Raportet duhet t'i referohen dispozitave që nuk janë zbatuar duke emërtuar(numrin e datën e aktit, nenin ose pikën e dispozitës që nuk është zbatuar, ose zbatuar pjesërisht*. Në raportet e inspektimit, në zbatim të Urdhrave të inspektimit nr.54, datë 18.02.2022; nr.144, datë 06.05.2022; .233, datë 06.07.2022; nr.279, datë 08.09.2022 dhe nr.384, datë 21.11.2022 nuk paraqiten problematikat konkrete, duke saktësuar dispozitën apo aktin me të cilin nuk janë në përputhje. Raportet e paraqitura në të gjitha rastet e sipërcituara shprehen se: "*Nga ana e DRF-ve janë respektuar kriteret për realizimin e analizave*", në lidhje me këtë konkluzion DKPS informacionin e paraqitur në raport mund ta sigurojë dhe pa realizuar procesin e inspektimit, pasi të dhënat e analizave raportohen pranë saj nga ana e DRF-ve në mënyrë periodike, sipas udhëzimeve përkatëse. DKPS në këto raporte u ka rekomanduar DRF-ve monitorimin e tejkalimeve apo mosrealizimeve. Rekomandimet nuk lidhen specifikisht me problematikat e evidentuara nga inspektimi dhe nuk janë të detajuara dhe të lidhura specifikisht me situatat konkrete të rezultuara nga procesi i inspektimit, siç parashikohet të jenë në pikën 3 të Kapitullit VI të Udhëzimit nr.12/2019 të FSDKSH-së. Pesë raportet e mësipërm, të drejtuar subjekteve të ndryshme, sipas Urdhrave përkatës, kanë të njëjtat rekomandime. Për periudhën 2020-2022, DSHSU dhe DRF-të Fier, Berat, Vlorë, Kamëz dhe Vorë janë mbuluar me inspektim më shumë se njëherë dhe DRF-të Korçë dhe Pogradec nuk janë inspektuar asnjëherë. Po për të njëjtën periudhë 3 qendra të ofrimit të shërbimit të dializës janë inspektuar më shumë se njëherë, konkretisht "Spitali A", Dega Durrës që mbulon me shërbim 17% të pacientëve është inspektuar tri herë, Institucioni shëndetësor jo publik "A. Berat", që mbulon me shërbim 9% të pacientëve 2 herë ndërsa "Spitali A 3"dhe "Spitali H.", që mbulojnë me shërbimin e dializës përkatësisht 12% dhe 21% të pacientëve nuk janë inspektuar asnjëherë.
Kriteri:	Pika 3, e Kapitullit VI e Udhëzimit nr.20, datë 24.12.2019 "*Mbi Metodikën e inspektimit, monitorimit dhe funksionimit të ofruesve të shërbimit shëndetësor parësor dhe spitalor të kontraktuar nga FSDKSH*".
Ndikimi/Efekti:	Raportet e inspektimit të përgjithësuara nuk sjellin vlerë të shtuar në subjektet e inspektuara.

Shkaku:	Mos respektimi i kritereve të përcaktuara në pikën 3 të kreut VI, të Udhëzimit nr. 20/2019 dhe mos parashikimi në këtë udhëzim i kritereve që do të shërbejnë si bazë në përzgjedhjen e subjekteve për inspektim.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi 1:	Nga Drejtoria e Kujdesit Parësor dhe Spitalor të merren masa, që çdo punonjës i saj, i ngarkuar për të realizuar procesin e inspektimit, të zbatojë me përpikmëri kërkesat dhe procedurat e përcaktuara në udhëzimin e inspektimit.
Rekomandimi 2:	Drejtori i Përgjithshëm i FSDKSH dhe Drejtori i Drejtorisë së Kujdesit Parësor dhe Spitalor të marrin masa, për të rishikuar dhe bërë disa ndryshime në Udhëzimin nr.20/2019 "Mbi metodikën e inspektimit, monitorimit dhe funksionimit të ofruesve të shërbimit shëndetësor parësor dhe spitalor të kontraktuar nga FSDKSH", në lidhje me përcaktimin e kritereve, mbi të cilat do të bëhet përzgjedhja e subjekteve, për inspektim.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: Drejtori i Drejtorisë së Kujdesit Parësor dhe Spitalor znj. M.M. dhe Drejtori i Përgjithshëm znj. A.Ç..

Sa më sipër arrihet në konkluzion:

- DKPS përgjatë vitit 2022, përgjithësisht ka realizuar veprimtarinë në drejtim të përmbushjes së misionit dhe objektivave të saj, të përcaktuara në Kapitullin VI të Rregullores nr. 2 "Për organizimin, funksionimin dhe përshkrimet e punës për drejtorinë e përgjithshme të Fondit", miratuar me Urdhrin nr. 277, datë 06.07.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm.
- Nga DKPS, nuk është punur në drejtim të përmirësimit të udhëzimeve në lidhje me kryerjen e analizave të treguesve periodikë, me qëllim unifikimin e këtyre treguesve në nivel vjetor.
- Procesi i realizimit të inspektimeve nuk ka qenë i mirë zbatuar, sipas kërkesave të udhëzimit për inspektimet në lidhje me mënyrën e paraqitjes së raportit të inspektimit. Gjithashtu, ka mangësi në procedurat e përcaktuara në udhëzimin e inspektimeve, pasi mungojnë kriteret e përzgjedhjes së subjekteve për inspektim.
- DKPS nuk ka ndërmarrë aktivitete kontrolli shtesë, për të realizuar në mënyrën e duhur kryerjen e verifikimeve të të dhënave nga kontratat me paketat e shërbimeve, nëpërmjet kryqëzimit të të dhënave mujore nga DRF-të dhe informacionit të sjellë nga koncesionari.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, mbi këtë drejtim auditimi, nuk janë paraqitur observacione.

2.5. Auditimi i përputhshmërisë së prokurimeve publike për mallra, shërbime dhe punë me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi duke përfshirë procesin nga hartimi i nevojave, përcaktimin e fondit limit, studimin e tregut, zgjedhjen e procedurës, zhvillimin e procedurës, deri në marrjen në dorëzimin të kërkesa të prokuruara nëpërmjet zbatimit të kontratës.

Për auditimin e këtij drejtimi u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Regjistri i parashikimit dhe realizimeve të prokurimeve publike për vitin 2022.
2. Planifikimi buxhetor i prokurimeve.
3. Dosjet e procedurave të prokurimeve.

4. Procedurat e prokurimit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) në faqen e APP (http://ŵŵŵ.app.gov.al/).
Për vitin 2022, Personat Përgjegjës për Prokurimet (PPP), janë përcaktuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor (AK) znj. A.Ç., me anë të Urdhrit nr. 6, datë 14.01.2022, si më poshtë:
1. z. A. S, me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve;
2. z. A.K, me detyrë Specialist i Sektorit të Prokurimeve;
Me urdhër të titullarit nr. 118 prot, datë 19.04.2022, është bërë zëvendësimi i personave përgjegjës të prokurimeve z. A. S. me z. E. D.
-Regjistri i parashikimeve të prokurimeve për vitin 2022, është miratuar me shkresën nr. 130/3 prot., datë 01.03.2022, jashtë afateve kohore, jo në përputhje me kërkesat e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu II, neni 3, pika 3.
Nga verifikimi i SPE, konstatohet se regjistri i parashikimeve dhe realizimeve për vitin 2022, është si vijon:

Tabela nr.1-"Planifikimi dhe realizimi i procedurave të prokurimit për vitin 2022, sipas llojit"

lekë

Nr.	Lloji i procedurës	Parashikimi		Realizimi	
		Numri	Vlera (lekë)	Numri	Vlera (lekë)
1	Blerje nën vlerën 100,000 lekë	10	827,100	8	528,729
2	Blerje me Vlerë të Vogël	11	7,344,585	9	4,059,225
3	Sistem Dinamik i Blerjeve	1	2,100,000	1	852,732
4	Procedurë e hapur	2	40.000.000	0	0
5	Procedurë e hapur e thjeshtuar	7	36,897,766	5	14,538,472,.6
SHUMA		**31**	**87,169,451**	**23**	**18,931,425**

Burimi: Regjistri i Parashikimit dhe Realizimit për FSDKSH, sipas SPE, vënë në dispozicion nga FSDKSH

Sa sipër rezulton së për vitin 2022, janë parashikuar gjithsej 31 procedura prokurimi me vlerë 87,169,451 lekë, nga të cilat janë realizuar 23 procedura me vlerë gjithsej 18,931,425 lekë. FSDKSH nuk ka realizuar 8 procedura me vlerë të planifikuar 68,238,026 lekë, çka tregon mangësi në procesin e parashikimit, në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu II, neni 3, pika 2, ku përcaktohet se: "*Regjistri i parashikimeve duhet të synojë planifikimin e mirë të përdorimit të fondeve publike dhe planifikimin e realizimin në kohë të procedurave të prokurimit publik."*

Nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizuan regjistrat e realizimit të prokurimeve në periudhën e auditimit ku rezulton se, janë realizuar gjithsej 23 procedura me fond limit në vlerën 30,882,643 lekë pa TVSH nga ku: 5 procedura prokurimi për (shërbime, mallra dhe punë) në shumën 24,985,061 lekë pa TVSH + 16 procedura "Blerje me vlerë të vogël", "Blerje Dinamike" dhe "Blerje nën 100,000 lekë" në shumën 9,379,584 lekë pa TVSH. Më hollësisht të dhënat për procedurat e prokurimit të zhvilluara gjatë periudhës së auditimit 2022, janë paraqitur sipas Aneksit nr. 1.

Për periudhën e auditimit janë audituar 11 (njëmbëdhjetë) procedura për punë publike, mallra dhe shërbime, në vlerën e fondit limit 26,763,059 lekë pa TVSH ose në masën 87 % të mbulimit të prokurimeve, respektivisht:

4 (katër) procedurat e prokurimi me vlerë limit në shumën totale 21,503,059 lekë pa TVSH, si më poshtë:

Nr.	Objekti i Prokurimit	Tipi i Kontratës (mall/punë/shërbim) Marrëveshje Kuadër	Lloji i Procedurës se Prokurimit	Fondi Limit	Vlera e kontratës	Emri i Operatorit Ekonomik/ i/të shpallur fitues dhe NUIS

1	Blerje artikuj kancelarie	Mallra	Proc e Hapur e thjeshtuar	5,855,496	4,414,595	M.&D.
2	Blerje artikuj tonera për printera dhe fotokopje	Mallra	Proc e Hapur e thjeshtuar	6,026,581	1,377,077	I.O.
3	Blerje Karburant	Mallra	Proc e Hapur e thjeshtuar	6,947,382	6,946,800	"G.C.GKG"
4	Riparim dhe vendosje pjese këmbimi për automjetet e Fondit	Shërbime	Proc e Hapur e thjeshtuar	2,673,600	1,800,000	A.M.S.

7 (shtatë) procedurat "Blerje me vlerë të vogël", në shumën 5,260,000 lekë pa TVSH, si më poshtë:

Nr.	Objekti i Prokurimit	Tipi i Kontratës (mall/punë/shërbim) Marrëveshje Kuadër	Lloji i Procedurës se Prokurimit	Fondi Limit	Vlera e kontratës	Emri i Operatorit Ekonomik/ i/të shpallur fitues dhe NUIS
1	Blerje pajisje zyre për Drejtorinë Qendrore të Fondit	Mallra	Blerje e Vogël	1,000,000	481,000	"R.A"
2	Lyerje e ambienteve te godinës se Fondit	Shërbime	Blerje e Vogël	800,000	400,000	M.B
3	Materiale elektrike dhe hidraulike, ndriçim	Mallra	Blerje e Vogël	700,000	433,300	XH .N.SH.G
4	Materiale per pastrim dhe dezinfektim	Mallra	Blerje e Vogël	1,000,000	498,800	XH .N.SH.G
5	Mirëmbajtje e sistemit te kondicionimit të godinës së Fondit	Shërbime	Blerje e Vogël	700,000	697,000	C.
6	Shpenzime ndërtimore për mirëmbajtjen e godinës	Shërbime	Blerje e Vogël	800,000	396,275	S.A
7	Shpenzime operative pritje përcjellje	Shërbime	Blerje e Vogël	260,000	197,500	P.

Në mënyrë të përmbledhur paraqiten sipas tabelës më poshtë:

Tabela nr. 2: "Procedura prokurimi të audituara"

Në lekë

Viti	Procedura të Prokuruar			Procedura të Audituar			
	Numër	Fond limit	Vlerë kontrate	Numër	Fond limit	Vlerë Kontrate	% e fondeve të audituara
2022	23	34,364,645	22,640,059	11	26,763,059	17,642,347	87 %

Burimi: FSDKSH, përpunoi KLSH

Nga procedurat e përzgjedhura për auditim, është konstatuar si më poshtë vijon:

1- Procedura prokurimit "Mirëmbajtje automjetesh të Fondit", viti 2022

Urdhër prokurimi nr.390 Prot., date 23.11.2022	NJHDT E. D.	KVO me urdhrin nr. 391 Prot, date 23.11.2022

Fondi limit 2,556,662 Leke Procedura e prokurimit- Procedure e hapur e thjeshtuar	A. K E.S.	Sh.S.– Kryetar I. Ç. – Anëtar D.L.– Anëtar
Burimi i Financimit: Fondet e FSDKSH.	Fitues: A.M.S, me NIPT L.....C	Vlera fituese 1,800,000 Leke
Datë e hapjes së tenderit 05.12.2022.	Diferenca nga fondi limit: 756,662 lekë.	
Marrin pjesë 2 OE S`kualifikuar – Ska	Miratimi i procedurës: Memo nr.3906 Prot., date 03.06.2022.	Vlera e kontratës 1,800,000 lekë pa TVSH dhe 2,160,000. lekë me TVSH.
Ankimime për vlerësim në AK - Jo Ankimime në KPP per vlerësim - JO	Afati kontratës 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.	Titullar i AK – A.Ç. Administrator i Shoqerise: A.M

Përcaktimi i kritereve teknike dhe fondit limit

- Me shkresën nr. 3906 prot, datë 03.06.2022, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, ka paraqitur kërkesë për miratimin e fillimit të procedurës për marrjen e një specialisti inxhiner mekanik për procedurën e prokurimit me objekt "Riparim dhe vendosje pjesë këmbimi për 8 automjete të Fondit", i cili do të jetë pjesë e Grupit të Punës për hartimin e specifikimeve teknike.
- Me Urdhër prokurimi nr. 267, datë 24.06.2022, titullari i AK, ka miratuar zhvillimin e procedurës blerje me vlerë të vogël me objekt "Përzgjedhjen e një specialisti inxhinier për procedurën e prokurimit riparim dhe vendosje pjesë këmbimi për automjete të Fondit".
- Kriteret për kontraktimin dhe shpërblimin e ekspertëve të jashtëm nga FSDKSH, janë përcaktuar në VKA nr. 2, datë 20.01.2015.
- Me procesverbal datë 26.08.2022, ndërmjet 3 ofertave të paraqitura, është dokumentuar përzgjedhja e ofertës fituese B.M, NIPT-L....D.
- Është lidhur kontrata me nr. 5439/1 prot., datë 06.09.2022, ku janë parashikuar 5 ditë punë, në total vlera 25,000 lekë. Në zbatim të kontratës është mbajtur procesverbal datë 11.09.2022, për evidentimin dhe përpilimin e specifikimeve teknike, preventiv sipas çmimeve për çdo artikull dhe procesverbalet për çdo automjet në veçanti.
- Në bazë të urdhrit të titullarit me nr. 274 prot., datë 06.09.2022 është ngritur grupi i punës për verifikimin e gjendjes teknike të automjeteve të FSDKSH dhe hartimin e specifikimeve teknike i përbërë nga z. A. Xh., Kryetar, z. B.M, anëtar dhe z. M. A. anëtar.
- Sipas procesverbalit datë 12.09.2022, Grupi i punës ka përcaktuar gjendjen teknike të automjeteve si dhe specifikimet teknike sipas zërave të riparimit për çdo automjet.
- Me shkresën nr. 5439/2 prot., datë 12.09.2022, Memo, Grupi i punës ka informuar Drejtoreshën e Përgjithshme dhe Sektorin e Prokurimeve mbi zbatimin e urdhrit nr. 274 prot., datë 06.09.2022.
- Në procesverbalin datë 12.09.2022, për verifikimin e gjendjes teknike të automjeteve të FSDKSH dhe hartimin e specifikimeve teknike, hartuar nga grupi i punës, nuk administrohet dokumentacion që argumenton nevojën e kryerjes së shërbimeve, ku duhej të përcaktohej km që kanë përshkruar mjetet, shërbimet që i janë bërë ndër vite sipas km, nevojat që kanë aktualisht për shërbime, amortizimin e tyre në vitin korrent etj. Një pjesë zërave të shërbimeve të parashikuara në procesverbal nuk janë të argumentuara, referuar kartelës së shërbimeve që duhet të mbahet për çdo automjet, si zërat riparim kamio, sistemi i furnizimit me karburant, kit freksioni, etj.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Grupi i punës për verifikimin e gjendjes teknike të automjeteve të FSDKSH dhe hartimin e specifikimeve teknike i përbërë nga z. A. Xh., Kryetar, z. B.M., anëtar dhe z. M. A. anëtar, pasi nuk janë respektuar kërkesat e Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 35 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2020 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik", Neni 78, pika 2, ku citohet: *"Hartimi i kërkesave*

për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.
Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.
Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit."
- Me urdhër të titullarit nr. 294 prot., datë 16.09.2022, është ngritur Grupi i Punës për argumentimin e fondit limit dhe hartimin e kritereve për kualifikim, i përbërë nga z. E.D., Kryetar, z. A. K. Anëtar dhe znj. E. S., Anëtar.
- Me shkresën nr. 5439/2 prot., datë 23.09.2022, drejtuar Drejtoreshës së Përgjithshme dhe Sektorit Juridik, Grupi i Punës ka paraqitur memo mbi argumentimin e fondit limit dhe hartimin e kritereve për kualifikim.
- Hartimi i fondit limit është bazuar në kontratat e viteve të mëparshme, konkretisht tre kontratat e fundit 2018, 2019 dhe 2020, duke marrë mesataren e tyre, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 35 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2020 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik", Neni 76, pika 1, germa c.

Hartimi i DST-të

- Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Njësia e Prokurimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim.
- Me shkresën nr. 6878 prot., datë 23.11.2022, drejtuar Drejtoreshës së Përgjithshme dhe Sektorit Juridik, Njësia e Prokurimit ka paraqitur memo mbi për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim.
- Me procesverbal datë 25.11.2022, Njësia e Prokurimit ka përcaktuar shtojcat që do të jenë pjesë e DST-ve.

Për kapacitetin teknik, pika 6,
- Vendndodhja e servisit duher të jetë brenda Qytetit të Tiranës me një sipërfaqe jo më të vogël se 500 (pesëqind m2) e cila duhet të vërtetohet me paraqitjen e Certifikatës së Pronësisë, ose me Kontratën e Qiramarrjes te noterizuar shoqëruar me Certifikatën e Pronësisë, të cilat duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.

- Pajisje (kompjuterike) për kontrollin dhe testimin (diagnostikimin) e sistemit elektrik dhe defekteve në motorr të automjetit.

a) Repart xhenerik me jo më pak se 4 (katër) linja kontrolli teknik të pajisur përkatësisht secila me:

- *Urë për ngritje dhe kontroll të mjetit me rrota të mbështetura dhe të varura, me kapacitet jo me pak se 3 ton e përshtatshme edhe për fuoristrada dhe furgone;*
- *Pajisje (kompjuter) për kontrollin dhe testimin e sistemit frenimit të automjetit.*
- *Pajisje (kompjuter) për kontrollin dhe testimin e sistemit amortizimit të automjetit.*
- *Pajisje për kontrollin fizik në sistemin e drejtimit dhe amortizimit për autovetura, fuoristrada dhe furgona.*

- *Pajisje për ndërrimin e fluidit (alkoolit) për komplet sistemin e frenimit.*

Vendosja e këtyre kritereve është i paargumentuar teknikisht, për sipërfaqen 500 m 2 të servisit, përse nevojitet 4 linja të kontrollit teknik, përse nevojitet ura e kontrollit për furgona, kur objekti i procedurës së prokurimit është për automjete të FSDKSH.

Mos argumentimi i kritereve të vendosura bie në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 36, pika 2, Neni 77, pika 1 dhe 4, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 41, pika 2, në të cilën citohet: *"Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.",* Neni 55, pika 4, Neni 78, pika 2.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: Anëtarët e Njësisë së Prokurimit, z. E. D., z. A. K. dhe znj. E. S..

<u>Zhvillimi i procedurës</u>

Nga auditimi në sistemin elektronik dhe dokumenteve faktike të procedurës së prokurimit me objekt "Mirëmbajtje automjetesh të Fondit*",* rezultoi se në tender kanë marrë pjesë 2 operator, për të cilin KVO ka kryer vlerësimin si më poshtë:

Nr.	Operatori ekonomik pjesëmarrës	Oferta ekonomike (pa TVSH)	Vlerësimi KVO-së
1	"A. M. S."	1,800,000	Kualifikuar dhe shpallur itues
2	"V.M."	1.841.250	Kualifikuar, renditur i dyti

Nga auditimi i ofertës fituese të paraqitur nga "A.M. S.", me vlerë 1,800,000 lekë pa TVSH dhe 2,160,000 lekë me TVSH, rezultoi se:

1- Shtojca 1-Formulari i ofertës, çmimi ofertës me TVSH është <u>shënuar 2,160,0000 lekë</u>, pra ka një gabim në çmimin e ofertuar me TVSH, për të cilën nga AK kontraktor nuk është kërkuar sqarim nga OE dhe nuk është bërë asnjë shpjegim në procesverbalin për shqyrtimin e ofertave me nr. 6878/4 prot., datë 09.12.2022, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 92-Shqyrtimi i ofertave dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 82, pika 2 dhe 3.

2- Në lidhje me plotësimin e kriterit **3.2-Kapaciteti teknik**, për *kategoritë 1-Motorrist; 4-Elektroaut; 5-Bojaxhi automjetesh; 6-Llamarinist Automjetesh,* në listë pagesat e dorëzuara nga OE fitues janë deklaruar në kodin ***7231.06- Mekanik automjetesh***, ndërkohë që këto kategori duhet të klasifikoheshin në kode të tjera sipas përcaktimeve të VKM Nr. 514, datë 20.9.2017 *"Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (Lkp), të rishikuar"*, Kodi Profesioni 7132 dhe 7231, konkretisht si më poshtë:

7231.03- Elektroaut;
7132.02- Bojaxhi automjetesh;
7231.05- Llamarinist Automjetesh;
7231.16- Motorist.

3- Në deklaratën e Garancisë dorëzuar nga OE fitues, në lidhje me garancinë për pjesët e këmbimit citohet *"Për pjesët e këmbimit qe do te përdoren për riparimin e automjeteve do te jene te reja, origjinale, prodhim sipas standardeve te CE, me garancinë jo me pak se 1 vit, nga data e montimit, <u>ose sipas normativave standarde te mirëmbajtjes se automjeteve</u>, **<u>bazuar ne km te përshkuar</u>.",*** në kundërshtim me përcaktimet e DST-ve të publikuara nga AK, pika 3.2-Kapaciteti Teknik, ku është përcaktuar *"Deklaratë se pjesët e këmbimit që do të përdoren për*

riparimin e automjeteve, do të jenë të reja, dhe prodhim sipas standardeve të CE, <u>për garancinë e pjesëve të këmbimit jo më pak se 1 vit, nga data e montimit."</u>

Sa më sipër, KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues "A. M. S.", *me vlerë* 1,800,000 *lekë,* edhe pse nuk ka plotësuar plotësisht kriteret e kërkuara në DST, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", neni 87 *"Kriteret për shpalljen e ofertës fituese",* neni 92 "*Shqyrtimi i ofertave*" dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 82 "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*".

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: Anëtarët e KVO, z. Sh.S., znj. I. Ç., z. D. L.

Marrja në dorëzim

Është nënshkruar kontrata me nr. 6878/8 prot., datë 28.12.2022 me vlerë 1,800,000 lekë pa TVSH dhe 2,160,000 lekë me TVSH.

- Me urdhër nr. 445 prot., datë 29.12.2022, të titullarit të autoritetit kontraktor, është ngritur Komisioni për ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve, i përbërë nga z. A.Xh., z. M. A., z. D. H., z. A. F. dhe z. A. D.
- Nga Komisioni për ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve është hartuar plani për zbatimin e kontratës me nr. 6878/1 prot., datë 30.12.2022.

Likuidimet e kontratës paraqiten hollësisht sipas tabelës më poshtë:

"Likuidime kontrata "Blerje kancelari" viti 2022"

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Nr./ dt. - fature	Vlera ne lekë	Likuiduar	Mbetet për Likuidim
1	Riparim Automjeti (Audi Q5,me targe AA...OK)	Nr.675 /2023 dt.16.05.2023	361,800	16.06.2023	
2	Riparim Automjeti (PAJERO, me targe TR ...R)	Nr.676/2023 dt.16.05.2023	386,520	16.06.2023	
3	Riparim Automjeti (SKODA,me targe AA ...JZ)	Nr.679/2023 dt.17.05.2023	239,040	16.06.2023	
4	Riparim Automjeti (PAJERO, me targe TR.... R)	Nr.678/2023 dt.17.05.2023	213,480	16.06.2023	
5	Riparim Automjeti (Mitsubishi Pajero,me targe TR ...R)	Nr.677/2023 dt.16.05.2023	259,440	16.06.2023	
	Totali		**1,460,280**		**699,720.00**

Burimi: FSDKSH, përpunoi KLSH

Nga verifikimi i zbatimit të kontratës dhe urdhër shpenzimeve, rezulton se likuidimet janë kryer bazuar në dokumentacionin justifikues, si akt-kontrolli, situacion punimesh, procesverbale për marrjen në dorëzim të shërbimeve/mallit, certifikatë garancie, fatura tatimore e lëshuar nga subjekti, kontrata dhe Memo mbi dorëzimin e dokumentacionit për zbatimin e kontratës.

2- Procedura prokurimit "Blerje Kancelarie" viti 2022

Të dhëna të përgjithshme të procedurës

Urdhër prokurimi nr 211 Prot., date 20.06.2022 Fondi limit 5,661,566 Leke Procedura e prokurimit – Procedure e hapur e thjeshtuar	NJHDT E. D. A. K. S. Ç.	KVO me urdhrin nr. 212 Prot, date 20.06.2022 H. H. – Kryetar M. P.– Anëtar D. L. – Anëtar
Burimi i Financimit: Fodet FSDKSH.	Fitues: M.&D. , me NIPT J....Q	Vlera fituese 4,414,595 Leke
Datë e hapjes së tenderit 04.07.2022.	Diferenca nga fondi limit 1,246,971lekë.	
Marrin pjesë 3 OE S`kualifikuar – S'ka	Miratimi i procedurës: Memo nr.3665 Prot., date 18.05.2022	Vlera e kontratës 4,414,595 lekë pa TVSH dhe 5,297,514 lekë me TVSH.

Ankimime për vlerësim në AK - Jo Ankimime në KPP per vlerësim - Jo	Afati kontratës 10 dite nga data e nënshkrimit të kontratës. Per artikullin leter A4 sipas nevojave AK	Titullar i AK – A.Ç. Administrator i Shoqërisë: B. N.

Përcaktimi i kritereve teknike dhe fondit limit

- Me shkresën nr. 3665 prot., datë 18.05.2022, Memo, drejtuar Drejtoreshës së Përgjithshme dhe Sektorit të Prokurimeve, nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, është paraqitur kërkesa për fillimin e procedurës "Blerje artikuj kancelarie për vitin 2022".
- Në bazë të urdhrit të titullarit nr. 176 prot., datë 26.05.2022 është ngritur grupi i punës për hartimin specifikimeve teknike, kritereve për kualifikim dhe llogaritjen e fondit limit, i përbërë nga z. E. M.Kryetar, znj. A. A. Anëtar dhe z. F.S. Anëtar.
- Me shkresën nr. 3754/1 prot., datë 27.05.2022, Memo, drejtuar Drejtoreshës së Përgjithshme dhe Sektorit të Prokurimeve, nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, është paraqitur sasia në total për çdo artikull për prokurim.

Në shkresën më sipër citohet se llogaritja e sasive për çdo artikull është bërë mbi bazën e kërkesave për materiale të paraqitura nga FSDKSH, DRF dhe Degët e Fondit, por në dosje nuk administrohen kërkesat përkatëse, të cilat argumentojnë sasitë e kërkuara mbi bazën e të cilave do të hartohet fondi limit.

- Me shkresën nr. 3754/2 prot., datë 03.06.2022, Grupi i Punës, ka paraqitur Memo, mbi hartimin specifikimeve teknike, kritereve për kualifikim dhe llogaritjen e fondit limit. Llogaritja e fondit limit, sipas sasive të përcaktuara në shkresën më sipër nr. 3754/1 prot., datë 27.05.2022, është bërë bazuar në metodën e testimit të tregut, por nuk është marrë mesatarja e tre ofertave, por çmimi i ofertës më të ulët, ndërkohë sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 35 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2020 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik", Neni 76, pika 1, germa b, ku citohet "*studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe".*

-Gjithashtu ajo që konstatohet është se OE fitues "M. & D." SHPK në testimin e tregut të realizuar nga AK për hartimin e fondit limit, për të njëjtën sasi mallrash, ka paraqitur ofertën datë 30.05.2022, në vlerë 9,835,197 lekë pa TVSH, ndërkohë në procedurën e zhvilluar datë 04.07.2022, ka paraqitur ofertën 4,414,595 pa TVSH, pra me një diferencë 5,420,602 lekë, më shumë se 50%, brenda një periudhe kohore gati 30 ditë.

Hartimi i DST-të

Me shkresën nr. 3754/2 prot., datë 03.06.2022, Njësia e Prokurimit ka hartuar DST dhe kriteret e kualifikimit. Në material është trajtuar argumentimi ligjor për çdo kriter të vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 36, Neni 77 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2020 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik", Neni 40 dhe Neni 55.

Me procesverbal datë 22.06.2022, NJHDT, ka miratuar shtojcat që do të jenë pjesë e DST-ve.

Zhvillimi i procedurës

Nga auditimi në sistemin elektronik dhe dokumenteve faktik të procedurës së prokurimit me objekt **"Blerje kancelari" viti 2022**, rezultoi se në tender kanë marrë pjesë 3 operator, për të cilin KVO me procesverbal datë 06.07.2022, ka kryer vlerësimin si më poshtë:

Nr.	Operatori ekonomik pjesëmarrës	Oferta ekonomike (pa tvsh)	Vlerësimi i KVO-së
1	"M.& D." SHPK	4,414,595	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2	"I. S.O." SHPK	4,753,317	Kualifikuar

3	"L. D." SHPK	5,252,300	Kualifikuar

Nga auditimi i ofertës fituese të paraqitur nga "M.& D." SHPK me vlerë 4,414,595 lekë pa TVSH dhe 5,297,514 lekë me TVSH, rezultoi se operatori ekonomik fitues ka plotësuar kriteret për kualifikim.

Marrja në dorëzim

- Është lidhur kontrata me nr. 3754/11 prot., datë 29.07.2022 me vlerë 4,414,595 lekë pa TVSH dhe 5,297,514 lekë me TVSH.
- Me urdhër nr. 250 prot., datë 02.08.2022, të titullarit të autoritetit kontraktor, është ngritur Komisioni për ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të mallrave, i përbërë nga z. E.B., znj. M. B., z. A. H.
- Nga Komisioni për ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të mallrave është hartuar plani për zbatimin e kontratës me nr. 3574/1 prot., datë 04.08.2022.
- Me shkresë datë 08.08.2022, administruar në FSDKSH me nr. 3754/14 prot., datë 08.08.2022, OE fitues "M.& D." SHPK, drejtuar AK, ka kërkuar zgjatjen e afatit të lëvrimit të kontratës pasi për shkak të situatës së paparashikuar të Pandemisë Covid-19 si dhe luftës në Ukrainë ka sjellë vonesa në transportin e mallrave nga data e parashikuar për dorëzim.
- Me shkresën nr. 3754/15 prot., datë 08.08.2022, Memo, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, Grupi për zbatimin dhe ndjekjen e kontratës, ka propozuar ndryshim e afatit të lëvrimit të kontratës, pasi kjo pikë nuk prek thelbin dhe objektin e kontratës.
-Me shkresën nr. 37514/16 prot., datë 08.08.2022, është bërë amendimi i kontratës nga të dyja palët kontraktore, duke ndryshuar afatin e lëvrimit të mallit nga 10 ditë në 30 ditë nga data e nënshkrimit të amendimit të kontratës, me përjashtim të artikullit letër A4, i cili do të lëvrohet pjesë-pjesë brenda 12 muajve.
- Me shkresën nr. 3754/17 prot., datë 15.08.2022, nga Komisioni për ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të mallrave është modifikuar plani për zbatimin e kontratës.
- Me shkresën datë 05.09.2022, administruar në FSDKSH me nr. 3574/19 prot, datë 19.09.2022, OE fitues "M. & D." SHPK ka njoftuar AK, se artikujt si *4- Dosje të mëdha buton, 100*350*250, materiali plastik; 5- Dosje të mëdha buton,120*350*250, material plastik*
*6- Dosje te madhe buton, 150*350*250, material plastik; 37- Dosje me mekanizëm (8 cm) me kuti. Dosjet duhet të jenë të plastifikuara brenda dhe jashtë me lartësi maksimale*.; ka kërkuar nga AK ndryshimin e elementit plastik nga përcaktimet teknike, me argumentin se materialet plastike, janë element shumë i rrezikshëm për ambientin dhe mjedisin, paraqesin vështirësi për t'i gjendur në tregun botëror, si dhe elementi plastik nuk lejon funksionalitetin e mekanizmit të dosjeve.
- Me shkresën nr. 3754/18 prot., datë 08.09.2022, njoftim për zbatimin e kontratës, AK ka njoftuar OE fitues "M. & D." SHPK për mos përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, pasi sasitë e mallit të prokuruar nuk janë dorëzuar e për pasojë do të aplikohen penalitete sipas parashikimeve të Kontratës nr. 3754/11 prot., datë 29.07.2022, Nenit 11-"Penalitet për mos përmbushje të kontratës".
- Me shkresën nr.3754/20 prot., datë 30.09.2022, Memo, Komisioni për ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të mallrave, ka njoftuar titullarin e AK, për ecurinë e zbatimit të kontratës, nga ku rezulton se OE fitues "M. & D." SHPK, nuk ka përmbushur plotësisht kontratën pasi një pjesë e artikujve nuk është dorëzuar, konkretisht zërat 4, 5, 6, 14, 25, 26, 37 dhe 54 dhe për këtë do të aplikohen penalitete sipas përcaktimeve të Nenit 11 të kontratës.
- Me urdhër nr. 430, datë 14.12.2022, është ndryshuar Komisioni i ndjekjes së kontratës dhe marrjes në dorëzim, me përbërje znj. J. I., znj. M. B., z. A.H.
- Me urdhër nr. 444, datë 29.12.2022, është ndryshuar Komisioni i ndjekjes së kontratës dhe marrjes në dorëzim, me përbërje z. R. K., znj. M. B., z. A. H.

Likuidimet e kontratës paraqiten hollësisht sipas tabelës më poshtë:

"Likuidime kontrata "Blerje kancelari" viti 2022"

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Nr./ dt. - fature	Vlera në lekë me TVSH	Vlera e Kancelarive ardhur me vonesë	25% vlerës së kontratës	4/1000 te vlerës për çdo ditë vonese	Vlera e Kancelarive E likuiduar	Vlera e Kancelarive E faturuar	Likuiduar
1	LETER A-4	11230/2022 dt.14.11.2022	422,399.99				422,399.99	422,399.99	22.12.2022
2	KANCELARI	9756/2022 dt.08.09.2022	2,189,494.80	591,416.00	547,373.70	121,495.04	2,067,999.76	2,189,494.80	23.12.2022
3	LETER A-4	12250/2022 dt.21.12.2022	844,800.00				844,800.00	844,800.00	31.01.2023
4	LETER A-4	12416/2022 dt.29.12.2022	996,019.20				996,019.20	996,019.20	31.01.2023
5	LETER A-5	12399/2022 dt.29.12.2022	844,800.00				844,800.00	44,800.00	31.01.2023
	Totali		**5,297,513.99**	**591,416.00**	**547,373.70**	**121,495.04**	**5,176,018.95**	**5,297,513.99**	

Burimi: FSDKSH, përpunoi KLSH

Nga verifikimi i zbatimit të kontratës dhe dokumentacionit justifikues si urdhër shpenzimeve, fletë hyrje dhe procesverbale për marrjen në dorëzim të mallit rezulton se një pjesë e artikujve janë dorëzuar me vonesë nga OE "M. & D." SHPK si më poshtë:

Fletë hyrje datë	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlefta	Ditë vonesë	Penaliteti
Nr. 6, dt 26.10.12022	Dosje me mekanizëm 10 cm	Copë	1202	116	139,432		25,655
Nr. 6, dt. 26.10.12022	Dosje me mekanizëm 12 cm	Copë	889	123	109,437		20,119
Nr. 6, dt 26.10.12022	Dosje me mekanizëm 15 cm	Copë	921	123	113,283		20,844
Nr. 6, dt 26.10.12022	Dosje me mekanizëm 8 cm	Copë	978	112	109,536		20,154
SHUMA					**471,688**	**46**	**86,774**
Nr. 8, dt 17.11.2022	Bllok mbledhje	Copë	205	263	53,915		14,880
Nr. 8, dt 17.11.2022	Makina kapese	Copë	105	66	6,930		1,912
SHUMA					**60,845**	**69**	**16,793**
Nr. 9, dt. 24.11.2022	SSD 256 GB	Copë	11	4620	50,820		15,449
Nr. 9, dt. 24.11.2022	Bllok Mbledhje	Copë	31	263	8,153		2,478
SHUMA					**58,973**	**76**	**17,927**
TOTAL					**591,416**		**121,495**

Nga ana AK, është aplikuar gabim penaliteti për vonesat në dorëzimin e mallrave, duke llogaritur 25% vetëm mbi zërin "Kancelari" dhe jo mbi vlerën totale të kontratës, në kundërshtim me përcaktimit e Nenit 11 të Kontratës nr. 3754/11 prot., datë 29.07.2022, ku ndër të tjera citohet se: *"Në rast se Kontraktuesi nuk dorëzon mallin në magazinën e "Autoritetit Kontraktor", sipas kushteve të caktuara në nenet e lartshënuara, detyrohet ti paguajë "Autoritetit Kontraktor", për çdo ditë vonesë kamatat në masë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total të "kontratës" por jo më pak se 25% të vlerës së saj.*
Sa më sipër llogaritja e saktë e penaliteteve për vonesat në dorëzimin e mallit paraqiten sipas tabelës më poshtë:

Fletë hyrje datë	Vlefta	Ditë vonesë	*25% vleres se kontrates*	Penaliteti *(1,324,378* 4/1000*ditë vonesë)*	Penalitet i mbetur pa paguar (1,011,823-121,495)
Nr. 6, dt 26.10.12022	471,688	46	1,324,378	243,685	
Nr. 8, dt 17.11.2022	60,845	69	1,324,378	365,528	
Nr. 9, dt. 24.11.2022	58,973	76	1,324,378	402,610	
TOTAL				**1,011,823**	**890,328**

Veprimet më sipër bien në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 124- Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2020 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 107-Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës, pika 1, 4, 6 dhe 7, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pika 42, 43, 44,52, 53 dhe

54, DST-të e procedurës së prokurimit, Kushtet e përgjithshme të kontratës, Neni 17, Kontratën nr. 3754/11 prot., datë 29.07.2022, Nenin 11- Penalitete për mos përmbushje të detyrimeve kontraktuale, *duke ngarkuar me përgjegjësi Grupin për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës i përbërë nga z. E. B., znj. M. B., z. A. H., znj. V. G. në cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit të Financës, znj. L.Sh. Drejtor e Drejtorisë Ekonomike.*

3- Procedura prokurimit "Blerje Tonerash" viti 2022

Urdhër prokurimi nr.269 Prot., date 30.08.2022 Fondi limit 6,014,079 Leke Procedura e prokurimit – Procedure e hapur e thjeshtuar	NJHDT E. D. A. K. M. D.	KVO me urdhrin nr. 270 Prot, date 30.08.2022 H. H.– Kryetar E. J.– Anëtar L. Ç. – Anëtar
Burimi i Financimit: Fondet e FSDKSH.	Fitues: I. SHPK, me NIPT J....Q	Vlera fituese 1,377,077.6 Leke
Datë e hapjes së tenderit 29.09.2022.	Diferenca nga fondi limit : 4,637,001.4 lekë.	
Marrin pjesë 6 OE S`kualifikuar – 3 OE	Miratimi i procedurës: Memo nr.3026 Prot., date 15.04.2022.	Vlera e kontratës 1,377,077.6 lekë pa TVSH dhe 1,652,493.12 lekë me TVSH.
Ankimime për vleresim në AK - Po Ankimime në KPP per vleresim - Po	Afati kontratës 30 DITE nga data e nëshkrimit të kontratës.	Titullar i AK – A.Ç. Administrator i Shoqërise: F. P.

Përcaktimi i kritereve teknike dhe fondit limit

- Me shkresën nr. 3026 prot., datë 15.04.2022, Memo, drejtuar Drejtoreshës së Përgjithshme dhe Sektorit të Prokurimeve, nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, është paraqitur kërkesa për fillimin e procedurës "Blerje artikuj tonera për printera dhe fotokopje për vitin 2022".
- Në bazë të urdhrit të titullarit nr. 262 prot., datë 22.08.2022 është ngritur grupi i punës për hartimin specifikimeve teknike, kritereve për kualifikim dhe llogaritjen e fondit limit, i përbërë nga z. E. M. Kryetar, z. E. C. Anëtar dhe znj. K.P. Anëtar.
- Me urdhër nr. 266 prot., datë 23.08.2022, të titullarit është ndryshuar Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike, kritereve për kualifikim dhe llogaritjen e fondit limit, me përbërje si vijon z. E. B.Kryetar, z. E.C. Anëtar dhe znj. E. S. Anëtar.
- Me shkresën nr. 5245/2 prot., datë 25.08.2022, Grupi i Punës, ka paraqitur Memo, mbi hartimin e specifikimeve teknike, kritereve për kualifikim dhe llogaritjen e fondit limit. Për përcaktimin e sasisë së artikujve që nevojiten është realizuar verifikimi dhe mbledhja e të gjithë nevojave të Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale si dhe gjendjet në magazinë, por bashkëngjitur Memos, mungon dokumentacioni justifikues, procesverbal apo kërkesë sipas Drejtorive që argumenton sasitë e kërkuara, mbi bazën e të cilave do të hartohet fondi limit, në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 34 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2020 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik", Neni 12, pika 1 dhe 4, Neni 76.
- Sipas procesverbalit datë 25.08.2022, është hartuar fondit limit bazuar në çmimet e tregut nga 4 oferta të paraqitura, duke marrë për bazë mesataren e çmimeve.

Hartimi i DST-të

- Me shkresën nr. 5245/2 prot., datë 25.08.2022, Grupi i Punës, ka paraqitur Memo, mbi hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 36, Neni 77 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2020 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik", Neni 40 dhe Neni 55.

Ankesa për DST

- Me shkresën datë 09.09.2022, administruar në FSDKSH me nr. 5245/7 prot., datë 12.09.2022, subjekti I. SHPK, ka paraqitur ankesë në lidhje me kriteret e veçanta për kualifikim, konkretisht pika c)"*...Operatori ekonomik duhet të deklarojë se tonerat origjinale përmbajnë pullën e sigurisë së prodhuesit. Emri i prodhuesit të jetë i stampuar si në kutinë e bojës, në pullën e sigurisë, ashtu edhe në kartrixhe, dhe të jetë i njëjti emër prodhuesi në kartrixhe, në paketimin e bojës dhe në pullën e sigurisë.....".*
- Me urdhër nr. 9, datë 12.09.2022, është pezulluar procedura dhe është caktuar Komisioni për shqyrtimin e ankesës i përbërë nga z. E. M., znj. I. C. dhe z. A. F.
- Me Vendimin nr. 10, datë 12.09.2022, Komisioni për shqyrtimin e ankesës, ka marrë në konsideratë ankesën duke bërë ndryshime në DST, publikuar në SPE me shtojcën nr. 1, datë 22.09.2022, duke ndryshuar dhe afatin e dorëzimit të dokumenteve nga data 19.09.2022 në datën 29.09.2022.
- Me Vendimin nr. 11, datë 22.09.2022, titullari i AK ka vendosur vazhdimin e procedurës së prokurimit.

Zhvillimi i procedurës

Nga auditimi në sistemin elektronik dhe dokumenteve faktik të procedurës së prokurimit me objekt *"Blerje artikuj tonera për printera dhe fotokopje për vitin 2022"*, rezultoi se në tender kanë marrë pjesë 6 operator, për të cilin KVO me procesverbal nr. 5245/12 prot., datë 06.10.2022, ka kryer vlerësimin si më poshtë:

Nr.	Operatori ekonomik pjesëmarrës	Oferta ekonomike (pa TVSH)	Vlerësimi i KVO-së
1	"I.O." SHPK	1,377,077	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2	"I. Gj.K." SHPK	1,727,940	Skualifikuar
3	"A. P." SHPK	1,944,888	Skualifikuar
4	"B. T."	2,997,000	Skualifikuar
5	"L. D." SHPK	4,061,200	Skualifikuar
6	"M.& D." SHPK	5,779,788	Kualifikuar

Ankesa për vlerësimin nga KVO

- Me shkresën nr. 5245/13 prot., datë 07.10.2022, AK ka publikuar shtojcën 10-Formulari i njoftimit të fituesit.
- Me ankesën datë 17.10.2022, subjekti "I. O." SHPK, ka paraqitur ankesë në lidhje me procesin e vlerësimit ofertave, pasi KVO ka skualifikuar të gjithë OE pjesëmarrës, përveç "M.& D." SHPK që ka dhe ofertën më të lartë, për mungesën e pullave të sigurisë pasi kanë paraqitur mostra për tonera ekuivalentë.
- Me ankesën datë 17.10.2022, subjekti "B. T." SHPK, ka paraqitur ankesë në lidhje me procesin e vlerësimit ofertave, pasi 2 nga kriteret e veçanta të kualifikimit janë në shkelje të ligjit të prokurimeve.
- Me Vendimin nr.14, datë 17.10.2022, është pezulluar procedura dhe është caktuar Komisioni për shqyrtimin e ankesës i përbërë nga z. E. C., znj. M. D.dhe z. A.F.
- Me Vendimin nr.15, datë 18.10.2022, është pezulluar procedura dhe është caktuar Komisioni për shqyrtimin e ankesës i përbërë nga znj. D. C., z. E. M. dhe z. D. Ll.
- Me Vendimin nr.16, datë 19.10.2022, për një ndryshim në Vendimin nr.14, datë 17.10.2022, është ndryshuar përbërja e Komisionit për shqyrtimin e ankesës (KSHA), i përbërë nga z. E.C., z. A.H. dhe z. A. F.
- Sa sipër rezulton se pjesë e komisionit të shqyrtimit të ankesave sipas Vendimit nr.16, datë 19.10.2022 (nr.5245/16 prot.) të titullarit të AK, është z. E. C., i cili gjithashtu është edhe pjesë e komisionit për argumentimin e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike, si dhe hartimin e kritereve për kualifikim, sipas urdhrit nr.266, datë 23.08.2022 (nr.5245/1 prot.), veprime këto që bien në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 101 "Hapat për shqyrtimin e ankesave në

autoritetin/entin kontraktor", pika 1 ku citohet: *"…Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit për të cilin është paraqitur ankesa…",* për të cilat ngarkohet me përgjegjësi titullari i AK Zj. A.Ç..

- Me Vendimin nr.17, datë 20.10.2022, për shqyrtimin e ankesë së OE "B.T." SHPK, KSHA ka vendosur rrëzimin e ankesë si të pabazuar. Gjithashtu dhe KPP me Vendimin nr. 1045/2022 ka rrëzuar ankesën në fjalë.
- Me Vendimin nr.18, datë 20.10.2022, për shqyrtimin e ankesë së OE "I.O." SHPK, KSHA ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës. Gjithashtu dhe KPP me Vendimin nr. 1046/2022 ka mbyllur çështjen në lidhje me ankesën në fjalë, pasi AK ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës.
- Me Vendimin nr. 20, datë 01.11.2022, titullari i AK ka vendosur vazhdimin e procedurës së prokurimit.
- Me procesverbal datë 07.11.2022, KVO ka bërë rivlerësimin e ofertave dhe është kërkuar informacion për 3 oferta pasi janë me çmim anomalisht të ulët si më poshtë:

"I.O." Sh.p.k	1,377,077
"I. Gj. K." Sh.p.k	1,727,940
"A. P." Sh.p.k	1,944,888

Kanë paraqitur sqarime për oferta anomalisht të ulët OE "I.O." SHPK me shkresën datë 04.11.2022 dhe "A. P." SHPK me shkresën 03.11.2022.
Në përfundim të vlerësimit nga KVO ka rezultuar si më poshtë:

Nr.	Operatori ekonomik pjesëmarrës	Oferta ekonomike (pa TVSH)	Vlerësimi i KVO-së
1	"I. O." Sh.p.k	1,377,077	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2	"I. Gj.K." Sh.p.k	1,727,940	Kualifikuar
3	"A. P." Sh.p.k	1,944,888	Kualifikuar
4	"M.& D." Sh.p.k	5,779,788	Kualifikuar

Nga auditimi i ofertës fituese të paraqitur nga "I. O." SHPK me vlerë 1,377,077 lekë pa TVSH dhe 1,652,493 lekë me TVSH, rezultoi se operatori ekonomik fitues ka plotësuar kriteret për kualifikim.

Marrja në dorëzim
- Është lidhur kontrata me nr.3245/29 prot., datë 30.11.2022 me vlerë 1,377,077 lekë pa TVSH dhe 1,652,493 lekë me TVSH.
- Me urdhër nr. 393 prot., datë 30.11.2022, të titullarit të autoritetit kontraktor, është ngritur Komisioni për ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të mallrave, i përbërë nga znj. D. Ç., znj. M. B., z. E.M..
-Nga Komisioni për ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të mallrave është hartuar plani për zbatimin e kontratës me nr. 5245/31 prot., datë 05.12.2022.
Likuidimet e kontratës paraqiten hollësisht sipas tabelës më poshtë:

"Likujdime kontrata "Blerje kancelari" viti 2022"

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Nr./ dt - fature	Vlera në leke pa TVSH	Vlera ne lekë me TVSH	Likuiduar
1	Tonera për printera dhe fotokopje	17396/2022 dt.16.12.2022	1,213,027	1,455,632	06.01.2023
2	Tonera për printera dhe fotokopje	17983/2022 dt.28.12.2022	164,050	196,860	09.01.2023

	Totali			**1,652,493**	

Burimi: FSDKSH, përpunoi KLSH

Nga verifikimi i zbatimit të kontratës dhe urdhër shpenzimeve, rezulton se likuidimet janë kryer bazuar në dokumentacionin justifikues, si fletë hyrje, procesverbale për marrjen në dorëzim të mallit, fatura tatimore e lëshuar nga subjekti, kontrata dhe Memo me nr. 5245/33 prot., datë 28.12.2022, mbi likuidimin e faturës.

4- Procedura prokurimit "Blerje Karburanti" për FSDKSH, viti 2022

Urdhër prokurimi nr.214 Prot., date 22.06.2022 Fondi limit 6,946,800 Leke Procedura e prokurimit – Procedure e hapur e thjeshtuar	NJHDT E. D. A. K. A. F.	KVO me urdhrin nr. 215 Prot, date 22.06.2022 Sh.S. – Kryetar I. Ç.– Anëtar T. M. – Anëtar
Burimi i Financimit: Fondet e FSDKSH.	Fitues: G. C. GKG shpk & G.O.G. SHA, me NIPT K...T, K...E	Vlera fituese 6,946,800 Leke
Datë e hapjes së tenderit 05.07.2022.	Diferenca nga fondi limit : 0 lekë.	
Marrin pjesë 1 OE S`kualifikuar – Ska	Miratimi i procedurës: Memo nr.1837 Prot., date 30.03.2022.	Vlera e kontratës 6,946,800 lekë pa TVSH dhe 8,336,160. lekë me TVSH.
Ankimime per vlerësim në AK - Jo Ankimime në KPP per vlerësim - JO	Afati kontratës 12 muaj nga data e nëshkrimit të kontratës.	Titullar i AK – A.Ç. Administrator i Shoqërisë F. M., O. B.

Përcaktimi i kritereve teknike dhe fondit limit

- Me shkresën nr. 1837 prot., datë 30.03.2022, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, ka paraqitur kërkesë për miratimin e fillimit të procedurës së prokurimit me objekt "Blerje Karburanti" për FSDKSH, viti 2022.
- Në bazë të urdhrit të titullarit nr. 210 prot., datë 20.06.2022 është ngritur grupi i punës për hartimin specifikimeve teknike, kritereve për kualifikim dhe llogaritjen e fondit limit, i përbërë nga z. A. Xh. Kryetar, zj. M. P. Anëtar dhe z. E.Ç. Anëtar.
- Gjendja e karburantit në datë 21.06.2022, në magazinën e FSDKSH është 2499 litra Gazoil 10 ppm dhe 0 litra Benzin 95 Oktan, sipas dokumentit të marrë nga magazina e institucionit datë 21.06.2022, nënshkruar nga znj. M. B., me detyrë magaziniere.
- Me shkresën nr. 4217/1 prot., datë 21.06.2022, Grupi i Punës, ka paraqitur Memo, mbi hartimin specifikimeve teknike, kritereve për kualifikim dhe llogaritjen e fondit limit. Sipas përshkrimeve në Memo, llogaritja e fondit limit është bërë për 23 automjete të disponuara nga FSDKSH dhe Drejtoritë Rajonale, 2 gjeneratorë të FSDKSH dhe 1 gjeneratorë të DRF Kukës, ku sasia që nevojitet paraqitet sipas tabelës më poshtë:

Produkti	**Sasia që nevojitet**	**Reduktim sipas VKM nr. 160, dt. 14.03.2022**	**Gjendje magazinë Dt. 21.06.2022**	**Sasia e mbetur**	**Cmimi leke/litër** *(Vendimi Bordit Transparencës dt. 18.06.2022)*	Vlera e llogaritur
Gazoil 10 ppm	83840	41920	2499	39421	208	8,179,858
Benzinë 95 oktan	5299	2614	0	2614	187	488,040
						8,667,898

Sa sipër rezulton se sasia e karburantit që nevojitet është reduktuar me 50 % sipas përcaktimeve të VKM nr. 160, dt. 14.03.2022 *"Për reduktimin e shpenzimeve të transportit për funksionarët, nëpunësit, punonjësit e institucioneve të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave dhe shoqërive/ndërmarrjeve me kapital shtetëror"*.
Fondi limit i vendosur në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve për vitin 2022, për blerje karburanti është në vlerën 13,894,800 lekë. Referuar Memos nr. 3348 prot., datë 06.05.2022, mbi ndryshimin e regjistrit të parashikimeve, sipas kërkesave të VKM nr.160, dt. 14.03.2022, cituar më sipër, fondi limit është përgjysmuar në vlerën 6,947,382 lekë.
Sa më sipër sasia e karburantit që do të prokurohet është si vijon:
Gazoil 10 ppm 31600 litra * 208 lekë/litër= 6,572,800 lekë
Benzinë 95 Oktan 2000 litra * 187 lekë/litër= 374,000 lekë
Vlera totale 6,946,800 lekë pa TVSH
- Në dosje nuk administrohet relacioni që argumenton orët e punës të gjeneratorëve gjatë vitit si dhe sasinë e karburantit që nevojitet, për pasojë hartimi i fondi limit është i paargumentuar në kundërshtim me përcaktimeve të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 34 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2020 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik", Neni 12 dhe 76. Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Grupi i punës për hartimin e fondit limit i përbërë nga z. A. Xh. Kryetar, zj. M. P. Anëtar dhe z. E.Ç. Anëtar.
- Procedura e përzgjedhur për blerjen e karburantit është procedura e hapur e thjeshtuar. Për menaxhimin me efektivitet të fondeve duhej të përzgjidhej procedura marrëveshje kuadër, bazuar në përcaktimin e çmimit të karburantit sipas Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 12.03.2022 si dhe përcaktimeve të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 59 "Përdorimi i marrëveshjes kuadër", pika 2: "Qëllimi i një marrëveshjeje kuadër është të vendosë kushtet e kontratave që do të prokurohen gjatë një periudhe të caktuar kohore, veçanërisht ato që kanë lidhje me çmimin dhe aty ku është e përshtatshme, me sasitë e parashikuara". Neni 61 "Qëllimi i përdorimit dhe detyrimet që rrjedhin nga një marrëveshje kuadër" pika 1: *"Një marrëveshje kuadër është e përshtatshme për mallra dhe shërbime të përdorura zakonisht me natyrë të përsëritur dhe/ose kur është e vështirë ose e pamundur për të përcaktuar paraprakisht volumet që duhet të prokurohen, dhe nuk ka siguri për kohën e ekzekutimit të kontratave".*
Hartimi i DST-të
- Me shkresën nr. 4217/1 prot., datë 21.06.2022, Grupi i Punës, ka paraqitur Memo, mbi hartimin specifikimeve teknike, kritereve për kualifikim, në përputhje me përcaktimet e Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 36, Neni 77 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2020 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik", Neni 40 dhe Neni 55.
Zhvillimi i procedurës
Nga auditimi në sistemin elektronik dhe dokumenteve faktike të procedurës së prokurimit me objekt "Blerje karburanti*",* rezultoi se në tender kanë marrë pjesë 1 operator, për të cilin KVO ka kryer vlerësimin si më poshtë:

Nr.	Operatori ekonomik pjesëmarrës	Oferta ekonomike (pa TVSH)	Vlerësimi KVO-së
1	BOE "G. O. G. & G. C. G."	6,946,800	Kualifikuar dhe shpallur fitues

Nga auditimi i ofertës fituese të paraqitur nga BOE "G. O. G. & G. C. G.", me vlerë 6,946,800 lekë pa TVSH dhe 8,336,160 lekë me TVSH, rezultoi se operatori ekonomik fitues ka plotësuar kriteret për kualifikim.
Marrja në dorëzim
- Është nënshkruar kontrata me nr. 4217/8 prot., datë 29.07.2022 me vlerë 6,946,800 lekë pa TVSH dhe 8,336,160 lekë me TVSH, me afat 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës.

- Me urdhër nr. 249 prot., datë 01.08.2022, të titullarit të autoritetit kontraktor, është ngritur Komisioni për ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të mallrave, i përbërë nga znj. E. S., znj. M.B. dhe z. F. S..
- Nga Komisioni për ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të mallrave është hartuar plani për zbatimin e kontratës me nr. 4217/10 prot., datë 04.08.2022.

Likuidimet e kontratës paraqiten hollësisht sipas tabelës më poshtë:

"Likuidime kontrata "Blerje karburanti" viti 2022"

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Nr./ dt. - fature	Vlera ne leke	Vlera e likuiduar	Dt. Likuidimit
1	Blerje karburanti per vitin 2022	5218/2022 dt.04.08.2022	8,335,966.00	8,335,966.00	30.08.2022
2	**Totali**		**8,335,966.00**	**8,335,966.00**	

Burimi: FSDKSH, përpunoi KLSH

Nga verifikimi i zbatimit të kontratës dhe urdhër shpenzimeve, rezulton se likuidimet janë kryer bazuar në dokumentacionin justifikues, si procesverbale për marrjen në dorëzim të mallit, fletë hyrje, fatura tatimore e lëshuar nga subjekti, kontrata dhe Memo mbi likuidimin e faturës dhe zbatimin e kontratës.

Llogaritja e çmimit për sasinë e karburantit të furnizuar është bazuar në përcaktimet e Nenit 2 të Kontratës nr. 4217/8 prot., datë 29.07.2022 dhe Nenit 4 të Aktit Normativ nr. 8, datë 25.03.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8450, datë 24.12.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", (i ndryshuar)", ku përcaktohet se: *"Të gjitha institucionet shtetërore që zhvillojnë procedura prokurimi për produktet dhe nënproduktet e naftës dhe gazit, të përcaktuara në vendimin e Bordit, duhet të mbajnë në konsideratë parashikimet e këtij ligji, si dhe vendimet e Bordit për çmimet e miratuara të produkteve dhe nën produkteve të naftës dhe gazit, gjatë gjithë kohëzgjatjes së periudhës së veçantë".*

Titulli i gjetjes: **Mangësi në procesin e parashikimit të realizimit prokurimeve dhe në përdorimin e fondit limit.**

Situata: -Nga auditimit i procedurave të prokurimit publik ka rezultuar se për vitin 2022, janë parashikuar gjithsej 31 procedura prokurimi me vlerë 87,169,451 lekë, nga të cilat janë realizuar 23 procedura me vlerë gjithsej 18,931,425 lekë. FSDKSH nuk ka realizuar 8 procedura me vlerë të planifikuar 68,238,026 lekë.

-Gjithashtu nga 11 procedura prokurimi të audituara ka rezultuar se nga fondi limit i parashikuar në vlerën 26,763,059 lekë janë lidhur kontratat me OE fitues në vlerën 17,642,347 lekë, pra 9,120,712 lekë më pak nga fondi limit i parashikuar apo 34 % e fondit limit të parashikuar, çka tregon mangësi në procesin e parashikimit të realizimit prokurimeve dhe fondit limit, me pasoja në mos perdorimin me efektivitet, eficience dhe ekonomicitet të fondeve publike, në kundërshtim me përcaktimet, në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu II, neni 3, pika 2, ku përcaktohet se: "Regjistri i parashikimeve duhet të synojë planifikimin e mirë të përdorimit të fondeve publike dhe planifikimin e realizimin në kohë të procedurave të prokurimit publik."

Kriteri: VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu II, neni 3, pika 2.

Ndikimi/Efekti:: Mos perdorimin me efektivitet, eficience dhe ekonomicitet të fondeve publike.

Shkaku: Mangësi në procesin e parashikimit të realizimit prokurimeve dhe në përdorimin e fondit limit.

Rendesia: E lartë

Rekomandimi: Titullari i autoriteti kontraktor të FDKSH, të marrë masa që në vijimësi, të bëhet planifikimi i realizimit të procedurave të prokurimit publik për punë, mallra dhe shërbime mbi neovjat reale, me qëllim perdorimin me efektivitet, eficience dhe ekonomicitet të fondeve publike.

Titulli i gjetjes: **Nga auditimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit "Mirëmbajtje automjetesh të Fondit", viti 2022, janë konstatuar mangësi në zhvillimin e procedurës.**

Situata: - Në procesverbalin datë 12.09.2022, për verifikimin e gjendjes teknike të automjeteve të FSDKSH dhe hartimin e specifikimeve teknike, hartuar nga grupi i punës, nuk administrohet dokumentacion që argumenton nevojën e kryerjes së shërbimeve, ku duhej të përcaktohej km që kanë përshkruar mjetet, shërbimet që i janë bërë ndër vite sipas km, nevojat që kanë aktualisht për shërbime, amortizimin e tyre në vitin korrent etj. Një pjesë zërave të shërbimeve të parashikuara në procesverbal nuk janë të argumentuara, referuar kartelës së shërbimeve që duhet të mbahet për çdo automjet, si p.sh. zërat riparim kamio, sistemi i furnizimit me karburant, kit freksioni, etj. Veprime këto në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 35 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2020 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik", Neni 78, pika 2.

- Hartimi i DST-të

Për kapacitetin teknik, pika 6

- Vendndodhja e servisit duhet të jetë brenda Qytetit të Tiranës me një sipërfaqe jo më të vogël se 500 (pesëqind m2) e cila duhet të vërtetohet me paraqitjen e Certifikatës së Pronësisë, ose me Kontratën e Qiramarrjes te noterizuar shoqëruar me Certifikatën e Pronësisë, të cilat duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.

- Pajisje (kompjuterike) për kontrollin dhe testimin (diagnostikimin) e sistemit elektrik dhe defekteve në motor të automjetit.

a) Repart xhenerik me jo më pak se 4 (katër) linja kontrolli teknik të pajisur përkatësisht secila me:

- *Urë për ngritje dhe kontroll të mjetit me rrota të mbështetura dhe të varura, me kapacitet jo me pak se 3 ton e përshtatshme edhe për fuoristrada dhe furgone;*
- *Pajisje (kompjuter) për kontrollin dhe testimin e sistemit frenimit të automjetit.*
- *Pajisje (kompjuter) për kontrollin dhe testimin e sistemit amortizimit të automjetit.*
- *Pajisje për kontrollin fizik në sistemin e drejtimit dhe amortizimit për autovetura, fuoristrada dhe furgona.*
- *Pajisje për ndërrimin e fluidit (alkoolit) për komplet sistemin e frenimit.*

Vendosja e këtyre kritereve është i paargumentuar teknikisht, për sipërfaqen 500 m 2 të servisit, përse nevojitet 4 linja të kontrollit teknik, përse nevojitet ura e kontrollit për furgona, kur objekti i procedurës së prokurimit është për automjete të FSDKSH. Mos argumentimi i kritereve të vendosura bie në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 36, pika 2, Neni 77, pika 1 dhe 4, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 41, pika 2, në të cilën citohet: *"Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.",* Neni 55, pika 4, Neni 78, pika 2.

-Vlerësimi i ofertave

Nga auditimi i ofertës fituese të paraqitur nga "A. M. S.", me vlerë 1,800,000 lekë pa TVSH dhe 2,160,000 lekë me TVSH, rezultoi se:

a- Shtojca 1-Formulari i ofertës, çmimi ofertës me TVSH është shënuar *2 160 0000* ***[Dy milion e njëqind e gjashtëdhjetë mijë]; lekë ,*** pra ka një gabim në çmimin e ofertuar me TVSH, për të cilën nga AK kontraktor nuk është kërkuar sqarim nga OE dhe nuk është bërë asnjë shpjegim në procesverbalin për shqyrtimin e ofertave me nr. 6878/4 prot., datë 09.12.2022, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 92-Shqyrtimi i ofertave dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 82, pika 2 dhe 3.

b- Në lidhje me plotësimin e kriterit **3.2-Kapaciteti teknik**, për *kategoritë 1-Motorrist; 4-Elektroaut; 5-Bojaxhi automjetesh; 6-Llamarinist Automjetesh,* në listë pagesat e dorëzuara nga OE fitues janë deklaruar në kodin ***7231.06- Mekanik automjetesh***, ndërkohë që këto kategori duhet të klasifikoheshin në kode të tjera sipas përcaktimeve të VKM Nr. 514, datë 20.9.2017 *"Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (Lkp), të rishikuar",* Kodi Profesioni 7132 dhe 7231, konkretisht si më poshtë:

7231.03- Elektroaut;
7132.02- Bojaxhi automjetesh;
7231.05- Llamarinist Automjetesh;
7231.16- Motorist.

c- Në deklaratën e Garancisë dorëzuar nga OE fitues, në lidhje me garancinë për pjesët e këmbimit citohet *"Për pjesët e këmbimit qe do te përdoren për riparimin e automjeteve do te jene te reja, origjinale, prodhim sipas standardeve te CE, me garancinë jo me pak se 1 vit, nga data e montimit, ose sipas normativave standarde te mirëmbajtjes se automjeteve,* ***bazuar ne km te përshkuar.",*** në kundërshtim me përcaktimet e DST-ve të publikuara nga AK, pika 3.2-Kapaciteti Teknik, ku është përcaktuar *"Deklaratë se pjesët e këmbimit që do të përdoren për riparimin e automjeteve, do të jenë të reja, dhe prodhim sipas standardeve të CE, për garancinë e pjesëve të këmbimit jo më pak se 1 vit, nga data e montimit."* Sa më sipër, KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues "A.M. S.", *me vlerë* 1,800,000 *lekë,* edhe pse nuk ka plotësuar

plotësisht kriteret e kërkuara në DST, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", neni 87 *"Kriteret për shpalljen e ofertës fituese",* neni 92 "*Shqyrtimi i ofertave*" dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 82 "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*".

Kriteri: - Ligji nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", neni 35, nenit 36, pika 2, Neni 77, pika 1 dhe 4, Neni 87.
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar, Neni 41, pika 2, Neni 55, pika 4, Neni 78, pika 2, Neni 82.

Ndikimi/Efekti:: Mangësi në hartimin e kërkesave për nevojën e shërbimeve dhe mallrave, në procesin e vlerësimit të ofertave.

Shkaku: Mos respektimi i përcaktimeve ligjore e nënligjore në fuqi mbi prokurimin publik.

Rendesia: E lartë

Rekomandimi: Titullari i autoriteti kontraktor të FDKSH, të marrë masa që në vijimësi, në organizimin e procedurave të prokurimit të argumentojë fondin limit bazuar në dokumentacion justifikues që përcakton nevojën për punë, shërbime dhe mallra, si dhe të respektojë kriteret dhe specifikimet e përcaktuara në DST në procesin e vlerësimit të ofertave.

Titulli i gjetjes: **Nga auditimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit "Blerje Kancelarie", viti 2022, janë konstatuar mangësi në procesin e marrjes në dorëzim të mallrave të furnizuara.**

Situata: Nga verifikimi i zbatimit të kontratës dhe dokumentacionit justifikues si urdhër shpenzimeve, fletë hyrje dhe procesverbale për marrjen në dorëzim të mallit rezulton se një pjesë e artikujve janë dorëzuar me vonesë nga OE "M. & D." Sh.p.k. Nga ana AK, është aplikuar gabim penaliteti për vonesat në dorëzimin e mallrave, duke llogaritur 25% vetëm mbi zërin "Kancelari" dhe jo mbi vlerën totale të kontratës, në kundërshtim me përcaktimit e Nenit 11 të Kontratës nr. 3754/11 prot., datë 29.07.2022, ku ndër të tjera citohet se: *"Në rast se Kontraktuesi nuk dorëzon mallin në magazinën e "Autoritetit Kontraktor", sipas kushteve të caktuara në nenet e lartshënuara, detyrohet ti paguajë "Autoritetit Kontraktor", për çdo ditë vonesë kamatat në masë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total të "kontratës" por jo më pak se 25% të vlerës së saj.* Sa më sipër llogaritja e saktë e penaliteteve për vonesat në dorëzimin e mallit paraqiten sipas tabelës më poshtë:

Fletë hyrje datë	**Vlefta**	**Ditë vonesë**	***25% vleres se kontrates***	**Penaliteti** *(1,324,378* 4/1000*ditë vonesë)*	**Penalitet i mbetur pa paguar (1,011,823-121,495)**
Nr. 6, dt 26.10.12022	471,688	46	1,324,378	243,685	
Nr. 8, dt 17.11.2022	60,845	69	1,324,378	365,528	
Nr. 9, dt. 24.11.2022	58,973	76	1,324,378	402,610	
TOTAL				**1,011,823**	**890,328**

Veprimet më sipër bien në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 124- Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2020 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 107-Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës, pika 1, 4, 6 dhe 7,

Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pika 42, 43, 44,52, 53 dhe 54, DST-të e procedurës së prokurimit, Kushtet e përgjithshme të kontratës, Neni 17, Kontratën nr. 3754/11 prot., datë 29.07.2022, Nenin 11- Penalitete për mos përmbushje të detyrimeve kontraktuale.

Kriteri: - Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", Neni 124,
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar, Neni 107-Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës, pika 1, 4, 6 dhe 7.
- Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pika 42, 43, 44,52, 53 dhe 54.
- DST-të e procedurës së prokurimit, Kushtet e përgjithshme të kontratës, Neni 17.
- Kontrata nr. 3754/11 prot., datë 29.07.2022, Nenit 11.

Ndikimi/Efekti:: Mangësi në procesin e marrjes në dorëzim të mallrave të furnizuara

Shkaku: Mos respektimi i përcaktimeve ligjore e nënligjore në fuqi mbi prokurimin publik

Rendesia: E lartë

Rekomandimi: Titullari i autoriteti kontraktor të FDKSH, të marrë masa e nevojshme administrative me qëllim arkëtimin e shumës 890,328 lekë nga subjekti OE "M. & D." Sh.p.k, vlerë e ardhur për shkak të aplikimit gabim të penalitetit për vonesat në dorëzimin e mallrave në kundërshtim me përcaktimet ligjore.

Titulli i gjetjes: **Nga auditimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit "Blerje Tonerash", viti 2022, janë konstatuar mangësi në zhvillimin e procedurës.**

Situata: -Përcaktimi i kritereve teknike dhe fondit limit

Me shkresën nr. 5245/2 prot., datë 25.08.2022, Grupi i Punës, ka paraqitur Memo, mbi hartimin e specifikimeve teknike, kritereve për kualifikim dhe llogaritjen e fondit limit. Për përcaktimin e sasisë së artikujve që nevojiten është realizuar verifikimi dhe mbledhja e të gjithë nevojave të Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale si dhe gjendjet në magazinë, por bashkëngjitur Memos, mungon dokumentacioni justifikues, procesverbal apo kërkesë sipas Drejtorive që argumenton sasitë e kërkuara, mbi bazën e të cilave do të hartohet fondi limit, në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 34 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2020 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik", Neni 12, pika 1 dhe 4, Neni 76.

- Zhvillimi i procedurës

- Me ankesën datë 17.10.2022, subjekti "I. O." SHPK ka paraqitur ankesë në lidhje me procesin e vlerësimit ofertave, pasi KVO ka skualifikuar të gjithë OE pjesëmarrës, përveç "M.& D." SHPK që ka dhe ofertën më të lartë, për mungesën e pullave të sigurisë pasi kanë paraqitur monstra për tonera ekuivalentë.
- Me ankesën datë 17.10.2022, subjekti "B. T." SHPK, ka paraqitur ankesë në lidhje me procesin e vlerësimit ofertave, pasi 2 nga kriteret e veçanta të kualifikimit janë në shkelje të ligjit të prokurimeve.

- Me Vendimin nr.16, datë 19.10.2022, për një ndryshim në Vendimin nr.14, datë 17.10.2022, është ndryshuar përbërja e Komisionit për shqyrtimin e ankesës (KSHA), i përbërë nga z. E. C., z. A. H. dhe z. A. F.
- Sa sipër rezulton se pjesë e komisionit të shqyrtimit të ankesave sipas Vendimit nr.16, datë 19.10.2022 (nr.5245/16 prot.) të titullarit të AK, është z. E.C., i cili gjithashtu është edhe pjesë e komisionit për argumentimin e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike, si dhe hartimin e kritereve për kualifikim, sipas urdhrit nr.266, datë 23.08.2022 (nr.5245/1 prot.), veprime këto që bien në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 101 "Hapat për shqyrtimin e ankesave në autoritetin/entin kontraktor", pika 1 ku citohet: *"...Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit për të cilin është paraqitur ankesa…".*

Kriteri:
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", Neni 34
- VKM nr. 285, datë 19.05.2020 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik", Neni 12, pika 1 dhe 4, Neni 76. Neni 101.

Ndikimi/Efekti:: Mangësi në hartimin e kërkesave për nevojën e shërbimeve, mallrave dhe në procesin e shqyrtimit të ankesave.

Shkaku: Mos respektimi i përcaktimeve ligjore e nënligjore në fuqi mbi prokurimin publik.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Titullari i autoriteti kontraktor të FDKSH, të marrë masa që në vijimësi, në organizimin e procedurave të prokurimit të argumentojë fondin limit bazuar në dokumentacion justifikues që përcakton nevojën për punë, shërbime dhe mallra, si dhe të respektojë përcaktimet ligjore në procesin e shqyrtimit të ankesave.

Titulli i gjetjes: **Nga auditimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit "Blerje Karburanti", viti 2022, janë konstatuar mangësi në zhvillimin e procedurës.**

Situata:
- Procedura e përzgjedhur për blerjen e karburantit është procedura e hapur e thjeshtuar. Për menaxhimin me efektivitet të fondeve duhej të përzgjidhej procedura marrëveshje kuadër, bazuar në përcaktimin e çmimit të karburantit sipas Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 12.03.2022 si dhe përcaktimeve të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 59 "Përdorimi i marrëveshjes kuadër", pika 2: "Qëllimi i një marrëveshjeje kuadër është të vendosë kushtet e kontratave që do të prokurohen gjatë një periudhe të caktuar kohore, veçanërisht ato që kanë lidhje me çmimin dhe aty ku është e përshtatshme, me sasitë e parashikuara". Neni 61 "Qëllimi i përdorimit dhe detyrimet që rrjedhin nga një marrëveshje kuadër" pika 1: *"Një marrëveshje kuadër është e përshtatshme për mallra dhe shërbime të përdorura zakonisht me natyrë të përsëritur dhe/ose kur është e vështirë ose e pamundur për të përcaktuar paraprakisht volumet që duhet të prokurohen, dhe nuk ka siguri për kohën e ekzekutimit të kontratave".*
- Në dosje nuk administrohet relacioni që argumenton orët e punës të gjeneratorëve gjatë vitit si dhe sasinë e karburantit që nevojitet, për pasojë

	hartimi i fondi limit është i paargumentuar në kundërshtim me përcaktimeve të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 34 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2020 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik", Neni 12 dhe 76.
Kriteri:	- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", Neni 34 - VKM nr. 285, datë 19.05.2020 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik", Neni 12 dhe Neni 76.
Ndikimi/Efekti::	Mangësi në hartimin e kërkesave për nevojën e shërbimeve, mallrave dhe menaxhimin me efektivitet të fondeve.
Shkaku:	Mos respektimi i përcaktimeve ligjore e nënligjore në fuqi mbi prokurimin publik.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Titullari i autoriteti kontraktor të FDKSH, të marrë masa që në vijimësi, në organizimin e procedurave të prokurimit të argumentojë fondin limit bazuar në dokumentacion justifikues që përcakton nevojën për punë, shërbime dhe mallra, si dhe të respektojë përcaktimet ligjore në procesin e përzgjedhjes së llojit të procedurës së prokurimit me qëllim përdorimin me efektivitet të fondeve publike.

II- <u>Procedura Prokurimi "Blerje me vlerë të vogël"</u>

- Me urdhër të titullarit të FSDKSH nr. 52, datë 18.02.2022, është ngritur Komisionit i Prokurimit me Vlerë të Vogël për vitin 2022, i përbërë nga znj. L. C. Kryetar, znj. A. L. anëtar dhe z. A. K. anëtar.
- Me urdhër të titullarit të FSDKSH nr. 72, datë 09.03.2022, është zëvendësuar njëri prej anëtarëve të Komisionit Prokurimit me Vlerë të Vogël, znj. A. L. me z. A. S.
- Me urdhër të titullarit të FSDKSH nr. 117, datë 19.04.2022, është bërë ndryshimi i Komisionit Prokurimit me Vlerë të Vogël, i përbërë nga z. E. D., znj. L. C. dhe z. A. K.
- Me urdhër të titullarit të FSDKSH nr. 175, datë 26.05.2022, është bërë ndryshimi i Komisionit Prokurimit me Vlerë të Vogël, i përbërë nga z. E. D., znj. M.D. dhe z. A. K.
- Me urdhër të titullarit të FSDKSH nr. 254, datë 16.08.2022, është bërë ndryshimi i Komisionit Prokurimit me Vlerë të Vogël, i përbërë nga z. E. D., znj. E.S. dhe z. A. K.

1- Shpenzime për pritje-përcjellje, për FSDKSH, viti 2022

- Me shkresën nr. 3664 prot., datë 18.05.2022, drejtuar Drejtorisë së Shërbimeve, nënshkruar nga znj. I. A., me detyrë asistente e Drejtorit të Përgjithshëm, është bëra kërkesa për blerjen e mallrave për nevoja të pritjes dhe përcjelljes në institucion.
- Me shkresën nr.3664/1 prot., datë 27.05.2022, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, është bëra kërkesa për miratimin e fillimit të procedurës së prokurimit.
- Me procesverbal datë 02.06.2022, Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, ka hartuar fondin limit bazuar në kontratat e viteve të mëparshme 2020 dhe 2021, në vlerën 205,600 lekë pa TVSH.
- Në ftesën për Ofertë është përcaktuar si kriter "*Subjekti që do të ofrojë shërbimin me këto mallra duhet <u>të jetë jo më shumë se 100 metra në rrugë këmbësorë</u> nga zyra e Autoritetit Kontraktor.* Vendosja e këtij kriteri është bërë për shkak të natyrës dhe rrethanave specifike të këtij shërbimi, duke qenë e pamundur ofrimi e këtij shërbimi në distancë, por nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël duhet të merren masa që në vijimësi të bëhen argumentimet dhe shpjegimet përkatëse në procesverbalin/ftesën për ofertë për hartimin e kritereve, referuar përcaktimeve të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", Neni 2, Neni 3, Neni 36, pika 2,

Neni 77, pika 1, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 40, pika 1, 2 dhe 3, Neni 56, pika 4, Neni 77, pika 2.
Në përfundim të procesit të vlerësimit është shpallur fitues OE P., NIPT- L...B, me ofertë me vlerë 197,500 leke pa TVSH dhe 237,000 lekë me TVSH.
-Është lidhur kontrata nr. 3664/4 prot., datë 09.06.2022, për një periudhë 12 mujore.
Janë realizuar likuidimet sipas tabelës më poshtë:

Nr	Përshkrimi i mallrave	Nr./ dt. - fature	Vlera ne leke me TVSH	Likuiduar	Mbetur pa likuiduar
1	Sherbim pritje Percjellje	Nr. 9 dt.01.09.2022	24,500	22.09.2022	
2	Sherbim pritje Percjellje	Nr. 10 dt.30.09.2022	18,000	26.10.2022	
3	Sherbim pritje Percjellje	Nr. 10 dt.20.12.2022	38,800	29.12.2022	
4	Sherbim pritje Percjellje	Nr. 3/2023 dt.31.01.2023	36,500	17.02.2023	
5	Sherbim pritje Percjellje	Nr. 4/2023 dt.11.04.2023	29,500		
	Totali		**147,300.00**		**97,500**

Burimi: FSDKSH, përpunoi KLSH

-Nga verifikimi i dokumentacionit bashkëngjitur urdhër shpenzimeve rezulton se informacioni mbi shpenzimet e kryera, takimet e realizuara, numrin e pjesëmarrësve, nuk është shoqëruar me dokumentacion justifikues si ftesa zyrtare për takimet, shkresa apo email, axhendën e takimeve, personat që do të marrin pjesë, jo në përputhje me përcaktimet e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për rregullat e Prokurimit Publik" i ndryshuar, neni 107, pika 3 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pika 42, 43, 44,52, 53 dhe 54, duke ngarkuar me përgjegjësi Përgjegjësen e Sektorit të Financës znj. L.Sh. si dhe z. E. B. me detyrë Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse.

2- Materiale për pastrim dhe dezinfektim
- Me shkresën nr.4457 prot., datë 07.07.2022, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, është bërë kërkesa për miratimin e fillimit të procedurës së prokurimit.
- Me procesverbal datë 21.08.2022, Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, ka hartuar fondin limit bazuar në testimin e tregut, sipas mesatares së 3 ofertave të paraqitura, në vlerën 670,000 lekë pa TVSH.
- Në përfundim të procesit të vlerësimit është shpallur fitues OE XH.N.SH.G., NIPT- L....T, me ofertë me vlerë 498,800 leke pa TVSH dhe 598,560 lekë me TVSH.
- Me urdhër nr. 268 prot., datë 25.08.2022, të titullarit, është ngritur Komisioni për marrjen në dorëzim të mallrave, i përbërë nga znj. L.C. Kryetar, znj. M. B. anëtar dhe znj. I. C. anëtar.
Likuidimet paraqiten sipas tabelës më poshtë:

Nr.	Përshkrimi I mallrave	Operatori	Urdhër Prokurimi/ Shërbimi	Nr./ dt. - fature	Vlera ne leke	Likuiduar
1	Blerje Materiale Pastrimi dhe Dezinfektimi	XH.N.SH G	nr.260, date 22.08.2022	nr.90, date 01.09.2022	598,560.00	08.09.2022

Burimi: FSDKSH, përpunoi KLSH

-Nga verifikimi i zbatimit të kontratës dhe urdhër shpenzimeve, rezulton se likuidimet janë kryer bazuar në dokumentacionin justifikues, si procesverbale për marrjen në dorëzim të mallit, fletë hyrje, fatura tatimore e lëshuar nga subjekti si dhe Memo mbi likuidimin e faturës dhe zbatimin e kontratës.

3- Mirëmbajtje e sistemit të kondicionimit të godinës së Fondit

- Me shkresën nr.4014 prot., datë 10.06.2022, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, është bëra kërkesa për miratimin e fillimit të procedurës së prokurimit., bashkëngjitur procesverbal për hartimin e specifikimeve teknike.
- Me procesverbal datë 06.07.2022, Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, ka hartuar fondin limit bazuar në testimin e tregut, sipas mesatares së 3 ofertave të paraqitura, në vlerën 700,000 lekë pa TVSH.
- Në përfundim të procesit të vlerësimit është shpallur fitues OE "C." SHPK, me ofertë me vlerë 697,000 leke pa TVSH dhe 836,400 lekë me TVSH.

Nga auditimi kanë rezultuar mangësi si vijon:

- Në ftesën për Ofertë është përcaktuar si kriter "*Shoqëria duhet te jete e pajisur me licence profesionale te zbatimit kategoria NS 12, klasifikimi jo me poshtë se germa E, kategoria NS-14 klasifikimi germa A , licence profesionale personale ne zbatim kategoria 12-b,c,f.g, si dhe licence profesionale personale ne Mbrojtjen Kundra Zjarrit."*. Vendosja e këtij kriteri pa përcaktuar nënkategoritë është i paargumentuar teknikisht, pasi jo të gjitha nënkategoritë e Klasifikimit NS-14, kanë lidhje me objektin e kontratës. Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël duhet të përcaktojë qartësisht dhe specifikisht kriteret për kualifikim referuar përcaktimeve të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 36, pika 2, Neni 77, pika 1 dhe 4, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 41, pika 2, Neni 55, pika 4, Neni 78, pika 2, Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", pika 7.
- Dokumenti i paraqitur për Qendrën e Asistences së autorizuar (Systemair) për shërbimin teknik për pajisjet e kondicionimit Chiller (Heat Pump), Fan Coil dhe AHU, është në gjuhën italiane, dhe nuk vërteton lidhjen kontraktuale ndërmjet OE fitues "C." SHPK dhe shoqërisë "T. SRL". Edhe pse mangësitë në paraqitjen e këtij dokumenti, nuk janë thelbësore për skualifikimin e ofertës fituese OE, Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël në vijimësi duhet të kërkoj sqarime përkatëse për këto devijime sipas përcaktimeve të bëra në Ftesën për ofertë, pika 10 dhe Ligjin nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 92-Shyqrtimi i Ofertave, pika 3.
-Është lidhur kontrata nr. 4013/6 prot., datë 15.07.2022, për një periudhë 12 mujore.
- Me urdhër nr. 238 prot., datë 15.07.2022, të titullarit, është ngritur Komisioni për ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve, i përbërë nga z. A. Xh. Kryetar, z. D.Ll. anëtar dhe z. G. H. anëtar.
- Nga Komisioni për ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve është hartuar plani për zbatimin e kontratës me nr. 4013/7 prot., datë 20.07.2022.

Janë realizuar likuidimet sipas tabelës më poshtë:

Nr	Pershkrimi i mallrave	Nr./ dt. - fature	Periudha	Vlera ne leke	Vlera e likuiduar	Dt. Likuidimit	Mbetur pa likuiduar
1	Mirembajtje e sistemit te kondicionimit te godines se fondit se fondit	144/2022 dt.23.08.2022	Korrik2022 - Gusht 2022	69,700	69,700	22.09.2022	
2	Mirembajtje e sistemit te kondicionimit te godines se fondit se fondit	162/2022 dt.19.09.2022	Gusht 2022 - Shtator 2022	69,700	69,700	11.10.2022	
3	Mirembajtje e sistemit te kondicionimit te godines se fondit se fondit	186/2022 dt.21.10.2022	Shtator 2022 - Tetor 2022	69,700	69,700	7.11.2022	
4	Mirembajtje e sistemit te kondicionimit te godines se fondit se fondit	219/2022 dt.21.11.2022	Tetor 2022 - Nentor 2022	69,700	69,700	12.12.2022	
5	Mirembajtje e sistemit te kondicionimit te godines se fondit se fondit	25/2022 dt.15.12.2022	Nentor 2022 - Dhjetor 2022	69,700	69,700	29.12.2022	
	Totali			**348,500**	**348,500**		**487,899**

Burimi: FSDKSH, përpunoi KLSH

- Nga verifikimi i zbatimit të kontratës dhe urdhër shpenzimeve, rezulton se likuidimet janë kryer bazuar në dokumentacionin justifikues, si procesverbale për marrjen në dorëzim të mallit, raport për zbatimin e kontratës, fletë hyrje, fatura tatimore e lëshuar nga subjekti si dhe Memo mbi likuidimin e faturës dhe zbatimin e kontratës.

4- Shpenzime ndërtimore për mirëmbajtjen e godinës

- Me shkresën nr. 6208 prot., datë 13.10.2022, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, është bëra kërkesa për miratimin e fillimit të procedurës së prokurimit.
- Me procesverbal datë 17.10.2022, Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, ka hartuar fondin limit bazuar në testimin e tregut, sipas mesatares së 3 ofertave të paraqitura, në vlerën 450,000 lekë pa TVSH.
- Nga titullari i Autoritet Kontraktor nuk është ngritur Grup Pune, në përbërje të secilit duhet të kishte një specialist të fushës, për verifikimin e punimeve që do të kryen, gjithashtu në dosje nuk administrohet procesverbal paraprak konstatues për nevojën e kryerjes së punimeve, por administrohet preventiv i hartuar dhe nënshkruar vetëm nga nëpunësi z. A. Xh.
- Në përfundim të procesit të vlerësimit është shpallur fitues OE "S. A." SHPK, me ofertë me vlerë 396,275 leke pa TVSH dhe 475,530 lekë me TVSH.
- Është lidhur kontrata nr. 6208/3 prot., datë 08.11.2022, me vlerën 396,275 lekë pa TVSH.
- Me urdhër nr. 374 prot., datë 11.11.2022, të titullarit, është ngritur Komisioni për ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve, i përbërë nga z. E.C. Kryetar, z. A. Xh. anëtar dhe znj. M. B. anëtar.
- Nga Komisioni për ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve është hartuar plani për zbatimin e kontratës me nr. 6208/5 pro.t, datë 14.11.2022.

Janë realizuar likuidimet sipas tabelës më poshtë:

Nr	Pershkrimi i mallrave	Nr/ dt - fature	Vlera ne leke	Vlera e likuiduar	Dt. Likuidimit
1	Shpenzime per mirembajtjen e godines	16/2022 dt.09.12.2022	475,530	475,530	22.12.2022
2	**Totali**		**475,530**	**475,530**	

Burimi: FSDKSH, përpunoi KLSH

-Nga verifikimi i zbatimit të kontratës dhe urdhër shpenzimeve, rezulton se likuidimet janë kryer bazuar në dokumentacionin justifikues, situacion punimesh, procesverbal për marrjen në dorëzim të punimeve/shërbimeve, raport përmbledhës për zbatimin e kontratës, fatura tatimore e lëshuar nga subjekti si dhe Memo mbi likuidimin e faturës dhe zbatimin e kontratës.

5- Blerje pajisje zyre

- Me shkresën nr. 6815 prot., datë 21.11.2022, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, është bëra kërkesa për miratimin e fillimit të procedurës së prokurimit.
- Me procesverbal datë 21.11.2022, Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, ka hartuar fondin limit bazuar në testimin e tregut, sipas mesatares së 3 ofertave të paraqitura, në vlerën 648,900 lekë pa TVSH.
- Në përfundim të procesit të vlerësimit është shpallur fitues OE "R.A" SHPK, me ofertë me vlerë 481,000 leke pa TVSH dhe 577,200 lekë me TVSH.
- Me urdhër nr. 427 prot., datë 14.12.2022, të titullarit, është ngritur Komisioni për ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të mallrave, i përbërë nga z. A. K. Kryetar, z. M. D. anëtar dhe znj. M. B. anëtar.

Janë realizuar likuidimet sipas tabelës më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Operatori	Urdhër Prokurimi/Shërbimi	Nr./ dt. - fature	Vlera ne leke	Likuiduar
1	Blerje pajisje Zyre për FDKSH	"RA. " SHPK	Nr.386 , date 22.11.2022	Nr.1136/2022, date 30.12.2022	577,200.00	01.02.2023

Burimi: FSDKSH, përpunoi KLSH

Nga verifikimi i zbatimit të kontratës dhe urdhër shpenzimeve, rezulton se likuidimet janë kryer bazuar në dokumentacionin justifikues, procesverbal për marrjen në dorëzim të mallrave, fletë hyrje, fatura tatimore e lëshuar nga subjekti si dhe Memo mbi likuidimin e faturës dhe zbatimin e kontratës.

6- Materiale elektrike dhe hidraulike, ndriçim

- Me shkresën nr.4530 prot., datë 12.07.2022, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, është bëra kërkesa për miratimin e fillimit të procedurës së prokurimit.
- Me procesverbal datë 15.08.2022, Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, ka hartuar fondin limit bazuar në testimin e tregut, sipas mesatares së 3 ofertave të paraqitura, në vlerën 650,000 lekë pa TVSH.
- Në përfundim të procesit të vlerësimit është shpallur fitues OE "XH.N.SH.G." SHPK, me ofertë me vlerë 433,300 leke pa TVSH dhe 519,960 lekë me TVSH.
- Me urdhër nr. 263 prot., datë 22.08.2022, të titullarit, është ngritur Komisioni për ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të mallrave, i përbërë nga z. A. Xh. Kryetar, znj. M. B. dhe z. G. H.anëtar.

Janë realizuar likuidimet sipas tabelës më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Operatori	Urdhër prokurimi/Shërbimi	Nr./ dt. - fature	Vlera ne leke	Likuiduar
1	Blerje Materiale Elektrike, Hidraulike, ndriçim	XH.N.S.G.	nr.257, date 16.08.2022	nr.87, date 24.08.2022	519,960.00	06.09.2022

Burimi: FSDKSH, përpunoi KLSH

Nga verifikimi i zbatimit të kontratës dhe urdhër shpenzimeve, rezulton se likuidimet janë kryer bazuar në dokumentacionin justifikues, si procesverbale për marrjen në dorëzim të mallit, fletë hyrje, fatura tatimore e lëshuar nga subjekti si dhe Memo mbi likuidimin e faturës dhe zbatimin e kontratës.

7- Lyerje e ambientëve të godinës së FSDKSH

- Me shkresën nr. 5369 prot., datë 01.09.2022, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse është bërë kërkesa për miratimin e fillimit të procedurës së prokurimit, bashkëngjitur preventiv i punimeve.
- Me procesverbal datë 15.09.2022, Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, ka hartuar fondin limit bazuar në testimin e tregut, sipas mesatares së 3 ofertave të paraqitura, në vlerën 720,000 lekë pa TVSH.
- Nga titullari i Autoritet Kontraktor nuk është ngritur Grup Pune, në përbërje të secilit duhet të kishte një specialist të fushës, për verifikimin e punimeve që do të kryen, në dosje nuk administrohet procesverbal paraprak konstatues për nevojën e kryerjes së punimeve, por administrohet preventiv i hartuar dhe nënshkruar vetëm nga nëpunësi z. A. Xh., i cili nuk është shoqëruar me skicën apo planimetritë e zyrave, mbi bazën e të cilave do të llogaritej sipërfaqja për çdo ambient.

- Në përfundim të procesit të vlerësimit është shpallur fitues OE "M.B." SHPK, me ofertë me vlerë 480,000 leke pa TVSH dhe 576,000 lekë me TVSH.
- Është lidhur kontrata nr. 5369/3 prot., datë 23.09.2022.
- Me urdhër nr. 309 prot., datë 30.09.2022, të titullarit, është ngritur Komisioni për ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të punëve/shërbimeve, i përbërë nga z. A. Xh. Kryetar, z. A.H. anëtar dhe z. F. S. anëtar.
- Nga Komisioni për ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve është hartuar plani për zbatimin e kontratës me nr. 5369/5 prot., datë 30.09.2022.
Janë realizuar likuidimet sipas tabelës më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Nr./ dt. - fature	Vlera ne leke	Vlera e likuiduar	Dt. Likuidimit
1	Shpenzime për lyerjen e godinës se Fondit	70/2022 dt.19.10.2022	479,998.20	479,998	22.11.2022
2	**Totali**		**479,998.20**	**479,998**	

Burimi: FSDKSH, përpunoi KLSH

-Nga verifikimi i zbatimit të kontratës dhe urdhër shpenzimeve, rezulton se likuidimet janë kryer bazuar në dokumentacionin justifikues, situacion punimesh, procesverbal për marrjen në dorëzim të punimeve/shërbimeve, raport përmbledhës për zbatimin e kontratës, fatura tatimore e lëshuar nga subjekti si dhe Memo mbi likuidimin e faturës dhe zbatimin e kontratës.

Titulli i gjetjes: **Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël për vitin 2022, janë konstatuar mangësi në zhvillimin e procedurave.**

Situata: 1-*Shpenzime për pritje-përcjellje, për FSDKSH, viti 2022.*
- Në ftesën për Ofertë është përcaktuar si kriter "*Subjekti që do të ofrojë shërbimin me këto mallra duhet të jetë jo më shumë se 100 metra në rruge këmbësore nga zyra e Autoritetit Kontraktor.* Vendosja e këtij kriteri është bërë për shkak të natyrës dhe rrethanave specifike të këtij shërbimi, duke qenë e pamundur ofrimi e këtij shërbimi në distancë, por nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël nuk janë bërë shpjegimet përkatëse, referuar rrethanave më sipër, në procesverbalin/ftesën për ofertë për hartimin e kritereve, referuar përcaktimeve të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", Neni 2, Neni 3, Neni 36, pika 2, Neni 77, pika 1, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 40, pika 1, 2 dhe 3, Neni 56, pika 4, Neni 77, pika 2.
-Nga verifikimi i dokumentacionit bashkëngjitur urdhër shpenzimeve rezulton se informacioni mbi shpenzimet e kryera, takimet e realizuara, numrin e pjesëmarrësve, nuk është shoqëruar me dokumentacion justifikues si ftesa zyrtare për takimet, shkresa apo email, axhendën e takimeve, personat që do të marrin pjesë, jo në përputhje me përcaktimet e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për rregullat e Prokurimit Publik" i ndryshuar, neni 107, pika 3 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pika 42, 43, 44,52, 53 dhe 54.
2-Mirëmbajtje e sistemit të kondicionimit të godinës së Fondit
-Në ftesën për Ofertë është përcaktuar si kriter "Shoqëria duhet të jetë e pajisur me licencë profesionale të zbatimit kategoria NS 12, klasifikimi jo më poshtë se germa E, kategoria NS-14 klasifikimi germa A , licence profesionale personale në zbatim kategoria 12-b,c,f.g, si dhe licence

profesionale personale në Mbrojtjen Kundra Zjarrit.". Vendosja e këtij kriteri pa përcaktuar nënkategoritë është i paargumentuar teknikisht, pasi jo të gjitha nënkategoritë e Klasifikimit NS-14, kanë lidhje me objektin e kontratës. Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël duhet të përcaktojë qartësisht dhe specifikisht kriteret për kualifikim referuar përcaktimeve të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 36, pika 2, Neni 77, pika 1 dhe 4, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 41, pika 2, Neni 55, pika 4, Neni 78, pika 2, Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", pika 7.

- Dokumenti i paraqitur për Qendrën e Asistencës së autorizuar (Systemair) për shërbimin teknik për pajisjet e kondicionimit Chiller (Heat Pump), Fan Coil dhe AHU, është në gjuhën italjane, dhe nuk vërteton lidhjen kontraktuale ndërmjet OE fitues "C."Sh.p.k dhe shoqërisë "T. SRL". Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël në vijimësi duhet të kërkoj sqarime përkatëse për këto devijime sipas përcaktimeve të bëra në Ftesën për ofertë, pika 10 dhe Ligjin nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 92-Shyqrtimi i Ofertave, pika 3.

3- Shpenzime ndërtimore për mirëmbajtjen e godinës

- Nga titullari i Autoritet Kontraktor nuk është ngritur Grup Pune, në përbërje të secilit duhet të kishte një specialist të fushës, për verifikimin e punimeve që do të kryen, gjithashtu në dosje nuk administrohet procesverbal paraprak konstatues për nevojën e kryerjes së punimeve, por administrohet preventiv i hartuar dhe nënshkruar vetëm nga nëpunësi z. A. Xh.

4- Lyerje e ambienteve të godinës së FSDKSH

- Nga titullari i Autoritet Kontraktor nuk është ngritur Grup Pune, në përbërje të secilit duhet të kishte një specialist të fushës, për verifikimin e punimeve që do të kryen, në dosje nuk administrohet procesverbal paraprak konstatues për nevojën e kryerjes së punimeve, por administrohet preventiv i hartuar dhe nënshkruar vetëm nga nëpunësi z. A. Xh., i cili nuk është shoqëruar me skicën apo planimetritë e zyrave, mbi bazën e të cilave do të llogaritej sipërfaqja për çdo ambient.

Kriteri:

- Ligji nr.162/2020 "Për prokurimin publik", Neni 2, Neni 3, Neni 36, pika 2, Neni 77, pika 1 dhe 4, Neni 92, pika 3.
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 40, pika 1, 2 dhe 3, Neni 41, pika 2, Neni 55, pika 4, Neni 56, pika 4, Neni 77, pika 2, Neni 78, pika 2, Neni 107, pika 3.
- Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", pika 7.
- Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pika 42, 43, 44,52, 53 dhe 54.

Ndikimi/Efekti:: Mangësi në hartimin e kërkesave për nevojën e shërbimeve, mallrave, në hartimin e kritereve për kualifikim dhe në procesin e marrjes në dorëzim të punëve, mallrave dhe shërbimeve.

Shkaku: Mos respektimi i përcaktimeve ligjore e nënligjore në fuqi mbi prokurimin publik.

Rendesia: E lartë

Rekomandimi: Titullari i autoriteti kontraktor, FDKSH të marrë masa që në vijimësi, në organizimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, të argumentojë fondin limit bazuar në dokumentacionin justifikues si dhe të ngrihen grupe pune me specialistë të fushës për përcaktimin e nevojave për punë, mallra e shërbime, të argumentojë hartimin e kritereve dhe specifikimive për kualifikim, si dhe të respektojë përcaktimet ligjore në procesin e marrjes në dorëzim.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me pikën 2/5 të Projekt Raportit, ka paraqitur observacion me nr. 1108/20 prot, datë 01.09.2023, administruar në KLSH me nr. 282/5 prot, datë 07.09.2023, z. E. D., në cilësin e anëtarit të Njësisë së Prokurimit, i cili ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:
Sipërfaqja prej 500 m2, është kërkuar për arsye se, operatori ekonomik nuk është vetëm në shërbim të autoritetit kontraktor, por është në shërbim dhe të publikut, mund të ekzistojë mundësia që automjetet duhet të qëndrojnë për disa ditë në servis dhe servisi duhet të ketë ambientet e nevojshme për qëndrimin e automjetit/automjeteve dhe ky kriter është në përputhje me ligjin.
Sa i përket pikës së dytë, 4 linja kontrolli janë kërkuar për të vërtetuar se, operatori ekonomik ka kushte për të realizuar kontratën në kohë të shpejt, duke patur parasysh që operatorët ekonomik ofrojnë shërbim dhe për publikun dhe mos vendosja e këtij kriteri do të zgjasë kohën e riparimit të automjeteve duke sjellë dhe problematika të ndryshme në mbarëvajtjen e punëve të autoritetit kontraktor.
Për pikën e tretë, në DST, është shënuar: Urë për ngritje dhe kontroll të mjetit me rrota, të mbështetura dhe të varura, me kapacitet jo më pak se 3 ton, e përshtatshme edhe për foristrada dhe furgone. Ky kriter është vendosur pasi AK disponon makina të tipit Mitsubishi Pajero që janë Fuoristrada, nuk janë vetura dhe për këtë arsye janë kërkuar ura me këto karakteristika.
Për shkak të një gabimi njerëzor, këto kritere nuk janë pasqyruar në procesverbalin e argumentimit, për këto kritere janë plotësisht bazuara në përcaktimet ligjore.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Në lidhje me pretendimet e parashtruara në observacion nuk janë paraqitur argumente apo dokumente shtesë nga ato të trajtuara për akt-konstatimet, për pasojë nuk merren në konsideratë.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me pikën 2/5 të Projekt Raportit, ka paraqitur observacion me nr. 1108/19 prot, datë 01.09.2023, administruar në KLSH me nr. 282/4 prot, datë 04.09.2023, z. Sh.S., znj.I. C., z. D. Ll., në cilësin e anëtarit të KVO-së, të cilët kanë bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:
Nga ana e grupit të auditimit, është ngarkuar me përgjegjësi Komisioni i Prokurimit Mirmbajtje automjetesh të Fondit per vitin 2022, përkatësisht i përbërë nga Sh.S., I. C. dhe D.L., nga auditimi i ofertës fituese të paraqitur nga "A. M. S.", me vlerë 1,800,000 lekë pa TVSH dhe 2,160,000 lekë me TVSH, rezultoi se: 1-Shtojca 1- Formulari I ofertës, cmimi i ofertës me TVSH është shënuar 2 160 0000 (dy million e njeqind e gjashtëdhjet mije) lekë, pra ka një gabim në cmimin e ofertës me TVSH për të cilën nga AK nuk është kërkuar sqarim nga OE dhe nuk është bërë asnjë shpjegim në procesverbalin për shqyrtimin e ofertave me nr. 6878/4 prot., datë 09.12.2022, veprime keto në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", neni 92- shqyrtimi i ofertave dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 82, pika 2 dhe 3.

Operatori ekonomik ka dorëzuar fromularin e ofertës (shtojca 1), ku në pikën e, çmimi i ofertës pa TVSH është 1,800,000 (një milion e tetëqind mijë) lekë dhe në pikën f, çmimi i ofertës me TVSH është 2,160,0000 (dy milion e njëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë.
Nga ana e OE është bërë një gabim me shtimin e një 0 (zero) tek vlera në shifra, por në përshkrimin e vlerës me fjalë shifra është e saktë.
Në lidhje me këtë pikë, bazuar në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"i ndryshuar, neni 82, pika 3/c, citohet: c)Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur shuma në fjalë ka lidhje me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas shkronjave "a" dhe "b", të kësaj pike, për rrjedhojë, në këtë rast, mbizotëron shuma në shifra dhe ajo në fjalë do të korrigjohet.
2- Në lidhje me plotësimin e kritereve 3.2- Kapaciteti teknik, për kategoritë 1- Motorrist; 4- Elektroaut; 5-Bojaxhi automjetesh; 6- Llamarinist automjetesh, në listë pagesat e dorezuara nga OE fitues janë deklaruar në kodin 7231.06- Mekanik automjetesh, nderkohe që keto kategori duhet te klasifikoheshin në kode të tjera sipas përcaktimit të VKM Nr. 514, datë 20.09.2017 "Për miratimin e listes kombetare te profesioneve të rishikuar", kodi profesioni 7132 dhe 7231, konkretisht si më poshtë:
7231.03- Elektroaut
7132.02- Bojaxhi automjetesh
7231.05- Llamarinist automjetesh
Ne piken 3.2 autoriteti kontraktor ka percaktuar nr. e punonjesve dhe emertimin e pa percaktuar kode.
Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka të punësuar në stafin e tij personeli teknik me profilet e punës të cituar më sipër, për secilin prej tyre duhet të paraqesë:
Kontrat individuale të punës si dhe ti ketë deklaruar këta punonjës në profilet e kërkuara si më sipër në Listëpagesat e punonjësve (E-Sig 025) të deklaruara në organet tatimore, për periudhën Shtatore 2022-Tetor 2022. Në lidhje me këtë pikë, KVO është bazuar në DST, pika 2, Kriteret e veçanta të kualifikimit, Operatori ekonomik ofertues duhet të kete të punësuar mbi 10 vetë si dhe të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, në përbërje të të cilit të ketë minimalisht 6 punonjës sipas profileve më poshtë:
- Motorist, pompist, mekanik/xhenerikë, elektroaut, bojaxhi automjetesh, llamarinist atumjetesh. Për të vërtetuar se operatori ekonomik ka të punësuar në stafin e tij teknik personelin teknik me profilet e punës të cituara më sipër, për secilin prej tyre duhet të paraqesë: Kontrata individuale të punës sipas kritereve të përcaktuara të cilat duhet të jenë të shoqëruara me diplomë dhe librezë pune si dhe listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi Shtator-Tetor 2022.
3- Në deklaratën e Garancisë dorëzuar nga OE fituese, në lidhje me garancinë për pjesët e kembimit citohet "Për pjesët e kembimit që do të përdoren për riparimin e automjeteve do të jenë të reja, orgjinale, prodhim sipas standarteve të CE, me garancine jo me pake se nje vit, nga data e montimit, ose sipas normativave standarte të mirmbajtjes së automjeteve, bazuar në km të pershkuara.", në kundështim me përcaktimin e DST-ve të publikuara nga AK, pika 3.2- Kapaciteti Teknik, ku është përcaktuar "Deklartë se pjesët e kembimit që do të përdoren për riparimin e automjeteve, do të jenë të reja, dhe prodhimi sipas standarteve të CE, për garancinë e pjesëve të kembimit jo më pak se 1 vit, nga data e montimit."
Në lidhje me këtë pikë OE ka dorëzuar deklaratën "Deklaratë e Garancisë", ku z. A. M. në cilësin e administratorit, deklaron se pjesët e këmbimit do të jenë të reja, origjinale sipas standartit dhe origjinave të markave të makinave përkatëse.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Në lidhje me pretendimet e parashtruara në observacion, sqarojmë se janë të njëjta me ato të paraqitur për akt-konstatimin, pra nuk janë paraqitur argumente apo dokumente shtesë, për pasojë observacioni nuk merret në konsideratë.

2.6. Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave duke përfshirë efektet e largimeve, rekrutimet dhe transferimet, llogaritjen e përfitimeve dhe çështjeve gjyqësore.

Funksionimi i strukturës së FSDKSH-së

Marrëdhëniet e punës në FSDKSH rregullohen sipas Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, i ndryshuar "Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë". Struktura organike e institucionit është miratuar në përputhje me pikën c, neni 21 i Ligjit nr. 10383 datë 24.02.2011 "Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë". Për vitin 2022 struktura rezulton e miratuar me Vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 14, nr. 631 prot., datë 02.02.2018 "Për miratimin e strukturës organizative, strukturës së brendshme dhe të rregullores për organizimin, funksionimin dhe përshkrimet e punës të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor", sipas të cilit numri i punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të FSDKSH është 160, i cili është ndryshuar me Urdhrin nr. 455, datë 13.10.2020 ku numri i punonjësve të Drejtorisë Qendrore të FSDKSH është caktuar 168 punonjës.

Gjatë vitit 2021 struktura e FSDKSH-së ka ndryshuar me urdhrin nr. 8 datë 18.01.2022 si më poshtë:

Shkurtohet 1 (një) pozicion pune specialist në sektorin e Protokoll-Arshivës dhe shtohet 1 (një) pozicion pune Koordinator i Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit. Ky ndryshim rezulton në zbatim të VKM-së nr. 618, datë 20.10.2021 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e rrjetit të koordinatorëve kundër korrupsionit".

Funksionimi i Këshillit Administrativ të FSDKSH-së

FSDKSH drejtohet nga Këshilli Administrativ i tij dhe Drejtori i Përgjithshëm.

Këshilli Administrativ i FSDKSH-së është organi më i lartë vendimmarrës. Ai përbëhet nga 6 anëtarë.

Organizimi i përgjithshëm i FSDKSH-së

Këshilli Administrativ i FSDKSH-së zgjedh Drejtorin e Përgjithshëm. Me VKA nr. 22 datë 03.12.2020 është komanduar znj. A.Ç. në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të komanduar.

Struktura e Përgjithshme Organizative e FSDKSH është e organizuar në:

- Drejtoria Qendrore e FSDKSH-së;
- 13 Drejtori Rajonale të Fondit;
- 4 Degë Rajonale të Fondit, në Tropojë, Sarandë, Pogradec, Lushnje;
- 18 Agjenci të Fondit.

Struktura organizative

Drejtoria e Përgjithshme e FSDKSH, është organizuar dhe funksionon si në vijim:

- Drejtori i Përgjithshëm;
- Kabineti, ka në përbërje 4 këshilltarë, 1 zëdhënës shtypi dhe 1 sekretar të Drejtorit të Përgjithshëm;
- 3 Zëvendës Drejtorë të përgjithshëm;
- Drejtoria Ekonomike, ka në përbërje 13 punonjës, 1 drejtor dhe 4 sektorë, përkatësisht, Sektori i Buxhetit me 3 punonjës, Sektori i Kontabilitetit me 3 punonjës, Sektori i të Ardhurave, Menaxhimit të Likuiditeteve dhe Aktiveve me 3 punonjës dhe Sektori i Financës së Brendshme me 4 punonjës.

- Drejtoria e Rimbursimit, ka në përbërje 9 punonjës, 1 drejtor dhe 2 sektorë, përkatësisht, Sektorin e Listës së Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore me 4 punonjës dhe Sektorin e Monitorimit dhe Analizës së Rimbursimit me 5 punonjës.
- Drejtoria e Kujdesit Parësor dhe Spitalor e cila ka në përbërje 14 punonjës, 1 drejtor dhe 4 sektorë, përkatësisht, Sektori i Shërbimit Spitalor me 3 punonjës, Sektori i Analizës, Monitorimit dhe Kostifikimit të Shërbimeve Spitalore me 4 punonjës, Sektori i Monitorimit, Analizës dhe Kontrollit Mjekësor Bazë me 4 punonjës dhe Sektori i Shërbimit Parësor me 3 punonjës.
- Drejtoria e Informacionit dhe Analizës Statistikore ka në përbërje 14 punonjës, 1 drejtor dhe 4 sektorë, përkatësisht, Sektori i Analizës me 4 punonjës, Sektori i Suportit Teknik dhe Administrimit të Rrjetit me 4 punonjës, Sektori i Certifikimit të Nënshkrimit Elektronik me 3 punonjës dhe Sektori i Programimit dhe Menaxhimit të Databazave me 3 punonjës.
- Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse ka në përbërje 32 punonjës, 1 drejtor dhe 5 sektorë, Sektori i Planifikimit me 3 punonjës, Sektori i Shërbimeve me 14 punonjës, Sektori i Protokoll-Arkivës me 5 punonjës, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimit me 6 punonjës dhe Sektori i Marrëdhënieve me Qytetarët me 4 punonjës.
- Drejtoria Juridike ka në përbërje 15 punonjës, 1 drejtor dhe 4 sektorë, përkatësisht Sektori i Përfaqësimit Ligjor me 4 punonjës, Sektori i Ligjshmërisë me 4 punonjës, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë me 4 punonjës, Sektori i Prokurimeve me 3 punonjës.
- Drejtoria e Auditit të Brendshëm ka në përbërje 12 punonjës, 1 drejtor dhe 3 sektorë, përkatësisht, Sektori i Auditimit të Sigurisë me 4 punonjës, Sektori i Auditimit të Këshillimit, Sigurimit të Cilësisë, Planifikimit dhe Raportimit me 4 punonjës dhe Sektori i Auditimit Tekniko-Mjekësor me 4 punonjës.
- Drejtoria e Kontrollit ka në përbërje 33 punonjës, 1 drejtor dhe 4 sektorë, përkatësisht, Sektori i Kontrollit të Depove Farmaceutike me 8 punonjës, Sektori i Kontrollit të 158 Farmacive/Agjencive Farmaceutike me 9 punonjës, Sektori i Kontrollit të Parësorit me 6 punonjës dhe Sektori i Kontrollit të Spitaleve me 10 punonjës.
- Drejtoria e Koordinimit të Informacionit dhe Studimit të Strategjive të Zhvillimit Shëndetësor ka në përbërje 7 punonjës, 1 drejtor dhe 2 sektorë, përkatësisht, Sektori i Koordinimit të Informacionit me 4 punonjës dhe Sektori i Studimeve të Strategjive të Zhvillimit Shëndetësor me 3 punonjës.

Mbi respektimin e strukturës

Referuar strukturës së muajit dhjetor 2022, rezulton se në Drejtorinë Qendrore të FSDKSH kanë qenë të punësuar 153 punonjës ose 15 punonjës më pak se numri total i punonjësve të miratuar në organikë. Ndërsa numri mesatar i punonjësve të FSDKSH gjatë vitit 2022 ka qenë 154 punonjës ose 14 punonjës më pak se numri i miratuar.

Vendet vakante / të lira

Për vitin 2022, rezultuan 15 vende vakante në Drejtorinë Qendrore të FSDKSH, të cilët janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.6.1. "Vendet e lira të punës gjatë vitit 2022"

Pozicioni në strukturën e FSDKSH	Nr. vakant i punonjësve
Zv. Drejtori i përgjithshëm	1
Specialist i Sektorit të Kontabilitetit, në Drejtorinë Ekonomike	1
Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit dhe Analizës së Rimbursimit, në Drejtorinë e Rimbursimit	1
Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Parësore, në Drejtorinë e Kujdesit Parësor dhe Spitalor	1

Specialist i Sektorit të Suportit Teknik dhe Administrimit të Rrjetit, në Drejtorinë e Informacionit dhe Analizës Statistikore	1
Specialist i Sektorit te Programimit dhe Menaxhimit të Databazave, në Drejtorinë e Informacionit dhe Analizës Statistikore	1
Specialist i Sektorit të Planifikimit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	1
Përgjegjësi i Sektorit të Protokoll-Arshivës, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	1
Pozicion shoferi, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	1
Drejtori i Drejtorisë Juridike	1
Specialist informaticien në Sektorin e Auditimit të Sigurisë, në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm	1
Specialist në Sektorin e Auditimit Tekniko-Mjekësor, në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm	1
Specialist i Sektorit të Kontrollit Parësor, në Drejtorinë e Kontrollit	1
Specialist në Sektorin e Kontrollit të Spitaleve, në Drejtorinë e Kontrollit	2
Totali	**15**

Burimi i të dhënave, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve në FSDKSH, përpunuar nga KLSH

Mungesat në strukturë mund të ndikojnë në ulje të performancës institucionale dhe mirëfunksionimin e punës.

Nga grupi i auditimit u konstatua se në strukturën e Drejtorisë së Përgjithshme të Fondit, jo për të gjitha pozicionet e punës është përcaktuar lloji i diplomës, si kriter për rekrutimin e punonjësve sipas pozicionit të punës.

Titulli i gjetjes: Mbi përcaktimin e kritereve sipas pozicionit të punës.

Situata: Nga grupi i auditimit u konstatua se në strukturën e Drejtorisë së Përgjithshme të Fondit, jo në të gjitha postet e punës është përcaktuar lloji i diplomës (Bachelor, Master Profesional, Master Shkencor) dhe specialiteti i kërkuar. Për vitin 2022 për 34 poste nuk është përcaktuar specialiteti i kërkuar, por si specialitet vendoset "Arsimi i Lartë", ose "Arsimi i Lartë/ Shkenca Shoqërore/Natyrore" pa përcaktuar se çfarë profesioni duhet të kenë punonjësit, duke lënë hapësirë për rekrutimin e punonjësve me specialitete jo të përshtatshme për aktivitetin që kryen Fondi dhe për pasojë mungesën e performancës institucionale të fondit, mungesë transparence etj.

Konkretisht për postet e punës, në pozicionet: koordinator i rrjetit antikorrupsion, këshilltarët e brendshëm, asistent i drejtorit të përgjithshëm, specialistët e sektorit të suportit teknik dhe administrimit të rrjetit, përgjegjësit dhe specialistët e sektorit të protokoll-arkivës, përgjegjësi i sektorit dhe specialistët e burimeve njerëzore dhe trajnimeve, përgjegjës dhe specialistët e sektorit të marrëdhënieve me qytetarët, përgjegjësit dhe specialistët e sektorit të marrëdhënieve me jashtë, përgjegjësit dhe specialistët e drejtorisë së koordinimit të informacionit dhe studimit të strategjive për zhvillimin shëndetësor. Veprimet e mësipërme *nuk janë në përputhje me VKM nr. 124, datë 05.03.2014 "Për miratimin e Statutit të FSDKSH", i ndryshuar, neni 10, pika 1/ç,* e cila përcakton se: Drejtori i përgjithshëm "*Miraton strukturën e brendshme, përshkrimet e punës së Drejtorisë së Përgjithshme dhe të zyrave vendore, si dhe rregulloret e organizimit dhe funksionimit të përgjithshëm të Fondit*.

Kriteri: VKM nr. 124, datë 05.03.2014 "Për miratimin e Statutit të FSDKSH", i ndryshuar, neni 10, pika 1/ç.

Ndikimi: Ka hapësirë për rekrutimin e punonjësve me kualifikime jo të përshtatshme për aktivitetin që kryen Fondi.

Shkaku: Mos përcaktimi i saktë i kritereve të kualifikimit në Rregulloren e Përgjithshme "Për Organizimin, Funksionimin dhe Përshkrimin e Punës".

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm dhe Sektori i Burimeve Njerëzore, të marrin masa për përcaktimin e nivelit të arsimit të kërkuar dhe specialitetit për çdo pozicion pune në strukturën organizative të Fondit dhe në Rregulloren për Organizimin, Funksionimin dhe Përshkrimin e Punës së Fondit.

Rekrutimi i punonjësve/ Procedurat e marrjes në punë/ Emërimet

Gjatë vitit 2022 janë emëruar 9 punonjës të rinj, nga të cilat, 2 emërime në pozicionin e Drejtorit të Drejtorive Rajonale të Fondit të Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor (Elbasan dhe Kukës) dhe 7 emërime në Drejtorinë e Përgjithshme të FSDKSH-së.

Tabela 6.2. "Lëvizjet e stafit gjatë vitit 2022"

Lëvizjet e stafit	Numër punonjësish
Emërime	9
Ndërprerje të marrëdhënieve të punës (dorëheqje)	7
Dalje në pension	3
Ndryshim pozicion pune	6
Largim nga puna me masë disiplinore	1
Lirim nga detyra	1
Komandim	5
Transferim	5

Burimi i të dhënave FSDKSH, punuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Procedurat e emërimit janë realizuar në përputhje me rregulloren përkatëse. Rekrutimi i punonjësve nëpërmjet konkurrimit të hapur është realizuar duke bërë publikimin elektronik të të gjithë informacionit, në faqen zyrtare të institucionit.

Nga auditimi u konstatua se procedurat e rekrutimeve në FSDKSH të publikuara në faqe për vitin 2022 rezultojnë për 8 pozicione pune të lira.

U audituan dosjet e procedurave të rekrutimit si më poshtë:

Tabela 6.3. "Urdhrat për emërimet 2022"

Dosje	Datë shpallje	Urdhër	Pozicioni vakant	Fituesi
1	17.03.2022	119 me nr. 3079 prot., datë 19.04.2022	Specialist në Sektorin e Analizës, Monitorimit dhe Kontrollit Mjekësor Bazë pranë Drejtorisë së Kujdesit Parësor dhe Spitalor	A.M.
2	17.03.2022		Specialist në Sektorin e Kontrollit të Parësorit, pranë Drejtorisë së Kontrollit	Rishpallje
3	17.03.2022		Specialist në Sektorin e Analizës, Monitorimit dhe Kostifikimit pranë Drejtorisë së Kujdesit Parësor dhe Spitalor	Rishpallje
4	27.09.2022	349 me nr. 5885/3 prot., datë 26.10.2022	Specialist jurist në Sektorin e Ligjshmërisë, pranë Drejtorisë Juridike	E. I.
5	26.10.2022		Specialist (Ekonomist/Mjek) në Sektorin e Kontrollit të Spitaleve	Pa fitues
6	26.10.2022	389 me nr. 6409/7 prot., datë 23.11.2022	Specialist në Sektorin e Monitorimit, Analizës dhe Kontrollit Mjekësor Bazë pranë Drejtorisë së Kujdesit Parësor dhe Spitalor	O. (V.) B.
7	26.10.2022	383 me nr. 6411/7 prot., datë 21.11.2022	Specialist në Sektorin e Koordinimit të Informacionit, pranë Drejtorisë së Koordinimit të Informacionit dhe Studimit të Strategjive të Zhvillimit Shëndetësor	E. T.
8	26.10.2022		Specialist (Fusha e Mjekësisë) në Sektorin e Kontrollit të Parësorit, pranë Drejtorisë së Kontrollit	Rishpallje

Burimi i të dhënave FSDKSH, punuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga auditimi rezulton se janë ngritur dhe administrohen në dosje urdhrat e titullarit për ngritjen e komisionit vlerësues të kandidaturave për punonjësit, relacionet e vlerësimit drejtuar titullarit

për punonjësit si dhe urdhrat për miratimin dhe shpalljen e fituesit nga titullari për punonjësit. Kandidatët që kanë shfaqur interes për t'u punësuar, janë vlerësuar me pikë, mbi bazën e kritereve të paracaktuara, konkretisht: "Arsimi", "Referenca", "Kompjuteri" dhe "Dokumentacioni" vlerësohen maksimumi me 10 pikë, "Nota mesatare" dhe "Eksperienca" vlerësohen maksimumi me 20 pikë, ndërsa "Gjuhë e huaj" me 15 pikë dhe "Trajnime" me 5 pikë.

Procedura e rekrutimit të punonjësve për pozicionin Specialist (Ekonomist/Mjek) në Sektorin e Kontrollit të Spitaleve, pranë Drejtorisë së Kontrollit në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

-Me urdhrin nr. 371, datë 07.11.2022 është ngritur komisioni i vlerësimit të kandidatëve për pozicionin e punës specialist (Ekonomist/Mjek) në Sektorin e Kontrollit të Spitaleve, me përbërje z. Sh.S., znj. E. I. dhe znj. A. R. Komisioni ka vlerësuar se kandidaturat e paraqitura i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe kanë kaluar në fazën e vlerësimit me pikë. Komisioni vlerësues i propozon Drejtorit të Përgjithshëm, që shpallja e vendit të lirë të punës të përsëritet, pasi kërkohet përzgjedhja e kandidatit në pozicion mjek. Sa më sipër sipas shpalljes ka kandidatë që i plotësojnë të gjitha kriteret e kërkuara për pozicionin ekonomist, megjithatë procedura është shpallur pa fitues.

Në vijim shpalljet propozohet të bëhen për pozicionet e domosdoshme vakante, në këtë rast nëse vendi vakant rezulton për mjek shpallja të bëhet për mjek jo për mjek/ekonomist.

Procedura e rekrutimit të punonjësve për pozicionin Specialist në Sektorin e Monitorimit, Analizës dhe Kontrollit Mjekësor Bazë pranë Drejtorisë së Kujdesit Parësor dhe Spitalor

-Me urdhrin nr. 369, datë 07.11.2022 është ngritur komisioni i vlerësimit të kandidatëve për pozicionin e punës Specialist në Sektorin e Monitorimit, Analizës dhe Kontrollit Mjekësor Bazë pranë Drejtorisë së Kujdesit Parësor dhe Spitalor, me përbërje znj. M.M., z. A. H. dhe z. A. H. Lidhur me këtë shpallje kanë shprehur interesin 2 kandidatura. Komisioni ka vlerësuar se kandidatura e znj. O. (V.) B. plotëson kriteret e përgjithshme dhe ato të kualifikimit dhe në fazën e dytë është vlerësuar me 72 pikë. *Në dosje gjendet dhe certifikata e gjuhës së huaj, e cila nuk është marrë në llogaritjen e vlerësimit me pikë.* Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur për këtë pozicion pune, rezulton se kandidatja ka dorëzuar dokumentacionin sipas kritereve të përcaktuara. *Mungon raporti mjekësor.*

Procedura e rekrutimit të punonjësve për pozicionin Specialist (Fusha e Mjekësisë) në Sektorin e Kontrollit Parësor, pranë Drejtorisë së Kontrollit.

-Me urdhrin nr. 370, datë 07.11.2022 është ngritur komisioni i vlerësimit të kandidatëve për pozicionin e punës Specialist (Fusha e Mjekësisë) në Sektorin e Kontrollit të Parësorit, pranë Drejtorisë së Kontrollit, me përbërje z. Sh.S., z. B. H. dhe znj. L. J. Lidhur me këtë shpallje ka shprehur interesin 1 (një) kandidat. Komisioni ka propozuar shpalljen edhe një herë të kësaj procedure rekrutimi, pasi në konkurrim është vetëm 1 kandidaturë. *Ndërkohë nuk specifikohet në rregullore që rastet e paraqitjes të 1 (një) kandidati të vetëm të mos merren parasysh dhe të bëhet rishpallja e pozicionit të punës.*

Procedura e rekrutimit të punonjësve për pozicionin Specialist në Sektorin e Kontrollit të Parësorit, pranë Drejtorisë së Kontrollit.

-Me urdhrin nr. 82, datë 30.03.2022 është ngritur komisioni i vlerësimit të kandidatëve për pozicionin e punës Specialist në Sektorin e Kontrollit të Parësorit, me përbërje z. Sh.S., z. B. H. dhe znj. L. J.. Lidhur me këtë shpallje kanë shprehur interesin 2 kandidatë. Komisioni ka vlerësuar se kandidatura e z. R.D. plotëson kriteret e përgjithshme dhe ato të kualifikimit dhe në fazën e dytë është vlerësuar me 57 pikë. *Por komisioni propozon ri shpalljen e këtij pozicioni pune, pasi në të dyja fazat e konkurrimit (kriteret e përgjithshme dhe vlerësimi me pikë) rezulton vetëm një kandidaturë. Sa më sipër nuk specifikohet në rregullore që në rastet kur në të dyja fazat e konkurrimit rezulton 1 (një) kandidaturë të bëhet rishpallja e pozicionit të punës.*

Procedura e rekrutimit të punonjësve për pozicionin Specialist në Sektorin e Analizës, Monitorimit dhe Kostifikimit pranë Drejtorisë së Kujdesit Parësor dhe Spitalor.
- Me urdhrin nr. 83, datë 30.03.2022 është ngritur komisioni i vlerësimit të kandidatëve për pozicionin e punës *Specialist në Sektorin e Analizës, Monitorimit dhe Kostifikimit pranë Drejtorisë së Kujdesit Parësor dhe Spitalor,* me përbërje znj. M.M., z. A. H. dhe znj. A. R. Lidhur me këtë shpallje kanë shprehur interesin 2 kandidatë. Por komisioni propozon ri shpalljen e këtij pozicioni pune, pasi dokumentet e dorëzuara rezultojnë pjesërisht të noterizuara. Komisioni vlerësues ka përgatitur relacionin në datë 20.04.2022 në papajtueshmëri me Rregulloren nr. 1 "Për funksionimin e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor", kapitulli V, pika 1.10 ku citohet "Komisioni vlerësues e përfundon detyrën e tij duke bërë raport, brenda **10 ditëve pune** nga data kur mbaron afati i paraqitjes së kërkesave për konkurrim."
Afati i paraqitjes së kërkesave për konkurrim në këtë procedurë rezulton data 30.03.2022 dhe raporti i komisionit vlerësuar është përgatitur me vonesë.

Rregullorja për emërimet e stafit në Drejtoritë Rajonale
Nga auditimi rezulton se në Rregulloren e Përgjithshme nr. 2 "Për organizimin, funksionimin dhe përshkrimin e punës në FSDKSH" Kreun 5 "Rregullorja e Burimeve njerëzore" në pikat 1.13 dhe 1.14 citohet se: "*1.13. Në rast se procedura vlerësohet e rregullt, Drejtori i Drejtorisë Rajonale e përcjell gjithë dosjen e procedurës së konkurrimit në Drejtorinë Qendrore, pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, me një shkresë përcjellëse, për miratim të procedurës. Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore e miraton punësimin ose e kthen për ta ribërë procedurën, kur në të vëren shkelje dhe parregullsi.*" dhe "*1.14. Me marrjen e miratimit si më sipër, Drejtori i Drejtorisë Rajonale bën emërimin e punonjësit duke lidhur kontratën përkatëse."* Pikat 13 dhe 14 të rregullores, janë në tejkalim të kompetencave të Drejtorit të Përgjithshëm, i cili emëron vetëm personelin e Drejtorisë së Përgjithshme, drejtuesit e drejtorive rajonale, agjencive. Ky veprim është në papajtueshmëri me VKM nr. 124, datë 05.03.2014 "Për miratimin e statutit të fondit të sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 10, pika 1/dh ku citohet se: "Drejtori i Përgjithshëm: dh*) Emëron dhe shkarkon personelin e Drejtorisë së Përgjithshme, drejtuesit e drejtorive rajonale, agjencive*" dhe neni 14, pika 2 ku citohet se: cilat ndër të tjera përcaktojnë se: *"Drejtorët e drejtorive rajonale dhe zëvendësdrejtorët emërohen nga Drejtori i Përgjithshëm. Personeli i drejtorive rajonale emërohet nga drejtori i drejtorisë rajonale".*
Konstatim: Mospërputhje ndërmjet Rregullores së Përgjithshme nr. 2 "Për organizimin, funksionimin dhe përshkrimin e punës në FSDKSH" me VKM nr. 124, datë 05.03.2014 "Për miratimin e statutit të fondit të sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Lidhur me sa më sipër me relacionin nr. 182/6 datë 30.09.2022 janë bërë rishikimet në rregulloren "Për organizimin, funksionimin dhe përshkrimin e punës në FSDKSH" dhe është ndryshuar paragrafi 1.13 si vijon "*Drejtori i Drejtorisë Rajonale përcjell dosjen e procedurës së konkurrimit në Drejtorinë e Përgjithshme pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, me shkresë përcjellëse për miratim. Sektori i Burimeve Njerëzore dhe trajnimeve bën vlerësimin e procedurës, e cila miratohet në rast se është e rregullt ose kthehet kur konstatohen parregullsi*." Pra janë marrë parasysh rekomandimet nga auditimi i kaluar i KLSH-së, lidhur me mospërputhshmërinë e evidentuar.

Kontratat e punës
Grupi i auditimit përzgjodhi 15 kontrata individuale (me afat dhe pa afat) të punës të punonjësve pjesë e strukturës së FSDKSH-së. U konstatua që Kontratat Individuale të Punës

ishin pjesë e dosjeve personale të punonjësve, i përfshijnë elementët e nevojshëm sipas kërkesave ligjore, si dhe ishin të firmosura nga të dyja palët, punëdhënësi e punëmarrësi.

Mbi komandimin e përkohshëm në detyrë

Nga auditimi konstatohet se gjatë vitit 2022, janë urdhëruar 5 komandime nga të cilat 3 pozicione drejtuese. Konkretisht:

Drejtori i DRF Elbasan, komanduar në këtë pozicion në datën 06.05.2022;

Përgjegjës i Sektorit të Protokoll Arshivës, DSHM, komanduar në këtë pozicion në datë 08.07.2022;

Drejtori i DSHM, komanduar në këtë pozicion në datë 21.12.2022;

Për më tepër konstatohet se gjatë vitit 2022 në Drejtorinë Qendrore të FSDKSH-së, 11 pozicione drejtuese pune janë drejtuar nga punonjës të komanduar, konkretisht:

Drejtor i Përgjithshëm i FSDKSH, komanduar në këtë pozicion nga data 03.12.2020

Drejtori i Drejtorisë së Rimbursimit, komanduar në këtë pozicion nga data 02.11.2020;

Drejtori i Drejtorisë së Kujdesit Parësor dhe Spitalor, komanduar në këtë pozicion nga data 17.09.2020;

Drejtori i Informacionit dhe Analizës Statistikore, komanduar në këtë pozicion nga data 11.11.2020;

Drejtor i Drejtorisë së Koordinimit të Informacionit dhe Studimit të Strategjive të Zhvillimit Shëndetësor, komanduar në këtë pozicion nga data 17.09.2020;

Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit, komanduar në këtë pozicion nga data 25.09.2020;

Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit të Depove Farmaceutike, komanduar në këtë pozicion nga data 28.09.2020;

Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzorë dhe Trajnimeve, komanduar në këtë pozicion nga data 07.10.2020;

Përgjegjësi i Sektorit Drejtoria e Koordinimit, komanduar në këtë pozicion nga data 07.10.2020.

Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimit Spitalor, komanduar në këtë pozicion nga data 22.10.2020;

Përgjegjësi i Sektorit të Certifikimit dhe nënshkrimit, komanduar në këtë pozicion nga data 13.11.2020;

Rezulton se gjatë vitit 2022 nuk është ndjekur asnjë procedure për plotësimin dhe emërimin e punonjësve në këto pozicione pune. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me Kapitullin 5, Pikën I/2.2 "Komandimi i përkohshëm në detyrë" të Rregullores "Për Funksionimin të Fondit të Sigurimeve të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor", ku citohet se: "2.*2 Për punonjësit që punësohen jashtë administratës së Fondit, komandimi zgjat për një afat kohor, jo më shumë së tre muaj, gjatë së cilës administrata e Fondit duhet të zbatojë procedurat dhe aktet ligjore e nënligjore për plotësimin përfundimtar të këtij vendi punë.*

Titulli i gjetjes:	Mos parashikimi i kohëzgjatjes së komandimit.
Situata:	Nga auditimi mbi përputhshmërinë e rasteve të komandimit të punonjësve në disa pozicione pune, referuar kritereve të përcaktuara në Rregulloren e burimeve njerëzore, Kreu 5 pika I/2.2 për pjesën e komandimeve konstatohet se: *"Komandimi i përkohshëm në detyrë", nuk parashikohet kohëzgjatja e komandimit të përkohshëm për punonjësit brenda institucionit, por vetëm për punonjësit jashtë institucionit*.
Kriteri:	Kreu 5, pika 1-2 të Rregullores nr. 1 "Për funksionimin e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit shëndetësor", miratuar me urdhrin nr. 277 datë 06.07.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm.
Ndikimi/pasoja:	Komandim pa afate të mirë-përcaktuara.
Shkaku:	Mosparashikim i saktë në Rregullore.

Rëndësia: **E mesme**

Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i FSDKSH-së, të marrë masa për ndryshimin e Rregullores së miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm FSDKSH nr. 244, datë 06.07.2020, me qëllim parashikimin e kohëzgjatjes së komandimit të përkohshëm për punonjësit brenda institucionit.

Transferimet/ Lëvizjet paralele

Nga auditimi u konstatua se gjatë vitit 2022, Drejtori i Përgjithshëm ka nxjerrë urdhra për kryerjen e 5 ndryshimeve të pozicionit të punës të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Tabela 6.4. "Ndryshimet e pozicionit të punës së punonjësve"

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni i punës së mëparshme	Pozicioni i punës ku transferohet	Urdhri i Transferimit
1	E.M.	Specialist në Sektorin e Analizës Monitorimit dhe Kostifikimit të Shërbimeve Spitalore	Specialist në Sektorin e Kontrollit të Spitaleve Drejtoria e Kontrollit	Nr. 74 datë 16.03.2022
2	M. D.	Asistente e Drejtorit të Përgjithshëm	Specialiste në Sek. e Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve DSHM	Nr. 79 datë 28.03.2022
3	V. Tr.	Përgjegjëse e Sektorit të Protokoll-Arshivës	Spec. në Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë Drejtoria Juridike	Nr. 85 datë 04.04.2022
4	E. D.	Specialist ne Sektorin e Ligjshmërisë	Përgjegjës në Sektorin e Prokurimeve Drejtoria Juridike	Nr. 108 datë 08.04.2022
5	A. S.	Përgjegjës në Sektorin e Prokurimeve Drejtoria Juridike	Specialist në DRF Tiranë	Nr. 86 datë 05.04.2022

Burimi i të dhënave Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve në FSDKSH, përpunuar nga KLSH

Nga auditimi rezulton se transferimi i bërë për z. A. S. me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm, nuk ka bashkangjitur kërkesën (ose miratimin) e punonjësit.

Ky veprim është në kundërshtim me Rregulloren e përgjithshme të funksionimit të Fondit, Kapitulli 5 "Rregullorja e burimeve njerëzore", Pika II "Ngritja në detyrë, lëvizja paralele dhe transferimi", Paragrafi 3 i cili citon: "*Transferimi kupton kalimin e punonjësit nga një Drejtori Rajonale/DSHSU në një tjetër, nga një Drejtori Rajonale/DSHSU në Drejtorinë Qendrore dhe anasjelltas, me kërkesën ose miratimin e punonjësit, bazuar në kodin e punës".*

Punonjësi ka hapur proces gjyqësor për këtë ndryshim pozicioni pune, ku kërkon dëmshpërblim prej 16 pagash.

Titulli i gjetjes: Mos zbatimi i rregullores në lidhje me transferimet.

Situata: Nga auditimi konstatohet se me urdhrin nr. 86 datë 05.04.2022 është transferuar punonjësi Altin Sula nga pozicioni i përgjegjësit në Sektorin e Prokurimeve Drejtoria Juridike në pozicionin specialist në DRF Tiranë. Transferimi nuk ka bashkangjitur kërkesën (ose miratimin) e punonjësit.

Kriteri: Kreu 5, pika II-3 të Rregullores nr. 1 "Për funksionimin e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit shëndetësor", miratuar me urdhrin nr. 277 datë 06.07.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm.

Ndikimi: Transferim pa kërkesë/miratim punonjësi, që mund të rezultojë në dëmshpërblim page.

Shkaku: Mos zbatimi i rregullores lidhur me transferimet.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i FSDKSH-së, të marrë masa për zbatimin e Rregullores së miratuar me Urdhrin nr. 277, datë 06.07.2020, lidhur me

transferimet e punonjësve në mënyrë që të shmangen proceset gjyqësore për dëmshpërblim page.

Largimet nga puna

Për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për shkaqe të ndryshme, 9 punonjësve.

Tabela 6.5. "Ndërprerja e marrëdhënieve të punës"

Arsyeja e ndërprerjes së marrëdhënies së punës	Nr. i punonjësve
Larguar me dëshirë	7 punonjës
Dalë në pension	3 punonjës
Larguar me masë disiplinore	1 punonjës
Lirim nga detyra	1 punonjës
Totali	**12 punonjës**

Burimi i të dhënave Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve në FSDKSH, përpunuar nga KLSH

Referuar tabelës, është kryer 1 largim me masë disiplinore, "Largim nga puna" sipas urdhërit nr. 104, me shkresën nr. 1997 datë 07.04.2022.

Grupi i auditimit konstatoi se është bërë ndryshim i punonjësve nga puna në bazë të rekomandimeve të Auditit të Brendshëm. Në gjykimin tonë mendojmë se rekomandimet me masë disiplinore për largim nga puna, duhet trajtuar me kujdes të veçantë nga Drejtori i Përgjithshëm për shkak të sensibilitetit të çështjes. Kemi konstatuar se me rekomandim të Auditit të FSDKSH-së në projekt raportin nr. 1835/2 prot., datë 07.04.2022 është propozuar largim nga puna për znj. V.Sh. ish-Drejtore e Drejtorisë Juridike në FSDKSH, për moszbatimin e dispozitave ligjore në përmbushjen e detyrave funksionale. Në vazhdim Drejtori i Përgjithshëm ka dalë me Urdhrin nr. 104, datë 07.04.2022 për dhënien e masës disiplinore "Largim nga puna" për znj. V. Sh.

Vlerësimi vjetor i punonjësve

Nga auditimi me përzgjedhje i dokumentacionit që administrohet në dosjen e vlerësimit vjetor të punonjëse rezulton se është hartuar formulari i vlerësimit vjetor të punonjësve nga drejtorët e drejtorive. Sipas shkresës së Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse nr. 7233, datë 14.12.2022 "Vlerësimi vjetor për vitin 2022", procesi i vlerësimit duhet të përfundojë brenda datës 23.01.2023. Rezulton se disa drejtori e kanë kryer vlerësimin e performancës për punonjësit në tejkalimin e afatit të caktuar konkretisht Drejtoria Ekonomike, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Kontrollit.

Në dosje administrohen **126 vlerësime për punonjësit nga 153** që është numri total i punonjësve. Konstatohen se shumica e vlerësimeve janë pa komente nga Drejtori i Drejtorisë (pjesë e detyrueshme) dhe të paplotësuara me të gjithë elementët e nevojshëm si: koha në pozicionin përkatës, periudha e vlerësimit, viti etj. Ky veprim rezulton në papajtueshmëri me shkresën nr.7233 prot., datë 14.12.2022 dhe Rregulloren e Personelit, Kapitulli 5- XII "Vlerësimi i rezultateve në punë të punonjësve sipas niveleve", pika 2.3 e cila citon: *"2.3. Vlerësimi bëhet mbi bazën e mbarëvajtjes në punë për një periudhë 12 mujore. Periudha e vlerësimit fillon nga 1 janari deri më 31 dhjetor. Në fillim të vitit të gjithë punonjësit njihen me detyrat dhe objektivat e punës."*

Në masë të konsiderueshme vlerësimi është në treguesin "Shkëlqyeshëm".

Trajnimet e punonjësve

Nga auditimi rezulton se për vitin 2022, Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse në FSDKSH me shkresën nr. 6483, datë 09.12.2021 ka kërkuar evidentimin e nevojave për trajnime nga drejtoritë e Fondit. Rezulton se për vitin 2022 nuk ka kalendar të miratuar të trajnimeve dhe

punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të FSDKSH nuk kanë kryer trajnime. Gjithashtu rezulton se nuk janë planifikuar shpenzime buxhetore për kryerjen e trajnimeve.
Ky veprim është në papajtueshmëri me Rregulloren "Për organizimin, funksionimi dhe përshkrimet e punës për Drejtorinë e Përgjithshme në Fond", kapitulli 8 "Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse", "Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve", Detyrat kryesore të përgjegjësit të sektorit, pika 16 citon: *"Organizon punën për hartimin e planit vjetor për trajnimin dhe kualifikimin e personelit".*

Titulli i gjetjes:	Mos zbatimi i rregullores në lidhje me vlerësimet vjetore dhe trajnimet e punonjësve.
Situata:	Nga auditimi konstatohet se në dosjen e vlerësimeve administrohen 126 vlerësime nga 153 punonjës. Për vitin 2022 nuk ka kalendar të miratuar të trajnimeve dhe punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të FSDKSH nuk kanë kryer trajnime.
Kriteri:	Kreu 5- XII, pika 2.3 te Rregullores nr. 1 "Për funksionimin e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit shëndetësor", miratuar me urdhrin nr. 277 datë 06.07.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm. Kapitulli 8 "Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse", "Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve", pika 16 e Rregullores nr. 2 "Për organizimin, funksionimin dhe përshkrimet e punës për drejtorinë e përgjithshme të Fondit", miratuar me urdhrin nr. 277 datë 06.07.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm.
Impakti:	Punonjësit për të cilët mungon vlerësimi në punë, nuk njihen me rezultatet e performancës gjatë vitit. Gjithashtu mungesa e trajnime të nevojshme mund të ndikojë në perfomancën në punë në lidhje me fushat e përgjegjësisë të secilit.
Shkaku:	Mos zbatimi i rregullores lidhur me vlerësimet vjetore dhe trajnimin e punonjësve.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa për të administruar vlerësime vjetore për të gjithë punonjësit, sipas formatit të miratuar të vlerësimit dhe për hartimin e kalendarit të trajnimeve, referuar nevojave reale të stafit.

Mbi shpenzimet e personelit
Për vitin 2022 shpenzimet për paga janë planifikuar në vlerën 223,436 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 176,786 mijë lekë ose janë realizuar në masën 79%. Shpenzimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore janë planifikuar në vlerën 37,092 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 28,853 mijë lekë ose 78% e vlerës së planifikuar. Ndërsa shpenzimet për dieta (brenda dhe jashtë vendit) janë planifikuar në vlerën 22,000 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 21,325 mijë lekë ose janë realizuar në masën 92% të vlerës së planifikuar.

Tabela 6.6. "Shpenzimet e planifikuar dhe të realizuara të personelit, FSDKSH (drejtoria qendrore)"
Në mijë lekë

Llogari ekonomike	Shpenzime	Planifikim	Realizim faktik	% e realizimit
600	Paga	223,436	176,786	79%
601	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	37,092	28,853	78%
6024	Dieta	25,720	23,711	92%
	Brenda vendit	22,000	21,325	97%
	Jashtë vendit	3,720	2,386	64%

Dokumentacioni justifikues për pagat:
Nga auditimi i dokumentacionit të pagave për punonjësit e FSDKSH-së, u konstatua se për muajt e përzgjedhur (Janar, Mars, Qershor, Shtator, Dhjetor) gjenden bashkëlidhur dokumentacioni përkatës i pagesave si: listë-pagesa mujore nënshkruar nga ekonomisti, Përgjegjësi i Financës, Drejtori Ekonomik dhe Drejtori i Përgjithshëm, listë-pagesa sipas numrit të llogarisë personale për pagën neto, listë-prezenca nënshkruar nga drejtorët e Drejtorive, si dhe listë-prezenca përmbledhëse e nënshkruar nga specialisti i burimeve njerëzore, Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore, Drejtori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtori i Përgjithshëm, raportet mjekësore, miratimi i lejeve, Urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm për komandimet në punë, për lëvizjet paralele, daljet në pension, ngritjet në detyrë, etj. Rezulton se pagesat janë kryer në përputhje me pagën e pozicionit të punës për çdo punonjës.
Për periudhën e audituar, nga verifikimi rezultoi se, është hartuar libri i pagave për çdo punonjës në të cilin pasqyrohen ditët e punës sipas muajve, paga bruto, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, tatimi, ndalesa për telefon, paga neto. Ky libër është ruajtur dhe në format elektronik. Nga verifikimi me përzgjedhje rezultoi se të dhënat në librin e pagave përputhen me të dhënat në listë-pagesë. Nga auditimi i listë pagesave si dhe krahasimi i tyre me transaksionet financiare të bërë me bankat respektive rezultoi të jenë të barabarta dhe nuk ka diferenca midis tyre.
Në lidhje me ndalesat mbi pagat**,** nga auditimi i listë pagesave rezultoi se mbi pagën bazë dhe shtesat janë llogaritur dhe ndalur kontributi i Sigurimeve shoqërore-shëndetësore në masën 11.2% (pjesa e punëmarrësit), gjithashtu është ndalur tatimi mbi të ardhurat si dhe është mbajtur sigurimi suplementar për Drejtorët e Drejtorive. Nga verifikimi i ndalesave mbi pagat u konstatua se për çdo muaj është bërë listë pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat, të cilat rakordojnë me të dhënat e pasqyruara për këto ndalesa në listë pagesat e punonjësve dhe pasqyrat për derdhjen e kontributit. Për çdo muaj janë llogaritur edhe ndalesat e tjera për telefon, etj. Pjesë e dokumentacionit të vendosur në dispozicion ishin dhe transfertat bankare për pagat dhe sigurimet sipas bankave përkatëse.

Dokumentacioni justifikues për dietat
Gjatë vitit 2022, janë realizuar shpenzime për dieta në shumën 23,711 mijë lekë. U audituan më përzgjedhje dietat për muajin Mars, Korrik dhe Nëntor 2022. Rezulton se bashkëngjitur veprimeve të kryera në bankat "R.", "Banka K. T.' dhe "C." ishin dokumentet autorizues për kryerjen e shërbimeve si dhe dokumentet justifikues që vërtetojnë kryerjen e shpenzimeve. Për periudhën e audituar shpenzimet për dieta janë kryer në përputhje me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", të ndryshuar si dhe me VKM nr. 870 datë 14.11.2011"Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit".

Vendimet gjyqësore që ndiqen dhe ekzekutohen nga FSDKSH.
Nga auditimi i dokumentacionit të vendimeve gjyqësore për largimet nga puna, të vënë në dispozicion nga sektori i përfaqësimit ligjor, rezulton se në fund të vitit 2022 janë në proces gjyqësor (shkallë të parë, Apel) 4 çështje me objekt "Dëmshpërblim page". Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria Juridike, nisur nga shumat e kërkuara në kërkesë-padi dhe vlera mesatare e pagës, shuma maksimale e pritur për shpenzimet gjyqësore është në vlerën prej 9,348,489 lekë. Në tabelën e poshtëshënuar paraqiten të dhënat e detajuara:

Tabela 6.7. "Vendimet gjyqësore me objekt "Dëmshpërblim page" për vitin 2022"

Nr.	Emër/Mbiemër	Pozicioni	Kërkuar	Gjykata ku ndiqet çështja	Statusi i çështjes
1	Sh.B.	Ish Drejtoreshë e Drejtorisë Rajonale të Fondit Kamëz - Vorë	16 paga/ 2,047,616 ALL	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane	Në proces (ka përfunduar në shkallë të parë)
2	V.Sh.	Ish Drejtoreshë Juridike në Fond	24.5 paga/ 3,625,412 ALL	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane	Seanca përgatitore është caktuar në shtator.
3	A. S.	Ish përgjegjës në sektorin e prokurimeve pranë Drejtorisë Juridike	16 paga/1,727,024 ALL	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane	Seancë përgatitore
4	G.M.	Ish Drejtoreshë e auditit të brendshëm në Fond	14.5 paga/ 1,948,437 ALL	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane	Apeluar nga Fondi

Burimi i të dhënave FSDKSH, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar të dhënave të Drejtorisë Ekonomike, gjatë vitit 2022, Drejtoritë Rajonale dhe Drejtoria Qendrore e FSDKSH kanë kryer likuidime për vendime gjyqësore të formës së prerë për ish punonjës të larguar nga puna, në vlerën totale **5,567,141 lekë**, vlerë e cila rezulton **efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit.** Tabela e mëposhtme paraqet likuidimet e bëra për vitin 2022 sipas Drejtorive Rajonale.

Tabela 6.8. "Pagesa për vendime gjyqësore për largimet nga puna 2022"

Në lekë

Nr.	Drejtoria Rajonale	Likuiduar 2022
1	Dibër	849,315
2	Shkodër	813,905
3	Tiranë	1,542,734
4	FSDKSH (Drejtoria Qendrore)	2,361,187
Totali		**5,567,141**

Burimi i të dhënave FSDKSH, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Grupi i auditimit kërkoi të dhëna analitike për pagesat e bëra nga FSDKSH (drejtoria qendrore) përgjatë vitit 2022. Rezulton se drejtoria qendrore e FSDKSH përgjatë vitit 2022 ka paguar 2,361,187 lekë për ekzekutimin e dy vendimeve gjyqësore për largimet e padrejta nga puna, duke krijuar detyrime të prapambetura për këto vendime në fund të vitit 2022 në vlerën 41,808 lekë. Gjithashtu rezulton se gjatë vitit 2022, në 1 rast pagesa për vendimet gjyqësore nuk është bërë në mënyrë vullnetare, por është pritur urdhri i shërbimit përmbarimor, duke rënduar më tej buxhetin me shpenzime përmbarimore në vlerën 145,480 lekë, shpenzime të cilat përbëjnë efekt financiar negativ për buxhetin e institucionit.
Nga auditimi nuk rezulton të jenë nxjerrë përgjegjësi apo të jenë marrë masa administrative në lidhje me vendimet gjyqësore për largimet nga puna, veprime në papajtueshmëri me pikën 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", ku citohet: "*Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjës për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në ngarkim të tyre brenda buxhetit vjetor të miratuar. Titullarët e njësive të qeverisjes së përgjithshme analizojnë të gjitha vendimet gjyqësore dhe kërkojnë nxjerrjen e masave administrative*".

Titulli i gjetjes: Mbi pagesat e vendimeve gjyqësore për largim të padrejtë nga puna të ish-punonjësve të FSDKSH-së.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit përkatës të vënë në dispozicion nga sektori i përfaqësimit ligjor, rezulton se në fund të vitit 2022 janë në proces gjyqësor (shkallë të parë, Apel) 4 çështje me objekt "Dëmshpërblim page". Nga përllogaritjet e kryera nga grupi i auditimit

	nisur nga shumat e kërkuara në kërkesë-padi dhe vlera mesatare e pagës, shuma maksimale e pritur për shpenzimet gjyqësore është në vlerën prej 9,348,489 lekë. Referuar të dhënave të Drejtorisë Ekonomike, gjatë vitit 2022, Drejtoritë Rajonale dhe Drejtoria Qendrore e FSDKSH kanë kryer likuidime për vendime gjyqësore të formës së prerë për ish punonjës të larguar nga puna, në vlerën totale **5,567,141 lekë, vlerë e cila rezulton efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit.** Grupi i auditmit kërkoi të dhëna analitike për pagesat e bëra nga FSDKSH (drejtoria qendrore) përgjatë vitit 2022. Rezulton se drejtoria qendrore e FSDKSH përgjatë vitit 2022 ka paguar 2,361,187 lekë për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për largimet e padrejta nga puna, duke krijuar detyrime të prapambetura për këto vendime në fund të vitit 2022 në vlerën 41,808 lekë. Gjithashtu rezulton se gjatë vitit 2022, në 1 rast pagesa për vendimet gjyqësore nuk është bërë në mënyrë vullnetare, por është pritur urdhri i shërbimit përmbarimor, duke rënduar më tej buxhetin me shpenzime përmbarimore **në vlerën 145,480 lekë, shpenzime të cilat përbëjnë efekt financiar negativ për buxhetin e institucionit**. Nga auditimi nuk rezulton të jenë nxjerr përgjegjësi apo të jenë marrë masa administrative në lidhje me vendimet gjyqësore për largimet nga puna, veprime jo në përputhje me pikën 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit.
Kriteri:	Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i punës i RSH", i ndryshuar, neni 155, pika 1 dhe 3. Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".
Ndikimi	Drejtoritë Rajonale dhe Drejtoria qendrore e FSDKSH kanë kryer likuidime për vendime gjyqësore të formës së prerë për ish punonjës të larguar nga puna, në vlerën totale 5,567,141 lekë, vlerë e cila rezulton efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit.
Shkaku:	Zgjidhje e kontratës së punës pa shkaqe të justifikuara nga punëdhënësi.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Këshilli Administrativ i FSDKSH dhe Drejtori i Përgjithshëm, të nxjerrin përgjegjësitë për të gjitha rastet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës në kundërshtim me kërkesat e Kodit të Punës dhe me kontratën individuale të lidhur me punëmarrësit, të cilat kanë shkaktuar apo mund të shkaktojnë efekte negative për buxhetin e shtetit.

2.7. Mbi auditimin e brendshëm dhe vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar.

I-Auditi Brendshëm

-Veprimtaria e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm në FSDKSH, është bazuar në Ligjin nr.114/2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", Manualin e Auditimit, Kartën e Auditimit dhe Kodin e Etikës për audituesit, dhe ushtron veprimtarinë e saj nëpërmjet implementimit të Planit vjetor ku përcaktohen qartë objektivat për t'u arritur, kapacitetet në dispozicion si dhe vlerësimin e menaxhimit të riskut.

-Drejtoria e Auditit të Brendshëm funksionon sipas strukturës organizative miratuar me vendimin nr.14, datë 02.02.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm "Për miratimin e strukturës

organizative, strukturës së brendshme dhe të rregullores për organizimin, funksionimin dhe përshkrimet e punës të FSDKSH", ndryshuar me vendimin nr.41 datë 03.02.2020.
Sikurse është trajtuar në raportin e mëparshëm të auditimit të KLSH, për vitin 2021, evidentohet e njëjta problematikë dhe për vitin 2022, në lidhje me varësin e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm nga Drejtori i Përgjithshëm. Bazuar në ligjin nr.10383, datë 24.02.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë" neni 15, ku cilësohet se "*Fondi drejtohet nga: a. Këshilli Administrativ dhe b. Drejtori i Përgjithshëm*", kjo drejtori në strukturën e miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm do të duhej të kishte varësi dyfishe nga të dy organet drejtuese, duke siguruar pavarësi në kontrollin dhe auditimin edhe të veprimtarisë së Drejtorit të Përgjithshëm dhe raportimin e kësaj veprimtarie në Këshillin Administrativ.
- Gjithashtu edhe në Kartën e re të Auditimit të Brendshëm, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm me nr.7084 prot., datë 07.12.2022, nuk është parashikuar varësia e dyfishtë nga të dy organet drejtuese, konkretisht Seksioni II.1-Statusi Organizativ, ndër të tjera citohet se "*..... DAB në Fond është pjesë e strukturës dhe organikës së Fondit..... Kjo Drejtori ka varësi organizative dhe është funksionalisht i pavarur* ***e raporton në mënyrë të drejtëpërdrejtë tek Drejtori i Përgjithshëm i Fondit*** *në cilësinë e titullarit të njësisë publike.*
-Gjatë vitit 2022 kjo strukturë nuk ka pasur ndryshime dhe Drejtoria e Auditit të Brendshëm ka funksionuar me tre sektor (Sektori i Auditimit të Sigurisë, Sektori i Auditimit të Këshillimit, Sigurimit të Cilësisë, Planifikimit dhe Raportimit dhe Sektori i Auditimit Tekniko-Mjekësor) dhe me 2 pozicione vakante, (1) Specialist Farmacist dhe 1 (një) Specialist IT, sikurse pasqyruar dhe në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 1-"Struktura 2022, Drejtoria e Auditit të Brendshëm"

Drejtoria Auditit të Brendshëm	**Struktura 2022**	**Vakanca 2022**
Drejtor Drejtorie	1	-
Përgjegjës Sektori	3	-
Specialist	9	2
Total	**13**	**2**

Burimi: FSDKSH, përpunoi KLSH

Në mënyrë të detajuar për të gjithë audituesit e AB të dhënat si certifikimi dhe eksperienca si AB në institucion, jepen në Tabelën *"Të dhëna për audituesit e Brendshëm"* bashkëngjitur akt verifikimit, ku nga 12 audites 10 prej tyre janë të pajisur me certifikatën "Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik", dhe 2 prej tyre janë në proces certifikimi.

Hartimi dhe realizimi i planeve të auditimit të brendshëm.
Drejtori i Përgjithshëm ka miratuar planin e auditimit për vitin 2022 të DAB-së me nr.4807/3 pro.t, datë 14.10.2021. Në planin vjetor të punës 2022 janë miratuar 22 programe auditimi, nga të cilat 20 të kombinuar, 1 përputhshmërie dhe 1 këshillimi.
- Me shkresën nr. 4682 prot., datë 15.07.2022, është ndryshuar plani vjetor, ku me kërkesë të titullarit është shtuar 1 (një) Auditim përputhshmërie në Fond, 1 (një) auditim përputhshmërie në Spitalin Rajonal Durrës (koncesioni i laboratorëve). Gjithashtu është hequr nga plani auditimi i kombinuar i parashikuar në Spitalin Rajonal Durrës duke u zëvendësuar më Spitalin Memorial Fier, pasi ky i fundit nuk është audituar asnjë herë, ndërsa Spitali Rajonal Durrës është audituar në fund të vitit 2021 dhe parashikohet të auditohet në fillim të vitit 2023. Parashikimi dhe realizimi i auditimeve për vitin 2022 paraqitet në mënyrë të përmbledhur sipas tabelës më poshtë:

Tabela nr. 2: "Plani dhe realizimi i auditimeve te brendshme 2022"

Nr.	**Auditime**	**Auditime**	**Statusi**

		Plan	Fakt	Realizuar	Evaduar 2023
1	Kombinuara	19	19	18	1
2	Përputhshmërisë (Zbatim rekomand)	1	1	1	-
3	Këshillimi	1	1	1	-
4	Me kërkesë të titullarit	3	3	3	-
	TOTALI	**24**	**24**	**23**	**1**

Burimi: FSDKSH, përpunoi KLSH

Nga auditimet e parashikuara janë realizuar 23 auditime në vitin 2022, ndërkohë 1 auditim është evaduar në shkurt 2023, pasqyruar në tabelën më poshtë, në të cilat janë adresuar gjithsej 198 rekomandime për përmirësimin e situatës, të gjitha të pranuara nga subjektet.

Tabela nr. 2: "Të dhëna mbi auditimet e realizuara, rekomandimet e dhëna dhe statusi i tyre për vitin 2022"

Nr.	Subjekte	Auditimi 2022		Auditimi 2022			
		Lloji	Afati	Rekomandime	Pranuar	Realizuar	Proces
1	Zbatim Rekomandime	Përputhshmërisë	1 Janar -31 Mars 22	-	-	-	
2	Dega Pogradec	I kombinuar	17 Janar - 04 Shkurt 22	3	3	3	-
3	Dega Lushnjë	I kombinuar	17 Janar - 04 Shkurt 22	7	7	6	1
4	DRF Kukës	I kombinuar	28 Shkurt - 18 Mars 22	12	12	11	1
5	DRF Diber	I kombinuar	28 Shkurt - 18 Mars 22	9	9	8	1
6	DRF Fier	I kombinuar	23 Mars - 15 Prill 22	8	8	-	-
7	DRF Berat	I kombinuar	23 Mars - 15 Prill 22	10	10	-	-
8	DSHM Fondi	Përputhshmërisë	27 Mars - 29 Mars 22	2	2		2
9	Dega Sarande	I kombinuar	19 Prill - 13 Maj 22	16	16	14	2
10	Dega Tropojë	I kombinuar	19 Prill - 13 Maj 22	9	9	7	2
11	DRF Tirana	I kombinuar	16 Maj - 03 Qershor 22	7	7	6	1
12	DRF Kamëz-Vorë	I kombinuar	16 Maj - 03 Qershor 22	8	8	8	-
13	DRF Korçë	I kombinuar	06 Qershor - 01 Korrik 22	8	8	8	-
14	DRF Durrës	I kombinuar	06 Qershor - 30 Qershor 22	11	11	-	
15	DRF Elbasan	I kombinuar	04 Korrik - 29 Korrik 22	5	5	5	
16	DSHSU Tiranë	I kombinuar	04 Korrik - 29 Korrik 22	6	6	6	
17	SRD Laboratorë	Përputhshmërisë	04 Korrik - 18 Korrik 22	7	7	5	2
18	SRM Fier	I kombinuar	06 Shtator - 10 Tetor 22	33	33	-	-
19	DRF, DI, KU, FR, BR	Cilësisë	Tetor-Nëntor	-	-		
20	DRF Lezhë	I kombinuar	17 Tetor - 11 Nëntor	6	6	6	
21	DRF Shkodër	I kombinuar	17 Tetor - 11 Nëntor	6	6	6	
22	DRF Vlorë	I kombinuar	14 Nëntor - 01 Dhjetor 22	2	2	2	
23	DRF Gjirokastër	I kombinuar	14 Nëntor - 01 Dhjetor 22	8	8	6	2
24	Fondi	I kombinuar	02 Dhjetor 22 - 13 Janar 23	15	15	-	-
				198	**198**	**107**	**14**

Burimi: FSDKSH, përpunoi KLSH

-Krahasuar me vitin 2021 është rritur numri i auditimeve të planifikuara me 4 programe më shumë në 2022, por ka rënë numri i rekomandimeve nga 231 në 198.
-Gjatë 3 mujorit të parë të vitit 2022 është bërë ndjekja e statusit të rekomandimeve, me program të veçantë me nr. 2033 prot., datë 11.04.2022, për 6 auditime, ndërkohë që në çdo program të kombinuar auditimi është përfshirë si pikë më vete dhe zbatimi i rekomandimeve në auditimet e mëparshme. Me shkresën nr. 2033 prot., datë 11.04.2022, është dërguar Raporti vjetor mbi ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm për vitin 2021.
- Nga auditimi i zbatimi të rekomandimeve ka rezultuar se nga 198 rekomandime të lëna, janë zbatuar 107 prej tyre, 14 në proces zbatimi, ndërkohë që 77 rekomandime i përkasin 5 subjekteve, të cilat janë në proces verifikimi në auditimet e radhës për vitin 2023.
- Me shkresën nr. 4807/4 prot., datë 14.10.2021, është dërguar plani strategjik dhe plani vjetor për periudhën 2022-2024, në Ministrin e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.

➢ Nga evidencat e vëna në dispozicion mbi veprimtarinë e drejtorisë së AB për vitin 2022, rezulton se nga DAB është hartuar evidenca sipas fushave të riskut, gjetjet dhe rekomandimet e bëra sipas këtyre fushave, sipas tabelës më poshtë:

Tabela nr. 3: "Veprimtaria AB sipas fushave të riskut"

Nr	Fushat e identifikuara me risk nga NJAB	A është fokusuar ndonjë mision auditimi në këtë fushë	A ka pasur gjetje në fushën e identifikuar me risk?	Nëse ka pasur gjetje auditimi, sa është numri i tyre?	Efektet Financiare të gjetjeve 000/lekë	A ka patur misione të zbatimit të rekomandimeve
1	Sistemi i prokurimeve, blerjeve e investimeve	Po	Po	12	0	Jo
2	Sistemi i pagesave, shpërblime, trajtime, komisione.	Po	Po	3	0	Jo
3	Fondet e sig.shoq, sig.shënd, përkujdesje shoqërore	Jo	Jo	0	0	Jo
4	Sistemet e tatimeve, taksave, doganave	Jo	Jo	0	0	Jo
5	Sistemet e administrimit pronës, pasurise	Jo	Jo	0	0	Jo
6	Sistemet e privatizimit, shitjes, qiradhënie	Jo	Jo	0	0	Jo
7	Sistemet e koncesioneve, ankandeve	Po	Po	7	0	Jo
8	Sistemet e legalizimeve,urbanistikës, kthim pronash	Jo	Jo	0	0	Jo
9	Sistemet e kreditimit, suvencione	Jo	Jo	0	0	Jo
10	Të tjera, (Buxheti, Kontrolli DRF-QSH, Farmaci, Spitale,etj)	Po	Po	176	0	6
	Totali			**198**	**0**	**6**

Burimi: FSDKSH, përpunoi KLSH

Sa sipër konstatohet se gjatë vitit 2022, veprimtaria e DAB është fokusuar në kontrollin e fushave si prokurimet, blerjeve e investimeve, sistemi i pagesave, shpërblime, trajtime, komisione, sistemet e koncesioneve, ankandeve dhe fushat si Buxheti, Kontrolli DRF-QSH, Farmaci, Spitale. Fushat e përcaktuara me risk nga DAB nuk përputhen plotësisht me riskun e veprimtarisë së FSDKSH si rimbursimi, kontrolli, zbatimi kontratave koncesionare, zbatimi i kontratave me spitalet, farmacitë, depot etj., të cilat kanë impakt të lartë financiar dhe social, pasi një pjesë e mirë e këtyre fushave mbulohen me kontrolle dhe nga drejtoritë e tjera si Drejtoria e Kontrollit, Drejtoria e Rimbursimit, Drejtoria e Kujdesit Parësor dhe Spitalor si dhe Drejtoria e Shërbimit Spitalor Universitar.
Nga evidencat më sipër rezulton se nga gjetjet e realizuara gjatë vitit 2022, në lidhje me fushat e përcaktuara me risk të lartë për veprimtarinë e FSDKSH, evidentohen vetëm 7 gjetje mbi sistemet e koncesioneve, ankandeve nga 198 gjetje në total. Mos përcaktimi i saktë i fushave me risk të lartë nuk ndihmon në nxjerrjen e konkluzioneve dhe përcaktimin e prioriteteve të veprimtarisë dhe sistemeve të kontrollit në FSDKSH.

Me shkresën nr. 341/1 prot., datë 14.02.2023, është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm "Raporti i Veprimtarisë Vjetore të Auditit të Brendshëm, për vitin 2022".
Nga Grupi i Auditimit janë përzgjedhur për auditim 5 dosje nga gjithsej 24 (20% e kampionit), bazuar në raportet me numër më të lartë gjetjesh kryesore, DRF Kukës, DRF Berat, Dega Sarandë, DRF Durrës dhe SRM Fier. Nga auditimi u konstatua si më poshtë:

Zbatimi i afateve

Zbatimi i afateve për realizimin e auditimit paraqiten sipas tabelës më poshtë:

Tabela nr. 4 "Zbatimi afateve në dosjet e përzgjedhura të auditimit"

Auditimi	Njoftimi	Takimi Fllestar	Zbatimi afatit/ dite	Afati auditimit	Projekt Raporti Nisja		Zbatimi afatit/ dite	Projekt Raporti Kthimi		Raporti		Zbatimi afatit/ dite
					Nr	Datë				Nr	Datë	
DRF Berat	18.03.2022	23.03.2022	6	23.03.2022-15.04.2022	1673/3	04.05.2022	20	1673/4	18.05.2022	1673/6	30.05.2022	12
DRF Durrës	27.05.2022	06.06.2022	11	06.06.2022-30.06.2022	3771/2	15.07.2022	15	3771/3	25.07.2022	3771/5	01.08.2022	7

DRF Kukës	21.02.2022	28.02.2022	6	28.02.2022-18.03.2022	1169/4	24.03.2022	6	1169/4	06.04.2022	1169/7	11.04.2022	5
DF Sarandë	11.04.2022	19.04.2022	8	19.04.2022-13.05.2022	3044/4	17.05.2022	4	3044/4	30.05.2022	3044/7	06.06.2022	7
SRM Fier	23.08.2022	06.09.2022	14	06.09.2022-10.10.2022	5249/6	27.10.2022	17	5249/7	03.11.2022	5249/8	11.11.2022	8

Burimi: FSDKSH, përpunoi KLSH

Nga auditimi është konstatuar se përgjithësisht janë zbatuar afatet procedurale në të gjitha fazat e procesit të auditimit që nga planifikimi, realizimi i auditimi në terren, hartimi i Projekt Raportit dhe Raportit Final dhe evadimin e materialit, me përjashtim të 3 rasteve ku nuk është zbatuar afati 10 ditor nga njoftimi i auditimit deri në takimin fillestar jo në përputhje me përcaktimet Manualit të Auditimit të Brendshëm, Kapitulli IV, pika 4.1.4 dhe 3 raste ku nuk është zbatuar afati 10 ditor nga përfundimi i auditimit në terren deri në dërgimin e Projekt Raportit në subjekt, jo në përputhje me përcaktimet Manualit të Auditimit të Brendshëm, Kapitulli IV, pika 4.1.12.

Vlerësimi i procedurave dhe standardeve të kryerjes së auditimit të brendshëm.
Nga auditimi i detajuar i auditimeve të kryera në të gjitha subjektet në lidhje me respektimin e kërkesave të manualit në hartimin e materialeve të auditimit për:
a- Letrat e punës së auditimit në fazën përgatitore të programit;
b- Letrat e punës në fazën e ekzaminimit të dokumentacionit të subjektit, hartimit të Projekt Raportit dhe Raportit Final nga audituesit;
c- Bazueshmërinë ligjore të gjetjeve, argumentimin e konkluzioneve të nxjerra nga audituesit në përputhje me standardet e auditimit, rezultoi se:

- Dosjet e auditimit janë plotësuar me dokumentet standarde në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm si: Autorizim për caktimin e grupit të punës për të kryer angazhimin e auditimit; Njoftim paraprak për fillimin e angazhimit të auditimit; Program i angazhimit të auditimit; Ndarja e detyrave; Deklaratat e konfliktit të interesit; Dokumentet që lidhen me kryerjen e angazhimit të auditimit; Testet dhe shënimet e mbajtura nga audituesit dhe dokumentet që merren nga palët e treta në lidhje me auditimin e brendshëm; Takimi përmbyllës; Projekt raporti i auditimit të brendshëm me shkresën përcjellëse; Raporti përfundimtar i auditimit të brendshëm sipas formatit tip; Plani i veprimit i sugjeruar nga grupi i auditimit për zbatimin e rekomandimeve subjektit të audituar; Memo dërguar Drejtorit të përgjithshëm të FSDKSH nga grupi i auditimit për informim me përmbledhjen e raportit të auditimit së bashku me opinionin, si dhe letrat e punës të secilit auditues.
- Përveç sa më sipër në 5 dosje të përzgjedhura për auditim është konstatuar se mungojnë formatet e vlerësimit të riskut për sistemet e audituara konkretisht *"Formati Standard 4: Vlerësimi i Riskut për Mjedisin e Përgjithshëm të Kontrollit"*, "*Formati Standard 5: Vlerësimi i risqeve për sisteme/fusha të veçanta të llogarisë"* dhe "*Formati Standard 6: Buxheti dhe afati kohor për angazhimet e auditimit"* pjesë e kapitullit IV të Manualit te Auditimit të Brendshëm, si pjesë e procesit fillestar të planifikimit të njësisë.
- Nga dosjet e shqyrtuara për vlerësim u evidentua se çdo grup auditimi ka grumbulluar informacionin e nevojshëm, të mjaftueshëm, të besueshëm, për përgatitjen e Raporteve të Auditimit. Audituesit kanë analizuar informacionin e grumbulluar nëpërmjet metodave dhe teknikave të përdorura të auditimit, që janë gjykuar më të përshtatshme dhe të besueshme për subjektin.
- Në dosjet e auditimit gjenden të administruara letrat e punës dhe evidencat e përshtatshme, të cilat lënë gjurmë dhe dëshmojnë mbi proceset e ndjekura për zbatimin e programit të auditimit

të miratuar. Në përfundim të procedurave të auditimit çdo grup auditimi, ka bërë sistemimin, klasifikimin dhe mbylljen e dokumenteve në dosjen e auditimit dhe arkivimin e saj.
- Procesi i sigurimit të cilësisë, është i dokumentuar dhe është kryer nga përgjegjësi i grupit dhe nga Drejtori i DAB, duke hartuar raportin përkatës të kontrollit të cilësisë.
- Raportet kanë strukturën formale sipas përcaktimeve në pikën 4.1.12 "Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar" të MAB dhe përgjithësisht reflektojnë lidhjen organike gjetje-konkluzion-rekomandim.
- Gjetjet reflektojnë problematikën dhe mangësitë e konstatuara në material si dhe kanë të përcaktuar bazën ligjore. Rekomandimet e lëna nga njësia e auditit të brendshëm kanë qenë përgjithësisht të karakterit organizativ, kanë të përcaktuar afatin e zbatimit të tyre dhe nivelin e rëndësisë së tyre (I lartë, I mesëm dhe I ulët).

II- Për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në zbatim të pikës 7 të programit të auditimit u auditua dokumentacioni si më poshtë:
- Rregullorja e brendshme e miratuar, rregulla të brendshme të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimin e tyre;
- Shkresat e përcaktimit të NA në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar;
- Shkresat për krijimin e grupeve të Menaxhimit Strategjik;
- Trajnimet e stafit si dhe planifikimet për trajnime të tyre;
- Lista ose harta e proceseve të punës;
- Procedurat për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara;
- Raportet e monitorimit, deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm;
- Pyetësori i Vetëvlerësimit, etj.

Drejtimet kryesore të auditimit janë:
-Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.
Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi/ Komunikimi, si dhe Monitorimi.
-Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.
Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor *(këtu e në vijim FSDKSH),* nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: *"Mjedisi i Kontrollit", "Menaxhimi i Riskut", "Aktivitetet e Kontrollit", "Informimi dhe Komunikimi"* si dhe *"Monitorimi",* sipas përcaktimit të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" i ndryshuar, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin. Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

1. Komponenti "Mjedisi i Kontrollit"

-FSDKSH është i vetmi organ autonom publik, i cili ofron dhe administron sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë. Fondi menaxhon skemën e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor, në përputhje me politikat kombëtare të kujdesit shëndetësor, të vendosura nga Ministria e Shëndetësisë.

- FSDKSH organizohet dhe funksionon në bazë të statutit të miratuar me VKM nr.124, datë 05.03.2014 "*Për miratimin e Statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë*", sipas të cilit organet drejtuese janë Këshilli Administrativ dhe Drejtori i Përgjithshëm.
- Funksionon sipas strukturës organizative miratuar me vendimin nr.14, datë 02.02.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm "Për miratimin e strukturës organizative, strukturës së brendshme dhe të rregullores për organizimin, funksionimin dhe përshkrimet e punës të FSDKSH" në të cilën evidentohen 9 drejtori dhe 14 drejtori rajonale dhe varësie.
- Me urdhrin nr.277, datë 06.07.2020 është miratuar "Rregullorja e Përgjithshme për Funksionimin e Fondit", ndryshuar me Urdhrin e Drejtorit Përgjithshëm të Fondit me nr.447, datë 30.12.2022 dhe nr.182/7 prot., datë 30.12.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren "Për funksionimin e Fondit të Sigurimit të detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor", pjesë përbërëse e të cilës është edhe Rregullorja e Burimeve Njerëzore, Rregullorja e Përdorimit të Mjeteve, Rregullorja e Shkëmbimit të Informacionit dhe Kodi i Etikës.
- Gjithashtu me urdhrin nr. 277, datë 06.07.2020 është miratuar dhe *"Rregullorja për organizimin, funksionimin dhe përshkrimet e punës për Drejtorinë e Përgjithshme të Fondit*" në të cilat përshkruhen hollësisht detyrat dhe kompetencat si dhe kriteret për secilin pozicion pune sipas drejtorive, si dhe *"Rregullorja për organizimin, funksionimin dhe përshkrimet e punës për Drejtoritë Rajonale të Fondit"*.
- Për vitin 2022 është hartuar plan-veprimi për MFK, dërguar me shkresën nr.1304 prot., datë 28.02.2022 në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, i cili përfshinë aktivitete të planifikuara, afatet e realizimit, strukturat përgjegjëse dhe lidhja me komponentin e sistemit, raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.
- Për vitin 2022, nga Drejtoritë dhe Sektorët janë hartuar planet vjetore dhe mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Këshillit Administrativ lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve.
- Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Administrativ dhe NA si dhe raportim çdo 4-mujor në MFE.
- Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, dhe DHAB në MFE.
- Me urdhrin nr.111 datë 08.04.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm është ngritur dhe funksionon Grupi i Menaxhimit Strategjik në përputhje me kërkesat e ligjit nr.10296 datë 08.07.2010, neni 8, pika 8, shkronja b.

Nga verifikimi i veprimtarisë së Grupi të Menaxhimit Strategjik (GMS) rezultoi se për vitin 2022 ka marrë 5 vendime, vënë në dispozicion grupit të auditimit, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016, pika 2.2.4. Bashkëngjitur çdo vendimi administrohen procesverbalet e takimit të GMS.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit vënë në dispozicion është konstatuar se janë miratuar gjurmët e auditimit për të gjitha veprimtaritë kryesore të njësisë si edhe lista me proceset e punës për secilën drejtori në përputhje me parashikimet e ligjit nr.10296 datë 08.07.2010, të ndryshuar, neni 16.
- Në përputhje me nenin 18 të ligjit nr.10296 datë 08.07.2010, të ndryshuar, është hartuar dhe miratuar "Deklarata dhe Raporti Vjetor 2022 për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm", në të cilën evidentohet fusha e përgjegjësisë, qëllimi i SKB, aftësia për të trajtuar riskun, risku dhe kuadri i kontrollit si dhe rishikimi efektivitetit të SKB, dërguar me shkresën nr.819, datë 27.02.2023 në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

2. Komponenti "Menaxhimi i Riskut"

-FSDKSH për vitin 2022 ka menaxhuar riskun duke u bazuar në Strategjinë e Riskut 2022-2024, miratuar me vendimin nr.3, datë 29.07.2022 të Grupit të Menaxhimit Strategjik, e cila përmban Deklaratën e Politikës së Menaxhimit te Riskut, Vizionin dhe Misionin, Objektivat e Fondit, argumentimin e nevojës për menaxhimin e riskut, risqet kryesore të Fondit si dhe hapat e mëtejshme që duhet të ndërmerren për menaxhimin e riskut.
-Me vendimin nr.2, datë 01.06.2022 "Për miratimin e regjistrit të përditësuar të riskut për vitin 2022" të Grupit të Menaxhimit Strategjik, është miratuar regjistri riskut sipas drejtorive, në të cilën identifikohen 155 risqe. Në dokumentacionin bashkëngjitur vendimit, gjendet informacioni analitik dorëzuar nga drejtoritë përkatëse lidhur me listën e proceseve të punës, risqet e identifikuara dhe gjurmën e auditit, dorëzuar kordinatorit të menaxhimit të riskut.
-Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk punon me sistem HRMIS, por me hedhje manualisht në programin Microsoft Office Excel. Hedhja, pasqyrimi i të dhënave personale dhe profesionale të çdo punonjësi të punësuar kryhen nëpërmjet programit Excel- it apo Ẁord- it.
-Drejtoria e Ekonomike për mbajtjen e Kontabilitetit operon me programin Excel dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave e cila kryhet nga sektori i financës, niveli i riskut për të gabuar mbetet i lartë.
- Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të kësaj njësie ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e FSDKSH-së, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.
- Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

3. Komponenti "Aktivitetet e Kontrollit"
- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë, krahas detyrave, janë identifikuar edhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës, si procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj.
- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.
- Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit komisionit të përllogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave/punimeve/shërbimeve.
- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh.
- Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet.
- Për vitin 2022 të gjitha drejtoritë kanë dërguar pranë GMS hartën e proceseve të punës dhe gjurmët e auditimit mbi të cilat bazohet gjithë veprimtaria kontrollit në tërësi. Gjithashtu bazuar në Rregulloren e Brendshme çdo drejtori tjetër ka detyra kontrolli për problemet që mbulon dhe çdo strukturë dhe njësitë vartëse kanë hartuar objektivat e veta për vitin, duke identifikuar e vlerësuar riskun.
- FSDKSH si organi që menaxhon skemën e sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor përmes kontraktimit me ofruesit e shërbimeve shëndetësore siç janë qendrat shëndetësore, subjektet farmaceutike dhe spitalet, publike e jopublike, realizon kontrolle të vazhdueshme për

kryerjen e shërbimeve dhe përdorimin e fondeve nga ofruesit e shërbimeve nëpërmjet njësive/sektorëve të vartësisë. Këto sektorë kontrolli kanë punuar me plane mujore e vjetore kontrolli për realizimin e të cilave kanë raportuar në Drejtorinë e Përgjithshme.

- Për vitin 2022 për çdo kontroll janë rekomanduar planet e masave për përmirësimin e proceseve të rezultuara me mangësi në gjetjet e kontrollit. Përveç Drejtorisë së Kontrollit strukturë tjetër kontrolli është edhe ajo e Kontrollit Parësor e Spitalor.

-Një strukturë tjetër kontrolli është Drejtoria e Auditit të Brendshëm e cila funksionon e ndarë nga ky sistem kontrolli. Drejtoria e Auditit të Brendshëm auditon strukturat vendore dhe Drejtorinë e Përgjithshme. Detyra kryesore e kësaj drejtorie është vlerësimi i funksionimit të sistemit të kontrollit në të gjitha nivelet, identifikimi i dobësive si dhe përcaktimi i masave për përmirësimin e mëtejshëm.

4. Komponenti "Informimi dhe Komunikimi"

- FSDKSH disponon faqen e saj zyrtare në Web ku pasqyrohet aktiviteti dhe veprimtaria e saj, si dhe Rregullorja e Brendshme, broshura, planet e performancës, projekte të brendshme dhe të huaja, bashkëpunime brenda dhe jashtë vendit, aktivitete, struktura organike, publikime të ndryshme e shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e saj.
- Në rregulloren e përgjithshme për funksionimin e FSDKSH, pjesë e të cilës është edhe rregullorja e shkëmbimit të informacionit dhe kodi i etikës, janë të përcaktuar parimet dhe rregullat kryesorë në komunikimin e punonjësve dhe shkëmbimin e informacionit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit. Edhe në rregulloren për organizimin, funksionimin dhe përshkrimet e punës në të cilat përshkruhen hollësisht detyrat dhe kompetencat evidentohen linjat dhe afatet e raportimit. Në zbatim të tyre secila drejtori, sektor dhe drejtori rajonale gjatë vitit 2022 kanë raportuar veprimtarinë vjetore specifike, mbi të cilat hartohet dhe miratohet raporti vjetor i veprimtarisë së FSDKSH.
- Komunikimi zyrtar mes punonjësve realizohet përmes komunikimit shkresor, gjithashtu përdoret rregullisht e-mail zyrtar, ku kanë akses të gjithë punonjësit.
- Strukturat e kontrollit të evidentuara në veprimtaritë e kontrollit, në përfundim të punës së tyre dalin me akte administrative të ndryshme rekomanduese apo ndëshkuese, të cilat u komunikohen strukturave përkatëse përgjegjëse, me qëllim ndreqjen e gabimeve dhe përmirësimin e vazhdueshëm.
- Nga FSDKSH janë bërë raportime financiare dhe operacionale të brendshme mujore, 3 mujore dhe 6 mujore mbi realizimin e shpenzimeve sipas funksionit dhe klasifikimit, realizimin e të ardhurave sipas natyrës etj., bazuar në përcaktimet e Udhëzimit nr.1, datë 24.02.2022 "Për Zbatimin e Buxhetit të Fondit për vitin 2022".
- Me VKA nr.6, datë 13.05.2022 është miratuar "Raporti Financiar dhe Bilanci Vjetor 2021 i FSDKSH".

5. Komponenti: "Monitorimi dhe Raportimi"

- FSDKSH monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar çdo vit pranë Drejtorisë Përgjithshme e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave.
- Në bazë të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" nenin 19 dhe 29 dhe shkresave përkatëse të Ministrisë së Financave nga FSDKSH është plotësuar dhe dërguar pranë Njësisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit pranë Ministrisë së Financave "Pyetësori i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar" dhe "Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm", për vitin 2022 me shkresën nr. 819 prot., datë 27.02.2023.

- Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e Fondit dhe raportimet e drejtuesve të drejtorive përkatëse për përmbushjen e objektivave.
- Me shkresat nr.3881 prot., datë 01.06.2022, nr. 5928 prot., datë 30.09.2022 dhe nr.827 prot., datë 28.02.2023, janë hartuar dhe dërguar në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale raportet e monitorimit për çdo 4 mujor sipas Udhëzimit Standard nr.22 datë 17.11.2016 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore".
Një ndër detyrat e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, e cila auditon strukturat vendore dhe Drejtorinë e Përgjithshme është vlerësimi i funksionimit të sistemit të kontrollit në të gjitha nivelet, identifikimi i dobësive si dhe përcaktimi i masave për përmirësimin e tij, realizuar gjatë zbatimit të planit vjetor të punës.
- Me Urdhrin nr.259, datë 18.08.2022 të Drejtorit Përgjithshëm të Fondit, është paraqitur plan veprimi me të cilin ngarkon strukturat përgjegjëse të varësisë të marrin masa mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, duke përcaktuar afatet për zbatim dhe ndjekje.

Titulli i gjetjes:	**Mos marrja e masave për ndryshimin e akteve administrative për parashikimin e pavarësisë së Drejtorisë së Auditit të Brendshëm në kontrollin dhe auditimin e veprimtarisë së Drejtorit të Përgjithshëm dhe raportimin e kësaj veprimtarie në Këshillin Administrativ.**
Situata:	Nga auditimi mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm në FSDKSH për vitin 2022, ka rezultuar se nga FSDKSH nuk janë marrë masa për ndryshimin e akteve ligjore dhe administrative në lidhje me varësin e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm nga Drejtori i Përgjithshëm, problematikë kjo e trajtuar dhe në raportin e mëparshëm të auditimit të KLSH, për vitin 2021. Bazuar në ligjin nr.10383, datë 24.02.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë" neni 15, ku cilësohet se "*Fondi drejtohet nga: a. Këshilli Administrativ dhe b. Drejtori i Përgjithshëm*", kjo drejtori në strukturën e miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm do të duhej të kishte varësi dyfishtë nga të dy organet drejtuese, duke siguruar pavarësi në kontrollin dhe auditimin edhe të veprimtarisë së Drejtorit të Përgjithshëm dhe raportimin e kësaj veprimtarie në Këshillin Administrativ. - Gjithashtu edhe në Kartën e re të Auditimit të Brendshëm, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm me nr.7084 prot., datë 07.12.2022, nuk është parashikuar varësia e dyfishtë nga të dy organet drejtuese, konkretisht Seksioni II.1-Statusi Organizativ, ndër të tjera citohet se "*..... DAB në Fond është pjesë e strukturës dhe organikës së Fondit..... Kjo Drejtori ka varësi organizative dhe është funksionalisht i pavarur* ***e raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë tek Drejtori i Përgjithshëm i Fondit*** *në cilësinë e titullarit të njësisë publike.*
Kriteri:	- Ligji nr.10383, datë 24.02.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë" neni 15. - Ligji nr.114, datë 22.10.2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik". - Manualit të Auditimit të Brendshëm, Kapitulli IV, pika 4.1.4
Impakti:	Mungesa e pavarësisë së Drejtorisë së Auditit të Brendshëm në kontrollin dhe auditimin e veprimtarisë së Drejtorit të Përgjithshëm dhe raportimin e kësaj veprimtarie në Këshillin Administrativ.

Shkaku: Mos marrja e masave për ndryshimin e akteve ligjore dhe administrative për parashikimin e pavarësisë së Drejtorisë së Auditit të Brendshëm në kontrollin dhe auditimin e veprimtarisë së Drejtorit të Përgjithshëm dhe raportimin e kësaj veprimtarie në Këshillin Administrativ.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: FSDKSH të marrë masa në vijimësi të bëjë ndryshimet përkatëse në aktet administrative *(Rregullore për organizimin dhe Funksionimin e FSDKSH dhe Karta e Auditit)* duke parashikuar varësin e dyfishtë nga Këshilli Administrativ dhe Drejtori i Përgjithshëm, të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm.

Titulli i gjetjes: **Mosrespektimi i afateve procedurale në të gjitha fazat e procesit të auditimit si dhe mungesa e formateve te vlerësimit të riskut për sistemet e audituara.**

Situata: Nga auditimi mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm në FSDKSH, është konstatuar se në 3 raste nuk është zbatuar afati 10 ditor nga njoftimi i auditimit deri në takimin fillestar jo në përputhje me përcaktimet Manualit të Auditimit të Brendshëm, Kapitulli IV, pika 4.1.4 dhe 3 raste ku nuk është zbatuar afati 10 ditor nga përfundimi i auditimit në terren deri në dërgimin e Projekt Raportit në subjekt, jo në përputhje me përcaktimet Manualit të Auditimit të Brendshëm, Kapitulli IV, pika 4.1.12.

Gjithashtu nga auditimi i 5 dosjeve të përzgjedhura është konstatuar se mungojnë në to formatet e vlerësimit të riskut për sistemet e audituara konkretisht *"Formati Standard 4: Vlerësimi i Riskut për Mjedisin e Përgjithshëm të Kontrollit", "Formati Standard 5: Vlerësimi i risqeve për sisteme/fusha të veçanta të llogarisë" dhe "Formati Standard 6: Buxheti dhe afati kohor për angazhimet e auditimit"* pjesë e kapitullit IV të Manualit te Auditimit të Brendshëm, si pjesë e procesit fillestar të planifikimit të njësisë.

Kriteri: - Ligji nr.114, datë 22.10.2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".

- Manualit të Auditimit të Brendshëm, Kapitulli IV, pika 4.1.14 dhe 4.1.12

Impakti: Mosrespektimi i afateve procedurale për realizimin e auditimit dhe evadimin a materialeve, mos identifikim dhe vlerësim objektiv i fushave me risk dhe paqartësi në prioritet e programeve të auditimit.

Shkaku: Mosrespektimi i përcaktimeve të Manualit të Auditimit të Brendshëm, Kapitulli IV, pika 4.1.12.

Rëndësia: E ulët

Rekomandimi: Drejtoria Auditimit të Brendshëm, të marrë masa në vijimësi të zbatojë me korrektësi afatet procedurale në të gjitha fazat e procesit të auditimit si dhe të plotësojë me përpikmëri dokumentacionin standard të përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm.

Titulli i gjetjes: **Nga auditimi është konstatuar se funksionimi i sistemit të MFK ka shfaqur mangësi.**

Situata: Nga auditimi është konstatuar se funksionimi i sistemit të MFK në FSDKSH ka shfaqur mangësi pasi:

	-Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk punon me sistem HRMIS, por me hedhje manualisht në programin Microsoft Office Excel. Hedhja, pasqyrimi i të dhënave personale dhe profesionale të çdo punonjësi të punësuar kryhen nëpërmjet programit Excel- it apo Word- it. -Drejtoria e Ekonomike për mbajtjen e Kontabilitetit operon me programin Excel dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave e cila kryhet nga sektori i financës, niveli i riskut për të gabuar mbetet i lartë. - FSDKSH nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të kësaj njësie ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e FSDKSH-së, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. - Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.
Kriteri:	-Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar. -Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e MF nr. 108, datë 17.11.2016.
Ndikimi:	Mungesa e vlerësimit të riskut të mashtrimit dhe ekspozimi i kësaj njësie ndaj veprimtarisë mashtruese, niveli i lartë i riskut në pasqyrimin e të dhënave nga sektori i financës dhe administrimin e të dhënave personale dhe profesionale të çdo punonjësi.
Shkaku:	Mosrespektimi i përcaktimeve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Nga Titullari i FSDKSH, të merren masa për njohjen nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, duke përfshirë dhe riskun e mashtrimit, funksionimin e sistemit HRMIS për administrimin e burimeve njerëzore dhe pajisjen me programin Kontabilitet të Drejtorisë Ekonomike.

Për përmirësimin e gjendjes në të ardhmën rekomandojmë:

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga FSDKSH, në lidhje me financimin e Kontratës së Koncesionit të Kontrollit Mjekësor Bazë (KMB/Check-up) me nr. 3082/20 prot., datë 07.01.2015, të lidhur midis MSHMS dhe Shoqërisë Koncesionare "3P." SHPK, ka rezultuar se, janë kryer pagesa në shumën 876,082 mijë lekë për 454,828 kontrolle të kryera, nga 876,090 mijë lekë për 475,000 kontrolle të planifikuara referuar projeksionit. Vlera e shërbimit për 454,828 rastet e KMB të kryera gjatë vitit 2022, rezulton në shumën 838,885 mijë lekë me TVSH. Edhe në vitin 2022, si në vitet e mëparshme, që prej fillimit të

zbatimit të kësaj kontrate, janë likuiduar fatura referuar numrit të projektuar të KMB sipas kontratës dhe jo sipas numrit faktik të kryer, për rrjedhojë është faturuar shërbim i pakryer për 20,172 raste, me një kosto në shumën **37,198 mijë lekë me TVSH.**

Gjithashtu, nga analizimi i disa treguesve ka rezultuar se, pavarësisht shtimit të numrit të KMB në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021, sëmundjet kronike janë shtuar me 8,603 raste, vlera e rimbursimit të barnave për shkak të rritjes së sëmundshmërisë dhe kompleksitetit të tyre me 1,184,831 mijë lekë më shumë; rritja e numrit të shtrimeve në spitale me 18,979 raste më shumë, rritja e vizitave ambulatore në Spitalet Universitare dhe Bashkiake me 123,354 raste më shumë etj., **tregojnë se efektet e masës profilaktike "Kontrolli Mjekësor Bazë", nuk janë reflektuar në rezultat konkrete, në uljen e sëmundshmërisë së popullatës, duke cenuar efektshmërinë e përdorimit të këtyre fondeve.**

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 24-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1.Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, si përfaqësues në lidhjen e Kontratës Financiare Koncesionarit, të përgatisë një relacion të detajuar për MSHMS, si autoritet kontraktor që në bashkëpunim me Shoqërinë Koncesionare "3P." SHPK, të rishikojnë kushtet e kontratës, pika 3 "***Pagesa dhe mënyra e shlyerjes***", me qëllim eliminimin e pagesave për shërbim të pakryer, si rezultat i likuidimit të rasteve të cilat janë nën projeksion vjetor, si dhe të kryhen analiza mbi efektshmërinë e dhënies së këtij shërbimi.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga FSDKSH, në lidhje me financimin e Kontratës Koncesionare nr. 1503/44, datë 10.02.2016 "*Për ofrimin e hemodializës*" të lidhur midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shoqërisë "DV" SHPK, ka rezultuar se, edhe për vitin 2022, pagesa e koncesionarit nuk kryhet për shërbim të kryer, por për shërbim të faturuar, i cili përfshin likuidimin e rasteve të pakryera ose shprehur ndryshe, nën projeksion vjetor, si dhe të rasteve të realizuara mbi projeksion mujor, të secilës qendër dialize, **në total 8,854 raste, nga të cilat 6,918 raste nën projeksion dhe 1,936 raste mbi projeksion, në shumën 99,191 mijë lekë, që përfaqëson pagesë për shërbim të pa kryer.** Nga analizimi i të dhënave dhe informacionit të vënë në dispozicion nga FSDKSH, mbi seancat e dializës të kryera mbi dhe nën projeksion, niveli i realizimit të kësaj kontrate nga viti 2016 deri në vitin 2022, ka rezultuar i disbalancuar midis rajoneve. Planifikimi i projeksioneve nuk është në përputhje me nevojat reale për kryerjen e shërbimit, mjafton të evidentojmë faktin që rajonet Shkodër dhe Vlorë, që prej fillimit të këtij shërbimi në vitin 2016, paraqiten me realizim nën projeksion, konkretisht në Rajonin Vlorë me 12,091 seanca nën projeksion ose 162,546 mijë lekë të paguara për shërbim të pakryer; Rajoni Shkodër me 15,805 seanca nën projeksion, ose 212,476 mijë lekë shpenzime për shërbim të pa kryer, ndërkohë që sipas kontratës i paguhet koncesionarit çdo mbi projeksion mujor, për rajonet Lezhë, Elbasan dhe Korçë, të cilat paraqiten me mbi projeksion respektivisht me 2,531 raste, 12,672 raste dhe 481 raste, gjë që ka sjellë pagesa jo vetëm për nën projeksionin e këtyre qendrave, por dhe pagesa për mbi projeksionin, evitimi i të cilave bëhet nëpërmjet një planifikimi real të numrit sipas qendrave.

Për shmangien e pagesave për shërbim të pakryer, KLSH edhe në auditimin e mëparshëm i ka kërkuar FSDKSH dhe MSHMS, të negociojë me koncesionarin. Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve ka rezultuar se FSDKSH me shkresën nr. 34/53 prot., datë 07.09.2022 "Mbi zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit" i është drejtuar MSHMS, ku kërkohet bashkëpunimi për zbatimin e rekomandimit të lënë nga KLSH, ndërsa MSHMS me nr. 307/9 prot., datë 17.10.2022, ka nxjerrë Urdhrin nr.584, datë 17.10.2022 "Për ngritjen e grupit të punës për negocimin e kontratës koncesionare nr.1503/44, datë 10.02.2016 "Për shërbimin e hemodializës në pesë qendra pranë Spitaleve Rajonale të Vlorës, Shkodrës,

Elbasanit, Korçës dhe Lezhës". Pavarësisht këtyre masave formale, nga MSHMS nuk janë ndërmarrë hapa konkretë e për rrjedhojë dhe në vitin 2022 vazhdon e njëjta situatë.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 24-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
2.1. Rekomandim: Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të ndjekë zbatimin e Urdhrit nr.584, datë 17.10.2022 "*Për ngritjen e grupit të punës për negocimin e kontratës koncesionare nr.1503/44, datë 10.02.2016 "Për shërbimin e hemodializës në pesë qendra pranë Spitaleve Rajonale të Vlorës, Shkodrës, Elbasanit, Korçës dhe Lezhës"*, mbi kryerjen e negociatave me shoqërinë koncesionare "DV" SHPK, për: Rishikimin e projeksionit sipas rajoneve në bazë të historikut, që disponon MSHMS dhe FSDKSH; Rishikimin e kushteve të kontratës në lidhje me pagesat që në vijim të kryhen sipas parimit (Pay x Use), me qëllim **eliminimin e pagesave për shërbim të pakryer, të cilat në vitin 2022 rezultojnë në shumën 99,191 mijë lekë**.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga FSDKSH, në lidhje me financimin e Kontratës Koncesionit nr.1440/33, datë 10.12.2015 "PPP-Sterilizimi i pajisjeve mjekësore", të lidhur midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shoqërisë Koncesionare "S." SHPK, ka rezultuar se, për ndërhyrjet kirurgjikale të kryera gjatë vitit 2022, në tre llojet e spitaleve, universitare, rajonale dhe bashkiake, ka përdorim të seteve të ndryshme për të njëjtën tipologji kirurgjikale, në 15,339 raste në Spitalet Universitare; në 8,708 raste në Spitalet Rajonale dhe në 55 raste në Spitalet Bashkiake. Niveli i lartë i deviacioneve, ku për të njëjtën tipologji kirurgjikale përdoren nivele të ndryshme të kompleksitetit të seteve, në spitalet universitare arrin deri në 52 % të rasteve, në spitalet rajonale deri në 48.5 % të rasteve, kundrejt totalit të ndërhyrjeve, reflekton mangësitë në përfshirjen e kirurgjive sipas tipologjisë, referuar nivelit të seteve, por dhe të përmbajtjes me instrumente mjekësorë të seteve referuar nivelit të kompleksitetit, gjë e cila është e shoqëruar edhe me rritjen e kostove të këtij shërbimi dhe për rrjedhojë të mbështetjes buxhetore për vazhdimësinë. Ri konfigurimi i tyre edhe pas ndryshimeve në vitin 2020, referuar aneksit nr. 4 të kontratës nr. 1440/40, datë 10.12.2015, dhe shkresës nr. 28/20, datë 04.12.2020 të koncesionarit, protokolluar në MSHMS me nr. 150/21, datë 07.12.2020 me objekt "Konfigurim i seteve 30.11.2020", ka paraqitur mangësi dhe nuk ka minimizuar problematikën e evidentuar edhe në auditimin e mëparshëm të kryer nga KLSH.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 24-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
3.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor të përgatisë një relacion të detajuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si autoritet kontraktor, me qëllim marrjen e masave, që në bashkëpunim me Shoqërinë Koncesionare "S." SHPK, të bëjnë të mundur rishikimin e Kontratës "Mbi Konfigurimin e seteve, datë 30.11.2020, si dhe Aneksit nr. 4, në lidhje me ri konfigurimin e seteve kirurgjikale në dy drejtime:

- përfshirjen e kirurgjive sipas tipologjisë, referuar nivelit të seteve;
- numrin dhe llojin e instrumenteve dhe pajisjeve mjekësore që duhet të përmbajë një set, duke rritur gamën e tyre me qëllim minimizimin e kostove të këtij shërbimi, duke marrë në konsideratë nivelin e lartë të deviacioneve, për të gjitha rastet e përdorimit të një seti kirurgjikal të nivelit të mesëm, kur mund të përdorim kompleksitetin e ulët dhe të përdorimit të një seti të kompleksitetit të lartë kur mund të përdorim kompleksitet të mesëm ose të ulët, për shkak të mungesës së një ose disa instrumenteve në këto kompleksitete.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga FSDKSH, në lidhje me financimin e kontratës koncesionit/PPP nr. 1924/2 prot., datë 10.04.2019 "Shërbimi laboratorik" të lidhur midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (kontraktues) dhe

aksionerëve të koncesionarit "L", "E" dhe "A", është evidentuar se dhënia e këtij shërbimi është i kufizuar, nga kushtet e kontratës nr. 1924/2, datë 10.04.2019, pika 22.4 "Tavanet e buxhetit", sipas të cilit koncesionari nuk mund të tejkalojë fondin e miratuar për spitalet në zërin "Laboratorët", për rrjedhojë rastet shtesë duhet të transferohen në një listë pritje me përparësi, duke filluar nga periudha tjetër buxhetore e spitalit referues.

Përcaktimi i tavaneve vjetore buxhetore, kufizon kryerjen e analizave laboratorike për secilin spital, të sanksionuar në kontratën koncesionare të laboratorëve, duke rrezikuar ofrimin e analizave laboratorike, në masën e duhur, sipas nevojave spitalore dhe duke sjellë për pasojë drejtimin e pacientëve në marrjen e këtij shërbimi tek subjektet private, me kosto për qytetarët, si dhe përkeqësim të shëndetit nga moskryerja në kohë e analizave përkatëse.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 24-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1. Rekomandimi: Fondi i Sigurimit të Detyruar të Kujdesit Shëndetësor dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si kontraktor, duhet të kryejnë analiza të thelluara në lidhje me ecurinë dhe cilësinë e dhënies së këtij shërbimi, si dhe shpenzimeve në rritje të tij, me qëllim rritjen e efektivitetin të përdorimit të fondeve buxhetore.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga FSDKSH, në lidhje me financimin e kontratave PPP, ka rezultuar se në tre kontrata, vlera e financimit vjetor, si dhe parashikimet e financimit të tyre në PBA 2022-2024, janë përtej mbështetjes buxhetore të parashikuar për zbatimin e tyre.

- Vlera e parashikuar në dokumentet standarde të PPP "Për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikalë sterilë, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale", konkretisht në Aneksin 1, Kapitulli IV.1.1, është në shumën 9,657,000,000 lekë (pa TVSH)". Në kontratë cilësohet se: "*Vlera e parashikuar në këtë pikë* ***është vlera maksimale e mbështetjes financiare*** *e llogaritur si shuma e pagesave te parashikuara të 10 viteve së bashku pa TVSH, e cila do të kryhen nga Autoriteti Kontraktor në këmbim të shërbimit. Kjo është vlerë e parashikuar në bazë të studimit të fisibilitetit dhe planit financiar, të përgatitur nga komisioni për hartimin e këtij dokumenti".*

  Referuar ecurisë së zbatimit të kësaj kontrate, si dhe planifikimit të mbështetjes buxhetore, sipas PBA 2022-2024 rezulton se, kemi tejkalim të parashikimeve për mbështetje buxhetore referuar kontratës së lidhur me koncesionarin. Konkretisht, në vitin 2022 ishin parashikuar 1,750,000 mijë lekë sipas PBA dhe 1,700,000 mijë lekë në buxhetin vjetor të 2022, si dhe për vitin 2023 dhe 2024 janë parashikuar përkatësisht 1,770,000 mijë lekë dhe 1,790,000 mijë lekë, ç'ka tregon edhe tendencën në rritje të financimit të kësaj kontrate dhe nevojën për anagzhim fondesh buxhetore.
- Vlera e parashikuar në dokumentet e kontratës PPP "Shërbimi i hemodializës", si mbështetje buxhetore për 10 vjet, sipas parashikimeve është në shumën 7,221,364 mijë lekë në total.

  Aktualisht shpenzimet për financim janë në rritje nga viti në vit, kështu në vitin 2021 faturat e pranuara janë në shumën 749,918 mijë lekë, në vitin 2022 faturat e pranuara janë në shumën 807,647 mijë lekë, si dhe është planifikuar në PBA 2022-2024, për vitin 2023 shuma 887,000 mijë lekë dhe për vitin 2024 shuma 946,000 mijë lekë, nga 835,385 mijë lekë dhe 891,310 mijë lekë të parashikuara në kontratë, për mbështetje buxhetore për këto vite. Mënyra e likuidimit të kësaj kontrate, ka efekte negative me pasojë angazhimin e fondeve shtesë për mbështetje buxhetore.

- Përsa i përket PPP "Shërbimi laboratorik" ka rezultuar se në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021, numri i ekzaminimeve është rritur me 827,617 raste, ndërsa shpenzimet buxhetore me 509,715 mijë lekë, ose thënë ndryshe, niveli i rritjes së numrit të ekzaminimeve në total është 24.5 % më shumë se në vitin 2021, ndërsa niveli i rritjes së shpenzimeve buxhetore 46.2 % më shumë. Këta tregues demonstrojnë një rritje më të lartë të shpenzimeve buxhetore në krahasim me rritjen e numrit të ekzaminimeve, gjë e cila reflektohet në koston mesatare të ekzaminimit, ku në vitin 2021 rezulton në 326.5 lekë, ndërsa në vitin 2022 në 383.5 lekë, ose 17 % më shumë. Në kushtet kur çmimet referuese nuk kanë ndryshuar, kjo rritje është rezultat i kryerjes së ekzaminimeve me tarifa të larta, kundrejt atyre me tarifa të ulta, gjë e cila reflektohet në rritjen e shpenzimeve buxhetore. Gjithashtu, referuar të dhënave mbi shpenzimet e kryera në vitin 2020 dhe 2021, në shumat respektive 1,103,199 mijë lekë dhe 1,612,914 mijë lekë, si dhe ecurisë së planifikimit afatmesëm të buxhetit për financimin e këtij shërbimi rezulton se, vlera e tij do shkojë më tepër se parashikimi, duke kërkuar çdo vit më shumë angazhimin e fondeve buxhetore, shtuar këtu dhe faktin që një pjesë e kërkesave për ekzaminime transferohen në vitin pasardhës buxhetor.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 24-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i FSDKSH në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrin masa të menjëhershme për monitorimin e këtyre kontratave, me qëllim ndjekjen dhe disiplinimin e shpenzimeve, përdorimin me efektivitet të fondeve, të cilat rezultojnë me tendencë në rritje nga viti në vit, jo vetëm si rezultat i rritjes së rasteve, por dhe si rezultat i rritjes së kostove të shërbimit për pacient, duke tejkaluar mbështetjen buxhetore të parashikuar në kontratat koncesionare. Gjithashtu nga FSDKSH dhe MSHMS, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të merren masa për sigurimin e mbështetjes buxhetore për financimin e këtyre shërbimeve jetike për popullatën, në masën e duhur dhe në vijimësi.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e vendosura në dispozicion në lidhje me financimin dhe likuidimin e shpenzimeve për Kontratën e Koncesionit "PPP-Kontrolli Mjekësor Bazë" dhe "PPP-Sterilizimi i pajisjeve mjekësore", është evidentuar se vlera e shpenzimeve të kryera për dhënien e këtyre shërbimeve është likuiduar me TVSH, referuar kushteve të mëposhtme të kontratave.

- PPP "Kontrolli mjekësor bazë", sipas Kontratës së Financimit nr. 1195/2, datë 15.04.2015, pika 3 "Pagesa dhe mënyra e shlyerjes" është cilësuar: "Pagesa e koncesionarit do të bëhet bazuar në çmimin për njësi në vlerën 1,537 lekë pa TVSH, për sasinë minimale prej 475,000 kontrolle në vit. *Fatura e lëshuar nga ana e koncesionarit do të jetë faturë tatimore me TVSH e llogaritur mbi çmimin neto".*
- PPP "*Sterilizimit të instrumenteve dhe pajisjeve mjekësore*", Aneksi 6, pika 2.2 "*Çmimet e kontratës*", është cilësuar: "Çmimet do të jenë çmime neto pa TVSH dhe do të paguhen "Pay x Use". *Fatura e lëshuar nga koncesionari do të jetë faturë me TVSH e llogaritur mbi çmimin neto".*

Përcaktimi i mënyrës së pagesës, është në kundërshtim me Ligjin nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe PPP", neni 27 "Përmbajtja e kontratës", pika 1, ku cilësohet: "Kontrata përcakton të drejtat dhe detyrimet e autoritetit kontraktues dhe koncesionarit/partnerit privat, në përputhje me dispozitat e këtij ligji ***dhe legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë".*** Për rrjedhojë përcaktimi i mënyrës së pagesës, sipas faturës së lëshuar nga koncesionari me TVSH, është në kundërshtim me Ligji nr. 7928, datë 27.04.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" (i shfuqizuar), neni 25/11 "Barnat dhe shërbimi shëndetësor"; Ligjin nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", Kreu VIII "Përjashtimet, furnizimet

me shkallë zero, eksportet seksioni 1 furnizimet e përjashtuara", neni 51 "Përjashtimi i disa veprimtarive me interes të përgjithshëm", germa c dhe Udhëzimin nr. 6, datë 30.01.2015 "Për TVSH-në në Republikën e Shqipërisë" neni 38 "Furnizimet e barnave dhe shërbimeve shëndetësore". Gjithashtu, fondet e përdorura për pagesën e TVSH, në shumën 417,175 mijë lekë në vitin 2022, kanë ndryshuar destinacionin e përdorimit të tyre. Për rrjedhojë nëse TVSH e paguar për sterilizimin në vitin 2022, do të përdorej në destinacionin e duhur do të ishin kryer edhe 12,705 ndërhyrje kirurgjikale të kompleksitetit të mesëm më shumë. Ndryshimi i destinacionit të fondeve ka sjellë uljen e nivelit të shërbimit, po të konsiderojmë dhe faktin që ky shërbim është realizuar në masën 100 % të buxhetit të planifikuar, ç'ka do të thotë që tavani buxhetor ka kufizuar ofrimin e shërbimit.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 24-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor të përgatisë një relacion të detajuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si autoritet kontraktor me qëllim marrjen e masave, që në bashkëpunim me shoqëritë koncesionare "3P." SHPK dhe "S." SHPK, të bëjnë të mundur rishikimin e kushtit të kontratave koncesionare respektive, në lidhje me pagesën dhe mënyrën e shlyerjes, me qëllim kthimin në ligjshmëri dhe ndërprerjen e pagesave të TVSH-së, për këto shërbime të përjashtuara nga ky lloj tatimi, si dhe përdorimin e fondeve me efektivitet, në destinacionin e duhur, që është ofrimi i shërbimit ndaj pacientit.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi saktësinë e raportimit të planit dhe faktit të të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe rezultatit fiskal të FSDKSH ka rezultuar mospërputhje midis të dhënave të rakorduara dhe raportuara nga FSDKSH dhe të dhënave të raportuara nga MFE, në Tabelën e Treguesve të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, në lidhje me faktin e të ardhurave të realizuara nga derdhja e kontributeve dhe të tjera.

Nga krahasimi i të ardhurave të realizuara nga FSDKSH, kontributet dhe të tjera referuar akt rakordimeve të mbajtura me DPT, ISSH dhe derdhje direkte në llogarinë e FSDKSH me të dhënat e Tabelës së "Treguesve Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit", pjesë e Ligjit nr. 115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022", Kapitulli II.3 "Të ardhurat nga fondet speciale", **rezulton se fakti i të ardhurave ka mos përputhje për shumën 102 milionë lekë, të deklaruara më shumë nga MFE.** Sipas të dhënave të MFE fakti i të ardhurave nga fondet speciale (sigurimet shëndetësore) paraqiten në vlerën 16,266 milionë lekë, ndërsa nga FSDKSH, janë deklaruar 16,164 milionë lekë (të konstatuara), si dhe lëvizje cash në llogarinë e FSDKSH në shumën 15,692 milionë lekë.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 24-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

7.1. Rekomandimi: Titullari i FSDKSH dhe Drejtoria e Financës, të marrin masa që në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të shqyrtojnë mospërputhjet me Treguesit e Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, përsa i përket fondeve për sigurimet shëndetësore, të raportuara në Kapitullin II "Të ardhurave tatimore"; II.3.1 "Të ardhura nga Fondet Speciale", për të ardhurat nga kontributet shëndetësore dhe të tjera (FSDKSH).

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit për shpenzime administrative dhe investime, ka rezultuar një nivel i ulët i realizimit të tyre në vitin 2022, i cili varion nga 37.7% investimet deri në 85 % shpenzimet për paga. Gjithashtu, pavarësisht se dhe në vitin e mëparshëm paraqitet e njëjta situatë, pra ka nivel të ulët të realizimit të shpenzimeve, ky fakt nuk është marrë në konsideratë gjatë planifikimit të buxhetit për vitin 2022, pasi plani i vitit 2022 është në nivele më të larta se plani i vitit 2021 dhe më i lartë se fakti i vitit 2021, pavarësisht se edhe ky vit ka rezultuar në nivele të ulta realizimi, **duke shkaktuar angazhim**

të fondeve buxhetore më tepër se nevojat reale. Niveli i ulët i realizimit të shpenzimeve të planifikuara është evidentuar edhe në nivel DRF, në të gjithë zërat e buxhetit paga, sigurime, operative dhe investime.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 24-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
8.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Ekonomike, të marrë masa që në vijimësi të analizojnë në mënyrën e duhur nevojat për angazhim fondesh buxhetore, me qëllim planifikimin e tyre në masën e duhur.

Në vijimësi

9.Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i procesit të monitorimit të kontratave të lidhur midis ofruesve të shërbimit parësor dhe spitalor dhe Fondit, rezultoi se Drejtoria e Kujdesit Parësor dhe Spitalor (DPKS) si strukturë përgjegjëse për monitorimin e aktiviteteve të shërbimit parësor dhe spitalor, nuk ka të përcaktuar në Udhëzimin nr. 1, datë 12.01.2021 "Për llogaritjen dhe raportimin e indikatorëve të Qendrës Shëndetësore" procedurat, që duhet të ndjekë në lidhje me procesin e raportimit, verifikimit dhe konsolidimit të informacionit të ardhur nga Drejtoritë Rajonale të Fondit.
Konkretisht, në pikën 2, të nenit 12 të kontratave të lidhura me dhënësit e shërbimit spitalor përcaktohet se: "Fondi/DRF bën verifikimin e informacionit, të dërguar nga spitali sipas raportimeve të Aneksit nr. 2, si pjesë përbërëse e kësaj kontrate.", por në rregulloret mbi të cilat mbështet veprimtaria e DPKS, nuk parashikohet se si duhet të bëhet ky verifikim, gjithashtu në udhëzimet përkatëse të paketave dhe të monitorimeve, nuk parashikohen veprimet e DKPS, si strukturë përgjegjëse për monitorimin e kontratave.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 81-132 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
9.1.Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i FSDKSH dhe Drejtori i Drejtorisë së Kujdesit Parësor dhe Spitalor të marrin masa, për të rishikuar dhe bërë disa ndryshime në Udhëzimin nr. 1, datë 12.01.2021 "Për llogaritjen dhe raportimin e indikatorëve të Qendrës Shëndetësore", për të përcaktuar procedurat dhe veprimet që duhet të kryhen nga DKPS, për monitorimin e performancës, afatet kur duhet të raportohet, si dhe të standardizojë formën e raportimit.

Deri më 31.12.2023

10. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i praktikave për realizimin nga Drejtoria e Kujdesit Parësor dhe Spitalor (DKPS) të procedurës së përgatitjes së dokumentacionit në lidhje me Kontrollin Mjekësor Bazë, për 4 muajt e përzgjedhur të vitit 2022 rezultoi se:
Nga ana e DRF-ve ka pasur raste të tejkalimit të afatit, të parashikuar në pikën 2 të Udhëzimit të FSDKSH-së nr. 12, datë 18.05.2015 "Për procedurat e pagesës së Shoqërisë "3P." SHPK", për të dërguar informacion mbi kontrollet mjekësore bazë pranë Sektorit të Kontrollit Mjekësor Bazë, në 6 raste në muajt korrik dhe dhjetor të vitit 2022. Në rastet e evidentuara me tejkalim afati, datat në shkresat e dërguara nga DRF-të janë përtej datës 15, të muajit pasues, gjithashtu datat e mbërritjes së informacionit në Fond janë kryesisht përtej datës 15 të muajit pasues, ç'ka kufizon kohën në dispozicion të DPKS për të kryer kontrollin e dokumentacionit dhe rakordimin me koncesionarin.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 81-132 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
10.1.Rekomandimi: Drejtoria e Kujdesit Parësor dhe Spitalor të raportojë në strukturat përgjegjëse, mbi vonesat e pa arsyetuara DRF-ve për dërgimin e informacionit në lidhje me Kontrollin Mjekësor Bazë dhe të përfshijë në Udhëzimin nr. 12 datë 18.05.2015 "Për procedurat e pagesës së Shoqërisë "3P." SHPK, masa për tejkalimin e afateve për çdo strukturë, që raporton sipas udhëzimit.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i analizave tremujore dhe asaj vjetore, mbi treguesit e shërbimeve të koncesionarit të Laboratorit, rezultoi se nuk rakordojnë të dhënat nga konsolidimi i analizave tremujore me atë vjetore, si rezultat i mungesës së raportimeve periodike nga ana e institucioneve shëndetësore në DKPS. Kjo drejtori në analizat periodike i referohet vetëm të dhënave të paraqitura drejtpërsëdrejti nga koncesionari, pasi nuk ka procedura të përcaktuara për raportimin e institucioneve shëndetësore në DKPS, si rezultat i mungesës së një udhëzuesi mbi mënyrën e monitorimit dhe raportimit periodik të të dhënave mbi realizimin të PPP "Shërbimi laboratorik".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 81-132 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
11.1.Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i FSDKSH dhe Drejtori i Drejtorisë së Kujdesit Parësor dhe Spitalor, të marrin masa për të nxjerrë një udhëzim në lidhje me analizimin e treguesve të shërbimit laboratorit, ku të përcaktohen me detaje afatet e raportimit nga spitalet, DRF-të dhe nga ofruesi, mënyra si do të bëhen rakordimet e këtyre të dhënave nga Fondi, treguesit që duhen paraqitur në analizat e kryera nga DKPS dhe mënyrën si duhet të kryhet monitorimi i tyre.

Deri më 31.12.2023

12. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i procesit të inspektimit rezultoi se, 5 raporte inspektimi nga 8 të realizuara gjatë vitit 2022, nuk janë të strukturuar sipas kërkesave të pikës 3, të Kapitullit IV të Udhëzimit nr.20/2019 të FSDKSH-së. Në raportet e inspektimit, në zbatim të Urdhrave të inspektimit nr.54, datë 18.02.2022; nr.144, datë 06.05.2022; nr.233, datë 06.07.2022; nr.279, datë 08.09.2022 dhe nr.384, datë 21.11.2022 nuk paraqiten problematikat konkrete, duke saktësuar dispozitën apo aktin me të cilin nuk janë në përputhje. Raportet e paraqitura në të gjitha rastet e sipërcituara shprehen se: "*Nga ana e DRF-ve janë respektuar kriteret për realizimin e analizave*", në lidhje me këtë konkluzion DKPS mund të raportojë dhe pa realizuar procesin e inspektimit pasi të dhënat e analizave raportohen pranë saj nga ana e DRF-ve në mënyrë periodike, sipas udhëzimeve përkatëse. DKPS në këto raporte u ka rekomanduar DRF-ve monitorimin e tejkalimeve apo mosrealizimeve. Rekomandimet nuk lidhen specifikisht me problematikat e evidentuara nga inspektimi, nuk janë të detajuara dhe të lidhura specifikisht me situatat konkrete të rezultuara nga procesi i inspektimit, siç parashikohet në pikën 3 të Kapitullit VI të Udhëzimit nr.12/2019 të FSDKSH-së. Pesë raportet e mësipërme, drejtuar subjekteve të ndryshme, sipas Urdhrave përkatës, kanë të njëjtat rekomandime.
Për periudhën 2020-2022, DSHSU dhe DRF-të Fier, Berat, Vlorë, Kamëz dhe Vorë janë mbuluar me inspektim më shumë se njëherë dhe DRF-të Korçë dhe Pogradec nuk janë inspektuar asnjëherë. Po për të njëjtën periudhë 3 qendra të ofrimit të shërbimit të dializës janë inspektuar më shumë se njëherë, konkretisht "Spitali A", Dega Durrës që mbulon me shërbim 17% të pacientëve është inspektuar tri herë, Institucioni shëndetësor jo publik "AKS Berat", që mbulon me shërbim 9% të pacientëve 2 herë ndërsa "Spitali A 3" dhe "Spitali H.", që mbulojnë me shërbimin e dializës përkatësisht 12% dhe 21% të pacientëve nuk janë inspektuar asnjëherë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 81-132 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
12.1.Rekomandimi: Nga Drejtoria e Kujdesit Parësor dhe Spitalor të merren masa, që çdo punonjës i saj, i ngarkuar për të realizuar procesin e inspektimit, të zbatojë me përpikmëri kërkesat dhe procedurat e përcaktuara në udhëzimin e inspektimit.

Në vijimësi

12.2.Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i FSDKSH dhe Drejtori i Drejtorisë së Kujdesit Parësor dhe Spitalor të marrin masa, për të rishikuar dhe bërë disa ndryshime në Udhëzimin nr.20/2019 "Mbi metodikën e inspektimit, monitorimit dhe funksionimit të ofruesve të shërbimit shëndetësor parësor dhe spitalor të kontraktuar nga FSDKSH", në lidhje me përcaktimin e kritereve, mbi të cilat do të bëhet përzgjedhja e subjekteve, për inspektim.

Deri më 31.12.2023

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimit i procedurave të prokurimit publik ka rezultuar se për vitin 2022, janë parashikuar gjithsej 31 procedura prokurimi me vlerë 87,169,451 lekë, nga të cilat janë realizuar 23 procedura me vlerë gjithsej 18,931,425 lekë. FSDKSH nuk ka realizuar 8 procedura, me vlerë të planifikuar 68,238,026 lekë.
-Gjithashtu nga 11 procedura prokurimi të audituara ka rezultuar se nga fondi limit i parashikuar në vlerën 26,763,059 lekë janë lidhur kontratat me OE fitues në vlerën 17,642,347 lekë, pra 9,120,712 lekë më pak nga fondi limit i parashikuar apo 34 % e fondit limit të parashikuar, gjë që tregon mangësi në procesin e parashikimit të realizimit prokurimeve dhe fondit limit, me pasoja në mos përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve publike, në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", Kreu II, neni 3, pika 2, ku përcaktohet se: "*Regjistri i parashikimeve duhet të synojë planifikimin e mirë të përdorimit të fondeve publike dhe planifikimin e realizimin në kohë të procedurave të prokurimit publik*."
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 132-161 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
13.1 Rekomandimi: Titullari i autoriteti kontraktor të FDKSH, të marrë masa që në vijimësi, të bëhet planifikimi i realizimit të procedurave të prokurimit publik për punë, mallra dhe shërbime referuar nevojave reale, me qëllim perdorimin me efektivitet, eficience dhe ekonomicitet të fondeve publike.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit "Mirëmbajtje automjetesh të Fondit", viti 2022, janë konstatuar mangësi në zhvillimin e procedurës, si më poshtë:
- Në procesverbalin datë 12.09.2022, për verifikimin e gjendjes teknike të automjeteve të FSDKSH dhe hartimin e specifikimeve teknike, hartuar nga grupi i punës, nuk administrohet dokumentacion që argumenton nevojën e kryerjes së shërbimeve, ku duhej të përcaktohej km që kanë përshkruar mjetet, shërbimet që i janë bërë ndër vite sipas km, nevojat që kanë aktualisht për shërbime, amortizimin e tyre në vitin korrent etj. Një pjesë zërave të shërbimeve të parashikuara në procesverbal nuk janë të argumentuara, referuar kartelës së shërbimeve që duhet të mbahet për çdo automjet, si për shembull zërat riparim kamio, sistemi i furnizimit me karburant, kit freksioni, etj. Veprime këto në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 35 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2020 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik", Neni 78, pika 2.
- Në hartimin e DST-ve, për kapacitetin teknik, pika 6, vendosja e këtyre kritereve është e pa argumentuar teknikisht, për sipërfaqen 500 m 2 të servisit, përse nevojiten 4 linja të kontrollit teknik, përse nevojitet ura e kontrollit për fugona, kur objekti i procedurës së prokurimit është për automjete të FSDKSH. Mos argumentimi i kritereve të vendosura bie në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 36, pika 2, Nenin 77, pika 1 dhe 4 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Nenin 41, pika 2; Nenin 55, pika 4 dhe Nenin 78, pika 2.
- Nga auditimi i ofertës fituese të paraqitur nga "A. M. S.", me vlerë 1,800,000 lekë pa TVSH dhe 2,160,000 lekë me TVSH, rezultoi se:
a- Shtojca 1-Formulari i ofertës, çmimi ofertës me TVSH është shënuar 2,160,0000 lekë, pra ka një gabim në çmimin e ofertuar me TVSH, për të cilën nga AK kontraktor nuk është kërkuar sqarim nga OE dhe nuk është bërë asnjë shpjegim në procesverbalin për shqyrtimin e ofertave me nr. 6878/4 prot., datë 09.12.2022, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", Nenit 92-Shqyrtimi i ofertave dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Nenin 82, pika 2 dhe 3.

b- Në lidhje me plotësimin e kriterit 3.2-Kapaciteti teknik, për kategoritë 1-Motorrist; 4-Elektroaut; 5-Bojaxhi automjetesh; 6-Llamarinist Automjetesh, në listë pagesat e dorëzuara nga OE fitues janë deklaruar në kodin 7231.06 - Mekanik automjetesh, ndërkohë që këto kategori duhet të klasifikoheshin në kode të tjera sipas përcaktimeve të VKM nr. 514, datë 20.9.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar", Kodi Profesioni 7132 dhe 7231.

c- Në deklaratën e Garancisë dorëzuar nga OE fitues, në lidhje me garancinë për pjesët e këmbimit citohet: *"Për pjesët e këmbimit që do të përdoren për riparimin e automjeteve do të jenë të reja, origjinale, prodhim sipas standardeve të CE, me garancinë jo me pak se 1 vit, nga data e montimit, ose sipas normativave standarde të mirëmbajtjes së automjeteve, bazuar në km të përshkuar."*, në kundërshtim me përcaktimet e DST-ve të publikuara nga AK, pika 3.2-Kapaciteti Teknik, ku është përcaktuar *"Deklaratë se pjesët e këmbimit që do të përdoren për riparimin e automjeteve, do të jenë të reja, dhe prodhim sipas standardeve të CE, për garancinë e pjesëve të këmbimit jo më pak se 1 vit, nga data e montimit."* Sa më sipër, KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues "A. M. S.", me vlerë 1,800,000 lekë, edhe pse nuk ka plotësuar plotësisht kriteret e kërkuara në DST, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", neni 87 "Kriteret për shpalljen e ofertës fituese", neni 92 "Shqyrtimi i ofertave" dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave".

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 132-161 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandimi: Titullari i autoriteti kontraktor të FDKSH, të nxjerrë përgjegjësitë për shkeljet e mësipërme, si dhe të marrë masa që në vijimësi, në organizimin e procedurave të prokurimit të argumentojë fondin limit bazuar në dokumentacion justifikues që përcakton nevojën për punë, shërbime dhe mallra, si dhe të respektojë kriteret dhe specifikimet e përcaktuara në DST në procesin e vlerësimit të ofertave.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit "Blerje Tonerash", viti 2022, janë konstatuar mangësi në zhvillimin e procedurës, si më poshtë:

-Për përcaktimin e sasisë së artikujve që nevojiten është realizuar verifikimi dhe mbledhja e të gjithë nevojave të Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale si dhe gjendjet në magazinë, sipas shkresës nr. 5245/2 prot., datë 25.08.2022, por bashkëngjitur Memos, mungon dokumentacioni justifikues, procesverbal apo kërkesë sipas Drejtorive që argumenton sasitë e kërkuara, mbi bazën e të cilave do të hartohet fondi limit, në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 34 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2020 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik", Neni 12, pika 1 dhe 4, Neni 76.

- Në procesin e shqyrtimit të ankesave për fazën e vlerësimit të ofertave rezulton se pjesë e komisionit të shqyrtimit të ankesave sipas Vendimit nr.16, datë 19.10.2022 (nr.5245/16 prot.) të titullarit të AK, është z. E. C., i cili gjithashtu është edhe pjesë e komisionit për argumentimin e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike, si dhe hartimin e kritereve për kualifikim, sipas urdhrit nr.266, datë 23.08.2022 (nr.5245/1 prot.), veprime këto që bien në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 101 "Hapat për shqyrtimin e ankesave në autoritetin/entin kontraktor", pika 1 ku citohet: "…Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit për të cilin është paraqitur ankesa…".

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 132-161 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1 Rekomandimi: Titullari i autoriteti kontraktor të FDKSH, të marrë masa që në vijimësi, në organizimin e procedurave të prokurimit të argumentojë fondin limit bazuar në dokumentacion justifikues që përcakton nevojën për punë, shërbime dhe mallra, si dhe të respektojë përcaktimet ligjore në procesin e shqyrtimit të ankesave.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit "Blerje Karburanti", viti 2022, janë konstatuar mangësi në zhvillimin e procedurës, si më poshtë:
- Procedura e përzgjedhur për blerjen e karburantit është procedura e hapur e thjeshtuar. Për menaxhimin me efektivitet të fondeve duhej të përzgjidhej procedura marrëveshje kuadër, bazuar në përcaktimin e çmimit të karburantit sipas Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 12.03.2022 si dhe përcaktimeve të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar referuar nenit 59 "Përdorimi i marrëveshjes kuadër", pika 2 dhe nenit 61 "Qëllimi i përdorimit dhe detyrimet që rrjedhin nga një marrëveshje kuadër", pika 1.
- Në dosje nuk administrohet relacioni që argumenton orët e punës të gjeneratorëve gjatë vitit si dhe sasinë e karburantit që nevojitet, për pasojë hartimi i fondi limit është i paargumentuar në kundërshtim me përcaktimeve të Ligjit Nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, neni 34 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2020 "*Për miratimin e rregullave te prokurimit publik",* neni 12 dhe 76.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 132-161 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
16.1 Rekomandimi: Titullari i autoriteti kontraktor të FDKSH, të marrë masa që në vijimësi, në organizimin e procedurave të prokurimit të argumentojë fondin limit bazuar në dokumentacion justifikues që përcakton nevojën për punë, shërbime dhe mallra, si dhe të respektojë përcaktimet ligjore në procesin e përzgjedhjes së llojit të procedurës së prokurimit me qëllim përdorimin me efektivitet të fondeve publike.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël për vitin 2022 në FSDKSH, janë konstatuar mangësi në zhvillimin e procedurave, si më poshtë:
a-Shpenzime për pritje-përcjellje, për FSDKSH, viti 2022
- Në ftesën për Ofertë është përcaktuar si kriter "Subjekti që do të ofrojë shërbimin me këto mallra duhet të jetë jo më shumë se 100 metra në rrugë këmbësore nga zyra e Autoritetit Kontraktor". Vendosja e këtij kriteri është bërë për shkak të natyrës dhe rrethanave specifike të këtij shërbimi, duke qenë e pamundur ofrimi e këtij shërbimi në distancë, por nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël nuk janë bërë shpjegimet përkatëse, referuar rrethanave më sipër, në procesverbalin/ftesën për ofertë për hartimin e kritereve, referuar përcaktimeve të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", neni 2, neni 3, neni 36, pika 2, neni 77, pika 1, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 40, pika 1, 2 dhe 3, neni 56, pika 4, neni 77, pika 2.
-Nga verifikimi i dokumentacionit bashkëngjitur urdhër shpenzimeve rezulton se informacioni mbi shpenzimet e kryera, takimet e realizuara, numrin e pjesëmarrësve, nuk është shoqëruar me dokumentacion justifikues si ftesa zyrtare për takimet, shkresa apo email, axhendën e takimeve, personat që do të marrin pjesë, jo në përputhje me përcakimet e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për rregullat e Prokurimit Publik" i ndryshuar, neni 107, pika 3 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pika 42, 43, 44,52, 53 dhe 54.
b-Mirëmbajtje e sistemit të kondicionimit të godinës së Fondit.
-Në ftesën për Ofertë është përcaktuar si kriter "Shoqëria duhet të jetë e pajisur me licencë profesionale të zbatimit kategoria NS 12, klasifikimi jo më poshtë se germa E, kategoria NS-14 klasifikimi germa A , licencë profesionale personale në zbatim kategoria 12-b,c,f.g, si dhe licence profesionale personale në Mbrojtjen Kundra Zjarrit.". Vendosja e këtij kriteri pa përcaktuar nënkategoritë është i paargumentuar teknikisht, pasi jo të gjitha nënkategoritë e

Klasifikimit NS-14, kanë lidhje me objektin e kontratës. Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël duhet të përcaktojë qartësisht dhe specifikisht kriteret për kualifikim referuar përcaktimeve të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 36, pika 2, Neni 77, pika 1 dhe 4, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 41, pika 2, Neni 55, pika 4, Neni 78, pika 2, Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", pika 7.
- Dokumenti i paraqitur për Qendrën e Asistencës së autorizuar (Systemair) për shërbimin teknik për pajisjet e kondicionimit Chiller (Heat Pump), Fan Coil dhe AHU, është në gjuhën italiane, dhe nuk vërteton lidhjen kontraktuale ndërmjet OE fitues "C." SHPK dhe shoqërisë "T. SRL". Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël në vijimësi duhet të kërkojë sqarime përkatëse për këto devijime sipas përcaktimeve të bëra në Ftesën për ofertë, pika 10 dhe Ligjin nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 92-Shyqrtimi i Ofertave, pika 3.
c-Shpenzime ndërtimore për mirëmbajtjen e godinës
- Nga titullari i Autoritet Kontraktor nuk është ngritur Grup Pune, në përbërje të secilit duhet të kishte një specialist të fushës, për verifikimin e punimeve që do të kryen, gjithashtu në dosje nuk administrohet procesverbal paraprak konstatues për nevojën e kryerjes së punimeve, por administrohet preventiv i hartuar dhe nënshkruar vetëm nga një specialist.
d- Lyerje e ambienteve të godinës së FSDKSH
- Nga titullari i Autoritet Kontraktor nuk është ngritur Grup Pune, në përbërje të secilit duhet të kishte një specialist të fushës, për verifikimin e punimeve që do të kryen, në dosje nuk administrohet procesverbal paraprak konstatues për nevojën e kryerjes së punimeve, por administrohet preventiv i hartuar dhe nënshkruar vetëm nga një specialist, si dhe nuk është shoqëruar me skicën apo planimetritë e zyrave, mbi bazën e të cilave do të llogaritej sipërfaqja për çdo ambient. Veprimet më sipër bien në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", neni 2; neni 3; neni 36, pika 2; neni 77, pika 1 dhe 4; neni 92, pika 3 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 40, pika 1, 2 dhe 3; neni 41, pika 2; neni 55, pika 4; neni 56, pika 4; neni 77, pika 2; neni 78, pika 2 dhe neni 107, pika 3, si dhe Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", pika 7, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pika 42, 43, 44, 52, 53 dhe 54.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 132-161 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
17.1 Rekomandimi: Titullari i autoriteti kontraktor, FDKSH të marrë masa që në vijimësi, në organizimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, të argumentojë fondin limit bazuar në dokumentacionin justifikues si dhe të ngrihen grupe pune me specialistë të fushës për përcaktimin e nevojave për punë, mallra e shërbime, të argumentojë hartimin e kritereve dhe specifikimeve për kualifikim, si dhe të respektojë përcaktimet ligjore në procesin e marrjes në dorëzim.

Në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Në veprimtarinë e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm për vitin 2022, ka rezultuar se nga FSDKSH nuk janë marrë masa për ndryshimin e akteve administrative në lidhje me varësin e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm nga Drejtori i Përgjithshëm, problematikë kjo e trajtuar dhe në raportin e mëparshëm të auditimit të KLSH, për vitin 2021. Bazuar në ligjin nr.10383, datë 24.02.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë" neni 15, germa "a" dhe "b", struktura e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm duhet të ketë varësi dyfishtë, për të siguruar pavarësi në kontrollin dhe auditimin edhe të veprimtarisë së Drejtorit të Përgjithshëm dhe raportimin e kësaj veprimtarie në Këshillin Administrativ.

Gjithashtu edhe në Kartën e re të Auditimit të Brendshëm, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm me nr.7084 prot., datë 07.12.2022, nuk është parashikuar varësia e dyfishtë nga të dy organet drejtuese, konkretisht Seksioni II.1-Statusi Organizativ.
(Më hollësisht trajtuar në piken 2.7, faqe 174-185 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
18.1 Rekomandimi: FSDKSH të marrë masa në vijimësi të bëjë ndryshimet përkatëse në aktet administrative (Rregullore për organizimin dhe Funksionimin e FSDKSH dhe Karta e Auditit) duke parashikuar varësinë e dyfishtë nga Këshilli Administrativ dhe Drejtori i Përgjithshëm, të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm.

Në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Në veprimtarinë e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm në FSDKSH, është konstatuar se në 3 raste nuk është zbatuar afati 10 ditor nga njoftimi i auditimit deri në takimin fillestar jo në përputhje me përcaktimet Manualit të Auditimit të Brendshëm, Kapitulli IV, pika 4.1.4 dhe 3 raste ku nuk është zbatuar afati 10 ditor nga përfundimi i auditimit në terren deri në dërgimin e Projekt Raportit në subjekt, jo në përputhje me përcaktimet Manualit të Auditimit të Brendshëm, Kapitulli IV, pika 4.1.12. Gjithashtu nga auditimi i 5 dosjeve të përzgjedhura është konstatuar se mungojnë në to formatet e vlerësimit të riskut për sistemet e audituara konkretisht "Formati Standard 4: Vlerësimi i Riskut për Mjedisin e Përgjithshëm të Kontrollit", "Formati Standard 5: Vlerësimi i risqeve për sisteme/fusha të veçanta të llogarisë" dhe "Formati Standard 6: Buxheti dhe afati kohor për angazhimet e auditimit" pjesë e kapitullit IV të Manualit te Auditimit të Brendshëm, si pjesë e procesit fillestar të planifikimit të njësisë.
(Më hollësisht trajtuar në piken 2.7, faqe 174-185 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
19.1 Rekomandimi: Drejtoria Auditimit të Brendshëm, të marrë masa në vijimësi të zbatojë me korrektësi afatet procedurale në të gjitha fazat e procesit të auditimit si dhe të plotësojë me përpikmëri dokumentacionin standard përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm.

Në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Funksionimi i sistemit të MFK në FSDKSH ka shfaqur mangësi pasi:
-Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk punon me sistem HRMIS, por me hedhje manualisht në programin Microsoft Office Excel. Hedhja, pasqyrimi i të dhënave personale dhe profesionale të çdo punonjësi të punësuar kryhen nëpërmjet programit Excel- it apo Ẁord- it.
-Drejtoria e Ekonomike për mbajtjen e Kontabilitetit operon me programin Excel dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave e cila kryhet nga sektori i financës, niveli i riskut për të gabuar mbetet i lartë.
- FSDKSH nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike ekspozimin e kësaj njësie ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e FSDKSH-së, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.
- Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.
(Më hollësisht trajtuar në piken 2.7, faqe 174-185 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
20.1 Rekomandimi: Nga Titullari i FSDKSH, të merren masa për njohjen nga ana e stafit, të Ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, duke përfshirë dhe riskun e mashtrimit, funksionimin e sistemit HRMIS për administrimin e burimeve njerëzore dhe pajisjen me programin e Kontabilitetit të Drejtorisë Ekonomike.

Brenda datës 31.12.2023

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi procesin e rekrutimeve për vitin 2022, rezulton se në Rregulloren nr. 2, datë 06.07.2020 "Për Organizimin, Funksionimin dhe Përshkrimin e Punës së Fondit, për 34 poste pune, nuk është përcaktuar specialiteti i kërkuar dhe niveli i diplomës, referuar pozicionit të punës, por është vendosur si kriter "Arsim i Lartë", ose "Arsim i Lartë/Shkenca Shoqërore/Natyrore" pa përcaktuar se çfarë profesioni duhet të kenë punonjësit, duke lënë hapësirë për rekrutimin e punonjësve me specialitete jo të përshtatshme, për aktivitetin që kryen Fondi, si dhe për pjesën e komandimeve konstatohet se në Rregulloren nr. 1, datë 06.07.2020 "Për funksionimin e FSDKSH", Kreun 5 "Rregullorja e burimeve njerëzore", pika I/2.2 "Komandimi i përkohshëm në detyrë", nuk parashikohet kohëzgjatja e komandimit të përkohshëm për punonjësit brenda institucionit, por vetëm për punonjësit jashtë institucionit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 162-174 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

21.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i FSDKSH-së, të marrë masa për rishikim dhe plotësimin e mangësive të evidentuara në rregulloret e cilësuara më lart, me qëllim parashikimin e kohëzgjatjes së komandimit të përkohshëm për punonjësit brenda institucionit dhe përcaktimin e nivelit të arsimit të kërkuar dhe specialitetit për çdo pozicion pune.

Menjëherë

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi menaxhimin e burimeve njerëzore është konstatuar se nuk janë respektuar kërkesat e Rregullores nr. 1 "Për funksionimin e FSDKSH"; Kapitulli 5 "Rregullorja e burimeve njerëzore", Pika II "Ngritja në detyrë, lëvizja paralele dhe transferimi", Paragrafi 3 dhe Rregullores nr. 2 "Për organizimin, funksionimin dhe përshkrimet e punës për drejtorinë e përgjithshme të Fondit", Kapitulli 8 "Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse", "Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve", pika 16 në lidhje me:

- me urdhrin nr. 86 datë 05.04.2022 është transferuar punonjësi A. S., nga pozicioni i përgjegjësit në Sektorin e Prokurimeve Drejtoria Juridike në pozicionin specialist në DRF Tiranë. Transferimi nuk ka bashkëngjitur kërkesën (ose miratimin) e punonjësit;
- nuk është kryer vlerësimi periodik i performancës në punë për 27 punonjës;
- nuk ka kalendar të miratuar të trajnimeve dhe punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të FSDKSH nuk kanë kryer trajnime.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 162-174 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

22.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i FSDKSH-së dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrin masa që në vijimësi të administrojnë vlerësime vjetore për të gjithë punonjësit, sipas formatit të miratuar të vlerësimit; hartimin dhe miratimin e kalendarit të trajnimeve, referuar nevojave reale të stafit, si dhe respektimin e kritereve në rastet e transferimeve të punonjësve.

Në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Këshilli Administrativ i FSDKSH gjatë vitit 2022 ka zhvilluar në total 8 mbledhje, për të cilat rezulton se nuk është ndjekur intervali një mbledhje në dy muaj, në kundërshtim me Ligjin nr.10383, datë 24.02.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë" neni 18, "Mbledhjet dhe vendimet e këshillit administrativ", pika 1 dhe VKM nr. 124, datë 5.3.2014, "Për Miratimin e Statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor" në Republikën e Shqipërisë, Neni 6, pika 1. Konkretisht, pas mbledhjes së datës 15.02.2022, mbledhja e radhës është zhvilluar më 13.05.2022, me një vonesë gati një muaj dhe pas mbledhjes së datës 13.05.2022 mbledhja e radhës është zhvilluar më 19.07.2022, me një vonesë gati një javë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

23.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i FSDKSH, të marrë masa që në vijimësi të zbatojë diskrecionin e tij, për thirrjen e mbledhjeve të Këshillit Administrativ, në intervale kohore jo më pak se një herë në dy muaj.

Në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi janë konstatuar mangësi në vendimmarrjen e KA, pasi në dy raste për VKA nr. 22 "Për krijimin e komisionit teknik të listës së pajisjeve mjekësore të rimbursuara për vitin 2023" dhe VKA nr. 23 "Për krijimin e komisionit teknik të LBR për vitin 2023", mungon dokumentacioni që vërteton konfirmimet e përfaqësuesve të institucioneve të tjera për Komisionin Teknik (KT) dhe përzgjedhjen e tre emrave nga Drejtori i Përgjithshëm për çdo pozicion të pa mbuluar nga anëtarët e Fondit, në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr.124, datë 05.03.2014 "Për miratimin e statutit të FSDKSH në RSH", të ndryshuar, neni 18 "Komisionet teknike të paketave të shërbimit" pika 3 dhe 4. Si përfundim është e paqartë se cila ka qenë procedura specifike e ndjekur në përzgjedhjen e emrave konkret të komisionit, vendimmarrja e të cilit ka një efekt të lartë financiar në buxhetin e shtetit.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
24.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i FSDKSH, të marrë masa që në vijimësi të zbatojë përcaktimet e VKM nr.124, datë 05.03.2014 "Për miratimin e statutit të FSDKSH në RSH", të ndryshuar, neni 18 "Komisionet teknike të paketave të shërbimit" pika 3 dhe 4, duke u kërkuar institucioneve që mund të përfshihen në procesin e hartimit të paketave, të paraqesin kandidatura për anëtarë të komisioneve teknike.

Në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve është evidentuar se:
Nga subjekti i audituar është raportuar në KLSH, brenda afateve ligjore;
Nga Drejtoria e Përgjithshme e FSDKSH nga 34 rekomandime të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, janë pranuar 34, ose 100 % e tyre, nga të cilat:

- janë zbatuar plotësisht 26 rekomandime ose 76.5 % e tyre;
- nuk është zbatuar 1 rekomandim "Vlerësim dhe marrje masash disiplinore";
- është zbatuar pjesërisht 1 rekomandim dhe janë në proces zbatimi 6 rekomandime, për të cilat nga DP e FSDKSH janë marrë masa konkrete për realizimin e tyre, por finalizimi përfundimtar kërkon bashkëpunim me MSHMS si dhe vendimmarrje të Këshillit Administrativ të FSDKSH, i cili nuk kishte vepruar brenda afateve të përcaktuara nga KLSH. (Rekomandimet "Masa organizative" nr. 2.1; 3.1; 4.1; 9.1; 18.1; 21.2 dhe rekomandimi nr. 2.1 "Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike")

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 16-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
25.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, **i ri kërkojmë** Këshillit Administrativ të FSDKSH, marrjen e masave për shqyrtimin dhe miratimin e dokumenteve të përgatitura nga Drejtoria e Përgjithshme e FSDKSH, në zbatim të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit *"Blerje Kancelarie",* viti 2022, verifikimi i zbatimit të kontratës dhe dokumentacionit justifikues si urdhër shpenzimeve, fletë hyrje dhe procesverbale për marrjen në dorëzim të mallit rezulton se një pjesë e artikujve janë dorëzuar me vonesë nga OE "M. & D." SHPK. Nga ana AK, është

aplikuar gabim penaliteti për vonesat në dorëzimin e mallrave, duke llogaritur 25% vetëm mbi zërin "Kancelari" dhe jo mbi vlerën totale të kontratës, në kundërshtim me përcaktimit e Nenit 11 të Kontratës nr. 3754/11 prot., datë 29.07.2022, ku ndër të tjera citohet se: "Në rast se Kontraktuesi nuk dorëzon mallin në magazinën e "Autoritetit Kontraktor", sipas kushteve të caktuara në nenet e lart shënuara, detyrohet ti paguajë "Autoritetit Kontraktor", për çdo ditë vonesë kamatat në masë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total të "kontratës" por jo më pak se 25% të vlerës së saj. Sa më sipër llogaritet një vlerë 890,328 lekë penalitet i pa paguar. Veprimet më sipër bien në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, neni 124- Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2020 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 107-Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës, pika 1, 4, 6 dhe 7, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pika 42, 43, 44,52, 53 dhe 54, DST-të e procedurës së prokurimit, Kushtet e përgjithshme të kontratës, neni 17, Kontratën nr. 3754/11 prot., datë 29.07.2022, nenin 11- Penalitete për mos përmbushje të detyrimeve kontraktuale.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 132-161 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
1.1 Rekomandimi: Titullari i autoriteti kontraktor të FDKSH, të marrë masat e nevojshme administrative me qëllim arkëtimin e shumës 890,328 lekë nga subjekti OE "M. & D." SHPK, vlerë e ardhur për shkak të aplikimit gabim të penalitetit për vonesat në dorëzimin e mallrave në kundërshtim me përcaktimet ligjore.

Deri më datë 31.12.2023

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE FINANCIARE NEGATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit përkatës të vënë në dispozicion nga sektori i përfaqësimit ligjor, rezulton se në fund të vitit 2022 janë në proces gjyqësor (shkallë të parë, Apel) 4 çështje me objekt "Dëmshpërblim page". Referuar këtyre të dhënave mbi shumat e kërkuara në kërkesë-padi dhe vlerës mesatare të pagës, shpenzimet gjyqësore parashikohen në vlerën prej 9,348,489 lekë. Ndërsa sipas të dhënave të Drejtorisë Ekonomike, gjatë vitit 2022, janë kryer likuidime për vendime gjyqësore të formës së prerë për ish punonjës të larguar nga puna, **në vlerën totale 5,567,141 lekë**, nga e cila shuma prej 2,361,187 lekë i përket dy vendimeve gjyqësore të Drejtorisë së Përgjithshme.
Gjithashtu rezulton se gjatë vitit 2022, në 1 rast pagesa për vendimet gjyqësore nuk është bërë në mënyrë vullnetare, por është pritur urdhri i shërbimit përmbarimor, duke rënduar më tej buxhetin me shpenzime përmbarimore **në vlerën 145,479 lekë**, shpenzime të cilat përbëjnë efekt financiar negativ për buxhetin e institucionit. Nga auditimi nuk rezulton të jenë nxjerr përgjegjësi apo të jenë marrë masa administrative në lidhje me vendimet gjyqësore për largimet nga puna, veprime të cilat nuk janë në përputhje me pikën 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 162-174 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
1.1. Rekomandimi: Këshilli Administrativ i FSDKSH dhe Drejtori i Përgjithshëm, të nxjerrin përgjegjësitë për të gjitha rastet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës në kundërshtim me kërkesat e Kodit të Punës dhe me kontratën individuale të lidhur me punëmarrësit, të cilat kanë shkaktuar efekte negative për buxhetin e shtetit, si dhe të ekzekutojë në mënyrë vullnetare të gjitha vendimet gjyqësore të formës së prerë, me qëllim eliminimin e shpenzimeve përmbarimore të pa nevojshme.

Në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr.154/2014 "Për organizmin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", germat "b" , "c" dhe "ç"; neni 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Rregulloren nr. 1 "Mbi funksionimin e FSDKSH", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 277, datë 06.07.2020, Kreu XV "Shkeljet dhe masat disiplinore dhe procedimi disiplinor", i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH, që në vlerësim të shkeljeve dhe masave të propozuara nga ana jonë, të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore për personat përgjegjës të atakuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit:

I- "Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna", referuar Rregullores nr. 1 "Mbi funksionimin e FSDKSH", Kreu XV "Shkeljet dhe masat disiplinore dhe procedimi disiplinor", pika 5 "Masat Disiplinore", germa "c", për punonjësit e mëposhtëm:

1. Z. Sh.S., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit, në cilësinë e anëtarit të KVO-së;
2. Znj. I. Ç., me detyrë Specialist Sektori i Ligjshmërisë, Drejtoria Juridike, në cilësinë e anëtarit të KVO-së;
3. Z. D. L., me detyrë Specialist Sektori i Përfaqësimit Ligjor, Drejtoria Juridike, në cilësinë e anëtarit të KVO-së;
4. Z. E. D., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit dhe anëtarit të Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël;
5. Znj. E. S., me detyrë Specialist Sektori i Prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit dhe anëtarit të Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël;
6. Z. A. K., me detyrë Specialist Sektori i Prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit dhe anëtarit të Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël;
7. Z. A. Xh., me detyrë Specialist Inxhinier Sektori i Shërbimeve, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, në cilësinë e anëtarit të Komisionit për hartimin e Fondit Limit, Komisionit për ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve, dhe Grupit të punës për verifikimin e gjendjes teknike të automjeteve;
8. Z. M. A., me detyrë Shofer Sektori i Shërbimeve, në cilësinë e anëtarit të Komisionit për ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve, Grupit të punës për verifikimin e gjendjes teknike të automjeteve.

Për shkeljet e konstatuara si më poshtë:
- Në tre raste nga auditimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit *"Mirëmbajtje automjetesh të Fondit", viti 2022, "Blerje Tonerash", viti 2022* dhe *"Blerje Karburanti", viti 2022,* rezultoi se në procesin e hartimit të fondit limit nga AK nuk administrohet dokumentacion që argumenton nevojën e kryerjes së shërbimeve dhe sasitë e kërkuara, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 34, neni 35 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2020 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik", Neni 12, pika 1 dhe 4, Neni 76, Neni 78, pika 2.
- Në një rast nga auditimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit *"Mirëmbajtje automjetesh të Fondit",* viti 2022, rezultoi se hartimi i DST-ve, kapaciteti teknik, pika 6, është i pa argumentuar teknikisht. Mos argumentimi i kritereve të vendosura bie në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 36, pika 2, Neni 77, pika 1 dhe 4, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 41, pika 2, Neni 55, pika 4, Neni 78, pika 2.
- Në një rast nga auditimi procedurës së prokurimit *"Mirëmbajtje automjetesh të Fondit",* viti 2022, KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues "A. M. S.", me vlerë 1,800,000 lekë, edhe pse

nuk ka plotësuar plotësisht kriteret e kërkuara në DST, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", neni 87 "Kriteret për shpalljen e ofertës fituese", neni 92 "Shqyrtimi i ofertave" dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave".
- Në një rast nga auditimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit *"Blerje Karburanti", viti 2022,* rezulton se përzgjedhja e procedurës e hapur e thjeshtuar, është e gabuar, pasi për menaxhimin me efektivitet të fondeve duhej të përzgjidhej procedura marrëveshje kuadër, bazuar në përcaktimin e çmimit të karburantit sipas Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 12.03.2022 si dhe përcaktimeve të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 59 "Përdorimi i marrëveshjes kuadër", pika 2, Neni 61 "Qëllimi i përdorimit dhe detyrimet që rrjedhin nga një marrëveshje kuadër" pika 1.
- Në dy raste nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël *"Shpenzime për pritje-përcjellje, për FSDKSH, viti 2022"* dhe *"Mirëmbajtje e sistemit të kondicionimit të godinës së Fondit",* përcaktimi i kritereve në ftesën për ofertë nuk është argumentuar teknikisht, nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël nuk janë bërë shpjegimet përkatëse, referuar përcaktimeve të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", Neni 36, pika 2, Neni 77, pika 1, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 40, pika 2 dhe 3, Neni 41, pika 2, Neni 55, pika 4, Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", pika 7.
- Në një rast nga auditimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit me vlerë të vogël *"Shpenzime për pritje-përcjellje, për FSDKSH,* nga verifikimi i dokumentacionit bashkëngjitur urdhër shpenzimeve rezulton se informacioni mbi shpenzimet e kryera, takimet e realizuara, numrin e pjesëmarrësve, nuk është shoqëruar me dokumentacion justifikues në kundërshtim me përcakimet e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për rregullat e Prokurimit Publik" i ndryshuar, neni 107, pika 3 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pika 44, 52 dhe 54.
- Në një rast nga auditimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit me vlerë të vogël *"Mirëmbajtje e sistemit të kondicionimit të godinës së Fondit"* dokumentacioni i paraqitur nga OE fitues nuk përputhet plotësisht me kriteret e vendosura nga AK, jo sipas përcaktimeve të bëra në Ftesën për ofertë, pika 10 dhe Ligjin nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 92- Shqyrtimi i Ofertave, pika 3.

II- "Vërejte", referuar Rregullores nr. 1 "Mbi funksionimin e FSDKSH", Kreu XV "Shkeljet dhe masat disiplinore dhe procedimi disiplinor", pika 5 "Masat Disiplinore", germa "b", për punonjësit e mëposhtëm:

1. Zj. M. P., me detyrë Specialiste Sektori i Buxhetit, Drejtoria Ekonomike, në cilësinë e anëtarit të Komisionit për hartimin e Fondit Limit;
2. Z. E. Ç., me detyrë Specialist Sektori i Përfaqësimit Ligjor, Drejtoria Juridike, në cilësinë e anëtarit të Komisionit për hartimin e Fondit Limit;
3. Znj. M. B., me detyrë Magazinier Sektori i Shërbimeve, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, në cilësinë e anëtarit të Grupit për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës;
4. Z. A. H., me detyrë Specialist Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, në cilësinë e anëtarit të Grupit për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës;
5. Znj. V. G., në cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit të Financës;
6. Zj. L.Sh., në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë Ekonomike.

Për shkeljet e konstatuara si më poshtë:
- Në një rast nga auditimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit *"Blerje Karburanti", viti 2022,* rezultoi se në procesin e hartimit të fondit limit nga AK nuk administrohet dokumentacion që argumenton orët e punës dhe sasitë e kërkuara, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 34 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2020 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik", Neni 12, Neni 76.
- Në një rast nga auditimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit *"Blerje Kancelarie",* viti 2022, rezultoi se nga ana AK është aplikuar gabim penaliteti për vonesat në dorëzimin e mallrave, duke llogaritur 25% vetëm mbi zërin "Kancelari" dhe jo mbi vlerën totale të kontratës, për pasojë llogaritet një vlerë 890,328 lekë penalitet i pa paguar, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 124- Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës, VKM nr. 285, datë 19.05.2020 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 107-Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës, pika 1, 4, 6 dhe 7, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pika 44, 52 dhe 54, DST-të e procedurës së prokurimit, Kushtet e përgjithshme të kontratës, neni 17, Kontratën nr. 3754/11 prot., datë 29.07.2022, nenin 11- Penalitete për mos përmbushje të detyrimeve kontraktuale.

E. TË NDRYSHME.

1. Për punonjësit e tjerë të cilësuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nuk rekomandojmë masa disiplinore pasi shkeljet e konstatuara pavarësisht se ekzistojnë, në gjykimin e grupit të auditimit nuk janë materiale dhe nuk justifikojnë dhënien e një mase disiplinore.

2. Meqenëse, me Programin e auditimit nr.733/1 prot., datë 11.09.2023, KLSH është në auditim në FSDKSH për çështjen "Përputhshmëria me aktet ligjore dhe rregullatore në fuqi të veprimtarisë së organeve drejtuese të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, lidhur me rimbursimin e barnave: Këshilli Administrativ, Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtoritë përkatëse në FSDKSH", nuk janë finalizuar me gjetje, konkluzione, evidentim përgjegjësie dhe rekomandime elementët që kanë të bëjnë me këtë çështje.

V. ANEKSE:

1. Lista e shkurtimeve të përdorura në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

FSDKSH	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm Shëndetësor.
RSH	Republika e Shqipërisë.
PPP	Partneritet Publik Privat
SU	Spital Universitar
DKPS	Drejtoria e Kujdesit Parësor dhe Spitalor
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
DHAB	Drejtoria e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik

QSH	Qendër Shëndetësore
DRF	Drejtori Rajonale e Fondit
DK	Drejtoria e Kontrollit
LBR	Lista e Barnave të Rimbursuara
VKA	Vendim i Këshillit Administrativ
DSHSU	Drejtoria e Shërbimeve Spitalore Universitare
DP	Drejtor i Përgjithshëm
PBA	Programit Buxhetor Afatmesëm
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
ISSH	Instituti i Sigurimeve Shoqërore
KMB	Kontroll Mjekësor Bazë
DAPSHET	Drejtoria e Administrimit të Paketave dhe Ekzaminimeve Terciale
MPF	Mjek i Përgjithshëm i Familjes
MS	Mjek Specialist
SKP	Sektori i Kontrollit Parësor
DIAS	Drejtoria e Informacionit dhe Analizës Statistikore
SKD	Sektori i Kontrollit të Depove
SKS	Sektori i Kontrollit Spitalor
SB	Spital Bashkiak
SR	Spital Rajonal
Grup ATC	Grup Anatomik, Terapeutik Kimik
KÇB	Komisioni i Çmimit të Barnave

<u>Drejtimi i auditimit nr. 2.2</u> "Mbi veprimtarinë e Këshillit Administrativ dhe DP të FSDKSH"

Tabela nr. 2.1 "Mbledhjet e zhvilluara nga Këshilli Administrativ dhe vendimet e mara përgjatë vitit 2022".

Mbledhja nr/datë	Vendimet 2022
Nr.1 datë 15.02.2022	**Vendimi nr.1:** "Miratimi i buxhetit të FSDKSH për vitin 2022". **Vendimi nr.2:** "Për financimin shtesë të spitaleve publike për realizimin e paketave të shërbimeve të miratuara me VKM…". **Vendimi nr.3:** "Për një ndryshim në vendimin nr.489 datë30.07.2021 të KM, për miratimin e listës së barnave që rimbursohen nga FSDKSH dhe masën e mbulimit të çmimit të tyre". **Vendimi nr.4:** "Për miratimin e listës së pajisjeve mjekësore të rimbursueshme, si dhe masën e mbulimit të çmimit të tyre, miratimin e propozimit të pr-vendimit të KM për një shtesë në VKM nr.61 datë 03.02.2017 "për miratimin e paketave të pajisjeve mjekësore të rimbursueshme". **Vendimi nr.5:** "Për miratimin e kontratave për rimbursimin e fishave të diabetit për vitin 2022".
Nr.2 datë 13.05.2022	**Vendimi nr.6:** "Për miratimin e raportit financiar dhe bilancit vjetor 2021 të FSDKSH". **Vendimi nr.7:** "Për miratimin e raportit vjetor 2022 të FSDKSH".
Nr.3 datë 19.07.2022	**Vendimi nr.8:** "Për miratimin e disa ndryshimeve në udhëzimin për mënyrën e pagesës dhe shpërblimit për punonjësit e QSH nga skema e Detyrueshme e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor". **Vendimi nr.9:** "Për disa ndryshime në rregulloren e burimeve njerëzore të FSDKSH në kapitullin "Paga".

	Vendimi nr.10: "Për mënyrën e përdorimit të fondit rezervë për vitin 2022".
Nr.4 datë 30.08.2022	**Vendimi nr.11:** "Për një ndryshim në VKA nr.1 datë 15.02.2022, "Për miratimin e buxhetit të FSDKSH për vitin 2022". **Vendimi nr.12:** "Për shpërndarje nga rezerva e buxhetit të shërbimit spitalor për vitin 2022". **Vendimi nr.13:** "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 të FSDKSH". **Vendimi nr.14:** "Për propozimin për një ndryshim në VKM nr.43 datë 19.01.2022, "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga Skema e DSKSH për vitin 2022". **Vendimi nr.15:** "Për miratimin e projekt-vendimit të KM 'Për disa ndryshime në VKM nr.308 datë 21.05.2014, 'Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga FSDKSH në shërbimin spitalor' të ndryshuar". **Vendimi nr.16:** "Për miratimin e rregullores 'Mbi procedurat dhe metodologjinë e kostifikimit të paketave shëndetësore që financohen nga FSDKSH dhe kostifikimin e shërbimeve spitalore në institucionet publike".
Nr.5 datë 04.10.2022	**Vendimi nr.17:** "Për shpërndarje nga rezerva e buxhetit të shërbimit spitalor për vitin 2022". **Vendimi nr.18:** "Për disa ndryshime në rregulloren e burimeve njerëzore të FSDKSH, në kapitullin "Paga". **Vendimi nr.19:** "Për miratimin e disa ndryshimeve në udhëzimin për mënyrën e pagës dhe shpërblimit për punonjësit e QSH nga Skema e DSKSH".
Nr.6 datë 11.11.2022	**Vendimi nr.20:** "Për rishpërndarje fondesh nga buxheti i shërbimeve spitalore dhe shpërndarje fondesh nga rezerva e buxhetit të shërbimit spitalor për vitin 2022". **Vendimi nr.21:** "Për miratimin e disa ndryshimeve në udhëzimin për mënyrën e pagesës dhe shpërblimit për punonjësit e QSH nga Skema e DSKSH". **Vendimi nr.22:** "Për krijimin e komisionit teknik të listës së pajisjeve mjekësore të rimbursuara për vitin 2023". **Vendimi nr.23:** "Për krijimin e komisionit teknik të LBR për vitin 2023".
Nr.7 datë 19.12.2022	**Vendimi nr.24:** "Për një ndryshim në VKA nr.1 datë 15.02.2022".**Vendimi nr.25:** "Për miratimin e listës së pajisjeve mjekësore (fisha diabeti) të rimbursueshme dhe miratimin e propozimit të pr-vendimit të KM për një shtesë në VKM nr.61 datë 03.02.2017 "Për miratimin e paketave të pajisjeve mjekësore të rimbursueshme".**Vendimi nr.26:** "Për miratimin e kontratës për qarkullimin nga importuesi të pajisjeve mjekësore që rimbursohen". **Vendimi nr.27:** "Për miratimin e një amendimi të kontratës "Për rimbursimin e farmacisë për recetën elektronike". **Vendimi nr.28:** "Për miratimin e kontratave me dhënësit e shërbimeve në kujdesin shëndetësor parësor dhe spitalor për vitin 2023".
Nr.8 datë 30.12.2022	**Vendimi nr.29:** "Për shpërndarjen nga rezervat e buxhetit të shërbimit spitalor për vitin 2022".

Burimi: FSDKSH, përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Tabela nr. 2.2 “Urdhërat e Drejtorit të Përgjithshëm”

Nr	Nr Urdhërit	Data	Prot.	Drejtoria	Lënda
1	1	06/01	29	DSHM	Emerin E.K.
2	4	10/01	117	DSHM	Riklasifikim Page H.
3	7	14/01	299	DP	Komisioni DPArkivave 2022
4	10	26/01	593	Dr.Rimbursimit	Disponibilitet Janar22
5	14	01/02	691	Dr.Kontrollit	Farmaci Rajoni Durres
6	32	03/02	760/1	Dr.Kontrollit	Depo D.-tematik
7	36	03/02	117/3	DSHM	Riklasifikim Page H.
8	40	14/02	206/2	DP	Grup pune ICD10
9	41	17/02	1115	Dr.Kontrollit	Farmaci Kamez-Vore
10	52	18/02	1163	DP	KPVV-viti 2022
11	72	09/03	1163/1	DP	Shfuquzim urdhëri 52
12	73	15/03	1612	DSHM	Riklasifikim Page M.
13	74	16/03	1627	DSHM	Ndryshim pozicioni M.
14	75	16/03	1611/2	DSHM	Ndihme ekonomike
15	86	05/04	1907	DSHM	Transferim S.
16	88	05/04	1926	Dr.Kontrollit	Farmaci Rajoni Tiranë
17	104	07/04	1997	DSHM	Largim nga detyra Mase Sh.
18	107	08/04	2021	DSHM	Komandim H.
19	115	19/04	3062	DSHM	Riklasifikim Page D.
20	117	19/04	1163/2	DP	Ndryshim urdhëri 72
21	118	19/04	287/4	DP	Ndryshim urdhëri 6
22	134	21/04	3162	Dr.Rimbursimit	Ndryshim Udheri 20 dt.26/03/21
23	137	26/04	3150/1	DSHM	Nderprerje marredhenie E.K.
24	140	27/04	2095/3	DP	Ndryshim urdhëri 112
25	141	29/04	3131/3	DP	Ndryshim urdhëri 121
26	145	06/05	3349	DSHM	Komandim P.
27	146	10/05	3266/3	DSHM	Ndihme ekonomike
28	149	12/05	3519	DSHM	Riklasifikim Page Ll.
29	171	18/05	1782/1	DSHM	Ndihme ekonomike
30	172	20/05	3714	DP	Grup pune rregullore proc online
31	174	26/05	3186/3	Dr.Kontrollit	Depo-Megapharm
32	180	30/05	3830	Dr.Kontrollit	Farmaci Rajoni Vlore
33	190	03/06	3664/2	KPPV	Fillimprocedure pritje-percjellje
34	208	16/06	4165	DP	Komision Ad-Hoc
35	210	20/06	4217	DP	Specialist karburanti
36	213	21/06	4031/1	DKPS	Ndryshim i Urdhërit Nr.195 Inspektim S.S
37	229	06/07	4447	DSHM	Riklasifikim page A.H.
38	230	06/07	4448	DSHM	Riklasifikim page I.O.
39	231	06/07	4449	DSHM	Riklasifikim page I.C.
40	239	22/07	4797	Dr.Kontrollit	Kontroll Farmaci Pogradec
41	252	15/08	5030/1	DSHM	Nderprerje e marredhenieve te punes M.K.
42	264	23/08	5252	DP	Ndryshim i Urdhërit Nr.28
43	272	06/09	5437/1	Dr.Juridike	Sherbim jashte vendit Telaviv
44	314	05/10	6019	DSHM	Riklasifikim page E.M.
45	346	21/10	6321/1	DSHM	Ndihme ekonomike M.B.
46	352	31/10	6352/2	Dr.Koordinimit	Mbulimi i shpenzimeve te E.F.
47	365	03/11	6268/1	DSHM	Nderprerje e marredhenieve te punes A.M.
48	372	11/11	6634	DSHM	Riklasifikim page J.Xh.
49	373	11/11	6635	DSHM	Riklasifikim page E.S.
50	407	30/11		DSHM	Riklasifikim page Ku.
51	431	15/12	7262	DSHM	Riklasifikim page P.
52	432	15/12	7263	DSHM	Riklasifikim page F.
53	442	27/12	7440	DIAS	Ndryshim Urdher 363 viti 2019
54	444	29/12	3754/26	Dr.Juridike	Ndryshim Urdher 230
55	446	30/12	7239/12	DP	Ndryshim Urdhëri 429

Tabela anekese, Drejtimi nr. 3 “Auditim mbi programimin, zbatimin dhe raportimin e buxhetit të sigurimeve shëndetësore për vitin 2022 duke përfshirë, detajimin fillestar, rishpërndarjen buxhetore, nivelet e realizimit të planit, konfirmimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara si dhe financimin e aktiviteteve të rimbursimit të barnave, kontratave koncesionare / PPP dhe paketave”.

Tabela nr.3.1 “Transferimet buxhetore ne QSH”

DRF	600		601		602		604		606		23	
Dibër									18,000			
									1,750			
					850							
									1,250			
					1,200							
					60							
					1,600							
	989		96		1,293							
					1,600							
							1,054					
					900							
					593							
					36							
Totali	989	-	96	-	8,132	-	1,054	-	21,000	-	-	-
Berat	990		263									
	557		90									
									35,000			
							955					
	60											
								73				
										20,000		
	1,607											
Totali	1,607		353				955	73	35,000	20,000		
Durrës					360							
					1,356							
	1,314		210									
	4,860		788		480							
	1,491		238									
	1,970		296									
										40,000		
	420		72									
	101		39									
	519		87									
	887		22									
	1,682		1,009									
	891				684							
								16,407				
									53,000			
										30,000		
Totali	14,135	-	2,761	-	2,880	-	-	16,407	53,000	70,000	-	-
Elbasan	150		78									
	525		76									
					3,420							
					2,203							
					380							
	17		10									
	125		30									
					360							
	74											
			52									
					510							
			61									
								2,504	13,277			
	486		62		760							
									38,000			
	279		58									
	400											
Totali	2,056	-	427	-	7,633	-	-	2,504	51,277	-	-	-
Fier									600			
									200			
									900			
					856							
	315		14									
							3,719					
	17											

	26											
									43,000			
	173		142							5,000		
	315											
Totali	846	-	156	-	856	-	3,719	-	44,700	5,000	-	-
Gjirokastër									8,000			
							2,500					
					1,718							
	2,231		343									
									10,000			
			61					75	4,000			
Totali	2,231	-	404	-	1,718	-	2,500	75	22,000	-	-	-
Korçë	11,010											
					60							
					360							
	440		74									
							1,611		418			
			70									
									38,000			
							3,910					
	126											
Totali	11,576	-	144	-	420	-	5,521	-	38,418	-	-	-
Kukës									2,087			
											100	
									1,800			
					873							
									1,080			
					888							
	550		70									
							494					
	1,321		253		1,043							
									9,000			
	210											
Totali	2,081	-	323	-	2,804	-	494	-	13,967	-	100	-
lezha					1,520							
							7,750					
	1,725		310									
	1,944		344									
					400							
					470							
									30,000			
							5					
	362		524									
Totali	4,031	-	1,178	-	2,390	-	7,755	-	30,000	-	-	-
Shkodër	540											
							11,000					
	6,530		1,750		500							
							1,113					
									42,000			
								118				
Totali	7,070	-	1,750	-	500	-	12,113	118	42,000	-	-	-
Tirana			3,597		800							
			134									
					300							
					120							
					1,500							
					4,000							
	2,275		380									
					439							
			150		172							
			230									
					60							
			391		2,000							
					849							
					400							
			449									
					1,104							
	171											
	218			218								
					1,200							

								110,000				
											36,663	
	3,861											
	3,204											
									160,000			
Totali	9,729	-	5,331	218	12,944	-	-	110,000	160,000	-	36,663	-
Vlorë									32,000			
									1,400			
	1,400		80									
					1,280							
									1,200			
							13,600					
							4,000					
	450		80									
							6,492					
Totali	1,850	-	160	-	1,280	-	24,092	-	34,600	-	-	-

Tabela nr.3.2 “Plani fillestar i shërbimit spitalor, sipas VKM nr. 43/2022 dhe Plan përfundimtar”

Në mijë lekë

Institucionet	VKM 43, datë 19.01.2022						Total	
	Art. 600	Art. 601	Art. 602	Art. 602 PPP Lab.	Art. 604	Rez.	Fillestar	Përfun.
Berat	332,000	48,000	170,000	50,000			600,000	580,641
Bulqizë	93,000	13,400	30,000				136,400	126,460
Delvinë	44,000	6,300	6,500				56,800	51,090
Devoll	60,000	8,500	10,000				78,500	78,875
Dibër	325,000	45,500	115,000	30,000			515,500	493,833
Elbasan	535,000	75,500	220,000	80,000			910,500	926,241
Fier	462,000	64,000	200,000	100,000			826,000	816,041
Gramsh	146,000	20,500	30,000				196,500	202,540
Gjirokastër	265,000	37,500	100,000	30,000			432,500	413,946
Has	57,000	7,900	13,000				77,900	74,330
Kavajë	147,000	20,500	30,000				197,500	177,472
Kolonjë	98,000	13,200	20,000				131,200	119,670
Korçë	496,000	70,200	246,000	75,000			887,200	889,797
Krujë	152,000	21,000	30,000				203,000	185,270
Kuçovë	80,000	10,200	16,000				106,200	102,105
Kukës	335,000	53,200	110,000	30,000			528,200	458,810
Kurbin	100,000	14,300	30,000				144,300	142,120
Lezhë	312,000	43,400	132,000	50,000			537,400	551,787
Librazhd	180,000	25,200	51,000				256,200	242,382
Lushnjë	266,000	37,500	100,000	30,000			433,500	423,881
Malësi e madhe	26,000	3,800	6,000				35,800	35,836
Mallakastër	51,000	9,000	13,000				73,000	68,150
Mat	160,000	22,500	34,000				216,500	200,960
Mirditë	127,000	17,400	27,000				171,400	164,850
Peqin	44,000	6,200	7,500				57,700	53,220
Përmet	96,000	13,400	35,000				144,400	133,690
Pogradec	200,000	28,300	77,000				305,300	289,780
Pukë	110,000	15,200	36,000				161,200	159,155
Sarandë	186,000	25,800	100,000	20,000			331,800	357,412
Skrapar	80,000	14,500	16,000				110,500	123,512
Shkodër	647,000	91,800	220,000	60,000			1,018,800	1,057,396
Tepelenë	110,000	14,700	16,000				140,700	129,720
QSUT	2,930,000	392,000	3,050,000	700,000			7,072,000	9,133,492
SUOGJ “MBRETËRESHA GERALDINË”	345,000	46,000	250,000	20,000			661,000	626,071
SUOGJ “KOÇO GLIOZHENI”	290,000	40,800	210,000	20,900			561,700	574,255
SU “SHEFQET NDROQI”	452,000	58,000	350,000	70,000			930,000	1,140,739
SU TRAUMA	165,000	22,500	200,000	43,000			430,500	563,597
Tropojë	112,000	18,000	32,000				162,000	181,413
Vlorë	512,000	72,800	300,000	50,000			934,800	913,534
“MemoriaL” Fier					874,800		874,800	1,105,396
Spitali Durrës				60,000	1,070,000		1,130,000	1,185,066
Paketat e shërbimeve (spitale private)					3,492,230		3,492,230	1,626,325
Transferta për individët (mjekë specialistë)					30,000		30,000	20,000
Trajtime me VKM					30,000		30,000	30,000
Pagesat e shërbimeve PPP					2,535,000		2,535,000	2,535,000
Rezervë				56,000		543,430	599,430	-

TOTAL	**11,128,000**	**1,548,500**	**6,639,000**	**1,574,900**	**8,032,030**	**543,430**	**29,465,860**	**29,465,860**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Tabela nr.3.3 "Fonde të financuara nga buxheti, të transferuara në spitale, viti 2022, sipas VKM nr. 43/2022"

Në mijë lekë

Nr.	Spitali	Totali		Realizimi %
		Plan progresiv	Fakt progresiv	
1	Berat	580,641	574,730	99.0%
2	Bulqize	126,460	124,530	98.5%
3	Delvine	51,090	51,034	99.9%
4	Devoll	78,875	78,756	99.8%
5	Dibër	493,833	488,919	99.0%
6	Elbasan	926,241	909,817	98.2%
7	Fier	816,041	805,871	98.8%
8	Gramsh	202,540	202,385	99.9%
9	Gjirokastër	413,946	410,506	99.2%
10	Has	74,330	74,171	99.8%
11	Kavaje	177,472	177,246	99.9%
12	Kolonje	119,670	118,434	99.0%
13	Korçë	889,797	889,289	99.9%
14	Kruje	185,270	184,800	99.7%
15	Kuçovë	102,105	101,930	99.8%
16	Kukës	458,810	452,662	98.7%
17	Kurbin	142,120	142,101	100.0%
18	Lezhe	551,787	550,658	99.8%
19	Librazhd	242,382	242,154	99.9%
20	Lushnje	423,881	419,900	99.1%
21	M. Madhe	35,836	35,236	98.3%
22	Mallakastër	68,150	67,768	99.4%
23	Mat	200,960	197,233	98.1%
24	Mirdite	164,850	164,747	99.9%
25	Peqin	53,220	52,937	99.5%
26	Përmet	133,690	133,086	99.5%
27	Pogradec	289,780	289,487	99.9%
28	Puke	159,155	158,985	99.9%
29	Sarande	357,412	357,053	99.9%
30	Skrapar	123,512	122,720	99.4%
31	Shkodër	1,057,396	1,049,478	99.3%
32	Tepelene	129,720	127,316	98.1%
33	QSUT	9,133,492	9,116,063	99.8%
34	SUOGJ "M.G."	626,071	624,482	99.7%
35	SUOGJ "K.G.	574,255	572,936	99.8%
36	SU "Sh. Ndroqi"	1,140,739	1,140,719	100.0%
37	SU "Trauma"	563,597	553,361	98.2%
38	Tropoje	181,413	181,259	99.9%
39	Vlore	913,534	911,589	99.8%
	Totali	**22,964,073**	**22,856,348**	**99.5%**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Tabela nr.3.4 "Të ardhura të realizuara në nivel DRF, për vitin 2022"

Në mijë lekë

Nr.	Drejtoritë Rajonale	Totali të ardhurave			Kontributet		Të tjera	
		Plan	Fakt	Realiz.%	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Berat	16,759	4,068	24.3%	15,759	3,489	1,000	579
2	Diber	20,040	5,470	27.3%	19,040	3,807	1,000	1,663
3	Durres	23,169	6,753	29.1%	20,169	4,445	3,000	2,308
4	Elbasan	54,605	7,480	13.7%	51,605	6,285	3,000	1,195
5	Fier	69,136	8,966	13.0%	67,136	7,792	2,000	1,174
6	Lushnje	1,500	829	55.3%	0	0	1,500	829
7	Gjirokaster	15,121	5,652	37.4%	14,321	4,936	800	716

8	Korçe	34,864	6,535	18.7%	32,864	4,561	2,000	1,974
9	Pogradec	9,745	1,757	18.0%	9,245	1,352	500	405
10	Kukes	7,329	2,109	28.8%	6,329	1,544	1,000	565
11	Tropoje	2,583	580	22.5%	2,283	533	300	47
12	Lezhe	11,922	5,166	43.3%	9,922	3,125	2,000	2,041
13	Shkoder	25,844	7,019	27.2%	21,444	4,032	4,400	2,987
14	Tirane	23,552	9,972	42.3%	11,552	3,141	12,000	6,831
15	Kamez-vore	2,000	1,534	76.7%	0	0	2,000	1,534
16	Vlore	16,917	5,683	33.6%	14,917	4,214	2,000	1,469
17	Sarande	9,914	2,770	27.9%	8,414	2,550	1,500	220
Totali (I)	**Drejtoritë Rajonale**	**345,000**	**82,343**	**23.9%**	**305,000**	**55,806**	**40,000**	**26,537**
1	Aparati	15,685,000	15,735,223	100.3%	15,625,000	15,635,761	60,000	99,462
2	DSHSU							
Totali (II)	**Aparati & DSHSU**	**15,685,000**	**15,735,223**	**100.3%**	**15,625,000**	**15,635,761**	**60,000**	**99,462**
1	Transfertë për shërbimin parësor	7,340,140	7,340,140	100.0%				
2	Transfertë për shërbimin spitalor	22,964,073	22,856,348	99.5%				
3	Transfertë pë Fondin nga Spitalori	6,501,787	6,441,482	99.1%				
Totali (III)	**Trafertave nga buxheti**	**36,806,000**	**36,637,970**	**99.5%**				
Totali (I+II+III)		**52,836,000**	**52,455,535**	**99.3%**	**15,930,000**	**15,691,567**	**100,000**	**125,998**

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i Auditimit të KLSH

Tabela anekse, PPP "Sterilizimi"

Tabela nr.3.5 "Përdorimi i seteve kirurgjikale sipas kompleksitetit dhe spitaleve për vitin 2021"

Spitalet	I lartë	I mesëm	I ulët	Total	Paketime me avull	Sterilizim. Temp te ulet
QSUT	6,509	5,623	7,088	19,220	36,345	1,786
SU "Shefqet Ndroqi"	152	59	308	519	1,237	253
SUOGJ "M Geraldine"	280	3,000	22	3,302		16
SUOGJ "Koço Gliozheni"	475	1,985	70	2,530		17
Sp.Univers Trauma	2,870	2,065	2,885	7,820	19,514	828
Shkodër	561	1,025	1,575	3,161	3,196	26
Elbasan	104	970	1,547	2,621		
Librazhd	28	289	229	546		
Gramsh	-	-	49	49		
Vlorë	187	749	762	1,698	2,797	36
Durrës	658	1,775	1,069	3,502	3,869	2
Fier	461	988	882	2,331		
Lezhë	168	568	385	1,121	1,642	
Krujë	9	33	70	112		
Berat	20	761	518	1,299	938	
Lushnje	9	315	515	839	1,888	
Kavajë				-		
Mirditë	-	13	21	34		
Dibër	90	350	338	778		
Mat	-	88	170	258	300	
Korçë	224	718	670	1,612		
Kolonjë				-		
Pogradec	-	267	126	393		
Sarandë	3	178	8	189		
Pukë	-	21	20	41		
Kukës	11	237	183	431	1,537	
Tropojë	-	-	62	62	968	
Bulqizë	-	-	7	7	24	
Gjirokastër	24	250	320	594		
Spitali Rajonal Memorial Fier	*	*	*	*	*	*
Totali	12,843	22,327	19,899	55,069	74,255	2,964

Tabela nr.3.6"Përdorimi i seteve kirurgjikale sipas kompleksitetit dhe spitaleve për vitin 2022"

Spitalet	I lartë	I mesëm	I ulët	Total	Paketime me avull	Sterilizim. Temp te ulet
QSUT	7,134	6,803	8,267	22,204	30,849	757
SU "Shefqet Ndroqi"	398	163	893	1,454	3,161	1,907
SUOGJ "M Geraldine"	359	2,970	31	3,360		38
SUOGJ "Koço Gliozheni"	486	1,956	52	2,494		25
Sp.Univers Trauma	3,231	2,009	3,374	8,614	23,914	993
Shkodër	754	1,162	2,099	4,015	4,212	2
Elbasan	173	977	1,513	2,663		
Librazhd	13	257	263	533		
Gramsh	-	3	71	74		

Vlorë	437	891	1,145	2,473	3,318	30
Durrës	763	1,578	957	3,298	3,521	10
Fier	356	919	863	2,138		1
Lezhë	304	578	477	1,359	1,856	30
Krujë	11	66	95	172	7	
Berat	23	682	587	1,292	1,202	
Lushnje	6	282	502	790	2,157	
Kavajë	-	-	3	3		
Mirditë	-	10	9	19		
Dibër	120	296	308	724		
Mat	-	10	143	153	329	
Korçë	316	609	741	1,666		4
Kolonjë				-		
Pogradec	2	206	134	342		
Sarandë	2	174	6	182		
Pukë	1	15	13	29		
Kukës	26	229	204	459	1,643	
Tropojë	1	1	58	60	737	
Bulqizë	-	-	4	4	14	
Gjirokastër	20	297	339	656		
Spitali Rajonal Memorial Fier	*	*	*	*	*	*
Totali	**14,936**	**23,143**	**23,151**	**61,230**	**76,920**	**3,797**

Tabela nr. 3.7 "Diferencat 2022/2021, në përdorimin e seteve kirurgjikale sipas kompleksitetit dhe spitaleve"

Spitalet	I lartë	I mesëm	I ulët	Total	Paketime me avull	Sterilizim. Temp te ulet
QSUT	625	1,180	1,179	2,984	(5,496)	(1,029)
SU "Shefqet Ndroqi"	246	104	585	935	1,924	1,654
SUOGJ "M Geraldine"	79	(30)	9	58	-	22
SUOGJ "Koço Gliozheni"	11	(29)	(18)	(36)	-	8
SU Trauma	361	(56)	489	794	4,400	165
Shkodër	193	137	524	854	1,016	(24)
Elbasan	69	7	(34)	42	-	-
Librazhd	(15)	(32)	34	(13)	-	-
Gramsh	-	3	22	25	-	-
Vlorë	250	142	383	775	521	(6)
Durrës	105	(197)	(112)	(204)	(348)	8
Fier	(105)	(69)	(19)	(193)	-	1
Lezhë	136	10	92	238	214	30
Krujë	2	33	25	60	7	-
Berat	3	(79)	69	(7)	264	-
Lushnje	(3)	(33)	(13)	(49)	269	-
Kavajë	-	-	3	3	-	-
Mirditë	-	(3)	(12)	(15)	-	-
Dibër	30	(54)	(30)	(54)	-	-
Mat	-	(78)	(27)	(105)	29	-
Korçë	92	(109)	71	54	-	4
Kolonjë	-	-	-	-	-	-
Pogradec	2	(61)	8	(51)	-	-
Sarandë	(1)	(4)	(2)	(7)	-	-
Pukë	1	(6)	(7)	(12)	-	-
Kukës	15	(8)	21	28	106	-
Tropojë	1	1	(4)	(2)	(231)	-
Bulqizë	-	-	(3)	(3)	(10)	-
Gjirokastër	(4)	47	19	62	-	-
Spitali Rajonal Memorial Fier	*	*	*	*	*	*
Totali	**2,093**	**816**	**3,252**	**6,161**	**2,665**	**833**

Tabela nr.3.8 "Datat e fillimit të shërbimit laboratorik në spitale"

Spitalet	Data e fillimit
QSUT	02.11.2020
SU "Shefqet Ndroqi"	25.03.2021
SU Trauma	01.04.2021
SUOGJ "Mbretëresha Geraldinë"	01.04.2021
SUOGJ "Koço Gliozheni"	01.04.2021
Berat	14.06.2021
Dibër	14.06.2022
Durrës	05.07.2021
Elbasan	12.07.2021

Fier	08.06.2021
Gjirokastër	24.01.2022
Korçë	19.07.2021
Kukës	19.09.2022
Lezhë	21.06.2021
Shkodër	02.08.2021
Vlorë	10.01.2022
Lushnjë	26.07.2021
Sarandë	21.09.2021

Burimi i të dhënave FSDKSH, punoi Grupi i auditimit të KLSH

Tabela anekse nr.3.9 "Ndryshimi në % i numrit të ekzaminimeve dhe shpenzimeve 2022/2021")

Nr.	Institucionet	Realizimi në % 2022/2021		Ndryshimi në &	
		Ekzaminime	buxhet	Ekzaminime	buxhet
1	QSUT	113.3	90.0	13.3	- 10.0
2	SUOGJ "Mbretëresha Geraldinë"	140.3	127.8	40.3	27.8
3	SUOGJ "Koço Gliozheni"	115.4	110.7	15.4	10.7
4	SU "Shefqet Ndroqi"	122.6	107.7	22.6	7.7
5	SU TRAUMA	137.3	147.1	37.3	47.1
6	Berat	194.0	146.1	94.0	46.1
7	Dibër				
8	Durrës	182.8	176.1	82.8	76.1
9	Elbasan	174.6	147.4	74.6	47.4
10	Fier	165.5	130.2	65.5	30.2
11	Gjirokastër				
12	Korçë	223.3	186.0	123.3	86.0
13	Kukës				
14	Lezhë	188.3	170.2	88.3	70.2
15	Lushnjë	206.9	178.3	106.9	78.3
16	Sarandë	411.2	186.1	311.2	86.1
17	Shkodër	230.8	214.7	130.8	114.7
18	Vlorë				
	Totali	**146.2**	**124.5**	**46.2**	**24.5**

Tabela anekese, Drejtimi nr. 4 "Vlerësimi i përputhshmërisë së aktivitetit të Drejtorisë e Kontrollit, Drejtorisë e Rimbursimit, Drejtorisë e Kujdesit Parësor dhe Spitalor si dhe të Drejtorisë e Shërbimit Spitalor Universitar lidhur me ushtrimin e kontrolleve në subjektet me kontratë me FSDKSH, testimin e rimbursimit të barnave dhe disponibilitetin e tyre në treg, realizimin e shërbimit për kontrata koncesionare dhe paketat e shërbimit shëndetësore, etj.".

Drejtimi i auditimit 4.1. "Mbi vlerësimin e përputhshmërisë së aktivitetit dhe funksionimit të sistemeve të kontrollit në Drejtorinë e Kontrollit, për vitin 2022".

Tabela nr.4.1.1 "Të dhëna mbi mbulimin me kontroll sipas numrit të subjekteve farmaceutike"

Nr.	Farmaci të kontrollura DRF Durrës		
	2020	2021	2022
1	J.	J.	J.
2	T.	L.	T.
3	A.Sh.	T.	A. Sh.
4	M.	I.	I.
5	M.	A. Xh.	A. Xh.
6		A.	E.
7		Sh.	M.
8		K.	B.Farmaci Nr. 1
9			M.
10			A.

11			M.
			S.
12			L.
13			J. C.

DRF Durrës: Nga shqyrtimi i informacionit ka rezultuar se janë përfshirë në kontroll të gjitha farmacitë me vlerë mesatare mujore rimbursimi, më të lartë.

Tabela nr.4.1.2 "Të dhëna mbi mbulimin me kontroll sipas numrit të subjekteve farmaceutike"

Nr.	Farmaci të kontrollura DRF Kamëz		
	2020	2021	2022
1	Z. AD	Z. AD	Z. AD
2	G.	F.	F.
3	Sh.	G.	Sh.
4	F.	Sh.	Y.
5	Y.	Y.	G.
6	E. 1	M.	E. 1
7		M. K.	M.
8		A. J.	

DRF Kamëz: Nga shqyrtimi i informacionit ka rezultuar se janë përfshirë në kontroll farmacitë me vlerë më të lartë të rimbursimit mesatar mujor.

Tabela nr.4.1.3 "Të dhëna mbi mbulimin me kontroll sipas numrit të subjekteve farmaceutike"

Nr.	Farmaci të kontrollura DRF Fier		
	2020	2021	2022
1		K.	V.
2		I.	K.
3		B.	I.
4		A. B.	J.P.
5		T.N.	B.
6		E. T.	A.
7		J. F.	R.
8		L.Y.	

DRF Fier: Nga shqyrtimi i informacionit ka rezultuar se janë përfshirë në kontroll farmacitë me vlerë më të lartë të rimbursimit mesatar mujor.

Tabela nr.4.1.4 "Të dhëna mbi mbulimin me kontroll sipas numrit të subjekteve farmaceutike"

Nr.	Farmaci të kontrollura DRF Tiranë		
	2020	2021	2022
1	M.	M.	M.
2	B.P.	B.P.	B. P.
3	S.P.2	S. P. 2	S. P.2
4	J.	N.	G.L.
5	N.	J.	J.
6	G. Lo.	G.L.	N.
7	T. m.	T.m.	K. F.
8	K. f.	K.F.	T.m.
9	C.	B.	N.
10	R.Ph.	J. f.	C.
11	E.	C.	R. Ph.
12	B.	D.	Ph.V.
13	R.	E.	E.
14	F. F.	E.	R.
15	N.	N.	F. Ph.
16	E.	J.	B.
17	D.	Ph.V.	D.
18	F.	R.Ph.	J. f.

19	J. f.	R.	L.
20	S.	F. Ph.	S.
21	L.	S.	J.
22	F.	L.	F. I.
23	I.	F. I.	A.
24	J.	Sh.	E.
25		E. F.	
26		F.	
27		Ë.Ph.	
28		L.	
29		I.	
30		E.	
31		F.	
32		G.	

DRF Tiranë: Nga shqyrtimi i informacionit ka rezultuar se janë përfshirë në kontroll farmacitë me vlerë më të lartë të rimbursimit mesatar mujor.

Tabela nr.4.1.5 "Të dhëna mbi mbulimin me kontroll sipas numrit të subjekteve farmaceutike"

	Farmaci të kontrollura DRF Berat		
Nr.	**2020**	**2021**	**2022**
1		L.	L.
2		K.	K.
3		B.	H.
4		P.J.	B.
5		L.	P. J.
6		T.	T.
7		M.	M.
8			L.

DRF Fier: Nga shqyrtimi i informacionit ka rezultuar se janë përfshirë në kontroll farmacitë me vlerë më të lartë të rimbursimit mesatar mujor.

Tabela nr.4.1.6 "Të dhëna mbi mbulimin me kontroll sipas numrit të subjekteve farmaceutike"

	Farmaci të kontrollura DRF Tropojë		
Nr.	**2020**	**2021**	**2022**
1		N.	L.
2		D.	N.

DRF Tropojë: Nga shqyrtimi i informacionit ka rezultuar se janë përfshirë në kontroll farmacitë me vlerë më të lartë të rimbursimit mesatar mujor.

Tabela nr.4.1.7 "Të dhëna mbi mbulimin me kontroll sipas numrit të subjekteve farmaceutike"

	Farmaci të kontrollura DRF Pogradec		
Nr.	**2020**	**2021**	**2022**
1		M. C.	M. C.
2		D. N.	D. N.
3		A.	A.
4			E. R.

DRF Pogradec: Nga shqyrtimi i informacionit ka rezultuar se janë përfshirë në kontroll farmacitë me vlerë më të lartë të rimbursimit mesatar mujor.

Tabela nr.4.1.8 "Të dhëna mbi mbulimin me kontroll sipas numrit të subjekteve farmaceutike"

	Farmaci të kontrollura DRF Dibër		
Nr.	**2020**	**2021**	**2022**
1	R.	D.	D.
2	D.	R.	R.
3	N.	N.	F.
4	M.	F.	N.

5	C.	M.	M.
6	F.		
7	K.		

DRF Dibër: Nga shqyrtimi i informacionit ka rezultuar se janë përfshirë në kontroll farmacitë me vlerë më të lartë të rimbursimit mesatar mujor.

Tabela nr.4.1.9 "Të dhëna mbi mbulimin me kontroll sipas numrit të subjekteve farmaceutike"

	Farmaci të kontrollura DRF Shkodër		
Nr.	**2020**	**2021**	**2022**
1	T. K.	T.& K.	B.
2	B.	Ph.	T.K.
3	Ll. F.	B.	Ph.
4	J.	J.	J.
5	G.SHPK		D. H.
6	E.		B. HB
7	G. SHPK		S.
8			G.

DRF Shkodër: Nga shqyrtimi i informacionit ka rezultuar se janë përfshirë në kontroll farmacitë me vlerë më të lartë të rimbursimit mesatar mujor.

Tabela nr.4.1.10 "Të dhëna mbi mbulimin me kontroll sipas numrit të subjekteve farmaceutike"

	Farmaci të kontrollura DRF Lezhë		
Nr.	**2020**	**2021**	**2022**
1	J.	J.	J.
2	R.	R.	R.
3	N.	B.	B.
4	M.	N.	L.
5	Gj.	L.	S. M.
6	S. M.		

DRF Lezhë: Nga shqyrtimi i informacionit ka rezultuar se janë përfshirë në kontroll farmacitë me vlerë më të lartë të rimbursimit mesatar mujor.

Tabela nr.4.1.11 "Të dhëna mbi mbulimin me kontroll sipas numrit të subjekteve farmaceutike"

	Farmaci të kontrollura Lushnjë		
Nr.	**2020**	**2021**	**2022**
1	A. N.	A.N.	A. N.
2	K.	P. V.	I.P.2
3	D.	I. P.2	P. V.
4	J.	J.	J.
5	N.		L.
6	P. Vo.		
7	A.		
8	A. M.		
9	D.P.		
10	P.		

DRF Lushnjë: Nga shqyrtimi i informacionit ka rezultuar se janë përfshirë në kontroll farmacitë me vlerë më të lartë të rimbursimit mesatar mujor.

<u>Tabela anekse Drejtimi nr. 4.2</u> "Për auditimin aktivitetit të Drejtorisë së Rimbursimit në lidhje me zbatimin e skemës së sigurimit për hartimin e listës së barnave, hartimin e kontratave".

Tabela nr. 4.2.1 “Sëmundjet rimbursimi 2022/2021”

Nr.	Kategoria	Rimbursim Viti 2022 (000/Lekë)	Rimbursim Viti 2021 (000/Lekë)	
1	Femijë 0-12 muajsh	342	380	- 38
2	**Invalid i plotë**	**1,956,749**	**1,947,238**	**9,511**
3	Invalid i pjesshëm	2,071	2,212	- 141
4	Invalid lufte	345	608	- 263
7	Veteran	28,131	40,718	- 12,587
9	**Pensionist pa afat**	**5,120,030**	**5,008,260**	**111,770**
11	Paaftë mendërisht ose fizikisht	114,888	156,447	- 41,559
12	Leje lindje/ Raport Mjekësor	457	79	378
17	Jetim	1	0	1
18	Sigurim vullnetar	153	152	1
20	I verbër	7,855	10,071	- 2,216
21	IEVP	12,615	11,180	1,435
22	**Pension social**	**88,760**	**79,054**	**9,706**
25	Student 18-25 vjeç	453	389	64
26	Ndihmë ekonomike	9,864	10,836	- 972
27	Grua shtatzënë	335	242	93
28	Azilkërkues	7,873	12,111	- 4,238
30	I punësuar	34,589	45,195	- 10,606
31	I vetëpunësuar	3,285	3,251	34
33	Femijë 1-18 vjeç	239,418	273,481	- 34,063
34	I papunë/punëkërkues	3,527	5,311	- 1,784
35	Të përndjekur politikë	624	564	60
36	Pension me afat	2,621	2,588	33
37	Përfitues të tjerë nga ISSH	214	145	69
38	Anëtar i papaguar i familjes	65	133	- 68
39	I vetëpunësuar në bujqësi	200	126	74
41	Invalid i pjesshëm jashtë kategorie	381	385	- 4
45	**Sëmundje Kronike**	**3,849,296**	**3,416,217**	**433,079**
46	**Invalid/Tetraplegjik**	**7,805**	**5,687**	**2,118**
47	Persona të diagnostikuar me Sars-Cov-2	3,940	28,122	- 24,182
	TOTAL	11,496,887	11,061,181	435,706

Tabela nr. 4.2.2 “Krahasimi i konsumit të barnave të vetëdeklaruara, që mungojnë nga importuesit për vitet 2021-2022 ”

Emri Tregtar	2022			2021			diferenca (22-21)		
	sasia	Rimbursim(lekë)	receta	sasia	Rimbursim(lekë)	receta	sasia	Rimbursim(lekë)	receta
Cellcept	30	1,077	1	19,370	698,703	83	-19,340	-697,626	-82
Duphalac	8,839	3,612,654	4,088	7,502	1,940,751	3,538	1,337	1,671,903	550
Klacid	69	44,908	69	156	101,660	153	-87	-56,752	-84
Fludara Oral	862	1,441,329	37	3,755	6,250,098	132	-2,893	-4,808,769	-95
Zytiga	9,480	28,326,623	71	51,000	151,703,720	367	-41,520	-123,377,098	-296
Mesaflor	9,230	186,650	34	147,905	3,377,879	693	-138,675	-3,191,230	-659
Agnis Plus	4,950	275,486	150	7,530	465,669	210	-2,580	-190,183	-60
Fromilid	239	3,780	12	475	7,335	28	-236	-3,555	-16
Insuman Rapid Solostar	326,886	163,412,280	53,378	354,573	177,728,610	60,745	-27,687	-14,316,330	-7,367
Ëarfarin 1mg	35,597	437,122	625	47,065	580,335	818	-11,468	-143,213	-193
Pronipin	1,905,303	5,534,096	26,113	2046748	5894437.19	27926	-141,445	-360,341	-1,813
Nifelat R	724,245	2,104,316	9,388	508,965	1,467,157	6,809	215,280	637,159	2,579
Tritace	398,389	4,796,531	8,272	289,486	2,777,648	6,199	108,903	2,018,883	2,073

Tritace	98,425	1,225,104	1,925	82,034	913,906	1,634	16,391	311,197	291
Lipanor	896,160	12,934,219	17,425	879,420	12,711,979	17,460	16,740	222,240	-35
Pegasys	708	3,516,368	153	1,632	8,205,540	386	-924	-4,689,172	-233
Actemra	736	15,039,051	99	928	19,099,308	120	-192	-4,060,256	-21
Haloperidol	187,564	37,458,584	16,720	183,512	36,670,410	16,836	4,052	788,174	-116
Haldol Depo	28,468	7,990,068	9,657	35,100	10,000,242	12,167	-6,632	-2,010,174	-2,510
Fevarin	688,109	19,087,187	14,883	647,245	18,010,706	14,884	40,864	1,076,481	-1
Resata	5,140	3,589,278	3,022	10,891	7,821,344	6,482	-5,751	-4,232,066	-3,460
Denerel	51,899	199,895	773	58,637	227,329	889	-6,738	-27,434	-116
Galvus Met	1,770	154,582	43	3,510	367,198	78	-1,740	-212,616	-35
Tansulosina Reliva	1,110,099	7,847,191	21,270	1,195,788	8,473,263	23,580	-85,689	-626,072	-2,310
Fluticapen	3,441	3,617,799	2,090	4,331	4,566,392	2,710	-890	-948,593	-620
Acetozolamide	20,482	501,943	402	5,400	133,650	116	15,082	368,293	286
Totali	**6,517,120**	**323,338,119**	**190,700**	**6,592,958**	**480,195,269**	**205,043**	**-75,838**	**-156,857,151**	**-14,343**

Burimi i të dhënave: FSDKSH, Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Tabela nr. 4.2.3 "Të dhënat në lidhje me rimbursimin e barnave të deklaruara si mungesë nga importuesit për vitin 2022"

Klasa	Grupi	Emri Tregtar	Firma	Sasia	Rimbursim	Receta	Pacienë_erx [12]	Mungesa [13]
L	Imunosupresivet	Cellcept	R	30	1,077	1	1	**11**
A	Laksativet	Duphalac	M	8,839	3,612,654	4,088	758	**6**
J	Antibakterialet sistemik	Klacid	M	69	44,908	69	66	**5**
L	Antineoplaziket	Fludara Oral	G	862	1,441,329	37	21	**5**
L	Barna ne terapine endokrine	Zytiga	J	9,480	28,326,623	71	34	**4**
A	Antidiareiket, antiinflamatoret dhe antiseptiket intestinal	Mesaflor	S	9,230	186,650	34	19	**2**
A	Antidiabetiket	Agnis Plus	F	4,950	275,486	150	13	**2**
J	Antibakterialet sistemik	Fromilid	K	239	3,780	12	12	**2**
A	Antidiabetiket	Insuman Rapid Solostar	S	326,886	163,412,280	53,378	10,380	**1**
A	Antidiabetiket	Galvus Met	N	1,770	154,582	43	18	**1**
B	Antikoagulantet	Ëarfarin 1mg	B	35,597	437,122	625	229	**1**
C	Kalcibllokuesit	Pronipin	P	1,905,303	5,534,096	26,113	5,983	**1**
C	Kalcibllokuesit	Nifelat R	R	724,245	2,104,316	9,388	3,335	**1**
C	Barnat vepruese ne sistemin renin - angiotensin	Tritace	S	398,389	4,796,531	8,272	1,915	**1**
C	Barnat vepruese ne sistemin renin - angiotensin	Tritace	S	98,425	1,225,104	1,925	430	**1**
C	Reduktuesit e lipideve ne gjak	Lipanor	S	896,160	12,934,219	17,425	4,576	**1**
L	Barna ne terapine endokrine	Pegasys	R	708	3,516,368	153	32	**1**
L	Imunosupresivet	Actemra	R	736	15,039,051	99	20	**1**
N	Psikoleptiket	Haloperidol	P	187,564	37,458,584	16,720	3,432	**1**
N	Psikoleptiket	Haldol Depo	K	28,468	7,990,068	9,657	2,169	**1**
N	Psikoanaleptiket	Fevarin	M	688,109	19,087,187	14,883	2,917	**1**
R	Preparatet nazale	Resata	R	5,140	3,589,278	3,022	2,064	**1**
R	Antiasmatiket	Fluticapen	E	3,441	3,617,799	2,090	701	**1**
R	Antihistaminiket sistemike	Denerel	M	51,899	199,895	773	196	**1**
S	Barnat ophtalmike	Acetozolamide	R	20,482	501,943	402	103	**1**

[12] Pacientë, që rimbursohen më anë të recetave elektronike. Vetëm pacientët e kategorisë IEVP nuk kanë receta elektronike.

[13] Herë deklarimi mungesë, nga vetedeklarimi i importuesve (Sipas Analizave mujore të disponibilitetit të barnave)

G	Urologjiket	Tansulosi na Reliva	P	1,110,099	7,847,191	21,270	7,419	**1**

Burimi i të dhënave: FSDKSH, Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Për sa më sipër, është hartuar Raporti përfundmitar i Auditimit.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT